

# ENVER HOXHA

VEPRA

51



**PROLETARE TË TË GJITHA VENDEVE, BASHKOHUNI!**

# **ENVER HOXHA**

**VEPRA**

BOTOHET ME VENDIM TË KOMITETIT  
QENDROR TË PARTISË SË PUNËS TË  
SHQIPËRISË



**ENVER HOXHA**



INSTITUTI I STUDIMEVE MARKSISTE-LENINISTE  
PRANË KQ TË PPSH

# ENVER HOXHA

V E L L I M I

51

MAJ 1973 – QERSHOR 1973

SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»  
TIRANË, 1986



## PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 51-TË

Vëllimi i 51-të i Veprave të shokut Enver Hoxha përmbledh materiale të periudhës maj-qershor 1973, pjesa më e madhe e të cilave botohen për herë të parë.

Në veprat e kësaj periudhe shoku Enver Hoxha thekson edhe një herë nevojën e zbatimit të direktivave që shtron Partia, sipas problemeve dhe detyrave që dikton koha, thekson domosdoshmërinë e forcimit të punës udhëheqëse e organizuese të organizatave të Partisë për t'i zbërthyer e analizuar në mënyrë shkencore këto direktiva dhe për të mobilizuar masat për zbatimin e tyre. Në këtë kuadër, tërhiqet vëmendja se në themel të punës e të jetës së Partisë qëndron zbatimi i parimeve dhe i normave leniniste të saj.

Tipar dallues i materialeve që botohen në këtë vëllim është pikërisht mbrojtja dhe zbatimi i këtyre parimeve dhe normave, në luftë kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre. Kësaj periudhe i përket mbledhja e Plenumit të 4-t të Komitetit Qendror të Partisë, në të cilën shoku Enver Hoxha mbajti raportin «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre», si dhe fjalën e mbylljes në këtë Plenum, ku analizoi në thellësi e gjerësi mjaft probleme të karakterit ideologjik, duke shpjeguar shkaqet e lindjes së qën-

drimeve liberale, burimin e tyre ideologjik, rrezikshmërinë që paraqesin dhe luftën frontale që duhet zhvilluar kundër tyre.

Lufta kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, theksohet në vëllim, është një luftë komplekse dhe reale që lidhet me gjithë qëndrimin dhe aktivitetin e njerëzve në punë, në shoqëri, në familje, ajo shprehet në mënyrën e jetesës, në shijet dhe sjelljet e tyre. Si e tillë ajo angazhon në vetvete gjithë masat e popullit, por, në radhë të parë, shtron kërkesa dhe detyra të mëdha para organizatave dhe organeve të Partisë, përpara çdo komunisti për të forcuar frymën revolucionare dhe qëndrimin revolucionar në çdo hap të jetës. «Ideali revolucionar komunist është një dhe i vetëm dhe ai na udhëheq në gjithë veprimtarinë e jetën tonë», — thotë shoku Enver Hoxha, prandaj organizatat e Partisë luftojnë për të formuar e rrënjosur te njerëzit tanë koncepte të drejta revolucionare për demokracinë, për emancipimin e njerëzve e sidomos të grave, për raportin midis të drejtave dhe detyrave, midis lirisë së personit dhe disiplinës shoqërore. Lufta e Partisë dhe kujdesi i vazhdueshëm për edukimin revolucionar të njerëzve tanë e veçanërisht të brezit të ri lidhet me fatet e revolucionit në vendin tonë, me të tashmen dhe të ardhmen e Shqipërisë socialiste. Ajo përbën, gjithashtu, një garanci për zhvillimin normal të jetës së shoqërisë shqiptare, të pastër e vitale, larg ndikimit shturës reaksionar e regresit borgjezo-revizionist.

Si rezultat i presionit ideologjik borgjezo-revizionist dhe i qëndrimeve armiqësore e antiparti të

F. Paçramit e T. Lubonjës, në atë periudhë u vunë re qëndrime jo të drejta në fushën e letërsisë dhe të arteve, qëndrime që binin ndesh me parimin bazë të metodës së realizmit socialist, partishmërinë proletare. Këto qëndrime u shprehën edhe në krijimtari, edhe në mendimin kritik e shkencor letrar. Në këtë terren u shfaqën ndikime në poezi e pikturë, në dramë e muzikë. U vunë re largime nga krijimtaria popullore dhe një qëndrim përçmues ndaj kësaj, largim nga temat epike drejt lirikës intime. Rol në këtë proces luajtën edhe paqartësi në mendimin kritik letrar-artistik që nxitnin luftën midis krijuesve «të rinj» e «të vjetër», që prishnin atmosferën krijuese, që mundoheshin të përlligjin ndikimet e huaja e qëndrimet liberale ndaj tyre në këto fusha.

Duke analizuar këto dukuri, shoku Enver Hoxha argumenton se qëndrime të tilla vijnë si rezultat i largimit nga orientimet e Partisë për këto probleme, nga moszbatimi i direktivave të saj. Vijnë, gjithashtu, si rezultat i mangësive në formimin ideoestetik të disa punonjësve të artit. Këto mangësi në formimin botëkuptimor të krijuesit bëhen shkak për t'u gënjyer nga forma boshe, për të ngatërruar modernen me modernisten, novatoren me izmat, traditën me konservatoren etj.

Me trajtimin marksist-leninist që u bëri probleme të raportit dialektik midis novatorizmit dhe traditës, përmbajtjes dhe formës, folklorit dhe artit të kultivuar, temës epike dhe asaj lirike, si dhe rolit që duhet të luajë në këto fusha «kritika shkencore e kualifikuar» që të ketë «brenda edhe patosin e domosdo-

lidhje me Vasilin dhe njëri prej tyre më thotë se kishte pasur muhabet me të dhe në bisedat që bënin, Vasili fliste me urrejtje kundër fashizmit. Këto ndjenja e shtynë atë të qëllonte kundër mbretit okupator.

Brez pas brezi Partia do t'i mësojë të rinjtë dhe të rejat tona me dashuri dhe me respekt të thellë për të gjithë ata që derdhën gjakun e tyre për lirinë e atdheut; do t'u shpjegojë përse e derdhën gjakun, do t'i frymëzojë që të mësojnë nga heroizmi dhe nga vendosmëria e heronjve dhe e dëshmorëve, se si atyre vdekja u është dukur e ëmbël, se si edhe Vasili, një djalë i ri i dalë nga populli, u hodh nërpara milicëve me kobure në dorë dhe shtiu mbi mbretin armik. Pse e bëri ai këtë? E bëri që populli të gëzonte të gjitha këto të mira që gëzon sot, për këto fusha të bukura, për uzinat, fabrikat, rrugët, hekurudhat, për hidrocentralet, shkollat e spitalet që po ndërtojmë vazhdimisht me gjak dhe me djersë, që populli të rrojë i lirë dhe i lumtur.

Të rinjtë tanë, vajzat dhe djemtë, të mos kujtojnë se këto të mira që gëzojmë sot kanë rënë nga qielli. Jo, në tabanin e tyre janë sakrificat dhe gjaku i popullit. Prandaj nuk duhet të na zërë gjumi, po të punojmë që fitoret t'i ruajmë e t'i mbrojmë nga çdo rrezik, se armiku, beu, agai, kulaku përgjojnë. Ata tani nuk dalin dot hapur, por, po na panë të flemë gjumë, nuk presin, na goditin, na futin thikën. Prandaj kurdoherë të jemi vigjilentë, jo vetëm ne, por edhe brezat e ardhshëm. Këtë mësim t'ua ngulim mirë në mendje çdo ditë të rinjve e të rejave, të gjithë njerëzve tanë, këtë ata duhet të mos e harrojnë kurrë.

Pashë sot varrezat e dëshmorëve këtu në Durrës,

të cilat janë ndërtuar shumë bukur, por populli ato akoma më mirë do t'i qëndisë me mermer, se janë vendet më të shtrenjta për ne dhe kushdo që do të shkojë atje të mendojë, të kujtojë të kaluarën dhe t'i shtohen forcat për të punuar gjithnjë më mirë, që atdheu të bëhet i fortë, i bukur, i pasur dhe i pathyeshëm.

Ke qenë në Piqeras, nënë Vitori?

**NËNË VITORIA:** Po, kam qenë. Atje kanë ngritur edhe një muze.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Në qoftë se keni ndonjë kujtim nga të Vasilit, ndonjë libër, ndonjë veshje të tij apo ndonjë send tjetër na i thoni që t'ua dërgojmë, në mënyrë që muzeu i Piqerasit të pasurohet me to.

**NËNË VITORIA:** Librat i kishte shumë qejf Vasili i nënës, nuk i hiqte nga duart, po gjëra të tjera nuk kishte, se ishim fukarenj, mezi siguronim bukën. Vasili vetë ka qenë djalë i urtë, nuk i dëgjohej zëri.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Juve, nëna e Vasilit dhe motra e tij, duhet t'ju kujtohen ngjarjet e së kaluarës, kur Vasili ishte i vogël, për shembull, kur ai ju kërkonte ndonjë kokërr ulli apo ndonjë kokërr qepë për të ngrënë atë copë të vogël buke apo ndonjë gjë tjetër që s'kishit t'ia jepnit. Të gjitha këto duhet t'ia tregoni brezit të ri, sepse sot djemtë dhe vajzat që ka rritur Partia i kanë trapezat të shtruara plot me të mira. Për këtë dhanë jetën e me gjakun e tyre sollën këto ditë të bukura ata që për vete qenë rritur me bukë thatë e me fije preshi. Të gjitha të shkruhen që t'i dinë jo vetëm djemtë dhe vajzat e sotme, po dhe brezat që do të vijnë. Duhet të kemi të qartë se Partia dhe shokët që u vranë

i bënë këto sakrificat për të krijuar një gjendje sa më të mirë për popullin, që jeta e tij të bëhet kurdoherë e më e lumtur.

**NËNË VITORIA:** Te ne sot ka ardhur Dielli i Shqipërisë, që ndriçon gjithë vendin tonë, në të katër anët. Për festën e 1 Majit të pashë në televizor dhe u kënaqa duke të parë, të marrsha të keqen nëna!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mos dukeshat si i plakur?

**NËNË VITORIA:** Dukeshe si drita. Të na rrosh sa malet!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sa vjeç je zotrote?

**NËNË VITORIA:** 76 vjeç.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Do të rrosh akoma edhe shumë, se ju nga Bregu i Detit rroni shumë.

Bregu është bërë tani shumë i bukur dhe akoma më i bukur do të bëhet. Nuk do të kalojë shumë kohë dhe atje do të ketë ullinj me bollëk, po kështu edhe portokalle e limona. Rinia ka ndërtuar tarraca në male. Atje tani çdo gjë po lulëzon. Kur të mbarojë muzeu i fshatit, duhet të shkoni atje që ta shikoni, sidomos ti, motra e Vasilit, që je më e re, se nëna ndoshta s'leviz dot dhe lodhet.

Kur të vini atje, vini në muze edhe fotografitë tuaja, të të gjithë pjesëtarëve të familjes së kohës kur rronte Vasili, edhe të plakut. Ky është!

**SHOQJA EFTIQIA ZAHO:** Po, babai ynë. Ka qenë marinar. Edhe ai ka mbytur një vapor italian. Urrejtjen kundër pushtuesve ne e kemi pasur traditë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ja, të gjitha këto gjëra

duhet t'i thoni dhe të jenë të shkruara në muzeun e Piqerasit.

Tani të më falni të ngrihem, se do të shkojmë edhe gjetkë. Ky takim për mua do të mbetet i paharruar. Ti, nënë e Vasilit, të mbahesh e fortë, të jesh kryelartë për djalin tënd, për birin e popullit dhe shokun tonë të luftës, Vasil Laçin. Ne do ta kujtojmë kurdoherë atë me mirënjohje!

Tani të bëjmë një fotografi këtu te dera, njërën nga të cilat do të ta dërgojmë ty, nënë Vitori dhe tjetrën do ta mbaj unë. Të dy do t'i vëmë ato në dhomat ku rrimë, që të kujtojmë njëri-tjetrin. Kur ta shikoj unë këtë fotografi do të mendoj se edhe nënë Vitoria po e shikon fotografinë time e do të na duket sikur flasim me njëri-tjetrin siç jemi këtu. Le të përqafohemi edhe një herë, e dashur, nënë Vitori. Qofshi mirë! Të mbaheni e fortë, pleqëri të bardhë! Mirupafshim!

Lavdi dëshmorëve! Lavdi kujtimit të Vasil Laçit që do të rrojë në shekuj në kujtesën e popullit shqiptar! Paç pleqëri të bardhë, nëna e Vasilit! Të të rrojnë çupat e mbesat. Paçi gjithnjë shëndet!

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Për ju pionierë», f. 112*

*Botohet sipas shënimeve të  
mbajtura në këtë takim, që  
gjenden në AQP*

## ADEM REKA MBI ÇDO GJË VINTE INTERESIN E PËRGJITHSIËM

*Nga biseda në familjen e Heroit  
të Punës Socialiste Adem Reka*

5 maj 1973

*Në rrugë dhe përpara shtëpisë së familjes së heroit Adem Reka kishin dalë për ta pritur udhëheqësin e dashur të Partisë dhe të popullit qindra punonjës dhe banorë të lagjes, të cilët e shoqëruan me duartrokitje dhe brohoritje entuziaste.*

*Në shtëpi shokun Enver e pritën e shoqja e Ademit, Ismetja, dhe motra e këtij, Fitnetja.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni me shëndet, ju vetë dhe fëmijët?

**SHOQJA ISMETE REKA:** Mirë jemi, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** U thashë dje shokëve të rrethit se kisha dëshirë të vija sot t'ju bëja një vizitë këtu, në shtëpi, juve, bashkëshortes së Adem Rekës, se ju jam borxhli që nuk kam ardhur dot deri tani. Ademin unë kurdoherë e kam pasur në zemër, ai është në çdo çast i pranishëm në punën tonë. Ai ka qenë dhe do të mbetet një hero për Partinë, për popullin, për rininë,



për brezat e ardhshëm, për të gjithë, sepse, me shembullin e tij të lartë, na frymëzon se si duhet të qëndrojmë dhe të luftojmë komunisti në ndërtimin e socializmit, si duhet të mbrojmë pronën e përbashkët. Adem Reka mbi çdo gjë vinte interesin e përgjithshëm. Ai e zbatonte plotësisht këtë direktivë të madhe të Partisë, pa marrë parasysh asnjë sakrificë, bile as jetën e tij. Këtu qëndron vlera e madhe e aktit heroik të Adem Rekës dhe e bindjes së tij për të zbatuar me çdo kusht e në çdo situatë direktivat e Partisë. Prandaj puna e Ademit, lufta dhe shembulli i tij, mbeten si një simbol i lartë frymëzimi, një shembull i madh për shokët, për popullin dhe për rininë. Me humbjen e Ademit ne humbëm shokun tonë, ju humbët shokun e jetës dhe babanë e fëmijëve, megjithatë duhet të qëndrosh e fortë, se ai ra për një çështje të madhe dhe do të mbetet i paharruar.

*SHOQJA ISMETE REKA:* Mundohem që edhe fëmijët t'i rrit e t'i edukoj me frymën e shëndoshë të Partisë, që të bëhen si i ati.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të gjithë duhet t'i edukojmë fëmijët tanë me frymën e Partisë, në shembullin e Ademit dhe të gjithë atyre që dhanë jetën për çështjen e madhe të Partisë dhe të popullit.

Ka nja dy-tri ditë që pamë në televizor filmin që i kushtohet jetës dhe aktit heroik të Ademit. E kisha parë atë film edhe tri ose katër herë të tjera, por gjithnjë kur e shikoj më pëlqen shumë. Në film tregohet se si Ademi ngrihet në mëngjes, lë familjen, në atë ditë furtune, çon djalin në kopsht dhe niset për të shpëtuar bigën, ku edhe bie në krye të detyrës. Sandër Prosi luan bukur rolin që i kanë caktuar. Edhe artisti që luan

rolin e Ademit, luan mirë. Kur pashë filmin isha bashkë me fëmijët në shtëpi dhe u thashë atyre: «Shikoni si jetoi, si punoi dhe si luftoi Adem Reka, tamam si një revolucionar i vërtetë, prandaj shembulli i tij të vlejë në jetë dhe në punë, si për ju dhe për gjithë rininë tonë». Djalini<sup>1</sup> tim të madh, që punon këtu, në Durrës, e këshilloj gjithnjë të jetë i fortë dhe i vendosur në mbrojtjen e pronës socialiste ashtu si Ademi. Fëmijët e Ademit do të rriten e do të edukohen nga Partia dhe do të bëhen punëtorë të mirë.

Po fëmijët ku janë?

**SHOQJA ISMETE REKA:** Vajza e madhe vazhdon shkollën e mesme të gjuhëve të huaja në Tiranë, ku studion për gjuhën angleze, vajza e dytë është në vitin e parë të shkollës së mesme të përgjithshme, kurse tjetra në klasën e gjashtë. Dy djemtë janë më të vegjël, ata janë akoma në fillore.

Me rastin e ditëlindjes suaj, shoku Enver, vajza e madhe ju ka ardhur për urim në shtëpi. Ja ku ka dalë edhe në fotografi me ju dhe me gjithë grupin e të rinjve që ju erdhën atë ditë për urim.

**SHOKU ENVER HIOXHA:** (*Duke parë fotografinë.*)  
Po, më kujtohet.

Është e drejtë dhe e nevojshme që gjuhët e huaja të studiohen në shkollat tona. Nxënësit që mësojnë në këto shkolla, nesër do të dalin mësues e do të mësojnë nxënës të tjerë. Për të kryer mirë detyrën, për t'i mësuar mirë nxënësit e ardhshëm, ata vetë, në radhë të

---

1. Ilir Hoxha, në atë kohë inxhinier në Uzinën Mekanike Bujqësore.

parë, duhet të studiojnë shumë dhe ta njohin mirë gjuhën e huaj për të cilën po përgatiten. Kështu nxënësit e tyre do të shfrytëzojnë sa më mirë literaturë tekniko-shkencore në gjuhë të huaj.

Ke ruajtur kujtime të Ademit ti, Ismete, çfarë ka pasur ai: gazeta, revista, rroba e sende të tjera personale të tij? Të mos i prishësh ato në asnjë mënyrë për t'ua bërë fëmijëve, këtyre mund t'u bëjmë lehtë rroba të tjera. Kurse sendet e Ademit ruaji që t'u shërbejnë të gjithëve, sidomos rinisë, se ato tani, e sidomos në të ardhmen, do të kenë një vlerë shumë të madhe.

Me shtëpi si jeni?

*SHOQJA ISMETE REKA:* Mirë jeni, shoku Enver, kemi dy dhoma e një kuzhinë dhe shokët na mbajnë afër, sidomos shokët e Partisë e të pushtetit në rreth, shokët e portit e të tjerë. Ju faleminderit shumë të gjithëve, i faleminderit, në radhë të parë, Partisë dhe juve, shoku Enver, që kujdeseni për mua e për fëmijët.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Partia bën punë të madhe për edukimin e brezit të ri, po kështu të rinjtë edukohen edhe nga organizatat e nga kolektivat ku punojnë e mësojnë, si edhe nga familjet. Po ka disa prindër që humbasin kontrollin mbi fëmijët dhe tregohen të pavëmendshëm ndaj tyre, ose ka raste që disa mësues e pedagogë nuk kujdesen sa duhet e si duhet për rininë. Mirëpo Partia këta i vuri përpara përgjegjësisë dhe gjendja ka ndryshuar.

Me Iljazin keni të bëni?

*SHOQJA ISMETE REKA:* Po, shoku Enver, Iljazi me Ademin janë kushërinj të parë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* U gëzova shumë që er-

dha këtu e që u takova me ju. Tani më duket sikur u takova me Ademin, megjithëqë nuk isha takuar ndonjëherë me të. Në port mund që edhe jemi takuar e jemi parë, se unë atje kam shkuar dy ose tri herë, sigurisht kur isha më i ri.

Ti Haki, je shoku i Ademit, si je me shëndet?

*SHOKU HAKI DIKA:* Mirë, shoku Enver, faleminderit.

*SHOKU ILJAZ REKA:* Shokët e Ademit e kanë bërë zakon, shoku Enver, që çdo 5 Maj t'i vijnë rregullisht në shtëpi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë mirë bëjnë. Bigën e tyre e kam parë. Ti, Haki, mos u ndaj prej saj, gjersa të të punojnë mendja, këmbët dhe duart.

Më vjen shumë keq që sot nuk i gjeta këtu fëmijët, por do të kem rast t'i takoj.

Qofshi kurdoherë të gëzuara e të lumtura me gjithë fëmijët! Kujtimi i Ademit qoftë i përjetshëm!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## TË TRE DO TË MBETEN PISHTARË TË PASHUAR

*Nga biseda në familjen e tre vëllezërve dëshmorë  
Thanasi*

**5 maj 1973**

*Shoku Enver Hoxha bëri një vizitë në shtëpinë e Evridhiqi dhe Pirro Thanasit, motrës dhe vëllait të tre vëllezërve dëshmorë nga Kavaja, Vangjel, Naun dhe Jani Thanasi, ku u prit me dashuri nga pjesëtarët e familjes, me të cilët zhvilloi një bisedë të ngrohtë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë se ju gjeta! U gëzova shumë që erdha këtu te ju, në shtëpinë e tre vëllezërve dëshmorë, që luftuan e dhanë jetën për popullin, për çështjen e Partisë, për këto ditë të lumtura që gëzon sot populli ynë. Veprën e tyre ne nuk do ta harrojmë kurrë, ata do të kujtohen brez pas brezi nga populli e Shqipëria, se bënë sakrificën më të madhe, dhanë jetën për lirinë e atdheut.

Siç thoshte e thotë vazhdimisht Partia, pa sakrifica nuk mund të fitohej liria, nuk mund të ndërtohej socializmi, nuk mund të sigurohej mirëqenia e popullit, e kalamanëve dhe jona, nuk mund të ndërtoheshin shtëpitë e banimit, uzinat e fabrikat, hidrocentralet, rrugët

e hekurudhat, shkollat ku shkojnë sot gjithë këta të rinj e të reja për t'i shërbyer sa më shumë atdheut, nuk mund të ngrihej një bujqësi e përparuar e moderne e të rritet një fshatarësi e tillë e mrekullueshme si kjo jona. Pra, pa gjakun e dëshmorëve populli nuk do të kishte të gjitha këto të mira që gëzon sot, prandaj ai u është mirënjohës atyre dhe familjeve që i lindën, i rritën dhe i edukuan me një patriotizëm të zjarrtë. Nga edukata patriotike e prindërve dhe e familjeve varet shumë një pjesë e konsiderueshme e formimit të rinisë me dashuri të madhe për atdheun dhe popullin. Kështu si vëllezërit tuaj të paharruar, ishin edukuar me mijëra djem e vajza të vendit, të cilët, me t'u bërë thirrje Partia, rrëmbyen armët dhe luftuan me trimëri, pa marrë parasysh asnjë sakrificë. Ishte kjo vendosmëri e ky patriotizëm i rrallë, ishte gjaku i 28 mijë dëshmorëve që dhanë jetën për liri e socializëm që sollën këto ditë të lumtura për popullin.

5 Maji te ne është Dita e Dëshmorëve. Për ne kjo është dita e atyre që nuk vdesin kurrë, pse ata, sa të jetë jeta, do të mbeten gjallë në zemrat e popullit. Shumë prej nesh, kush më shumë e kush më pak, luftuam e sakrifikuam për atdheun e për popullin, punuam dhe po punojmë. por ata që dhanë jetën do të mbeten të paharruar përgjithmonë.

Këtë 5 Maj vendosa të vija në Durrës, se në Tiranë kam vajtur çdo vit nëpër familjet e dëshmorëve, kurse Durrësit i kisha mbetur borxhli. Nexhmija [Hoxha] më porositi që të veja edhe në Kavajë për të takuar motrën e tre dëshmorëve vëllezër kavajas. Kur njoftova Iljazin për këtë, ky më tha se motra e tre dëshmorëve kavajas tani është këtu, në Durrës.

*SHOQJA EVRIDHIQI THANASI:* Unë, shoku Enver, kam qenë shoqe klase me shoqen Nexhmije, bile kemi qëndruar bashkë në një bankë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Prandaj porosinë për të ardhur këtu e kam më shumë nga Nexhmija dhe meqë ajo vetë nuk kishte mundësi të vinte sot, më tha t'ju sjell shumë të fala nga ana e saj.

Kjo qenka shtëpia e re që keni marrë tani. Jeni mirë këtu?

*SHOQJA EVRIDHIQI THANASI:* Shumë mirë jemi, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këto janë fotografitë e vëllezërve?

*SHOQJA EVRIDHIQI THANASI:* Po, këta janë të tre. Ajo atje është fotografia e Vangjelit, kjo më tej e Naunit dhe tjetra e Janit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të tre do të mbeten pishtarë të pashuar përjetë për popullin tonë.

Ti, Pirro, je vëllai i tre dëshmorëve.

*SHOKU PIRRO THANASI:* Po, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Në marinë punon?

*SHOKU PIRRO THANASI:* Po, shoku Enver. Me anijet tona ne shkojmë nga një shtet në tjetrin, në Poloni, në Rumani, në Bullgari e gjetkë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Si ju presin punëtorët e porteve andej?

*SHOKU PIRRO THANASI:* Na presin mirë shoku Enver dhe na respektojnë shumë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Popujt e këtyre vendeve ne shqiptarët na duan shumë, kurse udhëheqësit që kanë në krye janë revizionistë.

*SHOKU PIRRO THANASI:* Për ne, shqiptarët, kudo që shkojmë kanë respekt të madh, aq sa mund të them se nëpër porte nuk na bëjnë fare kontroll, kanë besim se ne nuk veprojmë jashtë ligjeve ndërkombëtare, por edhe ne tregohemi korrektë dhe me këtë qëndrim nderojmë, në radhë të parë, atdheun, popullin dhe Partinë që na edukon, pastaj veten tonë. Marinarët tanë nuk merren me kontrabandë, siç bëjnë marinarët e vendeve të tjera, kur dalin jashtë vendeve të tyre.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duhet të punojmë që respekti që kanë të tjerët për njerëzit tanë të ruhet. Ky respekt, që ushqejnë ata për ne, ka shumë rëndësi për emrin e mirë të Shqipërisë dhe nuk duhet të bëjmë asnjë gjë për ta tronditur këtë stimë<sup>1</sup> që kanë të tjerët për vendin tonë. Ky nder dhe respekt i takon Partisë. Me sjellje të këqija, qoftë edhe për vete, asgjë nuk fiton, por njollos një gjë të madhe, emrin e mirë të atdheut. Prandaj vazhdoni të punoni me nder, që ta ruani e ta çoni më lart nderin dhe respektin që ekziston për vendin tonë, për popullin tonë, për Partinë tonë.

*Shoku Enver Hoxha bisedon me të gjithë të pranishmit, i pyet për punën e për jetën e tyre, interesohet për fëmijët e familjes dhe vazhdon:*

Partia e bëri Shqipërinë të fortë, të lulëzuar dhe njerëzve u solli lumturi. Pa Partinë nuk do të kishim dalë në dritë. Edhe gjyshërit tanë kanë luftuar në të kaluarën, por ne fituam dhe mundëm t'i realizonim gjithë këto fitore, se kishim Partinë në krye. Prandaj

---

1. Nderim, respekt.



të gjithë i shprehin urime Partisë. Ja, zotrote<sup>1</sup>, të tëra vajzat i ke në punë, të martuara e të lumtura me burrat e tyre dhe ti tani rron e lumtur midis tyre, midis nipërve e mbesave të shumtë, sepse Partia u ka thënë dhëndurëve: nënat dhe vjehrrat janë të dashura. Edhe nuseve u ka thënë se përderisa burri do vajzën dhe vajza burrin, atëherë edhe vjehrra duhet ta dojë nusen dhe nusja vjehrrën. Të gjithë në familje të jenë të dashur e të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Është lumturi e madhe që në vatrën tona të mos ketë as më të voglën grindje.

**SHOQJA KASJANI LOLI:** Sa herë futim kafshatën e bukës në gojë, aq herë urojmë Partinë dhe ju që na prutë këto të mira.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Fëmijët janë të dashur. Partia i konsideron të gjithë njësoj, si djemtë, edhe vajzat. Edhe në punë të gjithë njësoj janë dhe shpërblehen sipas zotësisë, nuk ka preferenca se «ai është djalë» dhe t'i mbahet ana. Partia s'e bën këtë.

Në Kavajë ka pasur një çikë fanatizëm, po tani kohët kanë ndryshuar.

Plaku im nuk ishte fanatik, e kam fjalën këtu e përpara 50 apo 55 vjetëve, mirëpo në vend kishte fanatizëm, bile të madh, që e kishin mbjellë ideologjitë reacionare. Motrat e mia ishin akoma të vogla, kur në Gjirokastrë erdhi një i huaj<sup>2</sup>. Atëherë nuk kishte vajza në

1. Shoku Enver Hoxha i drejtohet vjehrrës së Pirro Thanasit. Kasjani Loli.

2. Është Ijala për Zhysten Godarin (1871-1956), personalitet politik francez me ide përparimtare, mik i Shqipërisë; ka shkruar disa libra për vendin tonë.

shkollë. Motra ime me ca gra të tjera vajti te hani i Hadërajve në sheshin e Çerçizit. Ato atëherë visheshin zakonisht me çarçaf të bardhë, kurse motra ime qe veshur, ja, kështu siç vishen vajzat sot. Mirëpo se kush vajti i tha plakut që vajza jote ishte në ballkon të hotelit. Kur erdhi në shtëpi. ai i tha motrës: «Po ti ku ishte?». «Isha në pazar për të parë atë të huajin», u përgjigj motra. Dhe plaku e qëllloi me pëllëmbë. Ai e bëri këtë i influencuar më shumë nga të tjerët dhe jo se ishte vetë fanatik.

Kavaja sot ka ndryshuar qind për qind me të kaluarën, është bërë qytet industrial, me shtëpi banimi të reja e të bukura, që do të shtohen akoma më shumë në vitet e ardhshme.

Kavaja ka dhe një skuadër të mirë futbollit. Tani amatorët e futbollit diskutojnë se cila skuadër do të fitojë, «Besa» e Kavajës, «Dinamoja» apo «Partizani». Këtu në Durrës besoj ka amatorë të të tria skuadrave, kurse unë vetë jam me Kavajën.

Sot kudo Shqipëria është në këmbë, ka një lëvizje të madhe e mobilizim për të kryer detyrat. Kudo ka gjallëri të jashtëzakonshme, sepse nga mësimet e Partisë njerëzit marrin forca të reja për të kryer punë akoma më të mëdha. Ju, shokë gazetarë, që shkruani për këto vizita në popull, duhet të flisni më shumë për mendimet e Partisë dhe të popullit.

Unë kam dëshirë të vij shumë herë për t'ju takuar, që të shkëmbejmë mendime bashkë, të bisedojmë, por, e kuptoni vetë, punët nuk më lënë.

Më lejoni tani të ngrihem. U gëzova shumë që erdha sot te ju. Qofshi të lumtur të gjithë! Kujtimi i atyre

që dhanë jetën për këto ditë të bukura, që gëzon populli sot, do të mbetet i paharruar.

Qofshi mirë të gjithë! Mirupafshim!

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*

## TË FORCOJMË FRYMËN REVOLUCIONARE DHE QËNDRIMIN VIGJILENT NË PUNË E NË JETË

*Diskutim në mbledhjen e byrosë së Komitetit  
të Partisë të Rrethit të Elbasanit*

15 maj 1973

Më lejoni, shokë, të them edhe unë disa mendime rreth çështjeve që shqyrtuat<sup>1</sup> në këtë mbledhje të sotme të byrosë. Kisha dëshirë të merrja një takim për së afërmi me shokët e organizatës së Partisë të rrethit tuaj. Raportin e shokut Jashar Menzelxhiu<sup>2</sup> dhe ato të shokëve të tjerë sekretarë, megjilthëse i mora me vonesë, i kam lexuar. Këtu dëgjova me vëmendje edhe diskutimet që bënë shokët për problemet që ka ngritur Partia kohët e fundit. Nga diskutimi i këtyre çështjeve në masën e Partisë dhe të popullit, byrotë e komiteteve

---

1. Në këtë mbledhje, ku merrnin pjesë kuadro të Partisë, të pushtetit, të organizatave të masave e kuadro të tjerë të rrethit, u diskutua rreth raporteve, në të cilat trajtoheshin probleme të zhvillimit të ekonomisë, të edukimit ideopolitik e estetik të masave, të punës organizative të Partisë, si dhe disa çështje të arsimit dhe të kulturës në rrethin e Elbasanit.

2. Në atë kohë sekretar i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit.

të Partisë të të gjitha rretheve janë duke bërë aktualisht konkluzionet përkatëse. Shokët nga qendra, ashtu siç erdha unë këtu, kanë shkuar të marrin pjesë në këto mbledhje për t'u njohur me gjendjen, për të marrë eksperiencën e Partisë për këto probleme dhe për ta përgjithësuar këtë eksperiencë, me qëllim që, pasi të përpunohet dhe pasi të jetë bërë Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë, që është në plan të bëhet aty nga muaji qershor<sup>1</sup>, t'i kthehet përsëri Partisë dhe popullit.

Problemet që po diskutojmë nuk janë të reja dhe, natyrisht, nuk mund të ezaurohen në dy apo tre muaj; ato do të shtjellohen vazhdimisht më tej për të mirën e punës dhe për interesat e socializmit. Vendimet që do të merren lidhur me to do të jenë një armë shumë e fuqishme në duart e Partisë për edukimin e njerëzve, që ndërtimi i socializmit në vendin tonë të shkojë gjithnjë përpara. Në këtë drejtim besimi i të gjithëve ne, komunistëve dhe i popullit, është i patundur, sepse, siç e shikoni vetë, situata në vendin tonë është shumë e shëndoshë, revolucionare. Nga disa të meta, gabime dhe lëshime të vërtetuara në punë, vetëm një parti marksiste-leniniste, siç është Partia jonë, nuk ka frikë, prandaj ajo ua bën të njohura masave të popullit, pse pikërisht te mbështetja në popull qëndron forca e Partisë. Ajo kurdoherë i hedh në diskutim të hapët dobësitë dhe arrin kështu rezultate frytdhënëse brenda një kohe të shkurtër, siç ka ndodhur edhe kohët e fundit. Ky qëndrim flet, në radhë të parë, për gjithë vijën e

---

1. Plenumi i 4-t i KQ të Partisë, 26-28 qershor 1973. Shih në këtë vëllim. f. 277.

drejtë, revolucionare, marksiste-leniniste të Partisë sonë dhe tregojnë se kryesorja, vendimtarja të ne është pozitivja, ndërsa të metat e dobësitë që kritikojmë përbëjnë disa shfaqje anësore që janë dukur në praktikë gjatë zbatimit të vijës. Mirëpo, kur u bëhen të njohura masave të gjera të popullit, këto ngrihen përnjëherësh në këmbë, indinjohen për shfaqjet e shëmtuara që ngjasin dhe mobilizohen për t'i luftuar.

Siç ngjet në të gjitha rrethet, edhe në rrethin tuaj, krahas anëve pozitive, mobilizimit në rrugën e Partisë dhe sukseseve të shumta të arritura, ka pasur edhe të meta, gabime dhe disa shfaqje negative, që ju i keni analizuar në mbledhje të ndryshme, i keni vënë në dukje dhe tani jeni duke marrë masa për t'i luftuar e për t'i ndrequr. Këto përpjekje për korrigjimin e të metave dhe të gabimeve, tregojnë forcën e madhe të organizatës së Partisë të rrethit tuaj, besnikërinë e saj ndaj vijës së drejtë të Partisë dhe marksizëm-leninizmit. Kjo është pozitive për organizatën e Partisë të rrethit të Elbasanit.

Siç na mësojnë vazhdimisht Partia dhe Komiteti i saj Qendror, për asnjë moment nuk duhet të mbulohen të metat dhe dobësitë në punë, përkundrazi është e nevojshme që ato t'u bëhen sa më të qarta masave në kohën e duhur, sepse kështu vetë njerëzit që gabojnë, do të edukohen, do të fitojnë besimin në vetvete dhe do të korrigjohen, kur janë për t'u korrigjuar. Nga eksperiencia e tyre negative do të përfitojnë edhe gjithë të tjerët që të mos gabojnë në ato drejtime.

Ka disa naivë që thonë se të metat dhe gabimet e vërtetuara në qëndrimin ndaj shfaqjeve të liberaliz-

mit i pa shoku Enver. Ata mendojnë kështu, duke u nisur nga fjalimet e mia të kohëve të fundit, por ky gjykim nuk është as i drejtë, as i saktë. Këto shfaqje i ka parë dhe i ka vënë në dukje, në kohën e duhur, Partia. Po të mos i kishte parë ajo, nuk i shikonte dot as udhëheqja e Partisë. Unë, si Sekretar i Parë, dhe gjithë shokët e tjerë të Komitetit Qendror, duke marrë të dhëna, vërejtje e këshilla të organizatave-bazë të Partisë dhe të komiteleve të Partisë në rrethe, bëjmë pastaj konkluzionet e gjithë punës. Partia është ajo forcë e madhe që në çdo kohë e moment vrojton, dhe, në të ardhmen, gjithashtu, do të vrojtojë që të njohë gjendjen, të zbulojë dobësitë e të metat në punë dhe pastaj të udhëheqë komunistët dhe masat për t'i ndrequr e korrigjuar ato.

Nga gjithë eksperiencia e kohëve të fundit e Partisë udhëheqja mendoi se ishte nevoja që disa probleme të shtroheshin në Parti dhe në masat e popullit. Dy fjalimet që mbajta unë, njërin në Presidiumin e Kuvendit Popullor<sup>1</sup> në muajin janar dhe tjetrin në Plenumin e 3-të të Komitetit Qendror të Partisë<sup>2</sup>, në shkurt, i diktoi nevoja e luftës kundër një sërë shfaqjesh të liberalizmit që ishin dukur në disa fusha të veprimtarisë praktike të Partisë. Mëqenëse në këto fjalime ngriheshin probleme

1. «Zhvillimi i letërsisë dhe i arteve të bëhet në luftë kundër çdo ndikimi të huaj ideologjik». Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 50, f. 1.

2. «Plotësimi i detyrave të planit mbetet si kurdoherë fronti kryesor i punës së Partisë dhe i masave të gjera punonjëse të qytetit dhe të fshatit». Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 50, f. 171.

që shqetësonin tërë Partinë, masat punonjëse të vendit, siç thashë më lart, i pritën ato me entuziazëm dhe u ngritën në këmbë për ndreqjen e të metave.

Por, gjatë kësaj pune fillestare, u duk tendenca e kufizimit të problemit vetëm në çështjen e artit dhe të kulturës, gjë që Byroja Politike nuk e gjykoj plotësisht të drejtë. Në të kundërtën, problemi ishte shumë më i gjerë, prandaj na u desh të gjenim mënyrën për ta gjallëruar akoma më tej diskutimin në Parti dhe në masa për të gjitha çështjet edhe në sfera të ndryshme. Për këtë arsye u detyrova të flisja përsëri në mbledhjen e komunistëve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, me rastin e dhënies llogari e zgjedhje ku, siç e dini, tërhoqa vëmendjen në faktin se fronti i luftës kundër shfaqjeve të liberalizmit ishte shumë më i gjerë sesa ai i fushës së arteve dhe të kulturës.

Diskutimi që u zhvillua paskëtaj në Parti dhe në popull, siç na rezultoi nga raportet që i kanë ardhur Komitetit Qendror dhe nga ato që thatë edhe ju këtu, vërtetoi se shqetësimet e udhëheqjes së Partisë ishin reale, të bazuara dhe se ato u shtruan në popull tamam në kohën e duhur, hapur e me shumë vend.

Ne jemi të bindur se shkundja e përgjithshme që u bë me këtë rast, duke ia nënshtruar kritikës së masave të metat dhe dobësitë e gjithë punës sonë, shfaqjet e liberalizmit dhe të oportunitizmit, butësitë dhe lëshimet, si në fushën e punës e të prodhimit, ashtu edhe në atë të edukimit e të organizimit, në shkollë, në familje e në shoqëri, ka ndihmuar për të ndrequr punën në mjaft drejtime. Dhe kjo është gjëja më pozitive, se do të na japë mundësinë që në Plenumin e



ardhshëm të Komitetit Qendror të Partisë të shkojmë me rezultate konkrete. Byroja Politike mendoj që kjo ishte një nga metodat më të efektshme që duhej ndjekur për përgatitjen sa më mirë të këtij Plenumi.

Kjo përgatitje nuk qëndron vetëm në hartimin e raportit, kryesorja është të ngrihen masat e Partisë dhe të popullit në këmbë, në veprim për këto probleme që do të shtrojë Komiteti Qendror, i cili, sikurse thashë, pasi të marrë mendimet e vërejtjet e punonjësve, t'i përpunojë ato, t'ua kthejë Partisë dhe masave si orientime për punë. Jemi të bindur se kemi edhe aprovimin tuaj për këtë metodë e stil pune që kemi menduar të ndjekim, se është në të mirën e Partisë dhe të popullit e kështu duhet të bëjmë kurdoherë.

Dëshiroj të theksoj që në fillim se punën e kryer deri tash nga gjithë Partia, të mos e konsiderojmë të mbaruar, duke u kënaqur vetëm me atë që është bërë. Që rezultatet e arritura të jenë të qëndrueshme dhe që tërë puna e bërë të mos shkojë si valë, si një dallgë e fortë dhe pastaj të dobësohet e më në fund të venitet, është e domosdoshme të kujdesemi në të ardhmen që punën e filluar ta ndjekim me të njëjtin ritëm si në drejtim të forcimit të bindjeve të thella të njerëzit, gjë që ka shumë rëndësi, ashtu edhe në zbatimin e masave që kemi caktuar, pra të vazhdojmë të bëjmë një punë të dendur propagandistike edukative brenda në Parti dhe me punonjësit jashtë saj dhe të ushtrojmë njëkohësisht kontroll të rregullt mbi të gjithë për zbatimin e masave të caktuara. Duke vepruar kështu, është e sigurt që puna e filluar nuk do të mbetet një valë dhe zjarr prej kashte.

E them këtë se Partia edhe herë të tjera ka folur dhe ka caktuar masa për një sërë problemesh, siç janë, për shembull, ai i disiplinës proletare, i normave, i kontrollit punëtor, i punës me rininë, me gruan etj., etj., por, krahas rezultateve të mëdha që janë arritur për shumë nga çështjet që kemi shqyrtuar e vendosur, është e drejtë të pohohet që, në disa raste, atyre nuk u kemi vajtur deri në fund. Këtej del nevoja ta forcojmë shumë kontrollin e zbatimit të vendimeve. Ky kontroll nuk duhet të kufizohet vetëm në zbulimin e të metave dhe të fajtorëve, por të synojë kryesisht në ndihmën për organizimin e punës si duhet në praktikë dhe për realizimin e detyrave. Prandaj të marrim të tëra masat që këtë kontroll ta forcojmë edhe në Parti, por ta forcojmë sidomos në pushtet, ku kemi njerëz të zotë, me kulturë dhe me eksperiencë të gjerë, të cilët me iniciativë të plotë ta nxitin dhe ta ndihmojnë bazën në zbatimin e të gjitha detyrave.

Mendoni, shokë, se vetëm plenumi i komitetit të Partisë dhe këshilli popullor i rrethit mund të kenë afër 200 kuadro drejtues e shokë të zgjedhur nga më të mirët, me pjekuri, me eksperiencë të madhe dhe me kompetenca të plota, në gjendje të venë kudo për të kontrolluar çdo gjë, për të bërë mbledhje me kë të gjejkojnë të nevojshme ata, për të marrë masa në vend për ndreqjen e të metave e gabimeve dhe për të inkurajuar njerëzit në punë. Shikoni, pra, ç'forcë e madhe ekziston vetëm në të dy këto organe, pa llogaritur pastaj punonjësit e aparateve të tyre, drejtuesit e institucioneve të ndryshme, të ndërmarrjeve ekonomike apo të kooperativave bujqësore, ku kemi, gjithashtu, shumë kua-

dro të përgatitur. Atëherë, vihet pyetja: me këtë mori kuadrosh, nuk jemi ne në gjendje t'i shumëfishojmë sukseset, të rritim cilësinë, të arrijmë rezultate materiale, morale, politiko-ideologjike akoma më të mëdha se këto të gjertanishmet? Sigurisht që jemi. Prandaj, të gjithëve na vihet detyrë të reflektojmë mbi këto situata që po zhvillohen, mbi këtë forcë të madhe që ekziston në gjirin e Partisë dhe të masave të popullit, për t'i kryer sa më mirë detyrat. Mundësitë janë të gjitha, por përpjekjet për më shumë nuk bëhen në nivelin e dëshiruar.

Nga tërë seksionet e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit vazhdimisht, çdo ditë, shkojnë shokë në bazë për ndihmë e kontroll, si në kooperativat bujqësore, në ndërmarrje të ndryshme, në shkollat e rrethit etj. Mos vallë detyra e tyre është të japin udhëzime dhe të sjellin në rreth vetëm konstatime, pa bërë asnjë përpjekje që planet në bazë të plotësohen? Jo, shokë! Detyra e gjithë kontrolluesve është të shikojnë me kujdes ç'bëhet në bazë për zbatimin e vendimeve të ndryshme, si punohet dhe cila është eksperiencia e mirë që duhet përgjithësuar, gjithashtu të zbulojnë edhe cilat janë të metat e dobësitë. Tok me punonjësit, të gjejnë shkaqet nga rrjedhin të metat, të vënë para kritikës neglizhentët e fajtorët dhe të marrin masa në vend që të ndreqen sa më parë dhe të sigurohet kështu realizimi i plotë dhe në kohë i planeve. Kjo kërkese vë detyrën e një kthese serioze në metodën tonë të punës.

Dobësitë në metodën dhe në stilin aktual të punës së organeve e të organizatave të Partisë, të pushtetit e të organizatave të masave janë, mendoj unë, një nga

shkaqet më të rëndësishme për lindjen dhe ekzistencën e të gjitha atyre të metave e dobësive që po kritikojmë.

Një praktikë krejt e gabuar në metodën e punës, që më duket është vënë re përsëri edhe kësaj radhe, është se, kur del një direktivë e re, një vendim apo një fjalim i ri, lihen mënjanë gjithë të mëparshmit dhe përqendrohet vëmendja në këtë të fundit. Puna e Partisë nuk është e lidhur vetëm me një apo dy fjalime, ajo është një punë e zhvilluar me dekada dhe e shoqëruar me një varg masash të lidhura fort njëra pas tjetrës, si hallkat e një zinxhiri.

Kështu, kur udhëheqja mendon të ngrejë një çështje në Parti, natyrisht bëhen përpjekje që të flitet shkurtazi, duke mbajtur parasysh që të mos përsëriten ato që janë trajtuar në të kaluarën. Mirëpo kjo nuk do të thotë aspak që problemet e ngritura më parë të harrohen. Përkundrazi, komunistët e kanë për detyrë t'i kenë kurdhoerë parasysh si duhet të gjitha direktivat apo vendimet e Partisë, ata duhet të kenë parasysh edhe teorinë e klasikëve të marksizëm-leninizmit dhe t'u referohen atyre sipas problemeve që dalin, sepse mënjanimi i një problemi, kur del një tjetër i ri, të çon, shokë, në punë me fushata dhe në shikimin e njëanshëm të çështjeve. Detyra jonë është t'i marrim të gjitha problemet në front, t'i caktojmë çdonjërit radhën, të ndajmë mirë forecat, por asgjë, asnjë detyrë të mos i shpëtojmë vëmendjes sonë, asnjëra prej tyre të mos mbulojmë dhe aq më pak të fshijë tjetrën.

Kam dëgjuar se aty-këtu te ndonjë ka pasur prirje për të nënvleftësuar orientimet e Partisë për punën bindëse që duhet bërë me masat, për vijën e masave,

duke u dhënë prioritet masave administrative. Kjo vjen pse shpesh harrohen orientimet e vendimet e mëparshme të Partisë dhe disa shokë, duke menduar gabim, kujtojnë sikur ato që ka thënë e vendosur Partia në të kaluarën, që janë po aq parimore sa edhe direktivat e reja, nuk qenkan më aktuale!

Të nisur nga këto konsiderata jo të drejta ka kua-dro që kërkojnë të hartohen «rregullore» edhe për çështje që mund dhe duhet të zgjidhen me anë të punës bindëse. Është kërkuar të aprovohen deri edhe «ligje» që të parashikojnë masa ndëshkuese ndaj atyre kooperativeve që mbajnë bagëti mbi numrin e lejuar nga statuti i kooperativës bujqësore, duke harruar se këtu kemi të bëjmë me pronën e grupit dhe se zbatimi me rreptësi i statutit duhet kërkuar nga vetë anëtarët, sipas rregulloreve që ata i kanë pranuar në mbledhjet e përgjithshme.

Është fakt se ne i bindëm njerëzit të futen në kooperative, domethënë, i bindëm të bashkojnë ish-pronën e tyre të vogël private në pronën e përbashkët socialiste, që është kryesorja, vendimtarja. Atëherë si të mos jemi ne të zotët t'u mbushim mendjen atyre që t'ia shesin kooperativës bagëtitë e tepërta, që kanë mbi numrin e parashikuar në statut? Është e drejtë kërkesa që këto bagëti të tepërta, ata që i mbajnë duhet t'i shesin, por ama duhet parë se, kur kooperativistëve u thonë të dorëzojnë bagëtitë dhe ata nuk pranojnë, në këtë çështje ka diçka që nuk ecën. Po përse s'i dorëzojnë bagëtitë e tepërta, për sa kohë që shkelet statuti që vetë anëtarët kanë aprovuar? Sepse nuk u paguhen paratë, por u thuhet se do t'ua japim më vonë, kurse anëtarit i kooperativës mund të ketë nevojë imediatisht për këto

para, se dikush do të martojë vajzën, një tjetër dëshiron të blejë një televizor, veshmbathje për familjen etj. Bagëtia është në pronësinë personale të anëtarit të kooperativës bujqësore, i cili ka të drejtë ta shesë atë në treg ose t'ia japë kooperativës, por veç kjo duhet t'i paguajë paratë. Pa bërë punë bindëse, nuk është e drejtë që kooperativa t'i kërkojë anëtarit t'ia paguajë çmimin e bagëtisë së oborrit me këste dhe ca më tepër ta ndalojë që ta shesë atë në pazar, në kundërshtim me vullnetin e tij. Kooperativa mund t'i blejë bagëtitë e tepërta të oborreve të anëtarëve edhe me këste, por me pëlqimin e tyre, pasi ata të jenë bindur për këtë veprim. Kur u kërkohej kooperativistëve që bagëtitë e tepërta të mos i shesin në pazar, po t'ia dorëzojnë kooperativës, ndërsa kjo, nga ana e saj, paratë të mos ua japë me kohë në dorë, atëherë edhe ata do të detyrohen të thyejnë normalat e statutit të kooperativës.

Mirëpo na intereson neve që kooperativisti t'i thyejë parimet e vendosura dhe të mbajë më shumë krerë bagëti nga sa i lejohej e të kthehet kështu në pronar të vogël? Jo, shokë, nuk na intereson. Këtej del, në radhë të parë, se puna politike dhe edukative e Partisë në kooperativë duhet të forcohet gjithnjë e më shumë. Prirjet për masa administrative i bëjnë disa shokë të harrojnë format e tjera dhe më kryesore të punës edukative me njerëzit.

Vjet, në diskutimet që u bënë mbas fjalës që mbajta në plenumin e Komitetit të Partisë në Rrethin e Matit<sup>1</sup>,

---

1. «Socializmin e ndërtojnë masat, Partia i bën këto të ndërgjegjshme». Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 48, f. 132.

pati edhe ndonjë kuadër që u kritikua për arrogancë e frymë komanduese dhe që tani ka kërkuar t'i hiqen «akuzat e padrejta» që i qenkëshin bërë, duke ngulur këmbë se «kishitë pasur të drejtë», se «njerëzve u duhen mbledhur rripat» etj., pra, sipas këtyre njerëzve duhet të vihet kërbaçi në fuqi. Njerëz të tillë, fjalimit tim të Matit, kanë synuar t'i kundërvënë fjalimin e 15 marsit, kur, në të vërtetë, midis tyre jo vetëm s'ka asnjë kundërtënie, por përkundrazi, ata janë vazhdim i drejtpërdrejtë i njëri-tjetrit, siç është e vazhdueshme dhe e rrjedhshme tërë vija e Partisë.

Disiplina e çeliktë, që ka kërkuar dhe kërkon kudo e vazhdimisht Partia, do të sigurohet dhe mund të sigurohet mbi bazat e zbatimit pa lëshim të vijës së masave, të forcimit të demokracisë sonë socialiste, të punës sqaruese, bindëse, edukuese dhe organizuese të Partisë, duke përdorur, kur nevojiten, edhe masa administrative. Për zgjidhjen me sukses të të gjitha detyrave, në çdo kohë, Partia ka kërkuar vazhdimisht si të domosdoshme kombinimin e punës bindëse e të masave organizative me ato administrative. Por, Partia ka theksuar gjithmonë se prioritet duhet të kenë dy të parat. Megjithatë, edhe masat administrative, kur merren me vend, janë efektive dhe kanë karakter edukativ. Por e përsëris se ato lypset të merren gjithmonë kur duhen dhe në bazë të ligjeve, pa kaluar në arbitraritete, që janë të palejueshme e të dënueshme nga Partia. Në rrugën e shkeljes së normave të Partisë dhe të ligjeve të shtetit nuk duhet të vazhdohet më.

Shokët, me të drejtë, vunë në dukje se nga ana e gjykatave, nga ana e punonjësve të Partisë ka pasur

lëshime, liberalizëm, butësi e sentimentalizëm. Kur disa e kanë mbushur kupën dhe puna edukative ndaj tyre nuk ka dhënë rezultate, atëherë duhet kaluar edhe në marrje masash. Kur një njeri ka përsëritur të njëjtin gabim, apo ca më keq faj, ai duhet kapur nga zverku dhe t'i tregohet vendi. Kur faji i kryer prej tij përbën krim, atëherë medoemos të çohet edhe në gjyq dhe të dënohet në bazë të ligjit. Puna bindëse edukative është konsumuar me këtë njeri, prandaj duhen marrë masa. Ndonjëri mund të thotë: po ky është punëtor, si të dërgohet në gjyq? Mund të ketë qenë punëtor, por me veprimet e fajshme që ka kryer, ai ka cenuar interesat e vetë klasës punëtore. Ndonjë tjetër mund të thotë se ai është komunist, si mund ta dënojmë penalisht? Ashtu është, ai mund ta ketë marrë taserën e Partisë, po jeta ka treguar se është futur kontrabandë në Parti.

Njeriu i ndershëm duhet të jetë konsekuent deri në fund dhe të qëndrojë luftëtar i vendosur për çështjen e popullit, për drejtësinë, për mbrojtjen dhe për zbatimin e vijës së Partisë. Nuk mund të lejohen butësi e lëshime për ata që shkelin vijën e Partisë, të drejtat e klasës punëtore, të fshatarësisë sonë kooperativiste dhe të tërë masave punonjëse, që janë të siguruar nga ligjet e shtetit.

Siç e kam shtruar edhe në fjalën e 15 marsit, siç doli edhe këtu te ju, në shpjegimin dhe kuptimin e rrethimit kapitalisto-revizionist dhe të luftës së klasave në shkallë ndërkombëtare dhe brenda vendit ka pasur boshllëqe të ndjeshme. Sukseset e arritura në përballimin e bllokadave që ndërmorën armiqtë kundër vendit tonë, si edhe presioni ideologjik, i shpërthyer nëpërmjet



një euforie të papërmbajtshme për të ashtuquajturën situatë paqeje në botë, «për zgjidhjen paqësore të të gjitha konflikteve» etj., sikur kishin krijuar deri diku një gjendje qetësie dhe jo vetëm kaq, por te disa nga njerëzit tanë edhe një ndjenjë mburrjeje pa vend.

Të dhënat flasin për pakujdesitë e vërtetuara në punën për përgatitjen ushtarake, për mungesa e për formalizëm në stërvitjet, si nga pjesëmarrësit, ashtu edhe nga oficerët që i drejtonin. Tash, kjo detyrë e dorës së parë duhet kuptuar më mirë. Pjesëmarrja në stërvitjet e muajve të fundit si kudo, edhe në rrethin tuaj, është mbi 90 për qind.

Edhe vigjilenca ndaj armiqve të jashtëm e të brendshëm duhet të mbahet kurdoherë ngritur, shokë, dhe të punohet që të shtohet dita-ditës, krahas rritjes së entuziazmit realist të masave, të udhëhequra nga Partia, për plotësimin e detyrave në fushën e ndërtimit socialist të vendit.

Në situatat aktuale, armiqtë e jashtëm janë aktivizuar shumë kundër vendit tonë. Tash nuk shihen përgatitje për luftë të armatosur kundër Shqipërisë, por disa nga ata kanë filluar t'i heqin maskat që kishin vënë e që ne nuk ua kemi besuar kurrë. Partia e dinte që ato ishin të imponuara nga koniunkturat e përkohshme politike. Të tilla maska që mbahen ndaj vendit tonë ka akoma, për arsye se në mes armiqve tanë ka kontradikta në synimet e tyre ndaj Shqipërisë. Partia e Punës e Shqipërisë di t'i përdorë këto kontradikta me zgjuarsiri dhe punon për t'i thelluar, pa shkelur parimet kryesore, siç janë mbrojtja e lirisë, e pavarësisë, e sovranitetit dhe e ndërtimit të socializmit.

Por shumë nga ata që deri tani na buzëqeshnin, duke parë se vendi ynë është i padepërtueshëm nga ana e tyre dhe se as buzëqeshjet, as maskat për një kohë të gjatë nuk arritën dot të zbutin qëndrimet e Partisë sonë të Punës dhe të Qeverisë së Republikës sonë Popullore, tash kanë filluar t'i nxjerrin dhëmbët, bile të organizojnë edhe fushata. Edhe pse dihet nga të gjithë që populli shqiptar nuk e ka filluar sot luftën kundër fesë dhe ideologjisë e institucioneve fetare, Vatikani, që deri dje heshtte, duke marrë shkak nga një tradhtar dhe element i degjeneruar, një ish-prift katolik, spiun i amerikanëve, agjent i anglezëve dhe i italianëve, një sabotator në kooperativën e Gurëzit, kundër të cilit para dy vjetësh është bërë gjyqi i hapët në Krutjë, tani u kujtua të flasë për çështjen e tij, duke shtrembëruar të vërtetën<sup>1</sup>.

Reaksioni botëror ka për qëllim ta ngrrejë këtë ngjarje në një fushatë të madhe ideologjike dhe politike, të organizuar dhe të kryesuar nga Vatikani, kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Në këtë fushatë bëhen përpjekje për të tërhequr edhe kishën igumenike ortodokse, me synimin e qartë që tërë reaksioni botëror të bashkohet në një front të vetëm dhe çështjen ta shtrojë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, sikur gjoja ne qenkemi duke persekutuar njerëzit e ndershëm etj., etj. Me të shpallur Vatikani se në Shqipëri na qenka pushkatuar një prift, për arsye se gjoja paska pagëzuar një kalama, jo vetëm këta, që gjer tani mbanin maska, por shumë gazeta të botës borgjeze filluan të

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 50, f. 483-484.

shkruajnë kundër nesh. Kur ne iu përgjigjëm dhe e demaskuam Vatikanin, shumë pak gazeta në Perëndim i botuan artikujt tanë. Kjo tregon unitetin e armiqve të jashtëm kundër Republikës Popullore të Shqipërisë. Ata e kanë halë në sy dhe bëjnë fushata shpifjesh për ta diskredituar, sepse shikojnë që ajo është një kala e padepërtueshme për ta. Ne jemi bërë të fortë, sepse jemi në rrugë të drejtë, sepse udhëhiqemi nga një Parti me të vërtetë marksiste-leniniste, që është e lidhur ngushtë me popullin.

Lufta që po bëjmë kundër shfaqjeve të huaja që ne kritikojmë dhe prej të cilave po spastrojmë ndërgjegjen e njerëzve tanë, godet armiqtë, sepse ata mendojnë që me anë të tyre do të mund të degjenerojnë njerëzit tanë, rininë tonë, klasën punëtore dhe pastaj të krijojnë kushte që të depërtojnë në Shqipëri. Prandaj kur shikojnë këtë që po bëhet te ne, kur shikojnë që ne gjithnjë e më shumë po forcohem, ata egërsohen akoma më tepër.

Për të gjitha arsyet që vura në dukje, shokë, neve na vihet detyrë ta rritim në maksimum vigjilencën, pse prapa Vatikanit dhe kishës së Athinës (se edhe kjo bëri një mbledhje ditët e fundit dhe në një nga nenet e rezolutës që shpalli, thuhet se gjoja në Shqipëri po persekutohen ortodoksët, që, sipas reaksionit grek, janë të tërë «vorioepirotë»), qëndron tërë reaksioni botëror, në radhë të parë, imperializmi amerikan e revizionizmi sovjetik, si edhe shtetet përreth kufijve të atdheut tonë, me të cilat kemi dhe do të vazhdojmë të mbajmë marrëdhënie diplomatike e tregtare. por sytë do t'i mbajmë kurdoherë hapur. Asnjëherë nuk do ta flemë mend-

jen, siç veprojnë disa njerëz, që, të prirë nga sentimentalizmi, mbyllin sytë dhe nuk tregohen vigjilentë e të kujdesshëm. Shumë nga vizitorët që vijnë nga jashtë nuk janë njerëz të këqij, por midis tyre ka edhe të atillë, që sjellin apostafat gjithfarë plaçkash dhe përpigën të propagandojnë «parajsën borgjeze», prandaj duhet të jemi vazhdimisht zgjuar e vigjilentë.

Natyrisht, ne nuk mund të mbyllemi në guaskë dhe të mos lëmë të na vijnë për vizitë vëllezërit tanë të një gjaku dhe vizitorë të tjerë nga jashtë. Dihet se edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ka emigrantë ekonomikë, që kanë në Shqipëri prindërit, motrat, vëllezërit, të cilët nuk i kanë parë prej dhjetëra vjetësh. Shumë prej atyre që vijnë shprehin mall dhe dashuri të madhe për atdheun, për njerëzit, thonë plot fjalë të mira për pushtetin tonë, që ka realizuar tërë këto vepra të mëdha dhe, kur kthehen, flasin pozitivisht, thonë të vërtetën për Shqipërinë. Por në mes tyre ka edhe njerëz jo të mirë. Të mbajmë parasysh se në mes tyre reagoni përpigët të futë edhe elementë të këqij, prandaj, në këto vajtje-ardhje, njerëzit tanë nuk duhet të humbasin vigjilencën.

Të mos flasim pastaj për kujdesin që duhet treguar ndaj disa njerëzve që nuk janë në rregull, të cilët e ulin veten dhe u kërkojnë të afërmve që kanë jashtë t'u dërgojnë disa lecka, si fanella, bluza etj., apo ndonjë televizor, edhe pse nga gjendja ekonomike janë shumë mirë. Me këto qëndrime ata tregojnë mungesën e respektit që kanë për veten e tyre, pa lëre pastaj për shoqërinë tonë në tërësi. Këto që po përmend i pohojnë vetë disa nga ata që vijnë nga jashtë si, bie fjala, nga Shtetet e

Bashkuara të Amerikës, të cilët kanë sjellë plaçka për të afërmit, sepse këta u kanë shkruar sikur në Shqipëri nuk ka gjë në treg. Mirëpo, kur vijnë këtu, habiten kur i gjejnë njerëzit e tyre si jo më mirë, jo vetëm me ushqim e veshmbathje, por me gjithë të mirat, me djem e vajza me universitet në një kohë që ata, në emigracion, nuk i kanë fëmijët as me shkolla të mesme, ose që për të bërë një operacion të thjeshtë apendisiti, apo për të mjekuar dhëmbët, u duhen shuma të mëdha. Kur gjatë kohës së qëndrimit në atdhe, atyre u lind nevoja dhe bëjnë ndonjë mjekim, pyesin sa duhet të paguajnë për të dhe habiten, kur marrin përgjigje se nuk do të paguajnë asgjë, kurse për shërbime të tilla në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në Argjentinë, në Australi, në Francë e gjetkë u duhet të punojnë për shumë kohë.

Ose le të marrim një fushë tjetër, ku vigjilenca duhet mbajtur vazhdimisht ngritur. Ne kemi sjellë e do të sjellim nga jashtë libra për punonjësit e shkencës dhe të kulturës, që ata të marrin dhe të shfrytëzojnë në dobinë tonë atë çka është e përparuar. Mirëpo bashkë me librat me të vërtetë shkencorë na dërgohen edhe shumë të tjerë që s'janë të tillë dhe, megjithëkëtë, asnjë kontroll nuk ushtrohet në këto drejtime. Punonjësit e Bibliotekës Kombëtare, të universitetit etj., duhet të kenë mendjen që ky fond librash të huaj, që depozitohet pranë tyre, të shfrytëzohet vetëm nga ata që janë të interesuar për arsye të punës.

I preka këto për të treguar sa e domosdoshme është rritja e vigjilencës, rëndësinë e saj aktuale dhe në perspektivë, me qëllim që ajo të jetë kurdoherë në një

shkallë të lartë. Kur flasim për vigjilencë, shtrohet çështja që të bëhet një punë e dendur politike. Partia për këtë ka dhënë e jep gjithmonë udhëzime. Çdo ditë dalin artikuj, në revista e në gazeta, që i ushqejnë vazhdimisht njerëzit tanë me orientime se si ta bëjnë gjithnjë e më mirë propagandën kundër armikut të klasës. Çështja është që gjithsecili nga ne të mendojë dhe të veprojë vetë e jo të lidhë duart apo të pyesë për çdo gjë si ta bëjë këtë ose atë.

Por duhet thënë se ka pasur disa shfaqje krejt të pafalshme në fushën e vigjilencës ndaj armiqve të brendshëm të klasës. Edhe në rrethin tuaj, siç u tha gjatë diskutimeve, doli se në disa organizata-bazë partie janë mbajtur qëndrime oportuniste ndaj elementëve kulakë ose atyre me qëndrim të keq politik. Në ndonjë rreth tjetër ka pasur ndonjë rast kur sapo kthehet nga burgu një i dënuar për veprimtari armiqësore, deri edhe komunistë i kanë shkuar në shtëpi që «ta urojnë»! Dikur, sidomos në zonat kufitare, çdo të huaji që nuk është nga ajo zonë, i kërkoheshin dokumentet. Tani në shumë raste as interesohet njeri për këtë punë. Ç'është ky lëshim që po bëhet? E shikoni, shokë, që nuk janë kuptuar mirë situatat që po kalojmë?

I përmenda të gjithë këta shembuj për t'ju tërhequr edhe një herë vëmendjen për domosdoshmërinë e rritjes së vigjilencës, për forcimin e edukimit klasor revolucionar të masave, që të jemi gjithmonë syhapur e të gatshëm.

Kur flasim për veprimtarinë dhe për presionin e armikut të klasës, zakonisht kemi parasysh armiqtë e jashtëm dhe armiqtë e brendshëm fizikë, por harrojmë

ose nënvleftësojmë atë që, siç e thashë në fjalën e 15 marsit, përbën një presion të brendshëm, fare të brendshëm dhe gjendet thellë në ndërgjegjen e njerëzve tanë, presionin e psikologjisë mikroborgjeze.

Ne kemi luftuar dhe vazhdojmë të luftojmë kundër mbeturinave mikroborgjeze, por disa kënaqen me parulla e slogane. Kur veprohet kështu, mbeturinat bëhen gjithnjë e më të rrezikshme, sepse këto i shtyjnë njerëzit të shikojnë vetëm interesin e ngushtë personal; i nxitin t'u kundërvihen disiplinës proletare dhe ligjeve të diktaturës së proletariatit; kultivojnë individualizmin, indiferentizmin, miqësitë, hatërlleqet e plot të këqija të tjera, që dëmtojnë rëndë shoqërinë tonë socialiste. Pra, është e domosdoshme të ndërmerret nga Partia një punë e organizuar shumë mirë me mjete edukative-organizative, e kombinuar sipas nevojave edhe me masa administrative, për t'u vënë fre dhe për t'i zhdukur gjithnjë e më shumë këto shfaqje të ideologjisë së huaj.

Në lëmin e ekonomisë ka rezerva të mëdha, që nuk shfrytëzohen si duhet, dhe në këtë neglizhencë ndikojnë shumë faktorë, siç janë mungesa e një discipline të fortë proletare në punë, normat e vendosura jo sipas kriterëve shkencore, vetëkënaqësia që vihet re te mjaft kuadro e punëtorë, liberalizmi në zbatimin e ligjeve, të rregulloreve, vendimeve, urdhëresave, urdhrave, udhëzimeve etj. Tash na rezulton se vështirësitë nuk kanë qenë të pakapërcyeshme, por më parë ishte punuar keq me njerëzit, prandaj mjaft të rinj e gra nuk futeshin në punë, por jetonin krejt si parazitë, sepse kërkonin vende pune të preferuara dhe vetëm në qytet, ose sepse kishin

pjesëtarë të tjerë të familjes në marrëdhënie pune me shtetin dhe siguronin «boll» të ardhura. Të dhënat që kemi, na tregojnë se mjaft përparime janë bërë në këtë drejtim, por puna do ndjekur në mënyrë që vru-lli i ndezur të mos shuhet si flakë kashte.

Shumë mungesa në punë viheshin re në ndërmarrjet shtetërore e në kooperativat bujqësore. Kishte që mungonin krejt pa arsye, por edhe midis atyre që mungonin me arsye, kishte mjaft që simulonin. Tetorëshi nuk shfrytëzohet plotësisht. Përveç mosfillimit në orar e srollatjeve gjatë punës, ishte bërë e zakonshme që jo një herë, po dhe dy herë pushohej për të ngrënë, herën e parë mëngjesin, pastaj drekën dhe kjo kohë e harxhuar pa punë nuk llogaritej jashtë tetë orëve të punës, por brenda tyre. Në këto drejtime na raportohet se tash është vendosur rregull, por rezultatet konkrete të këtyre masave do t'i shikojmë dhe do t'i matim me plotësimin e tejkalimin e planeve.

Inkurajuese janë të dhënat që kemi marrë për realizimin e planit nga ndërmarrjet ekonomike gjatë katërmujorit janar-prill. Edhe për Elbasanin, në qoftë se nuk gabohem, veç katër ndërmarrjeve që nuk plotësuan planin këtë katërmujor, të gjitha të tjerat e plotësuan dhe e tejkaluan atë. Raportohet se edhe katër ndërmarrjet e prapambetura po vihen në rrugë të mbarë dhe shpejt do të dalin nga kjo gjendje. Kjo është pozitive, po e ndiqni punën që të ecin edhe këto mirë dhe duke përqendruar vëmendjen te këto katër ndërmarrje, mos e hiqni kujdesin as nga të tjerat, që të mos mbetet pas asnjëra. Jeta vërteton se, kur i lë pa kontroll, edhe ndërmarrjet e përparuara dobësohen.



Për vendosjen e normave, e kemi thënë dhe herë tjetër se ka zvarritje burokratike. U bë një punë e mirë, thoni ju, që 80 për qind e punëtorëve punojnë me norma. Po pse të ketë akoma kaq shumë punëtorë që punojnë fare pa normë? Akoma ne kemi tejkalime të mëdha të normave, atëherë përse të mos vendosim si rregull që normat të mos ngrihen pak nga pak e me hamendje, por të studiohen mirë më parë, që normën ta tejkalojnë ata punëtorë që punojnë me ndërgjegje dhe e shfrytëzojnë intensivisht kohën e punës.

Punën e bërë për forcimin e disiplinës dhe për mobilizimin e të gjitha forcave për kryerjen e detyrave, sidomos në bujqësi, duhet ta shikojmë me rezultate konkrete, jo vetëm sepse në këtë sektor të rëndësishëm ka disa vjet që na janë krijuar deficite të ndjeshme, por edhe sepse sivjet moti i keq i vonoi shumë punimet bujqësore. Prandaj kërkohen përpjekje për të zënë kohën e humbur dhe njëkohësisht për t'u bërë bimëve të gjitha shërbimet që ta sigurojmë medoemos prodhimin e parashikuar.

Për mobilizimin e njerëzve për zbatimin e detyrave ekonomike i është vënë më shumë theksi anës edukative, edukimit politiko-ideologjik të tyre. Kjo është e drejtë dhe shumë e dobishme, por jo çdo gjë dhe jo nga të tërë zgjidhen çështjet vetëm në këtë rrugë. Kam parasysh këtu marrjen më mirë të masave tekniko-organizative nga drejtuesit e ndërmarrjeve, furnizimin materialo-teknik, vendosjen e rregullave të prera në punë, që nga kontrolli i ardhjes në orar deri te zhdëmtimi për dëmin material të shkaktuar. Në këto drejtime nga elementët e pandërgjegjshëm është abuzuar në

çështjen e demokracisë, duke thyer mjaft herë disiplinën e planit dhe parimin e centralizmit.

Në shkolla dhe në universitet ka pasur dobësi të theksuara si në punën e trupit mësimor, ashtu edhe nga nxënësit e studentët. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës nuk e ka kryer si duhet detyrën e vet në këtë drejtim. Ajo, duke qenë shumë e ngarkuar me punën e madhe që kërkonte riorganizimi i shkollës, sipas vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë, me plane, programe e tekste të reja, punë që, në përgjithësi, e përballoi mirë, harroi dhe nuk ndoqi si duhet gjënë kryesore të këtij riorganizimi, forcimin e punës edukative të shkollës. Në veprimtarinë edukative të shkollës ka akoma mjaft formalizëm. S'po bëhen përpjekjet e duhura për një harmonizim dhe lidhje më të mirë të punës së shkollës me atë të familjes dhe të organizatave shoqërore për ushtrimin e një ndikimi edukativ të për-bashkët.

Veçanërisht në shkollën tonë punohet dobët për formimin ideoestetik të nxënësve. Dhe këtu është fjala jo vetëm për dobësitë që vërehen në mësimin e lëndëve përkatëse, por sidomos për punën që zhvillohet brenda dhe jashtë procesit mësimor për zgjerimin e horizontit kulturor të nxënësve, për formimin e shijeve të tyre ideoestetike.

E njëjta gjë duhet thënë edhe për sa i përket edukimit moral të nxënësve. Tashmë dihen nga të gjithë thyerjet e disiplinës nga disa nxënës e studentë. Nga shkollat e mesme dhe tetëvjeçare, gjatë tremujorit të parë të këtij viti shkollor, ishin larguar mjaft nxënës dhe në disa shkolla që u kontrolluan, çdo nxënës i binte

të kishte bërë mesatarisht 40 mungesa, kurse nota mesatare ishte mjaft e ulët, midis pesës dhe gjashtës.

Është fakt i njohur tani se lufta për demokratizimin e shkollës nuk u bë e lidhur ngushtë me luftën për forcimin e disiplinës. Kohët e fundit nga Partia janë marrë masa serioze në këto drejtime dhe po duken përfundime të kënaqshme, megjithatë nga organizatat-bazë të Partisë në shkolla, nga organet e pushtetit, nga trupi mësimor dhe nga organizatat e rinisë kërkohet punë e vazhdueshme.

Organizatat e Bashkimit të Rinisë, posaçërisht në shkolla, por dhe në fshatra e qendra pune, nuk kanë qenë si duhet në krye të situatës për dobësi të udhëheqjes së saj, ndër ta dhe të Agim Meros, kur ishte sekretar i parë i Komitetit Qendror të BRPSH. Ky mjaft probleme i pa me sy liberal, iu rrit mendja dhe krijoi pikëpamje jo të drejta për rininë, gjë që dobësoi zbatimin e normave që udhëhiqnin jetën organizative të organizatës së saj.

Zbulimi i gabimeve të vërtetuara dhe autokritika që bënë organizatat e rinisë për to është një shenjë shumë pozitive dhe tregon se ato, të udhëhequra nga Partia, shpejt do ta shëndoshin gjendjen e tyre. Por Partia dhe kuadrot e rinisë duhet të nxjerrin mësim nga gabimet serioze që u lejuan të bëhen.

Njëanshmëria në drejtimin e punës së rinisë, prirja për të luftuar vetëm kundër patriarkalizmit dhe konservatorizmit, që ndrydh e frenon energjitë e rinisë, pa luftuar njëkohësisht edhe kundër ndikimeve borqjeze e revizioniste që e çoroditin dhe e degjenerojnë

atë, ishte një nga gabimet serioze në punën drejtuese të rinisë.

Nënvleftësimi i punës edukative në rini, bile pas punimit të Historisë së Partisë, heqja dorë nga format e organizuara për edukimin jashtë shkollës me masat e rinisë, duke menduar se në qendrat e punës rinia edukohet nga organizata e bashkimeve profesionale, ndërsa në fshatra nga organizata e Frontit Demokratik, ishte gjithashtu një gabim tjetër serioz.

Direktivat shumë të drejta të Partisë për të luftuar shfaqjet e zyrtarizmit, të burokratizmit dhe format e ngurta të punës me rininë, si edhe porositë e saj për të zbatuar një punë më të zhdërvjellët me rininë u interpretuan në mënyrë liberale, gjë që çoi në dobësimin e rregullave organizative, në shkeljen e disa normave të përcaktuara në statutin e Bashkimit të Rinisë. Në tërë punën që po bën sot Partia për forcimin e përgjithshëm të gjendjes, vend të veçantë duhet të zërë forcimi i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë.

E kemi thënë edhe herë tjetër se, veç udhëheqjes së rinisë, për këto dobësi në punën e organizatës së saj përgjegjësi të madhe kanë organizatat e Partisë, gjithë komunistët. Ku ishin ata që e lejuan këtë gjendje?

Komiteti Qendror i Partisë me të drejtë ka theksuar gjithnjë nevojën për t'u lënë më shumë iniciativë e vetëveprim organizatave të rinisë. Por mos vallë kjo do të thotë se Partia duhet të kujdeset më pak për rininë, se nuk është e nevojshme udhëheqja e vazhdueshme e saj për organizatën e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë? Te Partia rinia gjen forcën, orientimin dhe frymëzimin e saj. Kuadrot më të mirë të Partisë duhet

të ngarkohen t'i flasin rinisë, t'i shpjegojnë asaj qartë direktivat dhe vendimet që merr Partia. Dhe të mos ngjasë që edhe kandidati, që porsa pranohet në Parti nga radhët e rinisë, të largohet nga kjo organizatë, ose edhe kur merr pjesë në mbledhjet e saj, të mos japë atje asnjë ndihmë!

Rinia është një forcë e madhe e Partisë dhe e popullit tonë, një forcë e lavdishme që ka dhënë prova të mëdha besnikërie në Luftën e madhe Nacionalçlirimtare, si dhe në luftën për rindërtimin e atdheut. Partia kurdoherë ka besim të patundur te rinia, se ajo është e shëndoshë ideologjikisht e politikisht, parimore dhe luftarake. Shfaqjet që u vërtetuan vetëm te një pjesë e vogël e saj nuk janë karakteristika të gjithë rinisë sonë. Këtë duhet ta ketë të qartë Partia, duhet ta kenë të qartë, gjithashtu, edhe masat e popullit. Të mos harrojmë kurrë se rinia ka qenë dhe mbetet gjithnjë objekt i veprimtarisë së të gjithë armiqtve tanë, të jashtëm e të brendshëm. Prandaj duhet ta kalitim e ta brumosim vazhdimisht si revolucionare, si duke i folur për të kaluarën, për luftën e për vështirësitë e kapërcyera, ashtu edhe duke e hedhur në aksione, duke bërë që rinia të angazhohet seriozisht në punë, sa kohë që e reja ose i riu është nxënës e student, në mësim. Kurse kur del në jetë, në punën prodhuese apo kudo që të caktohet, rinia duhet të tregohet kurdoherë revolucionare, ashtu siç është në fakt.

Nuk duhet lejuar që të propagandohet si pa të keq në masat e popullit që «ja, të rinjtë i bëjnë këto», «rinia bën kështu», «rinia është ashtu». Këto shprehje duhen goditur, pse me një propagandë të tillë armiqtë përpiqen

ta shkëputin rininë nga Partia, nga rruga e saj e drejtë dhe ta tërheqin pas vetes. Këto shfaqje, që Partia lufton t'i zhdukë, i manifestojnë vetëm disa të rinj, por a nuk ka edhe të moshuar që janë të infektuar nga të tilla gjëra? Fundi i fundit edhe kur këto duken te disa të rinj, nuk janë pa faj as të moshuarit që nuk kanë pasur kujdes për edukimin e tyre. Prandaj kërko-het që ata të preokupohen më shumë për edukimin e brezit të ri. Gjithashtu, shkolla, institucionet artistike e kulturore, tërë mjetet e propagandës, sporti etj., të vi-hen më mirë në shërbim të edukimit revolucionar të rinisë.

Shkaku i këtyre dobësive, shokë, në praktikën e punës së Partisë, siç e thashë, është liberalizmi, por duhet theksuar se ky problem është trajtuar pak në mbledhjet e organizatave-bazë. Për të treguar ku e ka burimin ky liberalizëm po shtroj disa ide të përgjith-shme:

Në mjaft raste nuk ka një ndjenjë të plotë përgjegjësie nga çdo organizatë-bazë në tërësi dhe nga secili komunist në veçanti për të zbatuar vijën e Partisë në të gjitha sferat e jetës ku ajo vepron. Në disa sektorë të artit e të kulturës ka koncepte, sipas të cilave problemet artistike e kulturore janë çështje të specialistëve, prandaj ato s'mund t'i trajtojnë organizatat-bazë. Duke u pajtuar me këto koncepte fund e krye të gabuara, mjaft organizata partie në këta sektorë lidhën duart. Rutina dhe praktika e përditshme i bën disa organizata-bazë të tjera që të merren me çështje të ditës, si me kalendarin bujqësor etj., dhe të mos merren si duhet me problemet thelbësore ideopolitike, me edukimin e

njerëzve tanë. Ka pastaj organizata-bazë që, edhe kur shqyrtojnë probleme ekonomike, nuk i trajtojnë ato politikisht. Ndodh që edhe kur vihen re të meta e dobësi, nuk bëhen përpjekje për të gjetur shkaqet ideologjike të tyre, nuk përcaktohen mirë masat për zhdukjen e dobësive dhe nuk punohet sa duhet për t'u çelur masa-ve punonjëse perspektivën në këto drejtime.

Liberalizmi në jetën e brendshme të organizatave-bazë e ka burimin edhe në moszbatimin e normave të Partisë. Nuk njihet mirë nga të gjithë komunistët Statuti, ku janë sintetizuar parimet e normat e Partisë. Pikërisht këtu e kanë burimin mungesat në mbledhjet e zakonshme të organizatave-bazë, mosrespektimi i orarit të mbledhjeve të saj, moszbatimi i normave, mungesa e kërimit të llogarisë etj. Puna me vendimet në shumë raste është e dobët. Ka bile organizata-bazë që s'marrin fare vendime, ndërsa disa të tjera i marrin ato në formë të përgjithshme. Kjo bën që komunistët të mos aktivizohen dhe të mos nxjerrin detyra, për pasojë edhe disiplina e Partisë lë shumë për të dëshiruar. Në këtë mënyrë edhe kontrolli për zbatimin e detyrave dobësohet së tepërmi.

Në shumë raste nuk kuptohet si duhet roli pararojë i komunistit në zbatimin e detyrave. Komunistit s'i kërkohet llogari në organizatën-bazë si e kryen ai detyrën si militant politik, si aktivist shoqëror, si e kryen ai detyrën në punën e caktuar dhe a dallohet nga punonjësit e paorganizuar në Parti, a e jep shembullin personal dhe a i frymëzon punonjësit e tjerë që ka rreth vetes, që edhe ata të punojnë si duhet për plotësimin e detyrave.

Është e domosdoshme që edhe edukimi i sekretarëve të organizatave-bazë në kurse e në seminare të veçanta të bëhet jo vetëm për çështje me karakter organizativ, por edhe për çështje ideologjike, ku të mësojnë si të merren dhe si të punojnë sa më mirë për edukimin e anëtarëve të organizatës. Edukimi i njerëzve ka rëndësi të jashtëzakonshme. Njerëzit tanë e dinë se Partia jonë është Parti që udhëheq kudo e në çdo gjë, prandaj duhet të kuptojnë politikisht dhe ideologjikisht këtë rol udhëheqës të saj. Ai nuk duhet të kuptohet i kufizuar, vetëm te Komiteti Qendror i Partisë ose te komitetet e Partisë në rrethe. Jo, te ne udhëheq e drejton tërë Partia, me format dhe me rregullat që ka vendosur, me normat e saj të disiplinës dhe të centralizimit.

Që të kuptohet thellë kjo, natyrisht duhet të edukohen mirë ideologjikisht gjithë komunistët, pse ka shumë prej tyre që e harrojnë këtë parim të madh. Komunisti i thjeshtë harron, ose nuk e ka parasysh gjithmonë se ai është një drejtues. Kudo që jeton dhe punon, ai e ka për detyrë të vërejë, të ndihmojë, të kontrollojë, të edukojë të gjithë ata që ka rreth vetes dhe t'i mobilizojë në mënyrë të ndërgjegjshme për realizimin e detyrave. Komunistin duhet ta vrasë ndërgjegjja në rast se nuk mëson vazhdimisht për vete, me qëllim që të ndihmojë për t'i edukuar sa më mirë masat që ka pranë dhe, ca më keq, kur qëndron në bisht të tyre. Në rast se në kolektivin ku punon një komunist i tillë, vërchet se ka njerëz më të zotë se ai, atëherë përse duhet të rrijë ky në Parti? Për ç'arsye të mbahet kur nuk dallohet mbi të tjerët në çdo drejtim, nuk jep shembullin personal dhe nuk bën përpjekje që t'i nxitë e t'i frymëzojë ata për



realizimin e detyrave? Të gjitha kërkesat dhe detyrat që vë Partia për të zgjidhur, në radhë të parë, janë për komunistët. Këta duhet të jenë vetë në frontin kryesor të luftës, të punës, të vendosur gjer në fund për përballimin e vështirësive e të çdo sakrifice, pse vetëm kështu ata do të kenë të drejtën morale të kërkojnë nga të tjerët që të jenë luftëtarë dhe të punojnë mirë e me ndër-gjegje të lartë socialiste.

Kërkimi i llogarisë është i domosdoshëm për të gjithë, por komunisti, në radhë të parë, duhet t'i kërkojë llogari vetes. Ky proces i madh i brendshëm, ky shikim si në pasqyrë i të mirave dhe i të metave vetjake kërkon përpjekje për të luftuar me vendosmëri për zhdukjen e këtyre të metave dhe për të rritur vetitë e mira; vetëm kështu komunisti do të jetë në gjendje t'u kërkojë llogari të tjerëve. Këto përpjekje duhet t'i bëjë doemos secili, kurse komunisti duhet të luftojë akoma më shumë që të jetë vetë i pastër, që kur t'u kërkojë llogari të tjerëve, këta të mos kenë ku të gjejnë tek ai asnjë «pluhur», ndryshe, ata do të thonë: ai le të fshijë më parë «pluhurin» që e ka zënë, pastaj të kërkojë prej nesh. Komunisti duhet të bëjë përpjekje të pastrojë vetë ndërgjegjen, por të jetë, gjithashtu, i gatshëm të pranojë me gjakftohtësi të madhe që t'ia pastrojnë edhe shokët, sepse ata, gjithashtu, kanë të drejtë ta kritikojnë që ky të pastrojë njollat nga ndërgjegjja.

Kërkesa e llogarisë në rrugë partie te ne është kurdoherë e domosdoshme, pse e domosdoshme është edhe disiplina e vazhdueshme në punë për të mobilizuar të gjitha mundësitë për realizimin e planeve në të gjithë sektorët. Pa vendosur një disiplinë të rreptë e të vetë-

dijshme proletare në punë, do të kemi kurdoherë mosrealizime; prandaj lëshimet në këtë drejtim janë të palajshme. Kjo çështje duhet kuptuar drejt.

Edhe demokracia duhet të kuptohet drejt. Në qoftë se ka shtet më demokratik në botë, ky është shteti ynë, ku ekziston një demokraci e vërtetë proletare. Por demokracia jonë nuk mund të barazohet në asnjë mënyrë me liberalizmin. Liberalizmi s'ka të bëjë fare me demokracinë. Mirëpo disa njerëz i ngatërrojnë këto dy koncepte të ndryshme, megjithëse demokracia jonë e vërtetë nuk e lejon liberalizmin. Në vendin tonë Partia dhe shteti i proletarëve u kanë siguruar shtetasve të gjitha të drejtat, si ato të punës, të arsimit, të shfaqjes së lirë të mendimeve, të pjesëmarrjes në të gjitha punët e drejtimit shtetëror etj. Secili te ne ka, gjithashtu, të drejtë të kritikojë hapur dhe cilindo për të meta në sferat e ndryshme të punës dhe të jetës, por, në qoftë se ndodh që dikush nuk kritikon drejt, atëherë ka të tjerë që e kritikojnë këtë për ta ndrequr dhe, kur shihet se kritika bëhet me qëllim shpifjeje ose, ca më keq, me prirje armiqësore, atë e dërrmojnë. Çështja e demokracisë te ne nuk shtrohet si gjetkë, si një demokraci false borgjeze, po demokracia jonë është demokraci e vërtetë, e plotë dhe e gjithanshme, në interes të proletariatit dhe të socializmit. Demokracia jonë nuk e lejon tjetrin të flisë mbarë e mbrapsht, proletariati nuk i lejon armiqtë e tij të përmbysur t'ia marrin nga duart fitoret e arritura me gjak.

Përse po bëhet gjithë ky edukim te ne? Që njerëzit të jenë të matur në çdo punë e në çdo veprim, që ata të piqen, por pjekuria vjen gradualisht, ashtu siç fitohet

gradualisht eksperiencia e madhe në punë, nëpërmjet ndeshjes me vështirësitë, edukimit ideopolitik etj. Gjithë puna e Partisë e bën njeriun tonë që t'i kuptojë çështjet realisht, të bëjë kritika të drejta, me një fjalë ta përdorë demokracinë në interesin e përgjithshëm, në frymën e vërtetë të saj dhe pa dëmtuar të drejtat e shoqërisë në tërësi ose të individëve të veçantë. Pra, askush të mos e ngatërrojë demokracinë tonë, sundimin e shumicës mbi pakicën, me liberalizmin mikroborgjez, me shthurjen dhe anarkinë, të cilat janë të dënueshme nga Partia. Në këtë çështje duhet të jemi rigorozë. Partia na mëson të kemi kurdoherë parasysh se çdo teprim dhe shkarje, qoftë nga e majta, qoftë nga e djathta, i sjell kurdoherë dëme socializmit, vijës së Partisë dhe është në dobi të armiqve të klasës, sepse fuqizon presionin e tyre dhe bllokadën armiqësore ndaj vendit tonë.

Prandaj çdo shtetas e patriot, cilindo veprim të tij, çdo hap që hedh e çdo fjalë që thotë, duhet t'i matë kurdoherë në prizmin e interesave të mëdhenj të atdheut dhe të Partisë. Në qoftë se shikohen çështjet kështu, atëherë asnjëri nuk ka për të gabuar kurrë. Në qoftë se, përkundrazi, ndonjëri largohet nga ky parim, atëherë bie në prehrin e interesit të ngushtë personal, që zhvillohet në forma të ndryshme dhe që çon në qorrrokak.

Ne, komunistët, edukohemi ta zhvillojmë jetën në rrugën e drejtë që na mëson Partia. Ashtu si koha, edhe jeta ecën pa ndërprerje, ajo ngre vazhdimisht probleme të pritura dhe të papritura, të parashikuara dhe të paparashikuara. Këtyre të papriturave duhet t'u gjeshë barin e shërimit dhe rrugën e zgjidhjes në kohën e duhur, se jeta nuk pret, shumë nga problemet nuk presin,

prandaj duhet të na gjejnë të gatshëm për t'i zgjidhur. Ka shumë prej këtyre problemeve që janë të rastit dhe të çastit, megjithatë Partia duhet t'u gjejë zgjidhjen më të drejtë e në kohën e duhur, prandaj komunisti e ka për detyrë të jetë gati, në këmbë, në çdo kohë, që t'u japë përgjigje dhe zgjidhje çështjeve. Që ta bëjë mirë këtë punë, ai duhet të jetë vetë i përgatitur, i ngritur mirë ideologjikisht dhe politikisht dhe i prirur kurdoherë nga një frymë e lartë revolucionare, sepse kështu do të gabojë më pak dhe do të ndihmojë që jeta në vendin tonë të ecë gjithnjë e më përpara, duke qenë i ndërgjegjshëm që të gjitha problemet e jetës duhen përballuar.

Por komunistët nuk mund të jenë të tërë njëlloj, ata janë vërtet anëtarë ose kandidatë për anëtarë partie dhe kanë teserat në xhep, janë besnikë deri në vdekje për Partinë, atdheun etj., por midis tyre ka disa që nuk i kanë të qarta një varg çështjesh, ndonjëri lëkundet dhe ka raste që shpreh mosbesim për ndonjë problem. Disa herë presioni i borgjezisë e bën ndonjërin edhe të mos veprojë me energji, të tregohet i mefshtë etj.

Po në popull? Në popull ka më shumë të tillë. Atëherë çfarë detyre i vihet Partisë në këto raste? T'i përballojë me vendosmëri të gjitha shfaqjet e dobësitë që zbulohen dhe të punojë që bartësit e tyre të shkunden dhe të ndreqen, ndërsa armikun ta godasë. Për t'i përballuar këto situata opinioni duhet mbajtur i ngritur, siç është aktualisht. Mos vallë kjo gjendje sjell ndonjë gjë të keqe? Jo, përkundrazi, sjell vetëm të mira. Në vëmë re që para se të ngriheshin këto çështje, plani i nxjerrjes së kromit, nuk ishte realizuar, ndërsa tani u

realizuan edhe boshllëqet e krijuara gjatë muajve të parë të këtij viti. Kjo u arrit, se u ngritën në këmbë gjithë minatorët, të cilët u shqetësuan për pakujdesinë e treguar dhe i bënë thirrje ndërgjegjes së tyre, se nuk kishin vepruar drejt.

Pra, që të ngrihet opinioni në këmbë duhet që Partia të jetë vigjilente, propaganda e saj të jetë e gjallë, e organizuar dhe të godasë në shenjë, të mos jetë propagandë për propagandë. Në çdo moment duhet gjykuar: cili është problemi që del më në pah? Atëherë për zgjidhjen e tij duhet të veprojë propaganda në mënyrë të organizuar dhe bindëse. Po si mund të goditet në shenjë, në qoftë se nuk ndiqen shfaqjet që nxjerr jeta, brenda ose jashtë dhe nuk zbulohen shkaqet nga vijnë këto shfaqje? Propaganda nuk mund të godasë në shenjë, kur nuk ndiqet jeta në zhvillimin e saj, me të mirat dhe dobësitë.

Kur shihet, fjala vjen, se mungojnë nxënësit nëpër shkolla, do të thotë se ky është një problem me rëndësi për arsimin, prandaj Partia dhe organet e pushtetit duhet të fillojnë një propagandë të zgjuar dhe intensive në shkolla, ndër fëmijët, në familje e kudo, në mënyrë që kjo situatë e dëmshme menjëherë të likuidohet. Puna ideopolitike e Partisë duhet t'i përshtatet jetës, ngjarjeve, rrethanave, të ketë objektivin e saj imediat dhe perspektiv, se vetëm kështu do të jetë parandaluese dhe edukuese.

Letërsia dhe artet në vendin tonë, nën kujdesin e vazhdueshëm të Partisë, janë zhvilluar në rrugë të drejtë marksiste-leniniste dhe kanë luajtur një rol me rëndësi në edukimin komunist të masave. Ato kanë ndjekur

procesin e revolucionarizimit të jetës së vendit, kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në luftën për edukimin e njeriut të ri, me frymë patriotike e ndërgjegje socialiste, kanë ndihmuar për të ngritur më lart kulturën tonë të re socialiste.

Letërsia dhe artet, ashtu si gjithë veprimtaria e lufta e shoqërisë sonë socialiste, të udhëhequra nga Partia, janë zhvilluar në luftë me ndikimet e huaja ideologjike, të vjetra e të reja, konservatore e moderniste, e sidomos me ndikimet e huaja borgjezo-revizioniste. Një rëndësi të veçantë në këtë luftë kanë pasur orientimet e Plenumit të 15-të të Komitetit Qendror të Partisë, të vitit 1965<sup>1</sup>.

Por vitet e fundit, si rezultat i presionit të huaj e sidomos i dobësive të karakterit subjektiv në zhvillimin e luftës klasore ideologjike, në letërsinë, në artet tona, si dhe në punën kulturore për edukimin ideoestetik të masave, janë vënë re disa ndikime të hapëta të ideologjisë borgjeze e revizioniste e janë mbajtur qëndrime liberale ndaj tyre.

Në letërsi dhe në arte ka pasur shfaqje të liberalizmit dhe të modernizmit antiproletar, tendenca gjoja novatore për të shtrembëruar vijën, përkrahje dhe grupe nga ana e Fadil Paçramit dhe e Todi Lubonjës të një sërë elementësh liberalë e të deklasuar, tendenca

---

1. Ky Plenum, që i zhvilloi punimet më 25-26 tetor 1965, diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi rritjen e rolit të letërsisë dhe arteve për edukimin komunist të masave», mbajtur nga sheku Ramiz Alia. Në mbyllje të Plenumit, sheku Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm. (Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 39, f. 363.)

për të përhapur rrymat dekadente në letërsi, në muzikë, në teatër, në pikturë e gjetkë.

Tendenca revizioniste e këtyre elementëve jo në rrugë partie ka pasur për qëllim degjenerimin e rinisë, të studentëve, që këta të bëheshin mbështetja e punës së tyre armiqësore. Natyrisht, ata do të dështonin, ashtu siç dështuan.

Këta elementë që devijuan nga vija e Partisë, kur vepronin, hiqeshin si «kompetentë» e «specialistë» të mbaruar për problemet e letërsisë dhe të artit, jepnin mendime për çdo vepër, përkrahnin, natyrisht, të gjitha ato që u vinin për osh dhe denigronin të tjerat. Ata hiqeshin si «njohës të vijës», të jetës e të zhvillimit, por i shikonin së prapthi. Ata mendjen dhe zemrën nuk i kishin brenda në atdhe, fizikisht ishin këtu, po livadhisnin jashtë dhe bënë përpjekje që rrymat dekadente, si kubizmin në pikturë e hermetizmin në poezi etj., t'ia impononin zhvillimit të letërsisë e arteve tona. Natyrisht, kur u shkundën nga Partia, filluan qarjet: «Nuk njohëm jetën», «u gabuam», «nuk ishim të qartë në artet figurative» e të tjera slogane për të kapërcyer lumin.

Sigurisht që thjeshtësimi i rrezikut të ndikimeve mikroborgjeze revizioniste, sidomos nga elementët «e mësuar» intelektualë, nuk është një harresë, por një prirje, një tendencë që, po nuk u luftua, trashet. Predikimet se ndikimet e huaja «ekzistojnë në potencë», «nuk formojnë ndonjë rrezik» janë filozofime intelektualësh.

Të tillë njerëz kishin arritur deri atje sa ta përçmonin folklorin tonë dhe ta identifikonin atë me konservatorizmin. Ata kishin bërë të tyret të gjitha tiparet

e kritikës revizioniste e borgjeze të çdo kohe ndaj kulturës së popullit. Çdo gjëje të mirë e të bukur popullore të vendit tonë i ngjithnin nga një etiketë përçmuese si «folklorizëm» etj., shumë herë të pakuptueshme dhe nga ata vetë, pse ishin terma korrentë borgjezë në letërsi e në art, që rrjedha e kohës i kishte hedhur vetë në kanale. Këta estetë modernistë i vinin rëndësi formës artistike dhe aspak brendisë, përmbajtjes ideologjike e politike.

Ku do të mbështeteshin këta njerëz? Natyrisht jo në traditën tonë, kombëtare, e cila prej tyre konsiderohej regres, po në një «novatorizëm» të kuptuar sipas pikëpamjeve të tyre liberale. «Deri sot kemi folur për luftën në mes nesh dhe armikut, — thotë Fadil Paçrami, — tash duhet të flasim për luftën në mes nesh», domethënë, sipas tij, të harrojmë armikun dhe të mos flasim më për të.

Këta elementë snobë në art, në muzikë, në teatër bënë të tyre rrymat e vjetra dhe të reja borgjeze e moderniste në këto gjini dhe, duke u udhëhequr prej tyre e duke u shfaqur si njerëz «kompetentë», krijimeve realiste të njerëzve tanë u ngjithnin nga një etiketë përçmuese si, për shembull, «vepër natyraliste», «vepër arkaike», «vepër akademike», «vepër fotografike». Atyre u pëlqente ritmi i xhazit, Pikasoja i «epokës blu», i «epokës dada», i «epokës së kubizmit e abstraksionizmit» nëpër të cilat ka kaluar ai në pikturat e tij. Këtyre u pëlqente që njeriu t'i ngjiste «fikut të detit» dhe këmbët t'i kishte si «rrënjët e rrapit» dhe këto i realizonin në poezitë e në krijimet e tjera të tyre. Po për t'i fshehur këto tendenca degjenerimi borgjez e revizionist në



art dhe për të minimizuar rrezikun e tyre në rastet kur ato kritikohen, ata nxitojnë t'i quajnë shfaqje të thjeshta, formaliste, që zakonisht shoqërojnë krijuesit e rinj pa përvojë por jo si tendenca revizioniste. Ata thonë se kritikën që bëheshin kundër ndikimeve të huaja në arte, ishin gjoja vetëm «inate» çasti. Por këto «inate» nuk janë as të çastit, as edhe pa domethënie ideologjike.

Megalomania e disa intelektualëve shkrimtarë kishte arritur deri aty sa, duke spekuluar me parullën «shkrimtarët janë inxhinierë të shpirtrave njerëzorë», të shpreheshin: «E kemi ndier veten si parti e vogël», duke krijuar iluzionin se ishin ata që formonin dhe drejtonin opinionin e shoqërisë. Këta megalomanë të sëmurë mendonin se ishin ajka e intelektualëve tanë popullorë, se ishin ata dhe s'kishte të tjerë! Inteligjencia e prodhimit, inteligjencia e shkollave as që përfillej prej tyre. «Jemi të lirë të krijojmë ç'të duam dhe kur të duam», mendonin ata. Për ta s'kishte kërkesa, s'kishte disiplinë pune, as frenim dhe kontroll imagjinate e frymëzimi, të cilat, sipas pikëpamjeve të tyre, mund të realizoheshin jashtë realitetit dhe jashtë vijës së Partisë, jashtë normave të shoqërisë sonë socialiste. Bota e vogël mikroborgjeze dhe intelektualizmi i sëmurë i gozhdonte disa shkrimtarë dhe artistë liberalë të mos shihnin drejtësinë dhe madhësitinë e vijës së Partisë, të mos edukoheshin me frymën dhe me normat e saj.

Njerëzit tanë të artit nuk duhet t'i pranojnë, as t'i gëlltitin e t'i zbatojnë rrymat, korrentet, shkollat e ndryshme borgjeze. Edhe kritikën që u janë bërë këtyre rrymave t'i shohin e t'i vlerësojnë vazhdimisht nën prizmin e kritikës marksiste-leniniste. Por ka te ne të tillë

kritikë që angazhohen duke sulmuar vepra arti të artistëve tanë nga pozitat gjoja kundër natyralizmit, kundër akademizmit, duke marrë në fakt në mbrojtje kubizmin, hermetizmin etj. Përcaktimi i këtyre rrymave të ndryshme në art, kritika dhe mbrojtja që u është bërë, nuk njihen konkretisht, nuk njihet nga ç'pozita janë nisur autorët që kanë kritikuar ose kanë mbrojtur këto rryma, se ku e kanë pasur burimin këto qëndrime dhe çfarë ka rezultuar prej tyre. A duhet t'i pranojmë ne arsyetimet që ka bërë borgjezia për këto rryma apo t'i kalojmë në shoshën marksiste-leniniste? Dhe ca më keq, a mund të lejojmë ne që veprave të artistëve tanë t'u ngjitem në mënyrë shablone e të padrejtë tituj të tillë, për të qenë brenda mendimit borgjez në art dhe të kërkojmë të ndjekim po atë rrugë që ka ndjekur arti borgjez, duke bërë, siç bëjnë disa nga artistët tanë që thonë: «Të marrim diçka edhe nga kubizmi»? Atëherë pse jo edhe nga dadaizmi e kështu me radhë?

Po çfarë është kubizmi? Definicionin e këtij korenti regresiv degjenerues në art e gjejmë në çdo manual. Ai konsiston në vija gjeometrike dhe në sipërfaqe plane. Kubizmi karakterizohet nga largimi absolut i shfaqjes, i pasqyrimit real të pamjes së njeriut, të kafshës ose të sendit. Për kubizmin fytyra e njeriut etj. përbën «tragjiken», prandaj për t'i qëndruar larg kësaj, thonë kubistët, duhet ta paraqitim atë të shpërftytyruar vetëm në vija. Kjo është tabloja e tyre.

Si mund të pranojmë ne marksistët këtë rrymë dekadente, që përbuz vlerat e vërteta kulturore, përbuz skulpturën greke dhe kulturën e famshme të Rilindjes, të cilat i quan «iluzioniste», «akademike». Në këtë

kulturë kubistët gjejnë gjoja shkakun që çoi njeriun në mbivlerësimin e vetes, në ndarjet e në grindjet shoqërore. Kuptohet që këta njerëz të çoroditur kanë pasur pikëpamje jo vetëm të padrejta, por edhe antishoqërore e antimarksiste për burimin e konflikteve ndërmjet klasave dhe për zhvillimin materialist të historisë. Tablotë e kubizmit karakterizohen nga abstraksioni dhe, si të tilla, janë shumë larg pasqyrimit të realitetit. Kishte edhe nga njerëzit tanë që kërkonin të merrnin prej këtyre rrymave dhe t'i futnin në artet tona. Realizmi socialist është në kundërshtim të plotë me të gjitha këto rryma, që nga kubizmi e deri tek abstraksionizmi e surrelizmi.

Disa të paktë poetë të rinj filluan të adoptonin në poezitë e tyre rrymën dekadente, «hermetizmin». Kjo është fare e huaj për letërsinë tonë, për njerëzit tanë të një vendi socialist. me një demokraci nga më të përparuarat, se është demokraci proletare. Shkrimet e errëta, hermetike, janë pjellë e mendimit dhe e ndjenjave të çoroditura të njerëzve ku sundon kapitali, janë pjellë e shtypjes dhe e shfrytëzimit të njeriut nga njeriu, e shtypjes nacionale. Këto tendenca antisocialiste në poezi i përkrahnin me të madhe njerëzit me pikëpamje revizioniste, si Fadil Paçrami.

Te disa nga njerëzit tanë të artit dhe të letërsisë shikojmë të shfaqen tendenca abstraksioniste. Në veprat e tyre ata përpiqen të dalin nga rruga reale e natyrës dhe, si intelektualë që janë, përpiqen të bëjnë vetëm abstraksion. Ata orvaten të mos marrin nga natyra as edhe një element, qoftë edhe formal, për ta çdo gjë buron nga natyra e autorit dhe kjo çdo gjë materializohet

gjoja me interpretimin abstrakt. Prandaj, ne marksistët duhet t'i luftojmë këto tendenca të gabuara në art dhe në letërsi.

Në botën borgjeze bëhen përpjekje për t'i gjallëruar të gjitha këto shkolla të panumërta, që lindin si körpudhat dhe u përngjasin mendimit reaksionar, sektive fetare dhe herezive që janë zhvilluar gjatë shekujve. Marksistë-leninistët, ashtu si luftojnë kundër çdo gjëje reaksionare, kundër feve dhe herezive, duhet të luftojnë edhe ndaj të gjitha këtyre shkollave kaq të rrezikshme e të dëmshme për edukimin estetik të njeriut të ri.

Disa punonjës tanë të artit zhvillojnë luftë këmbëngulëse kundër të ashtuquajturit akademizëm dhe veprat e artistëve tanë të rinj, që pak njohin ç'do të thotë akademizëm, por kanë pasqyruar aq sa kanë mundur jetën e vendit, nuk mungojnë t'i akuzojnë se gjoja ndjekin këtë korrent. Ta përdorësh akademizmin në kuptimin përçmues të fjalës, ashtu siç është përdorur ai nga kritika borgjeze, pa ditur se ku e kanë origjinën këto kritika, natyrisht, është një punë e dëmshme dhe pa vend, pse krijuesi, edhe ai që lufton me fjalë akademizmin, kur gjendet përpara veprave të Leonardo da Vincit dhe të Mikelanxhelo Buonarotit etj., habitet, kënaqet dhe bie në ekstazë. Shkolla e Firences, me këta e me shumë të tjerë, ka qenë shprehja më e lartë e humanizmit të Rilindjes. Këto shkolla kanë dominuar disa shekuj dhe kanë frymëzuar plejada të tëra artistësh.

Më vonë, në shekullin e 19-të e të 20-të, borgjezia i stërholloi shijet e saj të mbrapshta, i ngurtësoi disa kërkesa të artit të Rilindjes dhe i shndërroi ato në nor-

ma zyrtare. Kundër këtyre normave lindën si reaksion rryma e shkolla të tjera që i dhanë më shumë prioritet imagjinatës. U bë kështu ndarja mes atyre që në botën artistike u quajtën artistë zyrtarë, akademikë, dhe të tjerëve që u quajtën të kohës, modernë dhe që atëherë akademizmi mori kuptim përmues, u bë sinonim i konformizmit, sinonim i mbrojtjes së konservatores, së vjetres, së prapambeturës. Po në gjithë këtë zhvillim të arteve dhe të shkollave të ndryshme, do të jetë foshnjarake nga ana jonë të mos njohim dhe të mos bëjmë dallim, kurdoherë nën dritën e një analize marksiste-leniniste, të drejtimeve progresive dhe regresive në art. Prandaj nuk është e drejtë të përdoren për të vlerësuar krijuesit tanë dhe krijimet tona ata terma që përdor borgjezia, pa studiuar e pa kuptuar brendinë dhe zhvillimin e tyre dhe ca më pak t'i përdorin këto kritika të borgjezisë pa mbajtur parasysh kohën kur janë bërë dhe arsyet për të cilat janë bërë.

Edukata ideopolitike e shkrimtarëve dhe e artistëve dhe puna e Partisë në organizatat ku militojnë ata, duhen forcuar. Për komunistët nuk ka dy lloj qëndrimesh, një në organizatën-bazë dhe një tjetër jashtë saj. E theksoj këtë, sepse disa komunistë, kur venë në organizatë, flasin në rregull, ndërsa kur dalin jashtë, veprojnë në të kundërtën.

Normat e Partisë në vijë, në punë, në jetë janë të domosdoshme për të gjithë dhe askujt nuk i lejohet t'i shkelë o t'u bëjë bisht atyre. Sidomos komunistëve intelektualë është e nevojshme t'u theksohet kjo vazhdimisht që të mos e harrojnë.

Nga komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë në

këto sfera kërkohet një punë e gjerë dhe e kujdesshme, e pjekur dhe pa lëkundje, kërkohet mënjanimi i qëndrimeve ekstreme që kanë për bazë liberalizmin dhe sektarizmin, mungesën e qëndrimit kritik ose konceptin e të qenit brenda. Për zgjidhjen e problemeve nga pozita parimore marksiste-leniniste, për përcaktimin e kriteve e të përpjesëtimeve të nevojshme të kulturës së huaj, që do të përdoret nga institucionet e ndryshme botuese, kulturore e artistike, në varësi nga mundësitë konkrete të tyre, kërkohet edhe një punë e diferencuar, pa rënë as në ksenofobi, as në ksenomani.

Ne duhet të kemi besim te shkrimtarët dhe artistët tanë. Krijuesit dhe punonjësit e kulturës e të artit, si kurdoherë, do t'i shtrëngojnë akoma më shumë radhët e tyre rreth Partisë. Nën udhëheqjen e saj dhe me përpjekjet e tyre revolucionare ata do të pastrojnë ato barëra të këqija që janë dukur në jetën tonë letrare, artistike e kulturore dhe me siguri do të çojnë përpara me guxim çështjen e madhe të kulturës, të letërsisë e të artit tonë socialist.

Në këtë rrugë e në këtë luftë, krahas kritikës parimore e konstruktive të Partisë, ata duhet të gjejnë kurdoherë ngrohtësinë dhe kujdesin e saj pa rezerva, se puna e tyre e mirë është pjesë e pandarë e revolucionit ideologjik dhe e kulturës sonë socialiste. Ne kemi besim se shkrimtarët dhe artistët tanë do të krijojnë vepra të frymëzuara nga idealet e mëdha revolucionare dhe nga lufta heroike e popullit tonë.

Detyra e Partisë është t'i ndihmojë njerëzit e artit jo vetëm për ngritjen e mëtejshme ideestetike të tyre, por edhe që të jetojnë më afër masave, të lidhen ngu-

shtë me shqetësimet e me luftën e tyre, të marrin pjesë aktive në aksionet e mëdha ideopolitike dhe ekonomiko-shoqërore të punonjësve. Kontaktet me masat janë absolutisht të domosdoshme, por këto të mos kuptohen si slogane, si literaturë, si shëlitje, por si punë ku shkrimtarët dhe artistët tanë do të bazojnë krijimtarinë e tyre, e cila duhet të jetë e shëndetshme, brenda vijës, brenda kërkesave të shoqërisë sonë. Krijimtaria e tyre duhet t'i rezistojë kritikës së masës, që është i vetmi gjykatës i drejtë e i kualifikuar.

Në përgjithësi, të gjithë njerëzit e kulturës, veçanërisht të rinjtë, duhen inkurajuar në rrugë të drejtë partie. Të mos lejohet krijimi midis tyre i tendencave të gabuara, «të rinj e të vjetër», «ju keni gabuar, ne s'kemi gabuar», «ju na keni akuzuar si konservatorë dhe tash ne ju akuzojmë liberalë». Gabimet duhet të shihen me sy partie, kudo ku janë shfaqur dhe duhen ndrequr. Ne komunistët nuk i ndreqim ato me frymën e hakmarrjes, të smirës dhe të inatit mikroborgjez, as vetëm me një autokritikë, qoftë kjo edhe e mirë, por me punë, me krijimtari, me vullnet dhe me besim të shumëfishuar, pa rënë në dëshpërim, në apati, në tërheqje nga fronti.

Duke trajtuar ndikimet e huaja ideologjike dhe shfaqjet e tyre konkrete në letërsi e në art, shkaqet e këtyre ndikimeve dhe përgjegjësitë për to, është e domosdoshme të theksojmë fort edhe një herë se përgjithësisht letërsia dhe artet tona janë zhvilluar në rrugë të drejtë, janë frymëzuar nga vija e Partisë dhe nga interesat e popullit e të socializmit. Këtë e vërteton realiteti i gjallë i zhvillimit të letërsisë e të arteve tona në

përgjithësi e konkretisht edhe gjatë periudhës së fundit, që nga Plenumi i 15-të i Komitetit Qendror për letërsinë e artet.

Letërsia dhe artet tona kanë arritur zhvillime të reja të rëndësishme, sasiore e cilësore, dhe u kanë bërë jehonë hovit revolucionar të masave, ngritjes së nivelit të ndërgjegjes e të kulturës së tyre.

Shkrimtarët dhe artistët tanë, të udhëhequr nga mësimet e Partisë, besnikë ndaj marksizëm-leninizmit, kanë krijuar vepra të frymëzuara dhe me brendi të shëndoshë. Këto vepra pëlqehen nga lexuesi, janë ushqim shpirtëror për të.

Veprat më të mira, më të realizuara në brendi dhe në formë, gëzojnë popullaritet të nën. Populli i do shkrimtarët dhe artistët e vet dhe prej tyre pret vepra gjithnjë e më të bukura.

Populli pret nga ne komunistët që të jemi kurdoherë në ballë të luftës e të përpjekjeve në të gjithë sektorët, të udhëheqim me kurajë, me guxim e partishmëri dhe të zgjidhim me kujdes problemet e rënda, të mëdha e të ndërlikuara që na ka vënë Partia përpara dhe, të lidhur ngushtë me masat, t'i përvishemi punës me forca të shumëfishuara për të realizuar në kohë dhe sa më mirë të gjitha detyrat dhe planet.

Komiteti Qendror ka bindjen e plotë se organizata e Partisë e rrethit të Elbasanit, si një organizatë e fortë dhe e shëndoshë, do t'i çojë masat e popullit të këtij rrethi, ashtu siç i ka çuar vazhdimisht, përpara në aksione për realizimin e detyrave dhe për ngritjen ideopolitike të tyre.



Prandaj, me besim të patundur në fitore, ju uroj edhe një herë, të dashur shokë, suksese në punët që ju janë ngarkuar.

*Botuar për herë të parë,  
me disa shkurtime, në li-  
brin: Enver Hoxha, «Gjith-  
monë vigjilencë» (Përmblen-  
dhje reprash), vëll. i 2-të,  
f. 225*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## KRIKAT DHE VËREJTJET PËR NJË VEPËR LETRARE DUEEN BËRË ME KUJDES E ME VEND DHE TË JENË SHOQËRORE

*Disa mendime rreth romanit të Ismail Kadaresë  
„Dimri i vetmisë së madhe»<sup>1</sup>*

15 maj 1973

Shumë nga ju e kanë kënduar romanin e Ismail Kadaresë «Dimri i vetmisë së madhe». Lidhur me këtë, dhe meqenëse kjo çështje u ngrit në mbledhje, unë doja të thosha, së pari, që Partia, me njerëzit dhe me anëtarët e saj, duhet të jetë kurdoherë e matur, në mënyrë që çdo gjë ta gjykojë me kujdes, drejt dhe me objektivitet. Kështu duhet ta gjykojmë ne edhe shokun Ismail Kadare si shkrimtar, si dhe veprën e tij të kohëve të fundit.

Ismaili është një shkrimtar me talent. Si në veprat

---

1. Këto mendime shoku Enver Hoxha i shfaqti gjatë pushimit midis seancave të mbledhjes së byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit. Një nga diskutantët në mbledhje preku në diskutimin e vet edhe çështjen e vërejtjeve e të kritikave që po i bëheshin nga masat dhe në shtyp këtij romani.

e tjera që ka shkruar gjer tani, edhe në romanin «Dimri i vetmisë së madhe» ka anë të mira pozitive. Natyrisht, në to gjen edhe ndonjë pjesë që është për t'u kritikuar dhe duhet korrigjuar. Prandaj për të dhënë një gjykim të drejtë e objektiv të veprës së tij të fundit, ashtu si kurdoherë, edhe në rastin konkret, duhen parë dy anët e medaljes, në mënyrë që kritika që i bëhet të mos jetë e njëanshme. Duhet gjykuar, pra, si puna dhe veprimtaria e shokëve të ndryshëm që në aktivin e tyre kanë anë të mira, por që në punë bëjnë edhe ndonjë gabim. Edhe ne vetë, kur bëjmë ndonjë raport, marrim mendimet e kolektivit. mbi të cilat bëjmë korrigjimet e nevojshme në boshllëqet e punës sonë, ua japim përsëri masave, që bëjnë edhe ato vërejtjet e tyre dhe, së fundi, bëjmë korrigjimet përfundimtare.

Sipas mendimit tim personal, në romanin «Dimri i vetmisë së madhe» trajtohet një çështje e rëndësishme, që përbën pjesën kryesore të veprës. Kjo është lufta që ka bërë dhe bën Partia e Punës e Shqipërisë kundër revizionistëve sovjetikë. Këtë pjesë unë mendoj që autori e ka trajtuar mirë, e ka shkruar në mënyrë artistike, jo me himne e plot mburrje, por në bazë të realitetit. Sigurisht, lufta për të cilën flet në romanin e tij Ismail Kadareja përfaqëson vetëm një periudhë, ajo nuk përfaqëson tërë luftën e gjatë që Partia jonë ka zhvilluar që në fillim kundër revizionizmit modern, siç mund të pretendojnë disa. Duhet pasur parasysh se kundër revizionistëve sovjetikë Partia jonë e Punës e ka filluar luftën që pas vdekjes së Stalinit. Udhëheqja e Partisë sonë ka qenë prej kohësh thikë më thikë me klikën e Hrushovit. Parullat «Rroftë Bashkimi Sovjetik» dhe të

tjera si kjo hidheshin nga Partia, por lufta ishte brenda, midis udhëheqjes së Partisë sonë dhe asaj sovjetike, pse ne e dinim se çfarë bënin revizionistët sovjetikë. Prandaj, kryesorja, që nuk duhet harruar, në këtë vepër është kjo luftë.

Disa thonë se në roman del si çështje kryesore mosdhënia e bukës, e grurit nga ana e hrushovianëve. Kjo nuk është kështu, gjë që kuptohet, po të këndohet me kujdes teksti. Ne nuk grindeshim me revizionistët vetëm për çështjen e grurit, kundërshtimet i kishim, në radhë të parë, për çështje ideologjike, megjithëqë edhe çështja e grurit, e marrë veças, nuk ishte diçka e vogël. Përkundrazi, në atë kohë edhe ajo ishte një çështje e madhe, se përbën fillimin e bllokadës nga ana e revizionistëve, që përpiqeshin të mposhtnin Partinë tonë dhe për këtë mundoheshin me të gjitha mënyrat të nxitnin popullin shqiptar për t'u ngritur kundër saj. Në atë kohë vetëm për 15 ditë kishim bukë për popullin. Këtë gjendje të rëndë e dinte mirë klika e Kremlinit, prandaj ajo u përpoq ta shfrytëzonte me çdo mjet për të arritur qëllimet e saj armiqësore kundër Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Partisë sonë të Punës. Por, siç dihet, ajo dështoi me turp. Pikërisht këtë çështje Ismaili e ka ngritur në një nivel mjaft të mirë si artist. Në roman ai ngre edhe kundërshtime të tjera që kemi pasur ne me revizionistët sovjetikë, si atë për bazën e Vlorës etj.

Të gjitha këto ngjarje, si shkrimtar, Ismail Kadareja i ka vënë në një ambient të caktuar shoqëror dhe tamam këtu ka vend për t'i bërë atij kritika, pse ka gjëra që nuk shkojnë, që nuk përfaqësojnë si duhet realitetin tonë shqiptar. Është fakt se në atë kohë pati disa

elementë tradhtarë, që zhvillonin aktivitet kundër Partisë, bile deri edhe anëtarë të Byrosë Politike e të Komitetit Qendror, si: Liri Belishova e Maqo Çomo, si dhe Koço Tashko e të tjerë. Thurjen e këtyre intrigave, çështë e drejta, autori duhet ta ndërtonte në një ambient shumë revolucionar, ku të dilte mirë në dukje vendosmëria dhe fryma e pamposhtur luftarake e popullit tonë në atë kohë. Çështja nuk qëndron tek ajo pse u nda apo përse nuk u bashkua Besniku me Zanën, por në roman ka vend që të hiqen disa gjëra të tepërta, siç është, midis të tjerash, edhe ai i një grupi të rinjsh që kryejnë akte vagabondazhi. Prandaj edhe unë mendoj se ka vend për t'i bërë kritikë romanit, po këto duhet të jenë të tilla që të mos e thyejnë autorin, t'i bëhen në mënyrë shoqërore, që ta ndihmojnë për ta përpunuar më mirë në botimin e ri. S'duhet harruar me këtë rast edhe çështja që midis shkrimtarëve ka disa që kanë smirë, kur ndonjë shoku i tyre bën diçka pozitive, dhe duan ta denigrojnë. Këta e kemi për detyrë t'i korrigjojmë dhe t'i vëmë në rrugën e drejtë.

Me sa e njoh unë, Ismaili, si njeri i zgjuar, i pranon vërejtjet dhe kritikën konstruktive që i bëhen dhe kam besim se do t'i realizojë ato<sup>1</sup>. Tani ai është duke bërë stazhin e kandidatit të Partisë në uzinën «Traktori», do të reflektojë për të metat e dobësitë e romanit dhe do t'i ndreqë ato. Por të mbahet parasysh se me gjithë

---

1. Duke reflektuar në vërejtjet dhe kritikën që bënë masat në takimet e drejtpërdrejta dhe bisedat e autorit me to, nëpërmjet letrave dhe shtypit, Ismail Kadareja e përpunoi romanin «Dimri i vetmisë së madhe», i cili, i përmirësuar, u botua për së dyti në vitin 1977 me titullin «Dimri i madh».

të metat që vihen re, këto nuk mund të ulin vlerën pozitive të veprës, e cila e paraqet drejt e realisht luftën e popullit, luftën parimore që ka bërë e bën Partia jonë kundër tradhtarëve të marksizëm-leninizmit e që nuk është diçka e izoluar.

Rëndësi të dorës së parë në roman ka qëndrimi i Partisë sonë në Moskë<sup>1</sup>, që aty është paraqitur mirë dhe, pikërisht, kjo si pjesa më e rëndësishme duhet vënë në dukje në fillim, pastaj mund të flitet për anët e tjera, për dobësitë e veprës. Kjo anë duhet pasur mirë parasysh, pse pikërisht armiqve tanë revizionistë u intereson shumë dhe dëshirojnë që ky roman, që demaskon qëndrimet e tyre, të hiqet nga qarkullimi dhe ca më mirë u intereson që të jemi vetë ne ata që të themi nuk bën dhe ta hedhim në ujë. Revizionistët sovjetikë pikërisht këtë duan, pse çështja thelbësore e kësaj vepre është lufta që ka bërë e vazhdon të bëjë Partia jonë kundër tyre, gjë që në roman del mirë. Po ta bëjmë ne këtë, revizionistët sovjetikë nuk do ta vënë aspak theksin në atë që romanin ne e hoqëm nga qarkullimi për arsye se nuk u bashkua Zana me Besnikun dhe për çështje të tjera si këto, të dorës së dytë e të tretë, por do të flasin me të madhe për atë që atyre u leverdis aq shumë sikur Partia e Punës e Shqipërisë u tërhoq nga lufta kundër hrushovianëve. Prandaj kritika kundër të metave e dobësive që ka ky roman duhet bërë me vend e me mjaft kujdes. Unë jam i bindur se Ismaili,

---

1. Është fjala për në Mbledhjen e 81 partive komuniste e punëtore të botës, që u mbajt në Moskë nga data 10 nëntor—1 dhjetor 1960.

si shkrimtar me talent që është, do t'i ketë parasysh të gjitha kritikak e drejta që i bëhen me qëllim konstruktiv dhe do t'i realizojë.

Kritika i bën mirë njeriut. Edhe Ismailit si kujtdo i bëjnë mirë këto kritika. Ai, si shkrimtar me horizont të gjerë kulturor dhe si komunist, do t'i rregullojë të metat e romanit, ndërsa çështja kryesore, që është shumë therëse për revizionistët sovjetikë, duhet të mbetet, të mos lëvizë asnjë çikë, se është goditur mjaft mirë.

Ismaili si shkrimtar ka një stil të veçantë të shkruarit. Kështu, për shembull, kur tregon për varrosjen e Nurihanit, ndonjë shkrimtar tjetër mund ta kishte paraqitur ndryshe ngjarjen, kurse ai vë në dukje se, në kohën që të afërmit e përcjellin për ta varrosur këtë bejlereshë, pranë kortezhit funebër kalon makina e ambasadorit sovjetik. Me këtë ai do të thotë se çështja që përfaqëson në vepër ky personazh negativ, ambasadori revizionist, do të varroset si Nurihani dhe klasa që përfaqëson ajo. Ose me tregimin për vrasjen e një piloti në Moskë, të cilit i vënë një buqetë me lule mbi varr, Ismaili përpiqet të demaskojë hipokrizinë e revizionistëve, duke lënë me këtë të kuptohet se ata kështu e kanë zakon të veprojnë, nga një anë të vrasin, pastaj të vënë lule. Ky është stili i të konceptuarit dhe i të shkruarit të tij.

Është, gjithashtu, i shpejtuar dhe jo i drejtë mendimi i disave që thonë se Ismaili nuk është në pozita të shëndosha ideologjike. Po të qe i tillë, ai nuk do të përshkruante drejt luftën e Partisë sonë kundër revizionistëve sovjetikë. Duhet pasur pastaj parasysh se nuk

ka qenë punë aq e lehtë për të që ta trajtonte në mënyrë të përsosur këtë temë, e para e këtij lloji në letërsinë tonë artistike.

*Botohet për herë të parë sipas  
shënimeve të mbajtura në këtë  
takim, që gjenden në AQP*



## PUNËTORËT QË PO NDËRTOJNË KOMBINATIN METALURGIK JANË HEROIKË

*Nga biseda me kuadro drejtues  
të Kombinatit Metalurgjik në Elbasan<sup>1</sup>*

16 maj 1973

*Shoku Enver Hoxha, i shoqëruar nga kuadro drejtues të Partisë dhe të pushtetit të rrethit të Elbasanit, bëri një vizitë në veprën e madhe të pesëvjeçarit të pestë, në Kombinatit Metalurgjik, ku u prit me dashuri dhe entuziazëm të madh nga punëtorët, specialistët, kuadrot dhe drejtuesit e kësaj vepre.*

*Në drejtorinë e përgjithshme të ndërtimeve të kombinatit, ai u takua me kuadro drejtues dhe me punonjës pararojë të ndërtimit dhe të montimit, dëgjoi informimet e bëra nga drejtori i drejtorisë së përgjithshme të ndërtimit të kombinatit, Veiz Gjebero, dhe sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rajonit të Kombinatit Metalurgjik, Fuat Koçllari.*

---

1. Punimet për ndërtimin dhe montimin e kësaj vepre filluan më 16.10.1971. Me vendim të KQ të PPSH të datës 9.10.1978 ky kombinat mori emrin «Kombinati Metalurgjik Çeliku i Partisë».

*SHOKU FUAT KOÇLLARI:* Kombinati ynë është dhe do të bëhet një vend kalitjeje për ne që punojmë sot këtu, për gjithë të tjerët që do të vijnë të punojnë paskëtaj dhe veçanërisht për rininë. Këtu bëhet një luftë dhe punë e madhe, prandaj punëtorët e rinj mund të mësojnë shumë nga puna heroike e punëtorëve të vjetër e të talentuar. Të rinjtë e kombinatit janë energjikë, të vullnetshëm, punojnë ditën dhe natën dhe dallohen për vrullin e tyre. Shumica kanë ardhur nga të katër anët e Shqipërisë, si nga Dibra, nga Korça, nga Durrësi etj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Rinia e vendit tonë punon për lulëzimin e atdheut, për vete dhe për brezat e ardhshëm. Rinia është lavdëruar kurdoherë me bazë, këtë ajo e ka treguar vetë me vepra, në punë. Ato kohë të vështira, kur prindërit dhe gjyshërit tanë shkonin larg për punë, për të fituar kafshatën e bukës, kanë kaluar. Korça, për shembull, prej këtej është dy orë e gjysmë me automobil, pra, fare afër. Pastaj njëlloj si në Korçë është edhe këtu, Korçë është kudo sot vendi ynë. Edhe këtu vjen era e freskët e Shëndëllisë. Këtë e them se të shkohet vazhdimisht, siç bëjnë disa, nga 4-5 ditë ose edhe më shumë për çdo muaj, në shtëpi, humbet kohë nga puna në kombinat. Ndodh që kush vete të rrijë katër ditë në familje i pëlqen të rrijë edhe dy ose tri ditë të tjera, duke menduar se nuk prishet punë. Një punëtori të vetëm nuk i prishet punë, po të marrë disa të ardhura më pak, por, duke e parë çështjen në prizmin e interesit të përgjithshëm, kur këtë e praktikojnë shumë njerëz, dëmi bëhet i madh.

Punëtorët tanë janë patriotë, ata punojnë me he-

roizëm për ndërtimin e lulëzimin e një jete të lumtur për popullin. Sidomos shokët punëtorë të kombinatit e kanë parasysh se këtu po ndërtohet një vepër kolosale nga më të rëndësishmet e vendit tonë. Deri tani janë ndërtuar te ne shumë vepra dhe secila ka rëndësinë e vet të madhe, por, si kurdoherë dhe çdo ditë që kalon, të gjithë e shikojmë sa i domosdoshëm bëhet prodhimi në vend i çelikut, pa të cilin ekonomia jonë nuk mund të ecë përpara, nuk mund të ketë përparim të vrullshëm. Ekonomia e një vendi nuk mund të zhvillohet pa makineri, pa fabrika, pa traktorë, pa automobila, pa trena, por këto prodhohen me hekur dhe përtërihen me pjesë këmbini që bëhen me çelik. Ato, natyrisht, vihen në lëvizje nga punëtorët, të cilët, me shembullin e tyre, udhëheqin gjithë punonjësit e tjerë në punë e në sakrifica, i udhëheqin me trimëri dhe me pjekuri. Punëtorëve u detyrohet baza e shëndoshë e regjimit tonë socialist, mbrojtja e pastërtisë së ideologjisë sonë, garanci e zhvillimit shoqëror ekonomik dhe industrial, që i jep një ndihmë kolosale edhe bujqësisë, gjë që për vendin tonë ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Kombinati do ta vërë vendin tonë në situata më të favorshme nga çdo pikëpamje, jo vetëm ekonomike; kjo vepër do të kontribuojë në konsolidimin e regjimit tonë socialist dhe të ideologjisë marksiste-leniniste, se këtu është duke u rritur dhe do të kalitet një pjesë e konsiderueshme e klasës sonë heroike punëtoresh, shtylla kurrizore e regjimit tonë socialist, këtu do të punojnë dhe do të jetojnë njerëzit që do të përleshën me zjarrin, me nxehtësinë, me gazrat, do të kaliten ata të durojnë vështirësitë e mëdha të profesionit dhe do t'i japin atdheut

«bukën» e domosdoshme për zhvillimin e pavarur ekonomik.

Ne kemi sot fabrika e makina dhe çdo vit do të kemi më shumë prej tyre, kemi, gjithashtu, traktorë, që do të shtohen nga viti në vit, do të rriten hekurudhat tona etj., etj., por, që të mbahen në eficiencë, të gjitha këtyre, herë pas here duhet t'u zëvendësohen pjesët që u konsumohen. Dy rrugë janë të mundshme për këtë qëllim, ose t'i importojmë ato, ose t'i zëvendësojmë vetë, duke i prodhuar në vend. Prandaj punëtorëve tanë u vihet detyrë që makineritë e caktuara për këtë kombinat t'i marrin në dorë mirë, si këta edhe specialistët tanë, dhe të arrijnë të prodhojnë me to sipas parashikimeve, me qëllim që importin ta shkurtojmë sa të jetë e mundur më shumë. Ne prodhojmë vegla ndërrimi në një masë akoma të vogël në krahasim me nevojat. Për ta rritur prodhimin e tyre luftojmë shumë dhe vitet e fundit kemi arritur disa rezultate të mira, sidomos për prodhim veglash ndërrimi për traktorë dhe për automjete. Megjithatë edhe në këto dy drejtime ka shumë për të bërë, pse çështja nuk vihet për të siguruar vegla ndërrimi vetëm për automjete e traktorë, por edhe për makineri të tjera. Në të ardhmen do të na duhen shumë vegla ndërrimi e të shumëllojta për gjithë këto fabrika e uzina që po ndërtojmë. Prandaj po e mendojmë qysh tani edhe këtë problem kaq të rëndësishëm. Aktualisht, nuk ka si flitet për një numër të kufizuar tornosh, por për një industri të tërë mekanike prej dhjetëra uzinash, ku edhe tani punojnë e do të punojnë me mijëra punëtorë e specialistë mekanikë, të cilët duhet të fitojnë zanat, të rriten, të perfeksionohen e të mendojnë, në radhë të

parë, për interesat e atdheut, të socializmit dhe jo thjesht për interesat e tyre personale, që, pa dyshim, janë të lidhur me interesat e përgjithshëm. Në qoftë se nuk i mendojmë kështu këto çështje, nuk mund të kemi përparim.

Me këtë dua të them që punëtorët, të rinj dhe të vjetër, që më vonë do të vënë në shfrytëzim kombinatin, duhet të zotërojnë teknikën që të punojnë e të prodhojnë më shumë e më mirë me to për popullin. Ai që do t'i zotërojë këto mjete në mënyrë të përsosur, siç e kërkon teknologjia, që do t'i shërbejë atdheut me heroizëm, siç bëjnë shumë heronj të punës socialiste që mirëmbajnë traktorët, automobilat e çdo mjet tjetër për vite e vite me radhë, duke ua zgjatur jetën tej normave teknike, pa dyshim që edhe të ardhura do të marrë më shumë. Po të mendojnë e të veprojnë të gjithë si këta, gjithë kjo makineri që kemi e do të kemi, do të bëhet një armë e fuqishme në duart e klasës punëtore, e cila do ta çojë vendin përpara me hop gjithnjë e më të madh. Këtë kombinat duhet ta ndërtojmë me një kujdes të jashtëzakonshëm dhe ta trajtojmë si prindërit fëmijën e vetme, të cilin e mëkëmbin dhe e rritin me kujdes që të bëhet i ndërgjegjshëm për Partinë dhe për popullin. Prandaj ndërtesat tanë duhet të ushqejnë një dashuri të zjarrtë për këtë vepër dhe ta ndërtojnë sa më parë e në mënyrë të përsosur.

Ky kombinat, me një teknologji shumë të ndërlikuar, ka një histori të vjetër. Revizionistët sovjetikë, çekoslovakë dhe gjithë të tjerët na sabotuan, nuk donin që ne të ndërtonim një vepër të tillë të madhe. Çekosllovakia donte të shfrytëzonte hekur-nikelin tonë për ta

përpunuar në vendin e vet, duke na kthyer ne në furnitorë të lëndës së parë, dhe të na jepte nga prodhimet e përpunuara me mineralin tonë kur të donte dhe aq sa t'i interesonte. Por përpjekjet e tyre nuk patën sukses. Ata as nga ana teknologjike nuk e zgjidhën dot problemin.

Vendit tonë i duhet t'i shfrytëzojë medoemos hekurin dhe nënproduktet e tij. Por kjo pasuri e madhe duhet shfrytëzuar në mënyrë sa më ekonomike. Vendi ynë nuk është një shtet i madh, me potencial të fuqishëm ekonomik, që të kompensojë lehtë shpenzimet, në rast se këto janë të shumta. Nga ana tjetër, Shqipëria është një vend me sipërfaqe toke të vogël, saqë një shi i paprerë po të bjerë, në të shumtën e rasteve e përfshin tërë territorin e saj. Prandaj, po nuk ra shi gjatë verës, bujqësia jonë dëmtohet rëndë. Duke pasur parasysh këto mundësi, ekonomisë sonë nuk i intereson t'i marrë mineralit që nxjerrim nga toka vetëm kobaltin dhe të lërë pa shfrytëzuar hekurin, çështja është që edhe nga ky të nxjerrim sa më shumë lloje çeliqesh.

Neve na vihet detyrë të mobilizohemi në mënyrë të përsosur, të marrim masa për organizimin sa më të mirë të punës, të forcojmë kudo disiplinën, instruktimin, kontrollin, punën politike dhe ideologjike. Edhe sikur të mësuar të jemi, kurrë të mos mendojmë se i dimë të gjitha, prandaj të vazhdojmë të mësojmë kurdoherë, se dituria nuk ka fund. Mësimi nuk është thjesht një stoli për vete, ai na duhet për t'i shërbyer atdheut. Krahas punës, të mësoni edhe të rinjtë, se rinia është e ardhmja. Këto vepra që ndërtojmë ne sot, do t'i shfrytëzojë rinia në të ardhmen, po ajo do të marrë fryte të mira, në rast se përgatitet dhe mëson të përvetësojë sa më mi-

rë shkencën e teknikën dhe, mbi të gjitha, në rast se edukohet me mësimet e Partisë. Edhe në këtë çështje është si në bujqësi. Në qoftë se interesohemi në kohën e duhur që fidanët të rriten të shëndetshëm, atëherë do të kemi prodhime të mira, por në qoftë se nuk kujdesemi, këta fidanë do t'i hanë krimbat, do t'i mbulojnë ferrat dhe atëherë nuk do të kemi fruta. Kështu është edhe me brezin e ri. Që ky të jetë kurdoherë i shëndetshëm, të interesohemi që ta rritim, ta kalitim ideologjikisht e politikisht, ta mësojmë e ta perfeksionojmë në profile të ndryshme.

Partia është interesuar për të rinjtë që këta të mësojnë profesione dhe të mësojnë me kujdesin më të madh. Nga ato që thonë specialistët tanë, si: Hajredin Çeliku, Veiz Gjebero, Hajredin Kumbaro e të tjerë, del se këto nuk janë profesione të lehta, bile janë shumë delikate. Nuk është kollaj, shokë, të shkrish çelikut. Është e vërtetë që në këtë vepër do të vendosen mjete moderne për nxjerrjen e gizës dhe të çelikut, po le të marrim vetëm një kërkesë, kujdesin për matjen e nxehtësisë që nevojitet për këtë punë. Metalurgu me eksperiencë, nxehtësinë që nevojitet për shkrirjen e çelikut në furrë e njeh edhe me faqe, pikërisht siç bënte bujku ynë për të vlerësuar nëse toka kishte arritur temperaturën e duhur për të mbjellë, duke ndenjtur vetë këmbëkryq mbi të. Ne, intelektualët, nuk dimë shumë nga këto, kurse ju punëtorët keni fjalë pak e punë shumë. Fjalët tuaja janë konkrete, janë këto vepra që keni ndërtuar e po ndërtoni në të katër anët e atdheut, të cilat i qëndrojnë kohës; ato janë veprat e Partisë dhe të popullit.

Partia ka bindjen se ju do ta realizoni me sukses këtë vepër të madhe. Duhet ta them se Partia dhe Qeveria që në fillim janë kujdesur veçanërisht për metalurgjinë dhe për dy veprat e tjera<sup>1</sup> të mëdha të këtij peshëjeçari dhe kanë caktuar specialistët më të mirë, kuadrot më me përvojë që gjithë jetën kanë dhënë prova të mëdha, që udhëheqin punimet në këtë kombinat të madh. U janë dhënë udhëzime të gjitha rretheve që, duke marrë parasysh rëndësinë, të ndihmonin në ndërtimin e kësaj vepre. Shokët e rrethit të Elbasanit e kanë parasysh këtë porosi dhe interesohen në mënyrë të veçantë për të. Prandaj dëshiroj, me këtë rast, të përgëzoj shokun Jashar [Menzelxhiu] dhe shokë të tjerë të Partisë dhe të pushtetit të rrethit tuaj për kujdesin e veçantë që tregojnë për këtë vepër të madhe industriale të vendit tonë.

Natyrisht, siç e thashë, këtu ka mjaft vështirësi, të cilat duhen kuptuar. Për vendimet që kanë të bëjnë me ndërtimin e banesave, janë duke u bërë përpjekje, por nuk mund të pretendojmë që çdo gjë shkon në mënyrë të përsosur. Klasa punëtore, si klasa drejtuese dhe më e përparuar, duhet të ketë mirë parasysh situatën në vend dhe në botë, pse atëherë do të jetë në gjendje të kuptojë edhe disa mungesa. Fjala vjen për çështjen e mishit. Ndodh që në ndonjë periudhë nuk ka nga të gjitha asortimentet e llojet e mishit. Megjithatë vazhdimisht ka në shitje mish derri, mirëpo e keqja është se ai nuk përdoret në masë dhe jo vetëm nga njerëzit e

---

1. Është fjala për hidrocentralin «Drita e Partisë» në Fierzë dhe për Uzinën e Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh.



moshuar, që ashtu janë mësuar, por ka shumë të rinj e të reja që nuk e hanë këtë lloj mishi. Këtë e bëjnë se preferojnë mish qengji, dhe jo se janë fetarë, se po të ishte kështu, nuk do të hanin as sallamin, as salsicet, që i hanë me qejf, edhe pse bëhen me mish derri. Prandaj duhet të punojmë për të formuar shije të drejta dhe problemin ta shikojmë me kujdes edhe nga ana ekonomike, sepse dosa lind deri 12 gica, kurse delja vetëm një qengj në vit. Prandaj kuptohet ç'leverdi ekonomike ka rritja e derrit, përveçqë mishi i tij është, gjithashtu, shumë i ushqyeshëm.

Me gjithë këto, në vendin tonë nuk ka pasur shqetësime ekonomike. Dihet mirë çfarë shqetësime dhe perturbacione ka në vendet kapitaliste e revizioniste. Në Itali, për shembull, mishi është shumë i shtrenjtë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës çmimi i tij është ngritur 40 për qind, në Francë e në Angli ka, gjithashtu, kriza të mëdha ekonomike, kurse në Jugosllavi çmimet janë rritur shumë. Ndryshe është te ne, ku çmimet kanë stabilitet. Edhe kur del ndonjë vështirësi, merren masa dhe çdo gjë normalizohet shpejt. Disa mangësi që vihen re te ne, nuk e kanë burimin vetëm në dobësitë administrative, po edhe në të metat e organizimit të prodhimit në bujqësi. Veç këtyre, bujqësinë shpesh e vështirëson edhe koha. Në këto mungesa ka, kështu, një kompleks faktorësh.

Por le të kthehemi tek ajo që thashë se të gjitha rrethet, si: Korça, Dibra, Durrësi dhe të tjera kanë ndihmuar dhe vazhdojnë të ndihmojnë me vullnet dhe kujdes, me çdo gjë të mundshme, për ndërtimin e kombinatit, duke ju dërguar këtu punëtorë, specialistë dhe kuadro.

Çështja që u tha këtu për të punuar me punëtorët e ardhur nga rrethet e tjera që të shkojnë në shtëpi jo dëndur, është e drejtë. Partia i mëson njerëzit tanë që ta rritin dashurinë për familjen, ajo punon që familjen ta kemi kurdoherë të fortë etj., po kjo nuk do të thotë që punëtorët që kanë ardhur këtu për punë të largohen shpesh e pa rregull. Prandaj duhet organizuar më mirë kjo punë, në radhë të parë, në interes të ndërtimit të kombinatit, po duke plotësuar, sa të jetë e mundur, edhe kërkesat e arsyeshme të punëtorëve. Këto kërkesa nuk përmbushen vetëm duke vënë në dispozicion autobusin për t'i çuar ata nëpër familjet, po duke ndihmuar punëtorët dhe specialistët të mbajnë letërkëmbim të rregullt dhe të shpejtë me njerëzit e tyre, gjatë kohës që janë këtu.

Të tërë ata që punojnë këtu, si ndërtuesit, ashtu edhe montuesit, shoferët që kanë transportuar dhe transportojnë mjete të rënda e delikate, janë njerëz të lavdishëm. Këtu ka punëtorë të kalitur, heroikë, të thjeshtë, si Mehmet Bekteshi, që nuk e vënë kurrë në dukje punën e tyre, nuk flasin për të.

Jam shumë i gëzuar që jeni mirë me punimet dhe që çdo ditë po përparoni në të gjithë sektorët.

*Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim. që gjenden në AQP*

## QË SHQIPËRIA TË RROJË NË SHEKUJ

*Fjala në mitingun në Kombinatin Metalurgjik  
të Elbasanit*

16 maj 1973

*Qindra punëtorë, ndërtues, montatorë sapo morën vesh ardhjen e shokut Enver Hoxha, mbushën sheshin para furnaltave. Këtë miting spontan që u zhvillua këtu e hapi Heroi i Punës Socialiste, brigadieri i furnaltës, Mehmet Bekteshi, i cili i uroi mirëseardhjen udhëheqësit të Partisë dhe e siguroi se punëtorët do t'i dorëzojnë furnaltat para afatit. Shoku Enver Hoxha e përqafoi dhe iu drejtua punëtorëve:*

Të dashur shokë punëtorë,

Tani që përqafova shokun Mehmet Bekteshi, më duket sikur ju përqafova të gjithë ju. Unë erdha sot në gjirin e ndërtuesve heroikë të njëjës prej veprave të mëdha të vendit tonë, punëtorëve të kombinatit metalurgjik, që t'ju përshëndes në emër të Komitetit Qendror dhe t'ju uroj suksese më të mëdha në punën për ngritjen e kësaj vepre të pavdekshme, me anën e së

cilës do të lulëzojë e do të përparojë akoma më shumë Shqipëria jonë e dashur. Kjo furrnaltë ka themele të forta si Partia jonë. Rroftë Partia!

Partia ka ëndërruar dhe është përpjekur energjikisht për të realizuar ndërtimin e kësaj veprë të industrisë së rëndë, metalurgjinë e zezë, sektor nga më kryesorët në industrializimin socialist të vendit tonë. Për realizimin e saj u deshën përpjekje të mëdha, të cilat do të kurorëzohen me siguri me sukses, në sajë të vijës së drejtë të Partisë, në sajë të heroizmit të klasës sonë punëtorë, të inxhinierëve e specialistëve dhe të kërkuesve tanë të talentuar të pasurive të nëntokës.

Para së gjithash, duhej të siguroheshim: a kishte në vendin tonë mineral, që të mund të ngrihej kombinati metalurgjik. Partia iu vu me kohë e me këmbëngulje kësaj detyre, punoi me durim dhe hasi në shumë pengesa e vështirësi nga elementët revizionistë, sidomos nga revizionistët sovjetikë, të cilët donin ta kishin vendin tonë nën thundër. Por erdhi koha e veprimtaria e tyre u demaskua. Partia dhe populli ynë nuk qëndruan në vend, por çanë përpara. Bijtë e tyre të lavdishëm zbuluan gjatë kësaj periudhe sasi të konsiderueshme mineralesh, në mes të të cilave edhe hekur-nikel e hekur-silikat. Tani po bëhen përpjekje për të gjetur thjesht hekur dhe kemi besim se do të gjejmë.

Përpara njerëzit tanë të vuajtur e të robtuar nga varfëria thoshin: «Eh, kjo perëndia, çfarë padrejtësie ka bërë! Pasi krijoi këtë botë, erdhi e hodhi këtu në Shqipëri ca male që i kishin mbetur në torbë, nuk na dha edhe neve ca fusha». Por botën nuk e ka krijuar perëndia, kjo është një gënjeshtër e krijuar nga mashtruesit e po-

pujve, që kanë shfrytëzuar paditurinë, mungesën e eksperiencës dhe frikën që në shekuj mbulonte njerëzit. Këta, që në kohë shumë të lashta, duke mos i shpjeguar dot fenomenet e natyrës, krijuan idenë e një fuqie të jashtëzakonshme, të «perëndisë», që në realitet nuk ekziston. Me qëllim që t'i mbante popujt nën thundër e t'i gënjente, feja u bë me kohë një narkotik, një helm, një opium për të vënë njerëzit në gjumë. Partia dhe populli ynë ka kohë që e kanë fshirë atë nga defteri. Ka pasur njerëz që besonin, bile edhe tani mund të ketë ndonjë që fshchurazi mban ramazan, por në fakt as vetë nuk është i bindur përse e bën këtë dhe ruhet që të mos e shikojnë as djali, as vajza, as nusja, apo dikush tjetër në shtëpi. Ne jemi të bindur se ndonjë plak që agjëron akoma, do ta harrojë fenë, sepse e ka parë që gjithë jetën ajo e ka lënë pa bukë, nuk i ka sjellë gjëkafshë. E çfarë i solli feja popullit tonë në të kaluarën? Vetëm shtypje, varfëri e mjerim. Popullit iu siguruan gjithë të mirat vetëm pasi erdhi Partia në fuqi, që është kundër gjithë besimeve fetare. Në kohën e Partisë dhe jo përpara, kur sundonin feja dhe fetarët, kapitalistët, fajdexhinjtë e agallarët, u zbuluan thesaretë mëdha në thellësitë e maleve e të fushave tona, u pajisën me dituri bijat dhe bijtë e popullit. Partia i edukoi, i zgjoi dhe i mësoi njerëzit të çajnë malet, të disiplinonjë ujërat, të pyllëzojnë tokat e zhveshura, të zbu-kurojnë fushat e të ndërtojnë kanale, për të ardhur bollëku. Vetëm në kohën e Partisë u ndërtua e po ndërtohet kjo industri e përparuar moderne që do të rritë begatinë dhe fuqinë e atdheut tonë socialist.

Në vendin tonë ka tashmë shumë miniera dhe ne

jemi krenarë që erdhi koha të ndërtojmë edhe metalurgjinë e zezë. Kjo ka një rëndësi historike për vendin tonë, prandaj të përpiqemi që atë ta mbarojmë me sukses dhe në kohë dhe Partia ka besim se do ta ndërtojmë me sukses. Prandaj ta organizojmë sa më mirë punën, që të gjitha ndërtimet, montimet, vënia në zbatim e projekteve dhe teknologjia të kryhen me sukses. Këto do të arrihen se ju jeni në gjendje, jeni të zotë e të aftë të kryeni vepra të mëdha, ashtu sikurse i keni kryer gjertani.

Partia krenohet me klasën punëtore, me aftësitë e saj të pashtershme. Kur pas Çlirimit filluam të ndërtonim socializmin në vendin tonë, disa nuk besonin, as nuk e merrnin me mend se do të ndërtoheshin vepra kaq të mëdha. Por shpejt e panë sa shumë gaboheshin. Njerëz të tillë ishin nga ata që nuk kishin besim te populli, te zotësia e te forca e tij e madhe. Ata nuk e njihnin popullin, e kujtonin atë raja, kujtonin se mendja e tyre dhe e agallarëve ishte në gjendje të lëvizte botën, sipas tyre ata ishin kërthiza e kësaj bote, kurse në fakt ishin zero.

Edhe përpara, ashtu si tani, në vendet e kapitalit çdo gjë, çdo vepër e përparim është realizuar me mendjen dhe me duart e punëtorëve. Proletariati ka ngritur hidrocentrale gjigante, uzina e fabrika, monumentet e mëdha të industrisë dhe të kulturës dhe jo kapitalistët. Këta vetëm kanë shfrytëzuar djersën dhe gjakun e punëtorëve.

*«Në çdo dollar ka gjurmë gjaku...»<sup>1</sup>,*

---

1. V. I. Lenin, Veprat, vëll. 28, f. 54.

ka thënë Lenini. Çdo gjë me të cilën mburret borgjezia, e ka ndërtuar klasa punëtore me zotësinë e saj.

Të tillë njerëz me mosbesim te punëtorët kishte edhe këtu, te ne, por Partia dhe populli i spastruan, megjithatë duhet të jemi vigjilentë, sepse armiqtë e klasës nuk e harrojnë kurrë të kaluarën, ata ëndërrojnë ditë e natë, kudo ku janë struktur, për ta kthyer atë kohë, po ajo nuk ka për të ardhur kurrë më, ajo ka marrë fund, prandaj jeta dhe ëndrrat e tyre kanë vdekur. pse populli dhe Partia sot janë në gjendje t'i shtypin, sikur pakëz veshin të nxjerrin. Megjithatë Partia i këshillon gjithnjë të punojnë atje ku i ka dërguar populli dhe kurdoherë nën kontrollin e tij, nën kontrollin e klasës. Kujtdo prej tyre që përpiqet të bëjë zigzage, Partia, klasa punëtore i bëjnë thirrje të qëndrojnë në brazdë, pse, në asnjë mënyrë, nuk do të lejojnë që interesat e mëdhenj të atdheut të cenohen për qejfin e njërit e të tjetrit. Interesi i popullit, interesi i klasës është mbi të gjitha. Ne duam që Shqipëria të rrojë në shekuj, prandaj në qoftë se ndonjërit i ka hipur në kokë dhe ka qejf të vishet e të jetojë jashtë normave e rregullave tona, ne i themi se në Shqipëri këto nuk lejohen. Sot në vendin tonë bëhet siç dëshirojnë klasa dhe Partia dhe jo sipas qejfit të disa njerëzve të çoroditur.

Klasa punëtore dëshironte që në vendin tonë të ngrihej metalurgjia, Partia i premtoi asaj se do ta ngrihim dhe ja, tani ajo po ngrihet madhështore si një vigan. Prodhimet e saj do të jenë «buka» e industrisë sonë. Por Partia i mëson të gjithë, ndërtuesit dhe montatorët e kësaj veprë, të vënë të gjitha forcat, diturinë dhe zgjuarsinë e tyre të madhe, që çdo ndërtim të bëhet i përsosur.

sur, ajo i këshillon, gjithashtu, punëtorët që nesër do ta shfrytëzojnë veprën, të bëjnë përpjekje për të marrë plotësisht zanatin e metalurgut, për të cilin atdheu ka nevojë të madhe. Ne duhet të jemi kurdoherë krejtësisht të pavarur nga jashtë në çdo gjë; të mos harrojmë se jemi të rrethuar.

Sot ne kemi ngritur një industri të fuqishme, kemi sidomos një industri mekanike të madhe, me të cilën jemi në gjendje të përballojmë me vegla ndërrimi shumë pajisje e mjete që kemi e do të kemi. Jo vetëm kaq, po me forcat tona do të ndërtojmë vetë makineri të tjera për fabrikat e uzinat e reja që do të ndërtojmë në të ardhmen. Për këtë arsye po ndërtohet gjithë kjo industri e madhe mekanike, e cila do të shtohet, do të dyfishohet e më vonë edhe mund të trefishohet. Fëmijët tanë, që nesër do të vijnë të punojnë në këtë kombinat, do të derdhin djersë, do ta kenë atë gjithë jetën dhe do t'ua lënë të freskët e madhështore edhe brezave të mëpasëm, të cilët do të vazhdojnë të ecin në këtë rrugë, sepse do të zbulojnë thesare të tjera, do të krijojnë mundësi të reja për të ndërtuar më shumë fabrika e kombinat, më të mëdha e më të përsosura.

Deri tani ne kemi bërë hapa të mëdhenj në kualifikimin profesional të njerëzve tanë. Ja, për shembull, konkretisht këtu te ju, ashtu si kudo në Shqipëri, po bëhen punë të mrekullueshme me cilësi të lartë. Megjithatë kudo ka akoma rezerva dhe çdonjëri nga ne ka akoma vend për të zgjeruar njohuritë e tij me dituri të reja, që duhet të fitohen me këmbëngulje e të shtohen dita-ditës. Prandaj t'i vëmë vetes detyrë të mësojmë vazhdimisht e pa u lodhur, se dituria është pa fund, dhe



vetëm duke mësuar do të përvetësojmë si duhet shkencën dhe teknikën. Këto janë armë me të cilat do të vëmë në shfrytëzim të plotë gjithë veprat moderne që jeni duke ndërtuar dhe të tjerat që do të ndërtojmë.

Në të ardhmen do të realizojmë gjëra të nrekullueshme, do të bëjmë hapa të tjerë më të mëdhenj në rrugën e ndërtimit të socializmit e më vonë të komunizmit. Kjo do të ndihmojë përmirësimin gjithnjë më mirë të jetesës së popullit, lehtësimin e kushteve të punës së njerëzve, pakësimin e kohës së qëndrimit në punë, zhvillimin më shumë të kulturës dhe rritjen e mirëqenies së masave etj. Të gjitha këto mundësi janë në duart tona dhe ne ato do t'i bëjmë realitet.

Mobilizimi për të realizuar me sukses fazën e parë të ndërtimit të kombinatit metalurgjik ka një rëndësi të jashtëzakonshme për ekonominë tonë. Bashkë me përfitimet materiale, ngritja e kësaj vepre ka rëndësi edhe për faktin se këtu do të kaliten e do të mësohen kuadrot e parë të kësaj dege bazë të industrisë. Ju, ndërtuesit e metalurgjisë së zezë, sidomos ju të vjetrit, që keni shërbyer me devocion në të gjitha anët e Shqipërisë, në kantieret e veprave të mëdha që ju qëndrojnë si medalje në qafë, e bashkë me ju punëtorët e rinj, si këta që janë këtu dhe të tjerë që vazhdojnë të punojnë gjetkë, jeni e do të jeni të nderuar e të respektuar kurdoherë nga gjithë populli shqiptar. Edhe mekanikët tanë nuk janë të rinj në zanatin e tyre, por ndryshe është me metalurgët. Këta po i futen një pune të re, prandaj le t'i vihen me zell të madh mësimi të këtij profesioni shumë të nderuar. Puna në kombinatin metalurgjik do të jetë për ta një shkollë e madhe. Në këtë drejtim të tre-

gohet kujdes i madh me ta, gjersa të bëhen zotër të vërtetë të profesionit, sepse janë metalurgët e parë që do t'i japin popullit prodhimet e industrisë sonë metalurgjike.

Kur furrxhiu nuk e pjek mirë bukën, blerësit ankohen. Kështu do të flasin edhe për ata metalurgë që, duke mos pasur kujdes gjatë punës, do të nxjerrin prodhim me cilësi të dobët. Gjëra të tilla ndodhin kur nuk i vihet veshi punës, ose kur metalurgu nuk bën përpjekje për t'u kualifikuar në profesion. Në raste të një pune të pakujdesshme çeliku dhe giza mund të thyhen, janë të sertë etj., etj. Këto mund të ndodhin, shokë, edhe sepse ky profesion është shumë i ndërlikuar e delikat dhe nuk mësohet dot në dy ose në tre muaj, prandaj duhen bërë vazhdimisht përpjekje të mëdha. Ne kemi bindjen se njerëzit tanë do t'i bëjnë ato.

Ju, shokë punëtorë të vjetër, tregoni kujdes të madh që të rinjtë t'i mësoni e t'i përkrahni, ashtu siç keni bërë deri tani, bile edhe më shumë akoma. T'i doni ata si bijtë, si vëllezërit dhe si fëmijët tuaj, të mendoni gjithnjë mirë për ta, të kujdeseni që ata të edukohen, në radhë të parë, politikisht dhe ideologjikisht me frymën e Partisë, sepse janë filizat e brezit të ri që po ngrihet, të atij brezi që nesër do të marrë në duar stafetën e revolucionit. Ata janë e ardhmja e Shqipërisë, për të cilën duhet të mendojmë e të punojmë që të jetë kurdoherë në duar të sigurta. Detyra jonë, si më të vjetër, është t'i ngremë, t'i mësojmë dhe t'i kalitim sa më mirë brezat që vijnë e kjo të vazhdojë edhe në të ardhmen. Prandaj, këtë thesar të çmuar të atdheut ta

trajtojmë me dashurinë më të madhe. Edhe metalurgjia do të jetë një shkollë shumë e përshtatshme që të rinjtë e të rejat të kaliten siç do Partia, të bëhen të çeliktë nga çdo pikëpamje, ideologjikisht dhe politikisht; ata do të mësojnë këtu një profesion shumë të nderuar, siç është profesioni i metalurgut apo i ndërtuesve që po ngrenë këtë vepër.

Me këtë rast dua të theksoj se, në qoftë se ka ndonjë që nënvleftëson punën e ndërtuesve, gabohet rëndë. Ndërtuesit na kanë dhënë mundësi të ngremë industrinë, të ndërtojmë vepra të rëndësishme, që kanë bërë të përparojë industria dhe bujqësia jonë. Janë ata, gjithashtu, që ndërtojnë shtëpitë tona të banimit, prandaj duhet të respektohen nga të gjithë, sepse që kur Shqipëria u çlirua, kanë bërë vazhdimisht sakrifica të mëdha. Në qoftë se ka njerëz që kanë shkuar kudo, janë ndërtuesit. «Nisuni për në Veri», u thoshim pas Çlirimit punëtorëve të ndërtimit dhe ata pa e bërë dy fjalën e Partisë shkonin ku u vihej detyrë. Dhe flinin në baraka, ku ç'binte jashtë, binte brenda. Pra kushtet e jetesës i kishin shumë të vështira, megjithatë, përpara interesave të mëdhenj të atdheut e të socializmit, ndërtuesit tanë i duronin dhe i kapërcenin me vendosmëri vështirësitë. Pasi mbaronin veprën, prapë shkonin në një tjetër, nga Veriu në Elbasan, nga Vlora në Korçë e kështu me radhë, kudo ku qe nevoja, dhe ndërtuesit tanë i thoshin Partisë «jemi gati» dhe shkonin, pavarësisht se familjet i kishin larg dhe pranë tyre venin rralle. Ishte ky shpirt vetëmohimi e sakrifice, që bëri të mundur të ndërtohen gjithë këto vepra të mëdha dhe të vazhdohet të ndërtohen shumë të tjera. Të gjithë ne

duhet t'i respektojmë këta njerëz që kanë bërë këta heroizma.

Unë, shokë, jam shumë i gëzuar dhe i mahnitur nga këto që po shoh këtu te ju. Kam parë edhe në vende të tjera furrnalta, mundet më të mëdha, por vlera dhe madhështia e furrnaltës sonë më duket më e madhe se ato, sepse ne jemi një popull i vogël, pora kemi kapërcyer 2 milionë, megjithatë shikoni sa madhështore po e bëjmë. Në të ardhmen do të ndërtojmë të tjera më të mëdha.

Të dashur shokë, ju uroj nga zemra për sa keni bërë! Organizata e Partisë e rrethit ka bërë çmos që t'ju dërgojë këtu drejtues të rinj, me eksperiencë të madhe, të cilët i edukon që të punojnë dhe të rrojnë bashkë me ju, t'ju dëgjojnë vazhdimisht me vëmendje, t'ju marrin kurdoherë mendimin dhe të këshillohen për çdo punë me ju.

Vija e Partisë sonë është e drejtë, ajo është vijë e masave, prandaj zëri i tyre duhet të dëgjohet kudo, pse po u largua prej saj Partia mbetet si peshku pa ujë. Pa lidhje me masat s'ka parti marksiste-leniniste. Kush nuk e kupton këtë, nuk ka kuptuar asgjë.

Këto janë mësimet e Partisë, të Komitetit Qendror të saj. Ashtu siç e thamë dje, në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Partisë të Rrethit tuaj, eksperiencia e tërë Partisë grumbullohet në Komitetin Qendror, përpunohet e sintetizohet dhe u kthehet përsëri Partisë dhe masave. Këtë eksperiencë udhëheqja përpunohet ta vërë në zbatim në jetë. Kështu vepron ajo, ndryshe, në rast se nuk është e lidhur me masat e Partisë dhe me ato të popullit, udhëheqja nuk ka si të nxjerrë diçka të

frytshme. Udhëheqja mban gjithnjë parasysht eksperiencën e madhe të Partisë dhe arrin në konkluzione të shëndosha që ua kthen përsëri masave dhe mbi këtë bazë i mobilizon për' të ocuar më përpara.

Gjendja jonë e brendshme është më e shëndoshë se kurrë. Duhet të jetë e qartë se kritikën që po bën Partia kundër disa shfaqjeve të huaja nuk kanë karakter të përgjithshëm. Këto janë shfaqje të veçuara të disa elementëve të çoroditur, disa nga të cilët nuk janë armiq, por njerëz të hallakatur. Partia këta nuk dëshiron, në asnjë mënyrë, t'i lërë të shkojnë tek armiku, por i ndihmon që të korrigjohen.

Populli duhet të bëhet i ndërgjegjshëm se midis nesh ka edhe të tillë që nuk i kuptojnë drejt disa çështje. Atëherë detyra jonë është t'i shkundim, t'i kritikojmë dhe t'i ndreqim. Kjo është rruga e Partisë. Për këtë arsye populli kurdoherë i ka përqaftuar, i përqafton dhe i zbaton me entuziazëm të madh direktivat e Partisë, se e ka provuar gjithnjë që janë për të mirën e tij. Ky entuziazëm sot është ngritur në kulm. Populli vlerëson drejt sa mirë po vepron Partia kundër këtyre shfaqjeve. Mendimi i popullit është i artë: me eksperiencën e vet ai na ka mësuar se në ujin që lihet të flejë, rriten mushkonjat, që pickojnë dhe sëmurin trupin, gjë që rrezikon jetën. Prandaj «duhen spastruar ujërat», s'ka rrugë më të mirë se kjo që na mëson populli.

Vigjilenca, shokë e vëllezër, duhet të jetë kurdoherë në nivel të lartë, e gjallë e luftarakë. Askush dhe në asnjë rast të mos mendojë se armiqtë e kanë pushuar luftën kundër nesh. Jo, kurrë të mos e keni një mendim të tillë. Armiku është armik dhe, kur të shikon të do-

bët, të sulmon. Në qoftë se të shikon të fortë, ai ka frikë dhe tërhiqet. Çfarë duhet të bëjnë atëherë Partia dhe populli? Të punojnë që të jenë të fortë. Në qoftë se nuk marrim masa dhe na zë gjumi, armiku gradualisht, pa u diktuar dhe si pa kuptuar, përgatit terrenin, nxit shfaqjet e huaja, thashethemet, thyerjet e disiplinës, dëmtimin e pasurisë socialiste, vënien e interesit personal mbi të përgjithshmin dhe plot gjëra të tjera si këto, shfaqje mikroborgjeze të vogla që, po të mos luftohen, na dobësojnë situatën. Armiku përpigjet të krijojë opinionin sikur të gjitha këto nuk përbëjnë asnjë rrezik, kurse këto i japin atij mundësi dhe i krijojnë terren të përshtatshëm të na luftojë. A e duan Partia dhe populli këtë situatë? Në asnjë mënyrë nuk e duan, prandaj populli gëzohet kur Partia merr masa, sepse shikon që këto nuk e dobësojnë situatën, përkundrazi e forcojnë.

Populli dhe klasa punëtore e njohin mirë Partinë e tyre dhe lidhjet e saj me popullin, prandaj nuk kanë frikë dhe druajtje për ta thënë mendimin hapur. Partia jonë flet pa druajtje dhe populli e duartroket, klasa punëtore brohoret «Rroftë Partia, e cila bëri shumë mirë që i mori këto masa!» dhe u bën thirrje atyre që kanë gabuar të vijnë në rrugë të drejtë, ndryshe pastaj, u tregon vendin.

Mësimet e Partisë kanë rëndësi të madhe dhe puna që bën ajo në rrugën marksiste-leniniste është gjithnjë në rritje. Ajo do të sjellë shumë të mira, të cilat janë dukur vazhdimisht. Me të lëshuar Partia një parullë, masat, që kanë besim të pakufishëm tek ajo, mobilizohen për ta zbatuar. Ju, shokë, që punoni këtu, i shikoni vetë si po i realizoni planet, por dua t'ju them se vitin e

kaluar disa ndërmarrje nuk i realizuan, pra dolën me deficite. Edhe gjatë dy muajve të parë të këtij viti disa nuk i realizuan planet. Mirëpo, me të folur Partia, ata realizuan katërmujorin dhe njëkohësisht plotësuan edhe deficitet e dy muajve të parë të këtij viti. Dhe kjo u arrit sepse pati mobilizim, shokë. Njerëzit dhe kolektivat ishin po ata, drejtuesit ishin po ata, por të tërë i vunë pyetjen vetes: «Ku po shkojmë kështu? Ç'po bëjmë?». Dhe e mblodhën veten, korrigjuan gabimet, realizuan e tejkaluan planet.

Ju uroj sukses, shokë punëtorë! E mbarofshi me sukses këtë vepër të rëndësishme! Partia dhe populli do t'ju jenë mirënjohës përjetë. Urime e përshëndetje të gjithëve! Mbetshi me shëndet, shokë punëtorë!

Rroftë Partia!

Rroftë klasa punëtore!

*Botohet për herë të parë si-  
pas shënimeve të mbajtura,  
që gjenden në AQP*

## TAKIMET DHE KËSHILLIMI ME POPULLIN JANË KURDOHERË TË DOMOSDOSHËM

*Nga biseda në familjen e File Musait<sup>1</sup>*

16 maj 1973

*Shoku Enver Hoxha, i shoqëruar nga sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit, Jashar Menzelxhiu, bëri vizitë në familjen e patriotit File Musai dhe zhvilloi aty një bisedë të ngrohtë.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Mirë se ju gjeta, o File. Si të kam, si e ke shëndetin? A je i fortë?

**SHOKU FILE MUSAI:** Mirë jam, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Po ti, motër Zylfie<sup>2</sup>, si je?

**SHOQJA ZYLFIE MUSAI:** Të gjithë mirë jemi, shumë mirë. Jam shumë e gëzuar që na erdhe në shtëpi, shoku Enver. Të na rros sa malet! Na e bëre Shqipërinë lule, me gjithë të mirat.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ju erdha në shtëpi si atëherë, gjatë luftës. Do të jenë të paharruara ato kohë

---

1. Patriot, në shtëpinë e të cilit, në Kishtë të rrethit të Gramshit, shoku Enver Hoxha dhe Shtabi i Përgjithshëm u strehuan gjatë Operacionit armik të Dimrit.

2. E shoqja e File Musait.



si për të gjithë, edhe për mua. Më kujtohet si tani ajo dhomë e madhe, me minderin anash dhe me dollapin mbi të. Gëzohem shumë që ju gjej të gjithë mirë. Tani qenkeni bërë gjithë këta.

**SHOKU KADRI MUSAI<sup>1</sup>:** Ne jemi 6 vëllezër dhe dy motra, shoku Enver. Që nga koha e luftës jemi shtuar shumë. Ja, shikoni sa shumë jemi bërë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ishin ditë të vështira atëherë, kurse tani kohët kanë ndryshuar, fëmijët rriten të lumtur e të gëzuar. Pa hajde një çikë te xhaxhi ti. (*Shoku Enver merr në duar një fëmijë të vogël rreth një vjeç. Pastaj pranë tij afrohen fëmijë të tjerë dhe të gjithë së bashku dalin në fotografi.*)

Erdha parmbremë dhe i thashë shokut Jashar: Dua të vete te Filja medoemos, se i kam dhënë edhe fjalën.

Ja, po e ngre këtë gotë raki, ashtu siç bënim në kohën e luftës, sido që nuk pinim. Megjithatë, kur futeshim tek ajo dhoma e vogël, e kthenim nga një gotë.

Gëzuar! Të rrosh, File! Të rrojë Partia! Të të rrojnë djemtë, çupat, nuset, nipërit e mbesat! Rrofshi të lumtur e të gëzuar të gjithë!

**SHOQJA ZYLFIE MUSAI:** Të na rroni ju sa malet! Të rrojë Partia, të rrojmë e të gëzojmë të gjithë së bashku!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kaluan 29 vjet që nga ajo kohë. Më kujtohet si erdhëm atëherë natën tek ti. Të kujtohet si na erdhën ballistët atëherë?<sup>2</sup>

1. I biri i File Musait.

2. Shih: Enver Hoxha, «Mes njerëzve të thjeshtë» — Kujtime, f. 309.

*SHOKU FILE MUSAI*: Dy ditë dhe dy net me ballistët ishim bashkë në një shtëpi, vetëm një mur na ndante me ta.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Po nga ata të Tares<sup>1</sup> kush rron?

*SHOKU FILE MUSAI*: Tarja ka vdekur, po janë djemtë.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Malli është i madh për gjithë njerëzit e luftës. Kam dëshirë të madhe t'i takoj e të bisedoj me gjithë shokët e vjetër të luftës, për të kaluarën, për të tashmen, për të ardhmen e vendit tonë, sepse këto çështje kanë qenë dhe janë të përbashkëta. Këtu qëndron forca e madhe e Partisë. Ne duhet ta kujtojmë kurdoherë së bashku të kaluarën, të diskutojmë e të pleqërojmë me njëri-tjetrin problemet, që të bëhet sa më mirë për popullin. Takimet me njerëzit e popullit janë kurdoherë të nevojshme, por, duke pasur edhe shumë punë të tjera, nuk e realizojmë gjithmonë këtë dëshirë. Megjithatë shokëve në rrethe u themi të mos i harrojnë shokët e miqtë e vjetër të luftës, sepse janë bazë e kësaj Shqipërie të re, janë njerëz që kanë bërë sakrifica jashtëzakonisht të mëdha. Shokët e asaj periudhe morën pushkën në çaste rreziku dhe u bënë me Partinë dhe me popullin. Shumë prej tyre ranë dëshmorë, të tjerët vazhduan luftën dhe pas Çlirimit kanë punuar dhe kanë fituar eksperiencë të madhe.

Hallet e popullit sot nuk janë kaq të mëdha si atë-

---

1. Tare Dyrmishi, patriot nga fshati Bërsnik i krahinës së Vërçës, në rrethin e Gramshit, në shtëpinë e të cilit shoku Enver Hoxha është strehuar gjatë Operacionit armik të Dimrit.

herë, ato as nuk janë të asaj natyre, por probleme që duhen zgjidhur ka. Shqipëria ka nevojë për shumë gjëra, duhet të përmirësohet akoma jeta e popullit, që ky të rrojë më mirë, po Partia punon dhe lufton që të sigurohet edhe jeta e brezave të ardhshëm. Të gjitha këto bëhen duke u këshilluar me popullin, në bisedime të hapëta, të sinqerta, jo me mendime e veprime të shpejtuara e të turbullta. Kështu ma merr mendja mua, File, gjithë këto gjëra që kemi përpara, t'i bëjmë me popullin dhe jo vetëm me një mijë e me dy mijë veta, prandaj këshillimi me të është i domosdoshëm, kontaktet e Partisë me masat janë të mira dhe japin rezultate.

Kështu Partia bëri një punë të madhe me gratë, i mësoi, dhe ato tani janë futur në punë, marrin rrogë, pra janë të zonjat e vetes. Kurse më parë ishte krejt ndryshe, gruaja ishte e mbyllur brenda katër mureve. Më kujtohet mëma ime kur i thoshte babait: «Më bëj një palë shollë<sup>1</sup>, more burrë!».

*SHOKU FILE MUSAI:* Shqipëria ka një popull të mrekullueshëm, po edhe populli ka sot një udhëheqje të mrekullueshme, ndryshe nuk do të ishin bërë tërë këto ndryshime të mëdha. Asnjëherë më parë, gjatë jetës së popullit shqiptar, nuk është parë një vrull e përparim kaq i madh, si ky pas Çlirimit e këtej.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Nga ky popull i mrekullueshëm dolëm ne komunistët.

*SHOKU FILE MUSAI:* Populli ka luftuar gjithmo-

---

1. Opinga, këpucë.

në, por mundi i ka shkuar kot se s'kishte udhëheqje. Vetëm këtë herë fitoi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Fitoi, se e udhëhoqi Partia, që zbatoi idetë e Marksit dhe të Leninit. Ne i çuam ato në popull, të cilit i forcuam besimin, i shpjeguam se duke u qëndruar besnik në jetë mësimëve të marksizëm-leninizmit, do të arrinte fitore. Ndryshe kjo nuk arrihej, siç nuk mund të arrihej me ballistët; edhe ata shqiptarë ishin, edhe ata e shkrepën pushkën, por këtë e bënë për të ngrënë në kurriz të popullit, për ta shtypur atë, për interesat e tyre.

Ju të rinjtë shkoni ndonjëherë në Kishtë?

*SHOKU KADRI MUSAI:* Nganjëherë. Fillova të shkruaj diçka nga kujtimet e luftës, shoku Enver, që të mos venë kot e të harrohen ngjarjet, se ka gjëra që nuk i dimë as ne, pale të rinjtë pastaj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Duhet gërmuar kujtesa, duhet hedhur çdo gjë në letër, se ajo është historia e popullit. Edhe përpara u kanë vënë rëndësi të madhe traditave e kujtimeve, kanë luftuar njerëzit për këtë qëllim, por regjimi i Zogut nuk pyeti për to. Unë shikoj që tani kanë dalë dokumente për njerëz që më parë nuk njiheshin. Ata ishin të thjeshtë, shokë të babait dhe të xhaxhait tim, po kush i njihte përpara? Mirëpo tani njerëzit tanë gërmojnë me zell arkivat, pyesin edhe në popull, sidomos të moshuarit, me qëllim që të përjetësohen ngjarjet. Populli pas Çlirimit ka krijuar gjëra të mëdha, shumë të bukura.

Kombinati metalurgjik që po ngrihet këtu do të jetë «buka» e industrisë sonë, një vepër madhështore. Çdo gjë mund të na ngjasë, po traktorët asnjëherë nuk

duhet të mbeten pa punë, makinat, gjithashtu, duhet të lëvizin e do të lëvizin edhe në sajë të kësaj vepre të madhe, sepse këtu do të prodhohen çelique të ndryshme. Shumë vegla do t'i bëjmë vetë dhe numri i tyre do të shtohet vazhdimisht në të ardhmen. Në qoftë se tani shumica e tyre vijnë nga jashtë, nesër, kur të mbarojë ky kombinat, nuk do të kemi nevojë për të sjellë shumë materiale importi, sepse do të jemi në gjendje që shumicën e sendeve e të mjeteve ta prodhojmë vetë. Ky është fillimi e, në perspektivë, prodhimi i metalurgjisë do të dy-e trefishohet. Kjo, sigurisht, nuk do të bëhet në një ose në dy vjet. Kombinati do të kompletohet dhe, siç thashë, do të prodhojmë jo vetëm për të përballuar nevojat e vendit, por edhe për të shitur, pra ka akoma shumë punë për ne dhe për brezat e ardhshëm.

U gëzova shumë, File, që të gjeta në shtëpi të lumtur e të gëzuar me gjithë të dashurit. Tani do të na lejoni të ngrihemi, se do të shkojmë edhe gjatë. Hajde t'i zbresim shkallët të dy bashkë, të mbajmë njëri-tjetrin.

*Pasi dolën në fotografi të gjithë së bashku në oborrin e shtëpisë, shoku Enver u nda me Filen, me nënë Zylfien dhe me gjithë pjesëtarët e tjerë të familjes, duke u uruar atyre jetë të gjatë, gëzim e lumturi. Njerëzit që kishin mbushur rrugën para shtëpisë, shpërthyen në brohoritje e gëzim të papërshekruar, duke e përcjellë e përshëndetur me duartrokitje, derisa makinat u larguan.*

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## QOFSHI GJITHINJË TË LUMTUR E TË GËZUAR!

*Nga biseda në familjen e Sherif Çekës*

16 maj 1973

*Shoku Enver Hoxha bëri vizitë në familjen e patriotit Sherif Çeka, në shtëpinë e të cilit, në Shmil, është strehuar gjatë kohës së luftës. Atje e pritën Selime Çeka, e shoqja e Sherifit (i cili nuk jeton më), e ëma, nënë Havaja, si dhe pjesëtarë të tjerë të familjes.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni me shëndet?

**SHOQJA SELIME ÇEKA:** Shumë mirë jemi, shoku Enver. Të na rrosh sa malet! Jemi të gëzuar që të shikojmë mirë me shëndet. Nga gëzimi që kam sot më duket sikur edhe Sherifi është i gjallë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Do të ulem këtu si në shtëpinë time, pranë nënës së Sherifit, si dikur, gjatë kohës së luftës. (I drejtohet nënës së Sherifit.) Të kujtohet kur vinim në Shmil te ju, atëherë, dhe ti na bëje bukën?

Jam shumë i lumtur dhe i gëzuar që erdha t'ju shoh, se më kishte marrë malli.

**NËNË HAVAJA:** Më duket sikur sot më ka ardhur Sherifi në shtëpi, më dukesh si djali im.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Kështu të më konside-

rosh, se jemi dashur shumë, si nënë e bir, me njëri-tjetrin. Sherifi, djali yt, ka qenë njeri shumë i mirë, burrë i mençur. Po kështu ishte edhe Ali Disha.

*Shoku Enver Hoxha u drejtohet fëmijëve të Sherifit:*

Ju keni pasur një baba shumë të mirë. Ai kishte influencë të madhe në Shmil dhe e ka ndihmuar shumë luftën dhe Partinë, prandaj ruaj kujtimet më të mira për të.

Njëherë, pas Çlirimit, Sherifi erdhi bashkë me Ali Dishën për të biseduar me mua, në Tiranë. Hynë brenda dhe filluan të heqin këpucët. «Ç'bëni ashtu», u thashë unë.

«Po heqim këpucët, — m'u përgjigjën, — se ngjishet qilimi».

«Mos i hiqni, — u thashë, — se ky qilim ka qenë i Shefqet Vërlacit!».

«Ama i atij qeni qenka?! Atëherë le të ngjishet!».

Dhe Sherifi me Aliun filluan të përplasnin këmbët mbi qilim dhe thanë «Vdekje bejlerëve!».

*SHOQJA SELIME ÇEKA:* Na keni gëzuar e nderuar shumë me ardhjen tuaj.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të gëzuar e të nderuar qofshi kurdoherë!

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Shoku Enver, sa mori vesh që Sherifi ishte i sëmurë, menjëherë dërgoi sekretarin e tij, shokun Haxhi Kroi dhe mjekun, të cilët u kujdesën, u bënë të gjitha përpjekjet, por ai nuk shpëtoi dot.

*SHOQJA SELIME ÇEKA:* Ju faleminderit shumë!  
Kur ishte sëmurë Sherifi më tha: «Po ju lë amanet

çunat, bëni kujdes që të ecin në rrugën e Partisë gjithë jetën».

*SHOKU ENVER HOXHA:* Qofshi ju shëndoshë, të gëzuar, të lumtur! Na vjen keq se, me gjithë përpjekjet që u bënë, nuk e shpëtuam dot Sherifin. Jeta kështu e ka.

*(Në shtëpinë e Sherif Çekës ndodhej dhe e shoqja e patriotit Ali Disha, e cila kishte ardhur për t'u takuar me shokun Enver Hoxha.)*

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ti, motër, si je me shëndet? Vajzat si i ke. a i ke martuar?

*SHOQJA SELIME DISHA:* Të gjithë mirë jemi, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Aliun e kisha mik të ngushtë, ishte burrë i mirë dhe i drejtë. Kam ndenjur në shtëpinë tuaj, kështu si dhe në shtëpinë e Sherifit. Atje ishte edhe plaka, nëna e Zenelit<sup>1</sup>, dhe nusja e Zenelit. Ato na kanë shërbyer, siç ju kanë shërbyer edhe juve e Aliut.

Njëherë erdhën aty afër ballistët. Ne morëm menjëherë pushkët dhe dolëm në bregun e Shmilit e zumë pozicion, kurse nusja e Zenelit shkoi nga dushku. Plakën me gjithë djalin, Abazin<sup>2</sup>, i lamë në shtëpi. Ne prisnim që andej të kalonin ballistët, por pas ca kohe Sherifi na dërgoi lajm se ata nuk do të vinin, prandaj u kthyem përsëri në shtëpi.

Abazin nuk e kisha parë që në kohën e luftës kur ishte i vogël. Ai vinte e më prekte koburen që mbaja në brez. Zeneli i fliste gjithnjë: «Abaz, mos e trazo atë

1. Zenel Disha, nipi i Ali Dishës.

2. Djali i Zenelit.



xhaxhin». Por, kur disa vjet më parë u bë festa e Labi-notit, më 1968, takova atje nusen e Zenelit. Pastaj erdhi e më takoi aty edhe Abazi, që qe rritur e bërë burrë.

Qofshi të lumtur e të gëzuar! T'ju rrojnë djemtë, nipërit e mbesat!

Ti, Selime, të rrosh sa malet! Kujtimi i Sherifit të jetë i paharruar!

Gëzuar të gjithëve!

Ti, nënë Hava, paç pleqëri të bardhë!

Kujdesuni për plakën, se ju rriti, ju bëri burra. Gratë tuaja sidomos të kenë kujdes për nënën, se ju ka bërë kokën.

Ramë Çeka<sup>1</sup> ç'fëmijë ka?

*SHOQJA SELIME ÇEKA*: Ka një djalë ushtar.

*SHOKU ENVER HOXHA*: E kam njohur Ramën.

Gëzuar! Në gëzime të gjithëve!

*NËNË HAVAJA*: Të na rrosh sa malet!

*SHOKU ENVER HOXHA*: Të tëra nuset i paske në punë, nënë Hava, shumë mirë. Puna të bën të shëndetshëm e të gëzuar.

*SHOQJA SELIME ÇEKA*: Jemi shumë të gëzuara. Të gjitha këto të mira na i solli Partia. Të rrojë Partia!

*SHOKU ENVER HOXHA*: Jam shumë i gëzuar që erdha sot këtu te ju. Qofshi mirë kurdoherë! T'ju rrojnë çupat, djemtë, nuset dhe gjithë të dashurit! Mbetshi me shëndet!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

---

1. Vëllai i Sherif Çekës.

## ÇDONJËRI TE NE DUHET TË MENDOJË E TË PUNOJË SI MILITANT

*Nga biseda me punëtorët e Kombinatit të Drurit  
në Elbasan*

17 maj 1973

*Shoku Enver Hoxha, i shoqëruar nga shokë të udhëheqjes së Partisë dhe të pushtetit të rrethit të Elbasanit, bëri një vizitë në Kombinatin e Drurit, ku u prit me brohoritje dhe duartrokkitje të stuhishme nga punëtorët. Pasi vizitoi fabrikat dhe repartet e ndryshme të kombinatit, ai pati një takim shumë të përzemërt me punëtorët pararojë dhe drejtuesit e kombinatit.*

**SHOKU ARQILE GUGU**<sup>1</sup>: Ne jemi shumë të gëzuar që ju kemi sot në gjirin tonë, shoku Enver. Nga koha kur keni bërë vizitën e fundit në ndërmarrjen tonë, ne kemi pasur vazhdimisht parasysh porositë tuaja shumë të vlefshme, prandaj kemi arritur rezultate të mira. Fabrika që sapo vizituat, të cilën e kemi ngritur kryesisht me forcat tona, prodhon mobilie të kurbuara. Këtu kemi filluar të prodhojmë dhoma gjumi, divanleto,

---

1. Në atë kohë drejtor i kombinatit.

mobile e orendi të ndryshme, me të cilat plotësohen jo vetëm nevojat e punonjësve të rrethit tonë, po edhe të shumë rretheve të republikës. Një kontribut të madh ka dhënë për këto kryeinxhinieri i kombinatit, shoku Ilo Shqau, që e kemi kuadër të vjetër e me përvojë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, ai është i vjetër, ka shumë vjet këtu, e mbaj mend edhe unë.

*SHOKU ARQILE GUGU:* Në fabrikën e kompensatës në vitin 1971, për herë të parë, duke shfrytëzuar një linjë që prodhonte vetëm për ambalazh, prodhuam kompensatën me format të madh, për të cilën kishim shumë nevojë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Për formatin e madh keni presa?

*SHOKU ARQILE GUGU:* Po, shoku Enver, shfrytëzuam ato ekzistueset.

Gjithashtu, të gjitha mbeturinat e kompensatës që digjeshin më parë në kaldajë, i kthejmë në kompensatë me format të vogël, në linjën që kemi ngritur. Këto prodhime të linjës së kompensatës, të linjës së pancleve dhe të arkave të ambalazhit, kanë bërë të mundur nga viti në vit të rritet koeficienti i përdorimit të lëndës së drurit. Tani vëmendjen kryesore e kemi përqendruar në drejtim të normave, të forcimit të disiplinës, të zbatimit të revolucionit tekniko-shkencor e sidomos në shfrytëzimin e lëndës drusore.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Përse janë të ulëta normat teknike, shoku kryeinxhinier?

*SHOKU ILO SHQAU:* Normat teknike, shoku Enver, i kemi në disa operacione pune me presa, ndërsa në disa operacione, siç është puna nëpër gadra, ku dia-

metri i trupit lëviz mjaft, është më zor të përcaktosh teknikisht treguesit e normave teknike, Megjithatë, edhe në to po marrim masa, kemi filluar të ndajmë trupat sipas diametrit dhe do të përpiqemi të kalojmë në rrugën e normimit teknik, sepse më përpara trupat me diametër 20 dhe 15 cm nuk i ndanim.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Po, gjenden rrugët për të vendosur normat teknike. Disa i kuptojnë ato si diçka të paarritshme, jashtëzakonisht matematike e metikuloze<sup>1</sup> dhe mendojnë që ndërmarrja e tyre nuk ka mundësi t'i realizojë. Por, ja se si arritët ju dhe e shikoni se nuk është diçka fort e ndërlikuar. Ju klasifikuat diametrat e trupave dhe mund të caktoni për cilindro diametër një normë të veçantë teknike, sepse nuk ka arsye të jenë të njëjlojta. Norma teknike është më e avancuar nga progresivja, është, pra, më shumë në interesin e përgjithshëm të socializmit dhe të vetë punëtorëve, se forcon disiplinën në punë, rrit rendimentin dhe ka shumë anë të tjera pozitive. Nuk duhet shkuar në pikëpamjet e disa specialistëve që thonë se nuk kemi mundësi të plota për t'i vendosur ato.

Pastaj puna e atij që zbaton norma teknike duhet të vlerësohet më mirë se të tjerët dhe nuk është e drejtë që ai që nuk punon me normë teknike të marrë më shumë nga një punëtor që punon me norma teknike, se qëllon që ata që hezitojnë të ngrenë normën, marrin më shumë lekë. Kjo nuk mund të ecë në socializëm dhe nuk ndihmon për vendosjen e normave të perfeksionuara teknike. Prandaj është e domosdoshme

---

1. Të përpikëta.

të bëhen disa hapa më të guximshëm dhe më progresivë në këtë drejtim nga teknikët dhe punëtorët tuaj.

*SHOKU ILO SHQAU:* Ne, shoku Enver, kemi bërë shumë për mekanizimin e proceseve të punës me lëndën e parë dhe, si rrjedhim, ka filluar ndarja e trupave, prodhimi është rritur, cilësia është përmirësuar dhe lënda e drurit është kursyer. Tani jemi në studim të përcaktimit të asaj që thatë ju dhe të normës teknike.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sharrat e Elbasanit i keni një ndërmarrje?

*SHOKU ARQILE GUGU:* Po, por nuk zënë ndonjë peshë të madhe në furnizimin e kombinatit me lëndë të parë.

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU:* Janë bërë base-ne shumë të mira që mbajnë drurin gjithnjë të freskët e me cilësi dhe për tre muaj kemi rezervë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Çfarë druri përdorni zakonisht këtu?

*SHOKU ARQILE GUGU:* Përdorim ah, ndërsa arrën e përdorim shumë pak.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa për qind përdorni dru arre?

*SHOKU ARQILE GUGU:* Fare pak, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Fronat që pashë në dhomën e ekspozitës, të destinuara për eksport, me rimeso janë prodhuar apo me ndonjë material tjetër?

*SHOKU ARQILE GUGU:* Jo, nuk janë me rimeso, janë thjesht me kompensatë të lyera me bojë arre dhe të lustruara mirë, kurse rimeson e arrës e kemi vetëm për në vend.

*SHOKU SKËNDER PEPI*<sup>1</sup>: Gjallërimi i jetës së organizatave-bazë të Partisë ka qenë gjithnjë në qendër të vëmendjes së punës sonë, por fjalimet tuaja të kohëve të fundit, shoku Enver, e kanë rritur akoma më shumë këtë veprimtari si dhe vetëveprimin e komunistëve e të punëtorëve. Janë kuptuar më drejt dhe më nga afër problemet që trajtoni ju lidhur me rrethimin imperialisto-revizionist. Kështu, te ne është rritur fryma e përgjegjësisë për detyrat, pavarësisht se furnizimi ynë me disa materiale varet nga importi, për të cilat shpesh ndodhemi në vështirësi.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Sa inxhinierë keni këtu?

*SHOKU ILO SHQAU*: 9 inxhinierë.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Ka shoqe inxhinierë?

*SHOKU ILO SHQAU*: Kemi vetëm një.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Ka inxhinierë të pyjeve këtu?

*SHOKU ARQILE GUGU*: Në ndërmarrjen tonë kemi tre inxhinierë pyjesh.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Kombinati juaj lëndën e parë e siguron në pyje dhe që punëtorët ta kryejnë mirë punën, duhet të kenë dijeni për lëndën e parë. Kjo është një nga kërkesat kryesore për ta. Të dinë si prodhohet lënda e parë, llojet e këtyre lëndëve, rezistencën e tyre, armiqtë e lëndës së drurit, të dinë, gjithashtu, përdorimin e tyre në format më të ndryshme e për sende e orendi të ndryshme, cili është i leverdishëm, cili është më pak i leverdishëm, ç'loj lënde du-

---

1. Në atë kohë sekretar i organizatës së Partisë të kombinatit.

het të përdorim për mobilitet e ndryshme. Punëtorët tuaj duhet të kenë dijeni se ç'mundësi ka vendi ynë për lëndën e parë që jep ahu, arra, pisha, panja e kështu për të gjithë drurët e tjerë pyjorë, se ata e përpunojnë këtë lëndë.

Këtu çështja qëndron si me furrxhiun që pjek bukën ose me prodhuesin e makaronave. Ata interesohen dhe duhet të interesohen për llojin e grurit, me të cilin bëhet buka, ose duhet të dinë çfarë gruri nevojitet për makarona, i fortë apo i butë, të jetë me kaq për qind amidon apo me më shumë, deri me sa për qind krunde duhet etj. Kështu ndodh edhe në çdo profesion tjetër, ku punëtori duhet të interesohet të dijë, para së gjithash, përbërjen e materialit apo të lëndës së parë që do të përpunojë, pse mbi këtë bazë do të ndërtohen pastaj teknologjia e mjetet e prodhimit, normat dhe të gjitha kërkesat e tjera.

Është e vërtetë, se kur filluam të ndërtojmë kombinatin e drurit nuk kishim shumë njohuri për këtë punë; inxhinierë kishim pak, studimet për pyjet e vendit tonë, për mundësitë dhe për perspektivën e tyre nuk ishin aq të përsosura, kurse tani e marrim me mend sa i domosdoshëm është plotësimi i kësaj kërkesë. Që nga ajo kohë, siç e shikoni, siç tha shoku drejtor, kombinati ynë i drurit ka bërë përparime të mëdha. Ky është një fakt, po të krahasojmë ku kemi qenë në fillim dhe ku jemi aktualisht. Prodhimi sot këtu është shtuar mbi 12 herë, në krahasim me fillimin. Ky shtim është bërë edhe në asortimente. Natyrisht, rritja është realizuar duke shtuar edhe mjetet që u janë dhënë në duar punëtorëve, bile edhe vetë numrin e këtyre. Pu-

nëtorët këtu kanë mësuar, kanë marrë mjeshtëri dhe dituri, prandaj është arritur gjithë ky përparim dhe për këtë Partia ju përgëzon ju, shokë punëtorë, inxhinierë, teknikë dhe drejtues të kombinatit.

Sukseset tuaja nuk mund të fshihen e as të zvogëlohen, por kini parasysh se nevojat e vendit për prodhime druri janë shumë më të mëdha nga sa prodhoni ju, dhe se lëndë e drurit është deficitare. Siç shihet, këtu ka një kontradiktë. Prandaj këto dy gjëra duhet t'i kemi kurdoherë parasysh në planifikim. Shteti duhet të ketë parasysh zëvendësimin e lëndës së drurit, sa të jetë e mundur më shumë dhe më shpejt, me materiale të tjera, duke përfshirë edhe lëndët plastike, në mënyrë që prodhimet të jenë më pak të kushtueshme. Pra, në këtë drejtim duhen bërë përpjekje e studime për të krijuar në të ardhmen mundësi që akoma nuk i kemi. Aktualisht na mbetet ta ekonomizojmë sa më shumë lëndën e drurit, se shikojmë që ka mjaft lëshime. Për këtë nuk e kemi fajin vetëm ju, por e kanë edhe drejtuesit e sharrave, pse ndërmarrjet e zdrukthëtarive dhe kombinati juaj kanë disa procese ku punohet me lëndë të përmasave të caktuara për të bërë mobilie të ndryshme. Deri në njëfarë shkalle juve ato duhet t'ju vijnë të përgatitura.

Por kjo nuk bëhet si duhet dhe për këtë shkak kemi një humbje të madhe. Me gjithë vërejtjet dhe këshillimet që i bëjmë ministrisë, prapë në këtë drejtim ka lëshime të dënueshme. Për këtë arsye mobiliet na dalin të kushtueshme e shumë të rënda, të rënduara me materiale të panevojshme. Kështu sot, me materialin që prodhohet në bankë, mund të bëjmë dy. Për këtë



drejtuesit e sharrave nxjerrin shumë justifikime, sikur mjetet nuk janë të përshtatshme, sikur ka mungesa etj. Ka mundësi që atje të mos kenë shumë mjete të përshtatshme, siç pretendojnë disa inxhinierë, por ata mekanizma që duheshin e janë kërkuar, shteti i ka sjellë në sharrat tona, veç nuk duhet harruar se nganjëherë disa prej tyre qëndrojnë nëpër pyje pa u shfrytëzuar. Është fjala për sharra të natyrave të ndryshme, të cilat punojnë me energji elektrike, janë moderne dhe krijojnë mundësi për zëvendësimin e punës së shumë punëtorëve dhe, veç kësaj, lehtësojnë punëtorët dhe ndihmojnë shumë edhe për uljen e kostos së prodhimit. Mirëpo shikojmë që me to nuk prodhohet lëndë me përmasat që nevojiten. Kjo ndodh edhe se furnizimet nuk bëhen në kohën e duhur.

Partia vazhdimisht e ka tërhequr vëmendjen për kujdesin e madh që duhet bërë për kursimin e lëndës së drurit. Dihet se po të rrimë një vit pa mbjellë grurë, nuk do të kemi të hamë bukë, po kështu, në qoftë se nuk do të marrim masa për pyllëzimin e vendeve të prera dhe për t'i rritur si duhet që brenda kohës së caktuar shkencërisht të japin lëndën e duhur, atëherë do të vijë një ditë kur nuk do të kemi më lëndë druri. Kështu do të jetë e pamundur t'u bëjmë ballë kërkesave dhe nevojave të mëdha që lindin dhe do të na lindin në të ardhmen, sepse kërkesat për lëndë druri do të jenë shumë të mëdha, për shkak të ndërtimeve të shumanshme kapitale që bëjmë e do të bëjmë. Por nuk janë vetëm ndërtimet kapitale, po edhe banesat e punonjësve; le të marrim, për shembull, Elbasanin. Ju nuk e bëtë me lehtësi mobilimin e hotelit të ri. Fundi, ç'është

ai? Një hotel. Por sa njerëz në republikë duan çdo vit nga një krevat të ri, nga një tryezë, karrige etj., etj.

Ne tani po ngremë nga të katër anët me mijëra apartamente për punëtorët. Të gjitha këto duhet të mobilohen, ato kërkojnë pajisje. Partia dhe shteti duhet të mendojnë, dhe në fakt kanë menduar, se me këto ndërmarrje mobilierish e kombinate që ekzistojnë, nevojat e mëdha gjithnjë në rritje nuk mund të përballohen. Krahas shtimit të tyre është edhe problemi i sigurimit të lëndës së parë. Prandaj është e domosdoshme që nga organet e Partisë e të pushtetit, në qendër e në bazë, të merren të gjitha masat për pyllëzimet. Pra, të tregohet kujdes në rritjen e drurëve pyjorë, në prerjen dhe në përpunimin me kritere të lëndës së drurit etj. Prandaj edhe këtu te ju, në kombinat, punëtorët, inxhinierët dhe teknikët, përveç të tjerave, duhet të edukohen me ndjenjën e lartë të kursimit të lëndës së parë, si dhe të shfrytëzimit të çdo lloj materiali drusor. Kjo që keni bërë ju gjer tani, është me të vërtetë një sukses, por me këtë nuk duhet të mburreni, se keni akoma shumë për të bërë.

Shoku kryeinxhinier dhe shoku drejtor na thanë se ju keni arritur të bëni një punë të mirë me zemrat e drurëve, që më parë i digjnit në kaldajë, kurse tani i shfrytëzoni për qëllime më të leverdishme. Kjo është një punë e lavdërueshme dhe na bën të mendojmë se gjithnjë duhet vrarë mendja e duhen gjetur zgjidhje të reja e të mos i bëjmë këto kaq vonë.

Pra, asnjë pjesë lëndë druri, qoftë edhe mbeturinë, të mos shkojë dëm, asgjë s'duhet ta lëmë të humbasë. Ky është ai kuptim i drejtë socialist i pronës së për-

bashkët që organizatat e Partisë e çdo komunist duhet të rrënjosin te çdo punëtor i ndërmarrjes për shfrytëzimin e plotë të lëndës së drurit, që është kaq shumë deficitare dhe për të cilën ka nevoja të mëdha populli dhe ndërtimi i socializmit. Dhe, që ta kuptojnë drejt këtë çështje punëtorët, duhet jo vetëm propagandë, e cila është kurdoherë e domosdoshme, dhe do ta bëjmë, po nuk është e vetmja që do ta zgjidhë problemin. Puna është që këto çështje të shpjegohen më thellë, si nga ana ekonomike, e kostos etj., por, në radhë të parë, të shpjegohet rëndësia e tyre politike e ideologjike. Këto kanë për synim që çdo punëtor të kuptojë që, kur të vërë dorën mbi lëndën e drurit, sado e vogël që të jetë ajo, të mendojë interesin e madh të atdheut, sepse edhe interesi i tij, i familjes së tij, i vëllait, i motrës, i babait, i shokëve të tjerë lidhet me këtë interes të madh.

Nga ana tjetër, kërkohet interesim edhe për problemet teknike. Propaganda dhe shpjegimet që bëhen, qofshin filozofike, politike apo ekonomike, duhet të materializohen në realizimin konkret të detyrave. Prandaj punëtorët dhe teknikët duhet të njohin mirë detyrat që u përkasin dhe të punojnë për perfeksionimin e tyre të vazhdueshëm. Kjo do të thotë që çdo punëtor ta zotërojë plotësisht makinën. Kur të jetë kuptuar mirë politikisht nevoja e kursimit të lëndës së drurit, e kohës së punës që nevojitet për nxjerrjen e një mobilieje të përsosur me sa më pak lëndë të parë, pra kur nxirret skarcitet vetëm aq sa lejohet teknikisht dhe jo më shumë, atëherë mobilia do të dalë me të vërtetë me cilësi. Kurse ai punëtor që merret me shfrytëzimin e skarciteteve, që mund të ketë edhe ai një makinë, duhet

të dijë ta zotërojë mirë që t'i shfrytëzojë dhe t'i përdorë si duhet mbeturinat, pse çdo gjë, si kudo, edhe këtu, ka teknikën e vet.

Të gjitha çështjet, qofshin ideologjike, politike, teknike, shkencore janë një kombinim i plotë veprimesh që punëtorëve duhet t'u bëhen vazhdimisht të qarta. Punëtorët janë kurdoherë të etshëm të mësojnë, prandaj njerëzit e mësuar duhet ta kenë parasysh këtë. Njerëzit që merren me punë intelektuale edhe mund të lodhen, duke u dhënë mësim punëtorëve, kurse punëtorët durojnë më tepër, janë më rezistentë, jo se nuk ndiejnë lodhje, por e mposhtin këtë me vullnet e vendosmëri. Prandaj njerëzit që kanë dituri, duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha në punë dhe, dituritë që kanë fituar, t'ua japin edhe punëtorëve. Unë nuk them se ata nuk e bëjnë këtë. Inxhinierët, teknikët janë njerëz të shquar, të lidhur ngushtë me popullin, me punëtorët. Rrallë e tek gjen prej tyre që nuk lidhet me masën, që nuk i ngjyen duart me vajra, apo që nuk njih hallet e punëtorëve, që nuk përpiqet të bëjë novacione etj. Çështja është që nga të dyja palët të bëhet një punë akoma më e frytshme.

Kombinati juaj është një nga veprat e rëndësishme të ekonomisë sonë, prandaj ky kolektiv të jetë shembull në çdo gjë, shembull në qëndrimin politik, në qëndrimin ideologjik, në zbatimin e vijës së Partisë, shembull në punë dhe në cilësinë e prodhimeve, që të pëlqehen nga blerësit dhe të kenë jetëgjatësi.

Sekretari i Partisë i ndërmarrjes suaj foli këtu për revolucionarizimin e ndërgjegjes së njerëzve. Kjo, kurdoherë, ka qenë, është dhe do të jetë vija e Partisë

sonë, kjo duhet të bëhet jetë në punën e përditshme të organizatës së Partisë edhe këtu. Po në ç'mënyrë? Çdo komunist e patriot kur shkon në punë, në shtëpi, kur është me shokë ose me anëtarët e familjes, kur është në rrugë, në lulishte, në teatër e kudo, duhet të mendojë dhe të punojë si militant, si shtetas i Republikës Popullore të Shqipërisë, që populli e ngriti me sakrifica të mëdha e me gjak dhe tani po e ndërton dita-ditës me djersë për ta bërë gjithnjë më të bukur, më të fortë e më të pasur. Çdo qytetar e ka për detyrë të mendojë dhe të punojë që ta lulëzojmë republikën dhe ta mbrojmë nga çdo armik. Është e domosdoshme që kurdoherë të secili nga ne të ziejë ndjenja e patriotizmit. Patriotizmi të bëhet për cilindo një jetë e dytë.

Kur qëllon të bisedojmë në kafe, mund të mos kemi posaçërisht për objekt një çështje patriotike, por një problem të zakonshëm të jetës, qoftë edhe një çështje vetjake. Por ne duhet të kemi parasysh se edhe jeta vetjake është pjesë e jetës së madhe shoqërore, dhe nuk është diçka e vetmuar. Vallë kur unë jam në shtëpi, në mes të katër mureve, s'kam të bëj me çështjet shoqërore? Po edhe çështjet e shtëpisë nuk mbeten vetëm brenda katër mureve, pse, në qoftë se dikush punon keq në shtëpi, ky qëndrim medoemos do t'i reflektohet edhe në punën shtetërore. Në një mënyrë ose në një tjetër, pikëpamjet jo të drejta që mund të ketë dikush nuk i shfaq vetëm në shtëpi, por do t'i reflektojë edhe te shokët, në shoqëri, në detyrë e kudo. Prandaj edhe ato gjëra që mund të duken si pa emër, pa titull, kanë rëndësinë e tyre politiko-ideologjike.

Në qoftë se të tëra çështjet e jetës i shohim me

syrin e njeriut të ngritur politikisht dhe i shpjegojmë në frymën e politikës së drejtë të Partisë, atëherë patriotizmi te ne vazhdimisht do të forcohet. Për shembull, kur babai mendon të fejojë vajzën, dëshira e tij e parë është t'i gjejë asaj një burrë të mirë ose, më drejt të themi, që vajza të gjejë vetë një burrë të mirë. Po ç'do të thotë kjo? Kjo do të thotë që i fejuari i vajzës të jetë me rendin tonë shoqëror. Po ç'do të thotë që i fejuari i vajzës të jetë me rendin tonë shoqëror? Kjo do të thotë që ai të dojë Partinë, popullin, klasën punëtore, të urrejë bejlerët dhe agallarët, që na kanë pirë gjakun tërë jetën, të jetë njeri i ndershëm. Ky është mendimi i çdo patrioti. Të gjitha këto cilësi përmblihen nga prindi në shprehjen: «Të zgjedhë një djalë të mirë». Prandaj, kur vajza i thotë babait se ka gjetur një djalë, ai e pyet: «Kush është ky djalë, moj bijë, dhe i kujt është, ç'punë bën?». «Po babai i djalit çfarë pune bën?», e pyet i ati vajzën. «Babai ka qenë fshatar i varfër», përgjigjet ajo. Atëherë atij i ngrohet zemra dhe nuk e pyet si është nga fytyra djali, nuk e pyet për bukurinë e jashtme, këtë le ta zgjidhë vetë çifti. Prindërve u duhen cilësitë e karakterit, që përmblihen në shprehjen: «Të jetë njeri i mirë». Në qoftë se i ka këto cilësi, babai i thotë së bijës: «Pa bjere një herë këtu, moj vajzë, t'ia shohim një çikë edhe në mendjen, të shohim nëse sillet mirë apo jo dhe, po i pati këto, atëherë të të urojmë të trashëgohesh!». E kam fjalën këtu që, të gjithë interesat tanë, deri edhe ata familjarë, janë të lidhur me interesat e mëdhenj të Partisë, prandaj me këtë sy duhet t'i shohim e t'i zgjidhim ata.

Situata në vendin tonë është e shëndoshë dhe për

këtë, merita e madhe, shokë punëtorë, i takon Partisë sonë që nga një vend në shumicën dërrmuese fshatarë, qytetarë të vegjël dhe zanatçinj, brenda 30 e ca vjetësh, arriti të krijojë një parti marksiste-leniniste, ta kalitë këtë parti e ta bëjë të çeliktë e, tok me të, të kalitë edhe masat e popullit dhe së bashku me to të ndërtojë socializmin në Shqipëri, në qytet dhe në fshat, të krijojë një klasë punëtore me nivel të lartë ideologjik. Kjo është merita e madhe e Partisë sonë marksiste-leniniste, që qëndron e papërkulur përpara valëve të tërbuara të rrethimit armiqësor imperialisto-revizionist.

Por dihet se midis njerëzve ka shkallëzime në çështjen e fornimit të tyre, se nuk janë të tërë të prerë me një gërshërë, njëri e kupton shpejt një çështje, tjetri e kupton më vonë e kështu me radhë. Prandaj Partia punon që t'i edukojë të gjithë, më të fortët e më të qëndrueshmit t'i kalitë edhe më shumë dhe, të tjerët që vijnë pas tyre, të kuptojnë mirë problemet që edhe këta të ecin përpara. Po ka edhe disa që nuk i kuptojnë përnjëherësh problemet dhe bëjnë lëshime, rrëshqasin ose gabojnë. Ka edhe nga ata që për një periudhë të gjatë qëndrojnë shumë mirë, kurse vjen një moment e thyhen për një arsye ose për një tjetër. Ndodh ashtu si me ferrat nëpër kopshte e rrugë që kanë akoma rrënjë dhe kur lulëzon trëndafili përpiqen t'i zënë frymën e ta rrethojnë. Atëherë «kopshtari» i qëron ferrat dhe bën që trëndafili të lulëzojë. Po kështu në fushat tona të mbushura me grurë del shpesh luleverdha që e pengon atë të rritet, atëherë bujku përdor herbicidin dhe e mbyt atë ose bën tëharrjen.

Nuk jam specialist i punës suaj, por nganjëherë diç-

ka këndoj për lëndën e drurit dhe e di se ka disa krimba që zhvillohen brenda drurit, në qoftë se nuk gabohem, janë dy lloje krimbash: një palë e gërryejnë mobilien, pra, drurin, nga brenda, hapin labirinte në të, kurse lloji tjetër pasi e gërryen lëndën e drurit për disa kohë kthehet në flutur dhe shkon në mobilet e tjera, i infekton edhe ato. Ky lloj krimbi mund të spërkatet e të ngordhë, kurse ai që nuk fluturon po qëndron brenda, është më i rrezikshëm dhe mobilia që sot duket e re dhe e bukur, një mëngjes, pas një kohe prishet.

Partia shikon që klasa jonë punëtore është e çeliktë, populli është patriot dhe i mobilizuar rreth Partisë, megjithatë te disa njerëz janë vënë re shfaqje të liberalizmit. Atëherë Partia orienton që këto të këqija të luftohen e të flaken nga mesi ynë, sepse janë pikërisht si ai krimbi i drurit ose i mollës. Partia lufton që populli të jetë i pastër dhe në unitet të çeliktë, që socializmi të ndërtohet me sukses dhe Shqipëria të bëhet gjithnjë më e fuqishme. Prandaj edhe njerëzit me ndikime liberale duhet t'i ndreqim.

Masat e gjera të popullit aprovuan njëzëri direktivat që Partia dha kohët e fundit. Tani të tërë hapin sytë, njerëzit janë bërë më vigjilentë dhe i drejtohen njëri-tjetrit, për shembull, motrës, vëllait, djalit, kur nuk janë në rrugë të drejtë, i tërheqin vërejtjen dhe me këto ndërhyrje e bëjnë të mendojë kështu: «Ky shtet, kjo klasë punëtore, kjo Parti më kanë siguruar të gjitha të mirat, unë vetë jam në punë, edhe gruan e kam në punë, kam të siguruar çerdhe për kalamanët, kur sëmuremi spitalin dhe mjekimet i kemi pa para,



djemtë, vajzat venë deri në universitet, pleqërinë e kemi të siguruar, jemi strehuar në apartament me qira fare të vogël, atëherë, përpara gjithë këtyre të mirave, si ta nënvleftësoj unë punën dhe të largohem një ose dy ditë prej saj?». Kështu, kujto që shkel disiplinën e punës duhet t'i shpjegohet se në qoftë se zbritja e tri ditëve pagë nuk i sjell ndonjë dëm të madh personit, interesi i përgjithshëm preket rëndë, po të veprojnë të gjithë kështu. Sikur edhe për një moment të mendohej nga të gjithë punëtorët tuaj kështu, këtu te ju për tri ditë duhet t'i vihej çelësi ndërmarrjes, mirëpo kjo do të thotë që njerëzit, e bashkë me ta edhe ju vetë të mos keni mobilie, që kalamanët tuaj të kenë mungesa, të mos kenë gjithë ato mundësi e lehtësi në çerdhe si ajo që kam parë në Lagjen e Re<sup>1</sup>, këtu në Elbasan, që ishte me të vërtetë diçka e mrekullueshme. Pra, njerëzit nuk mund t'i kenë të mirat materiale, në rast se gjithkush mbyllet në botën e tij të vogël dhe thotë: «Nuk u bë kiameti pse u vonova pak në punë». Po pse të vonohesh? Ti duhet të vesh në orar të caktuar në punë dhe ta bësh këtë jetë, pse kjo është një detyrë e madhe patriotike, detyrë për ndërtimin e socializmit. Nuk është e drejtë që njeriu të mësohet me këto të meta, nuk është, gjithashtu, e drejtë ta shikosh këtë çështje në prizmin vetjak, por në atë të interesit të përgjithshëm e të republikës. Kjo është detyrë për të gjithë, sepse po të mendojnë të tërë vetëm për vete, atëherë ç'do të bëhet?

Zbatimi i disiplinës proletare në punë ka rëndësi të madhe. Te ne disiplina është kurdoherë e ndërgjegjsh-

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 46, f. 185.

me. Punëtori ynë nuk përdor detyrimin, por ai i thotë shokut: «Çfarë po bën kështu? Përse vjen vërdallë? Kur unë derdh djersë, ti çfarë bën?! Shteti të paguan, pran-daj ti e ke për detyrë të bësh sakrifica. E di kush është shteti? Jam unë punëtori». Kur punëtori thotë këtë, njeriu i pandërgjegjshëm duhet të mendohet.

Klasa punëtore jo vetëm duhet të jetë vetë më e disiplinuar dhe në pararojë, në çdo drejtim, por të mësojë edhe të tjerët në shembullin e saj. Puna është që t'i ndreqim dobësitë e disa njerëzve. Partia nuk ka asnjë qëllim që t'i dënojë ose t'i hedhë tej ata, në asnjë mënyrë. Dënimi te ne është masa e fundit dhe përdoret në ato raste dhe për ata njerëz që nuk vënë mend, që nuk duan ta kuptojnë problemin politikisht dhe që nuk duan të pranojnë punën bindëse, që nuk duan të zbatojnë vijën e drejtë të Partisë, ideologjinë e saj, që nuk punojnë për interesin e të gjithë popullit. Pra, për ata që mbushin kupën, natyrisht, vepron ligji, por ligji që ka përmbajtje politike dhe ideologjike, vepron atëherë kur metoda e bindjes nuk bën efekt. Qëndrimet sentimentale në këto raste janë të dëmshme. Kur janë bërë të gjitha përpjekjet, nuk ka pse të mendohet: «Ta falim se është punëtor». Tamam pse është punëtor nuk duhet të bëjë veprime të palejueshme. Mund të falet tjetri një herë, të falet dy herë fundi i fundit, por të tretën herë nuk mund të falet dhe duhet dënuar. Si mund t'i falet faji një elementi që ka vjedhur pesë herë me radhë. Ka edhe ndonjë gjykatës që, me gjithë përpjekjet që janë bërë, thotë: «Merreni këtë dhe bëni punë edukative. . .». Në këto raste të mbahet parasysli se ky është një njeri, tek i cili puna edukative nuk zë vend.

Partia dhe populli janë zemërgjerë, po zemërgjerësinë e tyre ta kuptojmë drejt, sepse kjo vepron kur njerëzit gabojnë pa dashje, apo jo, more shokë punëtorë? Pse të tërë gabojmë, të përsosur nuk jemi dhe në këto raste Partia na heq veshin, prandaj të gjithë duhet të jemi të logjikshëm, të mendojmë e të mbajmë qëndrime të drejta kur Partia na kritikon.

Kur të kritikon shoku, kurdoherë nisu nga mendimi që ky nuk ta do të keqen, sidomos në organizatën-bazë të Partisë. Nga ky parim duhet nisur në çdo rast, pse kështu nuk gabon. Edhe kur të kritikojnë në kolektiv, shko, gjithashtu, me mendimin që gjithë këta njerëz që të kritikojnë, që të flasin për të metat e gabimet, nuk ta duan të keqen. Atëherë i kritikuari nuk duhet të hidhet si kaposh. Përkundrazi, duhet të mendojë rreth kritikave që i bëhen. Në qoftë se nuk është në gjendje të japë përgjigje, duhet të kërkojë ndjesë, t'u thotë shokëve t'i lënë kohë të mendohet. Në qoftë se është akoma i turbullt, mund t'u thotë: «Tani për tani, more shokë, nuk po e kuptoj këtë që po më thoni, as nuk po kuptoj si më ngjau kjo», kështu ai u hap zemrën shokëve dhe ata përnjëherë do ta falin. Këtu tregohet madhështia e Partisë, e kolektivit, zemërgjerësia e masave të popullit. Ata do të thonë: «Ky është njeri i ndershëm, edhe pse e ka përsëritur gabimin, prapë do ta falim, se duhet ndihmuar».

Organizata-bazë e Partisë edhe masat e kuptojnë kur një person gabon pa dashje, qoftë edhe dy herë. Kur bindet se një faj nuk është bërë me qëllim, rrethi shoqëror e ndihmon. Po kështu ky e kupton kur diçka bëhet me qëllim, ose që vepron i kurdisur etj. Kjo kupto-

het kur vigjilenca mbahet vazhdimisht ngritur, kur mendohet interesi i Partisë edhe i popullit, në radhë të parë, ndryshe, po nuk u mendua ky interes, bihet në indiferentizëm. Ka njerëz që kur kritikohet një shok që ka gabuar, heshtin, duke thënë me vete ç'më duhet mua të flas, se nesër edhe unë mund të bëj të njëjtin gabim që bëri ai. Kështu mbeten vetëm dy-tre që diskutojnë, për të cilët pastaj hapet fjala sikur janë llafazanë. Përhapet edhe mendimi jo i drejtë: «Ruajuni nga ata, se të bëjnë gjëmën», kurse në fakt ata që kritikojnë janë njerëz të drejtë, të guximshëm, prandaj edhe flasin. Ata që thonë: «Ç'më duhet mua, ç'të përzihem unë në këtë punë», nuk mendojnë si marksistë, dhe as si patriotë. Si, ç'të «përzihesh» ti? Po kush do të «përzihet» për t'i ndrequr?

Në këto momente revolucionare duhet të kemi shumë kujdes, se ka edhe nga ata njerëz që dalin, siç del mbi të tjerët kalliri i grurit pa një kokërr brenda, ka njerëz që përpiqen të dalin «mbi ujë», të cilët fillojnë e flasin shumë që të duken, le të jenë edhe krunde përbrenda. Të tillë njerëz, po të dëgjojnë shprehjen: «Ç'më duhet mua», fillojnë flasin vetë, japin vijën, kurse, në fakt, janë të krimbur. Prandaj, kush thotë përpara atyre: «Ç'më duhet mua kjo punë», bën një gabim të madh, lejon të dalë mbi ujë njeriun me kapacitet të ulët, njeriun që ka bërë një mijë e një gjëra, që përpiqet të përfitojë nga lëshimi që i bëhet e i vërsulet një shoku të mirë duke ia fryrë e zmadhuar fajet, i cili edhe pse ka bërë një faj ose gabim, nuk është njeri i keq. Kurse indiferenti rri mendon që po të flasë, do t'ia marrin për keq. Me këtë qëndrim ai nuk vepron drejt, por vepron

si liberal. Drurit të shtrembër i duhet thënë: «Ore ti, mik, pa rri një çikë aty ku je, se ky vërtet ka bërë një gabim, por, sipas mendimit tim, është njeri i mirë, prandaj si njeri i Partisë dëshiroj të të them se ti, që më flet kaq hapur e serbes, ke për vete shumë kusure» dhe ia numëron pa druajtje të tëra, i thotë: «Të njohim kush je, prandaj mbylle gojën, dil dhe bëj autokritikë para masës, mos u përpiq të fshihesh dhe korrigjohu për vete». Po të veprohet kështu, të tillë njerëzve u mbli-dhen rripat. Prandaj, në çdo rast, duhet vigjilencë, duhet pjesëmarrje aktive. Qëllimi është t'i shërojmë njerëzit, t'i bëjmë të ecin në vijën e Partisë, që të tërë të mobilizohen si duhet në rrugën e drejtë për ndërtimin e plotë të socializmit.

Në kombinatin tuaj shumica e punëtorëve janë gra. Të mos na vijë keq neve burrave, por është fakt që gratë në mbrojtjen e vijës së Partisë janë shumë më konsekuente dhe energjike se ne burrat. Ato kanë të drejtë të jenë të tilla, sepse Partia i nxori nga errësira në dritë, u dha të gjitha të drejtat: të punës, të fjalës, liritë demokratike, krijoi në familje një situatë krejt ndryshe nga ajo e dikurshmja, krijoi barazi të plotë me burrin dhe kryesorja është se i çliroi ato ekonomikisht. Gruaja jonë në socializëm gjeti realizimin e plotë të ëndrrave të saj: lumturinë personale, të familjes dhe të fëmijëve të saj. Ajo sa ngrihet në mëngjes nuk ka më shqetësimin se a do të ketë të hajë, a do të ketë të vishet kalaman i saj. Të tilla shqetësime ajo nuk ka më, sepse kohët e rënda për të kanë mbaruar. Gruaja shqiptare sot e ka perspektivën të qartë: ajo punon dhe merr rrogën, i plotëson të tëra nevojat, ka çerdhe e kopshte

për fëmijët, dyqanet të furnizuara me çdo gjë, apartament me qira të vogël, sigurimin shoqëror kur sëmuret etj., etj., përveçqë ka të drejtë të zgjidhet dhe të zgjedhë në organet e Partisë e të pushtetit kudo. Me këto kushte ajo, pra, s'ka pse të mos jetë në pararojë.

Partia kurdoherë ka thënë se socializmi nuk mund të ndërtohet pa grua të lirë dhe revolucionare, pse gruaja është gjysma e njerëzimit dhe pa lirinë e saj nuk mund të ketë socializëm, përkundrazi ka skllavëri. Në vendet kapitaliste, edhe në ato më të zhvilluarat, gruaja nuk gëzon të drejta, është gati si skllave. Edhe pse nga ana e jashtme gruaja atje mund të jetë e veshur mirë, ajo në fakt nuk gëzon asnjë të drejtë, bile, nuk e lejojnë as të votojë. Në shumë vende kapitaliste, për një punë të barabartë me burrin, gruaja paguhet më pak se ai; shumica dërrmuese e grave atje janë pa punë, bile edhe burra ka me miliona që janë pa punë, prandaj për gratë atje nuk pyet fare njeri. Të mos flasim pastaj për vendet e Afrikës, të Azisë e të Amerikës Latine, ku ekziston një mjerim i madh i përgjithshëm.

Kurse në vendin tonë gruaja ka arritur gjithë këto fitore të mëdha që ia detyron Partisë. Prandaj gruaja shqiptare është në pararojë për mbrojtjen e vijës së Partisë, për mbrojtjen e marksizëm-leninizmit, për mbrojtjen e socializmit. Edhe ju këtu, mbështetjen kryesore duhet ta keni te gratë, tek të rejat e të rinjtë; klasa punëtore këtë nuk duhet ta harrojë.

Ç'thonë punëtorët për këto probleme që ka ngritur kohët e fundit Partia përpara popullit? Po shoqet si i kanë pritur këto materiale të Partisë?

*SHOQJA YLVIJE SAKO*<sup>1</sup>: Ne, shoqet, kemi për të folur më shumë nga shokët, sepse, siç e theksuat edhe ju, shoku Enver, dhe siç e thekson Partia përherë, kemi qenë më të shtypura, ndaj lirinë e duam më tepër. Në qoftë se Partia dhe ju, shoku Enver, keni bërë një punë të dyfishtë apo të trefishtë për ndërtimin e socializmit, për çlirimin tonë keni bërë një punë shumë herë më të madhe. Çlirimin tonë ne ia dedikojmë Partisë dhe, në radhë të parë, juve, shoku Enver.

Siç e patë vetë, megjithëqë i porositëm punëtorët të rrinin nëpër vende, ata nuk përmbaheshin nga gëzimi tani që ju ordhët këtu, secili donte t'ju shihte, t'ju përqafonte, t'ju thoshte fjalët e zemrës. Të gjithë janë gati të vënë në jetë atë që na mëson Partia dhe ju, shoku Enver. Organizatën-bazë, ashtu si gjithë Partinë, edhe ne këtu në kombinat e kemi të fortë. Prandaj gjithë bota e ka zili Partinë tonë që është e shëndoshë dhe na udhëheq drejt.

I pretojme Partisë dhe juve, shoku Enver, se do të punojmë më shumë e më me cilësi, do të kursejmë më mirë jo vetëm lëndët që na vijnë nga importi, po edhe drurin, kompensatën, rimeson që, siç e thanë shokët, janë deficitare.

*SHOKU JASHAR MENZELXHIU*: Këto që na thate, shoku Enver, janë këshilla shumë të vlefshme për organizatën tonë të Partisë dhe për gjithë punëtorët e kombinatit, prandaj do të mobilizohemi me të tëra forcat për t'i realizuar me çdo kusht detyrat që na vutë përpara.

---

1. Punëtore në këtë kombinat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këtë situatë revolucionare që është krijuar duhet ta mbajmë gjithnjë lart.

Ju uroj juve, punëtorëve, punëtoreve, inxhinierëve, drejtorit dhe gjithë punonjësve të tjerë të kombinatit suksese në detyrë, ta realizoni me nder dhe ta tejkaloni planin. Ju uroj, gjithashtu, të gjithëve lumturi në familje, pse lumturia e familjes te ne është lumturia e gjithë republikës.

Të rrojë Partia!

Të rrojë klasa punëtore!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*



## TE REJAT E TE RINJTE JANE E ARDHIMJA E ATDIHEUT

*Nga biseda me një grup punonjësish të serrave  
të Ndërmarrjes Bujqësore të Elbasanit*

17 maj 1973

*Shoku Enver Hoxha, i shoqëruar nga drejtuesit kryesorë të Partisë e të pushtetit të rrethit të Elbasanit, bëri një vizitë në sektorin e serrave të domateve të hershme të Ndërmarrjes Bujqësore të Elbasanit. Këtu kishin dalë për ta pritur drejtori i ndërmarrjes, sekretari i byrosë së Partisë, brigadierë e punonjës të dalluar dhe të gjithë së bashku zunë vend në një kabanon ku punohej për seleksionimin e domateve për eksport. Rreth tryezës së mbushur me prodhime të freskëta të stinës, u zhvillua një bisedë e ngrohtë, në të cilën morën pjesë edhe dhjetëra punonjës të sektorit, kryesisht gra e vajza të reja.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Shikoni sa mirë është këtu, sa perime e fruta të bollshme po prodhoni! Bashkë me to të zë syri gjithë këto vajza të reja plot shëndet, që me duart e tyre të shkathëta kujdesen për domaten, për perimet e tjera dhe për frutat.

Vetëm disa fjalë dëshiroj të shpreh me këtë rast: Ju të moshuarit e keni për detyrë të kujdeseni shumë për këta të rinj e të reja punëtorë, se janë lulet e atdheut. Si do të jetë atdheu nesër, kjo varet shumë se si punohet sot për ta edukuar brezin e ri.

Në goftë se ju do të bëheni vajza dhe djem të mirë e revolucionarë. dhe kështu do të ngjasë. atdheu do të hedhë hapa të mëdhenj përpara, do të lulëzojë me ritme të shpejta. Sa serra më të mëdha se kjo që kemi këtu do të ndërtojmë në të ardhmen, sa ndërmarrje bujqësore të bukura do të ngrihen në të katër anët e vendit tonë! Sa domate e zarzavate të tjera, sa fruta, drithë, bagëti, do të shtohen, sa fabrika e uzina do të ndërtohen, sa minerale do të ketë vendi ynë! Po kush do t'i bëjë të gjitha këto? Do t'i bëjë sigurisht populli i udhëhequr nga Partia, do t'i bëjë klasa punëtore, do t'i bëjë fshatarësia jonë. do t'i bëjë rinia, do t'i bëni ju. Për këtë qëllim ju edukon me mësimet e Partisë organizata e rinisë, të cilën duhet ta doni, të veni rregullisht në mbledhjet e saj, të diskutoni, të jepni mendime dhe në bazë të tyre të merrni vendime, të mësoni rregullat dhe statutin e saj dhe t'i zbatoni ato me përpikëri. Çfarë vendimesh mund të merrni ju në organizatën tuaj? Atje mund të merrni vendime të shumëllojta, revolucionare. Ju mund të diskutoni, fjala vjen, për çështjet e punës, për mbrojtjen e atdheut, do të edukoheni si të jeni të disiplinuar, si të mësoni sa më mirë nëpër shkolla, si të zhvilloni artin dhe muzikën, me një fjalë, për çdo gjë mund të diskutoni në organizatën e rinisë. Pastaj kur të dilni nga mbledhja, me shoku-shokun mund të bisedoni për lloj-lloj problemesh të tjera, por kurdoherë në frymën

e Partisë, dhe ato që gjeni të drejta, t'i vini në jetë.

Ju, të rejat dhe të rinjtë duhet të ndiqni shkollat. Baballarëve e nënave u thoni se shoku Enver na ka porositur t'ju themi që asnjëherë të mos ju shkojë në mendje të na pengoni ne, vajzat, që të vemi në shkollë. Asnjëherë të mos u shkojë në mendje prindërve tuaj që t'ju pengojnë të ndiqni shkollat. Le të mendojnë ata për kohët e vështira dhe për rininë e tyre të mjeruar, kur beu e agai i kishte lënë pa mësim, i kishte lënë, si me thënë, qorra. Duan ata që edhe ju të mbeteni qorra? Jo, ata kurrë s'e duan një gjë të tillë. Shkolla të hap sytë, kështu mendon Partia dhe kështu është.

Rinia të vejë në shkollë dhe atje të mësojë jo vetëm për nota, por me rrënjë, t'i vejë në fund mësimin. Kështu, kur të dilni në jetë, punën që do t'ju ngarkohet do ta bëni të pastër, shtëpitë do t'i mbani bukur, fëmijët do t'i rritni si duhet, me prindërit, me shokët, me shoqërinë do të silleni jashtëzakonisht mirë. Kjo është kulturë dhe këtë kërkon socializmi. Për këtë punon Partia, kështu na mëson ajo dhe kështu duhet të bëjmë të gjithë, sepse vetëm në këtë mënyrë do të krijojmë një situatë të atillë të mirë për popullin, që të mos e ketë asnjë vend tjetër. Sot, në shumicën dërrmuese të shteteve, është në fuqi kapitalizmi që shtyp e shfrytëzon popujt, klasën punëtore, fshatarësinë, gratë, u thith djersën dhe i lë në varfëri e mjerim, nxjerr prej punës së tyre fitime me të cilat majm xhepin e vet.

Partia duhet t'jua mësojë të kaluarën se ju nuk e njihni, jeni akoma të reja. Por edhe ju vetë pyesni për këtë, sidomos gjyshërit, se edhe prindërit tuaj, relativisht, janë të rinj, shumica kanë lindur pak vjet për-

para se të krijohej Partia, prandaj as ata nuk e kanë jetuar tërë kohën e paraçlirimit. Tani gjendja ka ndryshuar, pse Partia luftoi dhe punon që populli dhe sidosmos brezi i ri të rrojë i lumtur.

Shokët e ndërmarrjes na kanë vënë këtu fruta për të na gostitur, prandaj sikur të afroheni të gjithë dhe të hamë së bashku.

Kur ishim të vegjël me shokët dhe shoqet e lagjes, sido që atëherë kishte fanatizëm, rrinim tok dhe, kur na binin në dorë qershi kaq të bukura si këto, ua varnim vajzave në veshë. Po juve ju varin çunat qershi në veshë, kur piqen? *(Duke iu drejtuar një punëtoreje të re.)* Ja, pa hajde ti këtu, të të var në vesh një qershi! Bile po të var një me tri kokrra.

Këtu, te ju takova dy vajzat e një miku tim të vjetër, Ali Dishës. Ai ishte burrë shumë i mirë dhe patriot nga Shmili. Në kohën e luftës kam qëndruar në shtëpinë e tij. Ai më donte shumë, edhe unë e doja, gjithashtu, shumë. Përveç plakës së shtëpisë, ai kishte dhe një nip të vogël tre vjeç, që e quanin Abaz. Në Shmil, në atë kohë, nuk kishte fruta, Aliu bile nuk kishte bukë të hante, se ishte i varfër, megjithatë ne partizanët na mbante, duke sakrifikuar kafshatën e fëmijëve, bile duke vënë edhe kokën në rrezik, pse atje mund të bëhej luftë e t'i digjej shtëpia.

Plaka e shtëpisë kishte në dhomën e saj një sënduk ku mbante disa rroba të vjetra, atje fshihte edhe ndonjë kokërr dardhë dimërore, i vetmi frut që kishte Shmili. Mirëpo ato ishin aq të forta, sa t'u bije me kobure nuk shpoheshin. Megjithatë Abazi i vogël i pëlqente dhe vinte tek unë e më thoshte: «Shoko, nënia ka dardhë»

atje», dhe më tregonte tinëz me gisht sëndukun. I thosha plakës atëherë: «Moj nënë, më jep një kokërr dardhë, se më duhet». «Ku e di ti që kam dardhë?», më thoshte ajo, kurse i vogli bënte sikur nuk dinte gjë. Plaka ma sillte kokrrën e dardhës, dhe unë ia jepja Abazit. Mirëpo plaka e kuptonte përse ia kërkoja dardhët, zaten ajo për atë i ruante. Abazi e hante kokrrën e dardhës dhe të nesërmen kërkonte tjetër, po ato të shkreta pak ishin dhe u mbaruan shpejt.

Kurse tani pa shikoni sa kemi, me bollëk, prandaj, a nuk ia merrni të gjithë një kënge?

*Të gjithë së bashku kënduan këngën «Shqiptarja partizane» dhe në mbarim punëtorët shpërthyen në brohoritje për Partinë dhe për shokun Enver Hoxha.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Sallatorët tuaj më duken me të vërtetë mjaft të shijshëm, edhe domatet që shikoj këtu në tavolinë, janë shumë të mira. Ato janë rritur e pjekur dhe kjo tregon për kujdesin tuaj.

Shokët e Durrësit na thanë se vetëm nga 9 hektarë domate që kanë në serra, sigurojnë 20 për qind të të gjitha të ardhurave që parashikohet të sigurojë Ndërmarrja Bujqësore e Sukthit. Kjo është një e ardhur shumë e madhe. Ka rëndësi që prodhimet të dalin në kohën e duhur. Një specialist i huaj u ka thënë tanëve se nuk i konkurrojnë dot domatet shqiptare, se nuk i nxjerrin dot në kohë, prandaj kanë hequr dorë nga mbjellja e domates së hershme. Nga ana tjetër, domatet e të tjerëve nuk kanë shijen e tonave, sepse këtu ka të bëjë shumë edhe klima, rrezet e diellit. Kurse domatet shqiptare kudo ku kanë vajtur preferohen shumë. Po portokalle keni këtu, në ndërmarrjen tuaj?

**SHOKU ALI SHAHINI**<sup>1</sup>: Portokalle kemi gjithsej 25 mijë rrënjë. Kokrrat që shikoni këtu në tavolinë ne i kemi prodhuar vetë, në ndërmarrjen tonë.

**SHOKU ENVER HOXHA**: Portokallet duhet t'i kenë atje përtej Shkumbinit, ku ndodhet një vreshtë. E keni akoma atë vreshtë ju? Unë e di atë, e kam vizituar shumë vjet përpara. Më kujtohet plaku Kosta<sup>2</sup> që ishte atje. Rron ai, apo jo?

**SHOKU ALI SHAHINI**: Po, po, rron, shoku Enver. Tani ai ka dalë në pension, por e mbajmë gjithmonë afër.

**SHOKU JASHAR MENZELXHIU**: (*Duke iu drejtuar punëtorëve të pranishëm.*) Kush nga ju dëshiron t'i thotë diçka shokut Enver? Pa na thuaj ti, skuadërkomandante, çfarë zotimesh do të marrë skuadra që drejton ti, përpara shokut Enver?

**SHOQJA HAJRIE TOPUZI**<sup>3</sup>: Më lejoni që në emër të kolektivit të ndërmarrjes dhe të brigadës së parë të perimores, t'ju falënderoj, shoku Enver, për vizitën që na bëtë. Kam 12 vjet që po punoj këtu, dhe nga dita në ditë po shoh si përparon vendi ynë dhe si po rritet mirëqenia jonë në familje dhe kudo. Kohët e fundit, pasi punuam fjalën tuaj të 15 marsit, kolektivi ynë po bën një punë të madhe për rritjen e normave. Planin e parashikuar jemi zotuar jo vetëm ta realizojmë, po ta tejkalojmë. Për mua dita e sotme është një gëzim i madh, se që kur isha në klasë të dytë nuk ju kisha

---

1. Në atë kohë drejtor i ndërmarrjes bujqësore.

2. Kosta Boçi.

3. Në atë kohë përgjegjëse skuadre në perimore.

parë. Zotohem se do të punoj më mirë që të jetojmë të lumtura në socializëm.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Të lumtë!

*(Duke iu drejtuar një vajze tjetër.)* Ti si e ke emrin?

*SHOQJA RAIFE DISHA:* Quhem Raife Disha.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ti qenke çupa e mikut tim, Ali Dishës.

*SHOKU ALI SHAHINI:* Në përgjithësi punëtorët dhe punëtorët e këtij sektori tani i kemi me arsim 7 dhe 8-vjeçar, kemi edhe shumë me shkollë të mesme bujqësore. Rreth 70 për qind të punëtorëve i kemi gra. Ato janë shumë të ndërgjegjshme në punë. Pas fjalimeve tuaja të fundit, shoku Enver, ne po punojmë me një frymë më të lartë mobilizimi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Këtë gjendje që keni krijuar ta mbani vazhdimisht të ngritur.

Sa lopë keni këtu?

*SHOKU ALI SHAHINI:* Kemi rreth 550 lopë të racës «Laramane» me një rendiment prej afër 3 000 litra qumësht në vit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kjo do të thotë se ju akoma keni rezerva të mëdha në prodhimin e qumështit. Mos u kënaqni me 3 000 litra qumësht në vit nga një lopë kaq e mirë siç është «Laramania».

Tani do të largohemi, po para kësaj, dëshiroj t'ju them se u kënaqa shumë, u gëzova nga ky takim. Ju faleminderit! Qofshi të gjithë mirë, të lumtur e të gëzuar!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## ORGANIZIMI EFEKTIV SIGURON MBARËVAJTJEN E PUNËS PRODHUESE

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

**19 maj 1973**

Ne duhet të nxjerrim mësim nga përvoja e deritanishme, gjatë së cilës, përveç anëve të mira, janë vërtetuar edhe të meta, dobësi e gabime në zbatimin e vendimit të Komitetit Qendror për punën drejtpërdrejt në prodhim që duhet të bëjnë kuadrot.

T'u pritet rruga lëshimeve, interpretimeve dhe udhëzimeve të padrejta që jepen shpesh nga dikastere e rrethe e që bien në kundërshtim me orientimet e Komitetit Qendror për këtë problem.

Nuk mund të quhet punë prodhuese ajo që caktohet të bëjë ndonjë kuadër si përgjegjës i kampeve veçore të pushimit të fëmijëve, në vatrën e kulturës apo

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua çështja se çfarë tregonte eksperiencia e deriatëhershme për zbatimin e orientimeve të KQ të PPSH për punën drejtpërdrejt në prodhim të kuadrove dhe masat që duhej të merreshin për thellimin e mëtejshëm të këtij problemi, lidhur me detyrat e reja që kishte caktuar Partia.



dhe aktivitete të tjera të këtij lloji, ku kuadri në fakt as punon fizikisht, as jeton bashkë me punëtorët dhe fshatarët. Kjo detyrë nuk mund të quhet e kryer as duke zgjedhur vetë vendin e punës në ndonjë ndërmarrje, pranë shtëpisë, duke e kaluar kohën më shumë kot, pa u angazhuar si duhet në frontet e prodhimit, ku punojnë e luftojnë forcat më të gjalla të punëtorëve dhe të fshatarëve dhe pa jetuar bashkë me ta, me qëllim që të mësosh prej tyre dhe të aktivizohesh për punë politike e shoqërore me masat. Prandaj është e domosdoshme të luftojmë çdo prirje të huaj që është në dëm të kalitjes së vetë kuadrove dhe në kundërshtim me qëllimin e madh politiko-ideologjik të vendimit që ka marrë Komiteti Qendror për pjesëmarrjen e të gjithë kuadrove në punë prodhuese.

Tani, bashkë me organet shtetërore, ne duhet të përcaktojmë masat për zbatimin si duhet të vendimit, me qëllim që kuadrot ta bëjnë punën drejtpërdrejt në prodhim, me forca të organizuara në objekte të caktuara. Kjo është një detyrë e madhe, të cilën duhet ta ndjekim. Plotësimi i saj kërkon të luftohen prirjet e dëmshme që krijojnë një kuptim jo të shëndoshë të kësaj direktive me rëndësi.

Dëshiroj të them disa mendime për këtë çështje. Në kryerjen e punës në prodhim nga kuadrot, vërtet kemi një eksperiencë të mirë, por, krahas kësaj, siç thashë më parë, ka edhe të meta. Prandaj më duket i nevojshëm rishikimi i orientimeve të dhëna deri më sot për punën prodhuese të kuadrove e nëpunësve, sepse, sipas mendimit tim, ato lënë shteg që të bëhen lëshime, për të cilat bëhet fjalë në materialet e paraqitura.

Detyra e Partisë për pjesëmarrjen në punën prodhuese të kuadrove dhe nëpunësve, është të punojë politikisht dhe ideologjikisht me ta, për t'i bindur se pjesëmarrja në punën prodhuese ka qëllim të dyfishtë: së pari, t'i kalitë ata si revolucionarë që të mos shndërrohen në burokratë e të myken nëpër zyra dhe, së dyti, me pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të tyre në prodhimin e të mirave materiale, të ndihmohet në forcimin e ekonomisë popullore.

Por, me këtë rast, doja të thosha që me çështjen e organizimit praktik të kësaj pune të mos merret Partia, por kjo gjë t'u ngarkohet organeve shtetërore dhe, konkretisht, zyrave të punës pranë komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve. Pjesëmarrja në punën prodhuese të kuptohet si një detyrë e rëndësishme që duhet kryer, ashtu sikurse kryhet shërbimi ushtarak. Për personat që parashikon ligji se duhet të kryejnë shërbimin apo stërvitjen ushtarake etj., dega ushtarake e rrethit nxjerr lajmërim-thirrjet dhe ata, me të marrë njoftimin, janë të detyruar të paraqiten në kohën dhe në vendin e caktuar për t'iu përgjigjur asaj me gatishmëri e përpikëri. Sipas mendimit tim, kështu duhet kuptuar e vlerësuar edhe lajmërimi që do t'u bëhet nëpunësve prej zyrës së punës, e cila do të ngarkohet të caktojë kohën dhe vendin e punës në prodhim. Nëpunësit, nga ana e tyre, janë të detyruar të paraqiten menjëherë në kohën dhe në vendin e caktuar për të bërë punën në prodhim.

Për këtë qëllim, në fund të vitit, çdo ndërmarrje, institucion dhe organizatë shtetërore apo shoqërore duhet të hartojë listën e punonjësve që, në bazë të ligjit,

janë të detyruar të marrin pjesë në punën prodhuese bashkë me propozimin se sa prej tyre duhet ta bëjnë atë në këtë muaj dhe sa në muajin tjetër. Personat që do të dërgohen me punë prodhuese do ta bëjnë atë në një muaj pa ndërprerje. Kjo duhet organizuar në mënyrë të tillë që ata mundësisht të mos ndahen në shumë grupe të vogla, sepse kështu do të shpërndaheshin forcat, do të vështirësohej kontrolli i tyre. Zyra e punës, duke pasur në kohë listat dhe duke u mbështetur në nevojat e planifikuara që ka rrethi për fuqi punëtore dhe në kërkesat e ndërmarrjeve ku do të kryhet puna prodhuese, bën për çdo muaj shpërndarjen e mijëra kuadrove dhe nëpunësve. Detyra e qendrave të punës, porsa të marrin lajmërimin nga komiteti ekzekutiv, është t'i dërgojnë menjëherë në vendin e caktuar njerëzit e planifikuar për punë prodhuese.

Puna drejtpërdrejt në prodhim është një domosdoshmëri; ajo duhet të kryhet nga çdo kuadër dhe të kuptohet nga të gjithë si një detyrë nga e cila nuk duhet të tërhiqet askush. Prandaj, çdo ndërmarrje, kooperativë, institucion dhe organizatë, në bazë të orientimeve të Komitetit Qendror të Partisë, duhet të marrë të gjitha masat për të mos u sjellë as më të voglën pengesë kuadrove që kanë për të kryer punën drejtpërdrejt në prodhim.

Zyra e punës e komitetit ekzekutiv të rrethit, nga ana e saj, të mos bëjë asnjë lëshim, po të ngulë këmbë që të gjithë kuadrot dhe nëpunësit e tjerë të organeve të Partisë, të pushtetit, të administratës, të ndërmarrjeve ekonomike, të institucioneve shoqërore-kulturore dhe të organizatave të masave, sipas kriterëve të vendosura, të punojnë një muaj drejtpërdrejt në prodhim, sidomos

në bujqësi dhe në ndërtim, ku ka fronte të gjera pune. Prandaj, as qendrat e punës, ku punojnë kuadrot dhe nëpunësit e tjerë, as organizatat-bazë të Partisë s'kanë të drejtë ta caktojnë vetë vendin e punës për personat që dërgojnë, pasi nevojat që ka rrethi i njeh më mirë se kushdo zyra e punës. Ajo cakton, fjala vjen, sa veta do të punojnë në ndërmarrjet bujqësore të rrethit dhe sa do të dërgohen në kooperativat bujqësore apo në kantieret e ndërtimit.

Për kohën që punonjësit kryejnë punën drejtpërdrejt në prodhim, qendra e tyre e punës nuk duhet t'i paguajë pa marrë vërtetimin nga qendra e punës ku punonjësi ka kryer punën prodhuese.

Puna në prodhim, para së gjithash, ka për qëllim kalitjen politike, ideologjike, fizike etj. dhe jo për t'i kursyer shtetit disa lekë. Që të zhduken shmangiet nga kjo punë me vlera të mëdha edukuese, i duhet lënë në kompetencë zyrës së punës që të marrë masa për organizimin dhe shpërndarjen e këtyre forcave të përquendruara. Kjo zyrë nuk do t'ia dijë se ç'përgjegjësi kanë kuadrot; ajo nuk pyet nëse njëri është drejtor, inxhinier, profesor, mjek apo diçka tjetër. Ata që i dërgohen me listë, ajo i konsideron fuqi punëtore dhe i dërgon të punojnë atje ku ka nevojë shteti. Kjo mënyrë veprimi mua më duket më e drejtë, më racionale dhe jep mundësi për ta organizuar sa më mirë. Vetëm një organizim i fortë do të mund të sigurojë mbarëvajtjen e punës prodhuese.

Pas plotësimit të tetorëshit të punës në prodhim kuadrot dhe nëpunësit, në kohën e lirë, duhet të kryejnë edhe detyra të tjera. Një mjek, ta zëmë, mund të akti-

vizohet me detyra suplementare, si fjala vjen, për një konferencë shëndetësore, apo për të vizituar punonjësit e sëmurë në kantierin ose në kooperativën ku bën punën në prodhim; një pedagogu mund t'i kërkohet të zhvillojë një konferencë pedagogjike në shtëpinë e kulturës etj., duke sakrifikuar për përgatitjen e këtyre punëve suplementare, kur është nevoja, kohën për çlodhje apo për gjumë, po jo atë të punës prodhuese.

Kuadrot që do të bëjnë punën në prodhim, nuk mund të ngarkohen të venë gjoja për të ndihmuar çerdhet, vatrën e kulturës, qendrën sanitare apo për të bërë ndonjë studim «për përmirësimin e gjendjes së organizatave-bazë të Partisë» etj., duke u nisur nga mania për të bërë shumë punë përnjëherë, sikur të tërë këta që dërgohen për të bërë punën në prodhim të ishin enciklopedistë. Të pretendosh kryerjen e shumë punëve në një kohë, praktikisht është e pamundur. Kur është rasti, për të tilla nevoja, të dërgohen njerëz të tjerë, kurse ata që caktohen të bëjnë punë prodhuese, duke përfshirë edhe arsimtarët, duhet të venë të punojnë në bujqësi ose në ndërtim, ku të përgatitin llaç, të bëjnë mure, të transportojnë tulla, hekura etj., etj., pra në vendet ku do t'i dërgojë zyra e punës.

Kriteri i ndjekur që gratë të bëjnë punën prodhuese në qytet, më duket i drejtë, prandaj le ta ruajmë këtë edhe në të ardhmen, kurse burrat ta bëjnë ku të jetë nevoja. Këto forca pune, sikurse thamë, t'i përdorim më shumë në kohën e fushatave bujqësore dhe në ndërtim e jo t'i dërgojmë me vend e pa vend në fabrika që e kanë të siguruar dhe të plotësuar fuqinë punëtore. Kjo çështje le të shikohet.

Për të gjitha këto sa thashë, ne duhet ta rritim shumë interesimin dhe përgjegjësinë e zyrës së punës. Asaj, në bazë të studimit të bërë më parë, sipas listave të ardhura nga ndërmarrjet dhe të vendimit të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor, i bie detyra të organizojë dhe të mbikëqyrë punën në prodhim dhe të gjithë të tjerët t'i binden.

Problemet që shtruam sot mendoj se duhen rregulluar me ligj. Prandaj, shokët e Qeverisë, le ta studiojnë se si mund të shfrytëzohet sa më mirë kjo mundësi që vihet në dispozicion. Sikurse thashë, në këtë drejtim, të mos ecet më sipas dëshirës dhe qejfit të drejtuesve të ndërmarrjeve apo të institucioneve, por të udhëheqin nevojat dhe interesat e përgjithshëm.

Këto mendime që shpreha këtu, të shikohen dhe, në qoftë se pranohen, të merren masa që zyrat e punës të vihen në rregull. Kjo do të jetë një nga detyrat e tjera të shumta që kanë këto zyra.

*Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas tekstit të nxjerrë nga procesverbali i mbledhjes së Sekretariatit të KQ të PPSH, që gjendet në AQP*

# ORGANIZIMI I BASHKIMEVE PROFESIONALE TË JETË SA MË MIRË NË FUNKSION TË DETYRËS SË TYRE KRYESORE — EDUKIMIT

*Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

19 maj 1973

Kur i sugjerova shokut Rita<sup>2</sup> [Marko] për ta rishikuar organizimin e sotëm të aparatit të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale, pata parasysh zgjerimin e madh të sektorëve të ndryshëm, veprimtarinë e gjerë që duhet të zhvillojë Këshilli Qendror si dhe specifikat që ka puna e bashkimeve profesionale në degët e ndryshme të ekonomisë e të kulturës. Kjo është e nevojshme për të mos zhvilluar një punë globale, por të diferencuar e sa më të specializuar, pasi përvoja na tregon se në punën e bashkimeve profesionale ka anë të mira, por ka edhe shfaqje të formalizmit.

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua edhe për disa ndryshime në organizimin e aparatit të Këshillit Qendror të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë.

2. Anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH, në atë kohë President i Këshillit Qendror të BPSH.

Tani për tani, mendoj se nuk është e domosdoshme të krijojmë organe të bashkimeve profesionale sipas degëve të ekonomisë dhe këto të lidheshin me Këshillin Qendror<sup>1</sup>. Por, në aparatën qendror, mua më duket se mund të bëhet një përmirësim, duke krijuar sektorë të punës së bashkimeve profesionale sipas degëve të ekonomisë, ashtu siç e kanë studiuar e propozuar shokët e Këshillit Qendror. Ky organizim në qendër do të orientojë edhe punën e këshillave të bashkimeve profesionale të rretheve e, me siguri, do të ndihmojë e do të nxitë strukturën aktuale të tyre, që nuk e ndryshojnë. Ky organizim do të bëjë, gjithashtu, që organizata e bashkimeve profesionale të interesohet më gjallërisht e në mënyrë më konkrete për të zbatuar detyrat që shtrohen para saj.

Në diskutimet e tyre, shokë të ndryshëm, ngritën disa preokupacione si: «Nga kush do të varen sektorët e rinj që krijojmë, sipas degëve të ekonomisë?» ose «të mos kalohet në punë paralele midis tyre dhe sektorëve funksionalë që kemi» etj. Natyrisht, kjo ka të bëjë me praktikën dhe me metodën e punës. Por mua më duket

---

1. Më vonë kjo çështje u studiuua dhe, për të përmirësuar më tej punën e Bashkimeve Profesionale, në Kongresin e 9-të të BPSH, i cili zhvilloi punimet nga data 6 deri më 9 qershor 1982, ndër të tjera u vendos që, nga gjiri i Këshillit të Përgjithshëm të BPSH, të krijohen katër këshilla qendrore sipas degëve kryesore të ekonomisë. Këshilli Qendror i punonjësve të industrisë dhe të minierave; ai i punonjësve të bujqësisë; i punonjësve të ndërtimit, komunikacionit, shërbimeve komunale e tregtisë, dhe i punonjësve të arsimit, kulturës e shëndetësisë.



se krijimi i këtyre katër sektorëve që propozohen, sipas degëve, është i drejtë. Konkretisht këta mund të jenë: sektori industri-miniera, që është një sektor i rëndësishëm; sektori i bujqësisë, që ka specifikën e vet; sektori ndërtim-komunikacion-komunale-tregti, si sektorë shërbimi dhe, i katërti, sektori arsim-kulturë-shëndetësi-administratë, që përfshin rreth 89 mijë punonjës, siç thuhet në relacionin e paraqitur.

Këta sektorë të rinj të drejtohen nga sekretarët e Këshillit Qendror. Çdo sektor mund të ketë 3-4 instruktorë, të cilët të jenë të profilit të përgjithshëm për punën e bashkimeve profesionale, në degët që mbulojnë. Sektorët e tjerë funksionalë që janë edhe sot, të kryejnë detyra sipas funksioneve të tyre. Kjo ka rëndësi të kuptohet mirë, prandaj të mendojmë se si ta zgjidhim drejt çështjen në praktikë. Mendoj se mund të veprohej edhe kështu, duke i bërë me nga katër instruktorë sektorët e rinj që krijojmë (pa shtuar kuadrin, por duke i siguruar brenda organikës së sotme, meqë ka edhe katër sektorë funksionalë që lidhen me punën e organizatës profesionale brenda vendit, veç sektorit të jashtëm). Atëherë, çdonjëri nga instruktorët e sektorëve, sipas degëve, do të ketë lidhje me një nga sektorët e tjerë funksionalë.

Më konkretisht: të katër instruktorët e sektorit të bujqësisë, për shembull, të mbajnë lidhje njëri me sektorin e prodhimit, i dyti me atë të edukimit, i treti me organizimin dhe i katërti me sektorin social. Kështu, kur mblihet sektori i bujqësisë nën drejtimin e sekretarit përkatës të Këshillit Qendror, grupi është komplet, por instruktorët e tij do të lidhen me tërë sektorët e apara-

lit funksional që kemi tani. Qysh para mbledhjes, instruktorët e sektorëve sipas degëve, përveç materialeve që kanë grumbulluar vetë, marrin edhe të dhëna nga sektorët funksionalë dhe diskutojnë. Nga mbledhja ngarkohen me detyra të venë në sektorët e tjerë e të bëjnë instruktazh, të japin detyra e të shtrojnë problemet që u ngritën e u diskutuan, të marrin statistika e ndonjë të dhënë tjetër që u duhet etj. Në këtë mënyrë bëhet më organike lidhja e këtyre sektorëve të rinj që krijojmë sipas degëve, nëpërmjet instruktorëve, me sektorët funksionalë të aparatit.

Të marrim edhe një sektor tjetër, atë të industrisë dhe të minierave. Në këtë sektor do të kemi 3 ose 4 instruktorë që drejtohen nga sekretari përkatës i Këshillit Qendror. Instruktorët e këtij sektori do të venë në të katër anët e vendit dhe do të merren me të gjitha problemet, qofshin këto të prodhimit, të edukimit, për çështje organizative etj. Megjithatë në aparatit e Këshillit Qendror kemi edhe sektorët funksionalë për këto probleme, atëherë, një nga instruktorët e sektorit të industrisë-minierave ka lidhje me sektorin e prodhimit, tjetri me sektorin e edukimit, i treti me sektorin e organizimit dhe tjetri me sektorin social. Kështu veprojnë edhe sektorët e tjerë sipas degëve në marrëdhënie me sektorët funksionalë të aparatit.

Edhe në rast se në sektorët e rinj që krijohen nuk do të kemi nga katër instruktorë, aq sa janë sektorët funksionalë, por vetëm tre, atëherë, njëri nga këta instruktorë do të mbajë lidhje me dy sektorë funksionalë. Për shembull, një instruktor i sektorit të industrisë e minierave mban lidhje me sektorin e prodhimit dhe të

organizimit, ose me sektorin e organizimit dhe me atë social; tjetri me sektorin e edukimit etj. Kështu do të veprojnë edhe instruktorët e sektorit të bujqësisë, të ndërtim-komunikacionit etj. Pra, nuk lidhet një sekretar vetëm me organizimin apo një sekretar tjetër vetëm me edukimin, por lidhen të gjithë sekretarët, nëpërmjet instruktorëve, me të gjithë aparatin.

Ju, shoku Rita, keni katër sekretarë të Këshillit Qendror. Në çdo mbledhje që zhvillon, ju i thërrisni shokët e sektorëve dhe u jepni udhëzime, u shtroni probleme, i instruktioni. Kjo nuk përjashton atë që një sekretar t'i thërresë më vete e t'u japë udhëzime për problemet që ka. Unë e kam çështjen këtu që, po i dhama çdo sekretari një sektor funksional, ka rrezik që ai të interesohet vetëm për këtë.

Po të bëhet kështu që sekretarit që ka sektorin e industri-minierave t'i ngarkohet edhe sektori i prodhimit, edhe ai social, atij të sektorit të edukimit mund t'i ngarkohet edhe sektori i arsim-kulturë-shëndetësi-administratës; një sekretar tjetër që ka sektorin ndërtim-komunikacion, të ketë edhe sektorin e organizimit dhe një tjetër bujqësinë dhe sektorin e jashtëm, kështu nuk mbetet zbuluar asnjë sektor. Pra, mund të bëhet kështu që çdo sekretar të drejtojë një nga sektorët që krijojmë sipas degëve dhe një nga sektorët funksionale që kemi. Instruktorët e sektorëve që krijohen, të lidhen drejtpërdrejt me sekretarët. Më konkretisht ndarjen e shikoni vetë.

Bashkimet profesionale duhet të kenë parasysh detyrën kryesore të tyre, edukimin. Të bëhen përpjekje që edukimi i punëtorëve të forcohet në rrugën e Parti-

së, në rrugën leniniste. Rruga leniniste është që edukimi të shikohet lidhur ngushtë me zbatimin e përpiktë të ligjeve, të rregulloreve dhe të planeve. Kjo duhet kuptuar drejt dhe jo në mënyrë të njëanshme. Të mos shikohet në mënyrë të njëanshme mbrojtja e punëtorëve, pa pasur parasysh mbrojtjen e shtetit të punëtorëve. Të mos bëjmë lëshime për punëtorët që shkelin ligjet dhe urdhrat e të godasim drejtorin, se ky bëka gabime. Po cilat qenkan gabimet e këtij drejtori? Se është i ashpër në zbatimin e vendimeve? Jo, nuk duhet gjykuar në mënyrë subjektive, siç mendon ndonjëri që, meqenëse këtu kemi klasën punëtore, atëherë hajde të godasim një drejtor që kërkon llogari, duke e cilësuar këtë pa të drejtë «arrogant».

Edhe në këtë çështje, bashkimet profesionale duhet të ndjekin rrugën e Partisë, rrugën leniniste, që do të thotë se të gjitha ligjet, rregulloret, normat e Partisë, janë njëloj për të tërë, si për drejtorin, ashtu edhe për punëtorin. Liberalizëm s'duhet të ketë as për administratën, as për klasën punëtore. Kjo duhet të marrë fund, sepse ka pasur edhe shfaqje liberale. Liberalizëm, si këto që thashë, ose siç ndodh në praktikën e punës që ka interesim më të madh për problemet ekonomike dhe nuk ka sa duhet interesim për çështjet e edukimit, nuk duhet lejuar. Këtu duhet gjetur masa e vërtetë për detyrat dhe të drejtat. Partia ka porositur që të zhvillohet luftë kundër burokratizmit, por kjo luftë s'ka mbaruar. Ka shfaqje të burokratizmit në aparat, kundër të cilit duhet luftuar; ka, gjithashtu, lëshime e shfaqje liberalizmi edhe nga punëtorët, të cilat, gjithashtu, duhen luftuar. Është e domosdoshme të veprohet drejt në këtë

fushë, në të gjitha drejtimet. pasi jeta po na tregon se të metat e lëshimet ndodhin për dobësi të punës së Partisë dhe të organizatave të masave, pra edhe të bashkimeve profesionale.

*Botohet për herë të parë sipas  
tekstit të nxjerrë nga proces-  
verbali i mbledhjes së Sekre-  
tariatit të KQ të PPSH,  
që gjendet në AQP*

## TË FORCOHEN PUNA DIHE PROPAGANDA E PARTISË KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA

*Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike  
të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

21 maj 1973

Do të prek vetëm disa gjëra, sepse të shumtat u thanë nga shokët. Këto që shqyrtuam janë çështje që i kemi diskutuar edhe herë të tjera, por është e drejtë dhe e nevojshme të vëmë mirë në dukje veprimtarinë e armiqve, shkaqet e kësaj veprimtarie, terrenin ku ajo gjen bazën të zhvillohet, me qëllim që të dimë se si të veprojmë dhe të marrim masat për ta dobësuar këtë veprimtari, duke e reduktuar sa të jetë e mundur në minimum. Kjo është një punë e madhe që duhet të bëhet vazhdimisht me këmbëngulje nga Partia, nga shteti, nga të gjitha organet dhe masat e popullit.

Veprimtaria armiqësore që zhvillohet kundër vendit tonë ka për qëllim të dëmtojë Republikën Popullore të Shqipërisë, të dëmtojë, në radhë të parë, Partinë,

---

1. Në këtë mbledhje u diskutua rreth raportit të Ministrisë së Punëve të Brendshme «Mbi drejtimet kryesore të veprimtarisë armiqësore gjatë katër vjetëve të fundit (1969-1972)».

vijën e saj, ta diskreditojë këtë vijë dhe të përgatitë terrenin për të papritura, të krijojë situata të favorshme për armiqtë tanë, të jashtëm e të brendshëm.

Armiqtë e jashtëm veprojnë nga shumë kanale, drejtpërdrejt dhe në mënyrë të organizuar kundër vendit tonë nëpërmjet agjenturave të tyre që lidhen me armiqtë e brendshëm. Të dyja palët, armiqtë e jashtëm dhe të brendshëm, synojnë dhe veprojnë për të sinkronizuar veprimtarinë me njëri-tjetrin, por ata përpiqen të përfitojnë edhe nga elementë të tjerë, të cilët mund të mos jenë të lidhur me agjencurat e tyre, por nga pakujdesia ose mendjehetësia, në fakt, i shkaktojnë dëme vendit tonë.

Për të dëmtuar vendin tonë armiqtë përpiqen të gjejnë fushë të veprojnë, prandaj kundër veprimtarisë së tyre duhet të qëndrojmë në krye Partia, në radhë të parë, me politikën, me vijën e drejtë dhe me të gjitha normat e saj.

Me vijën e saj të drejtë Partia ka krijuar një situatë të mirë në vendin tonë. Fakt është se gjendja jonë e brendshme politikisht, ekonomikisht, ideologjikisht dhe nga ana e mbrojtjes është e shëndoshë. Prandaj, të jemi realistë, të mos e errësojmë gjendjen dhe perspektivën tonë për shkak të kësaj veprimtarie duke mbivlerësuar armiqtë; të jemi të matur, të mos humbasim asnjëherë busullën në këtë drejtim, sepse forcat e popullit dhe të Partisë janë shumë të mëdha dhe në gjendje t'i bëjnë ballë çdo vështirësie dhe veprimtarie armiqësore. Duhet të kemi parasysh se veprimtaria e armiqve kundër Shqipërisë socialiste është zhvilluar, zhvillohet e do të zhvillohet edhe në të ardhmen.

Ne duhet t'i vëmë pyetjen vetes: një numër shfaqjesh të huaja, natyrisht duke i parë ato në atë shkallë sa janë, përse na ngjasin? Në fjalimin e 15 marsit unë dhashë disa arsye dhe vura theksin që të gjithë ne, të gjithë njerëzit tanë, është e domosdoshme t'i bëjnë një analizë ndërgjegjes së vet dhe, kur them ndërgjegjes, kuptojmë me këtë edhe veprimtarisë së tyre. Kjo duhet të bëhet dhe jo një herë, por çdo ditë e çdo orë, në qoftë se e quajmë veten komunistë dhe patriotë, sepse pa këtë analizë nuk ka mundësi t'i luftojmë shfaqjet e huaja. Për të mos zënë ndërgjegjja «pluhur» ky duhet shkundur. E mira është që ky pluhur të mos shkundet rrallë e me «tërmet», por të pastrohet vazhdimisht përditë, ashtu siç pastrohen rrobat çdo mëngjes, para se t'i veshim.

Krimet e ndryshme që ndodhin e kanë burimin edhe në faktin se nuk tregohet vazhdimisht e çdo ditë kujdes për zbatimin me rreptësi të normave të Partisë. Pikërisht këto norma ka shokë që nuk i kuptojnë mirë. Norma të Partisë janë jo vetëm të gjitha rregullat e shkruara në Statutin e Partisë, por edhe ato që shprehen në ligje, urdhëresa e rregullore, si dhe shumë e shumë të tjera që nuk janë të shkruara, por që bëjnë pjesë në traditat e mira e të lavdishme të popullit tonë, të cilat i ka përçafuar Partia, i ka përpunuar e i ka ngritur në një shkallë më të lartë, siç janë ato të mirësjelljes qytetare, të dashurisë për punën, të dashurisë për njerëzit, të mbrojtjes së pronës socialiste etj., etj. Të gjitha këto, çdo gjë e mirë, e shkruar dhe e pashkruar, bëjnë pjesë në normat e Partisë sonë, në bazë të të cilave duhet të ecim të tërë. Kush bën lëshime e shkelje,



qofshin këto të vogla ose të kufizuara në një apo në dy raste, atë do ta zërë «pluhuri» dhe nuk do të jetë ashtu siç e kërkon Partia. Por do të ishim krejt idealistë po të mendonim se mund të ecëj në jetë pa gabuar fare. Çështja është të luftojmë përherë që të punojmë e të jetojmë në mënyrë sa më korrekte, brenda normave. Por, siç konstatojmë, ka nga këto norma të Partisë që shkelen në mënyrë arbitrare edhe nga kuadro.

Ky është një problem me rëndësi të madhe për Partinë. Duke studiuar statistikat, do të shohim që normat i shkelin më shumë njerëzit e paformuar, pa përjashtuar këtu edhe disa kuadro. Ka pastaj njerëz, bile edhe kuadro, që përpiqen deri atje sa dalin në mbrojtje të disa elementëve që kryejnë faje, duke ndërhyrë me letra deri në Presidiumin e Kuvendit Popullor për t'i falur.

Unë mendoj se për shkeljet që bëhen, edhe kur këto nuk janë kryer nga kuadro, këta të fundit kanë shumë përgjegjësi. Këtë ide unë nuk e kam theksuar në fjalën e 15 marsit, se nuk qe rasti, dhe me qëllim që të mos përfitonte armiku nga një gjë e tillë.

Eksperiencia e lëvizjeve të mëdha revolucionare dhe mësuesit e mëdhenj të marksizëm-leninizmit na mësojnë të kemi kurdoherë kujdes me kuadrot, që të mos borgjezohen. Partia jonë këtë mësim të madh e ka mbajtur dhe e mban kurdoherë parasysh, ajo ka punuar edhe konkretisht në këtë drejtim, pse shumë rreziqe linden nga borgjezimi i kuadrove. Të gjithë e dimë rolin kundërrevolucionar të aristokracisë punëtore. Po cilët janë punëtorët aristokratë, siç i quan Marksi? Janë të gjithë ata që deri në një kohë kanë qenë punëtorë, por u është

dhënë rasti të mësojnë, të bëhen teknikë, inxhinierë, administratorë etj. Kapitalisti këta i merr, u jep përgjegjësi, i bën kuadro, i korrupton me paga të larta e privilegje dhe i vë në shërbim të vet. Këta shpesh flasin gjoja në emër të klasës punëtore, por puna që kryejnë dëmton interesat e saj dhe i shërben kapitalit.

Një gjë e tillë nuk ndodh me kuadrot e vendit tonë, që janë rritur dhe edukuar me mësimet e Partisë. Megjithatë eksperiencia historike e Komunës së Parisit na mëson që kuadrot të vihen kurdoherë nën kontrollin e rreptë të masave, të zgjidhen e të revokohen prej tyre, deri pagat e tyre të kemi kujdes që të jenë me diferenca të vogla nga ato të punëtorëve. Këto mësimet Partia jonë i ka bërë të vetat dhe i ka zhvilluar në rrugën marksist-leniniste. Prandaj kuadrot tanë, në përgjithësi, janë të regjur, të kalitur, shumë prej tyre kanë kaluar nga Lufta Nacionalçlirimtare, ndërsa pjesa më e madhe, e përgatitur pas Çlirimit, ka marrë pjesë aktive në luftën për ndërtimin e socializmit.

Të gjithë konstatojmë se, kur Partia lëshon një direktivë, kuadrot, e bashkë me ta edhe masat, mobilizohen, ngrihen në këmbë për ta realizuar direktivën. Por vihet pyetja: përse mjaft plane e detyra nuk kanë qenë realizuar edhe më parë? Ne duhet ta shohim me hollësi këtë çështje dhe të gjejmë shkaqet. Në rast se rezulton që këto shkaqe duhen kërkuar te mungesa e disiplinës, atëherë duhet parë se si janë zbatuar ligjet, urdhëresat apo normat në fuqi. Kuadri, qoftë ai i Partisë, qoftë ai shtetëror, është e domosdoshme të jetë vetë rigoroz, të japë kurdoherë shembullin personal, pastaj të kërkojë nga të tjerët, nga masat, zbatimin me rreptësi të këtij

apo të atij ligji, të kësaj apo të asaj norme. Pa këtë, normat dhe ligjet nuk do të gjenin zbatim të plotë. Prandaj, mendoj unë, e meta kryesore në moszbatimin e ligjeve, të vendimeve e të urdhëresave qëndron. në radhë të parë, te dobësitë dhe te lëshimet që bëjnë kuadrot. Vija e Partisë është e drejtë, masat, në përgjithësi, i shohin gabimet e disa kuadrove, por Partinë nuk e shikojnë vetëm te kuadrot. Në fakt, kur vendos për një problem Komiteti Qendror apo Qeveria, masat thonë vendosi Partia, kur vendos komiteti i Partisë apo ai ekzekutiv në rreth, ato, gjithashtu, thonë vendosi Partia. Mirëpo edhe pse në forume ne diskutojmë mirë dhe marrim vendime të drejta, aparatet ku punojnë e drejtojnë kuadro, shpesh nuk i ndjekin e nuk i zbatojnë si duhet vendimet, bëjnë lëshime dhe krijohet kështu një situatë, e cila e bën të nevojshme ngritjen përsëri me forcë të këtij ose atij problemi.

Këtu e ka burimin, më duket mua, shtruarja e problemeve me fushata. Mos është vallë kjo dëshira e anëtarëve të Partisë dhe e klasës punëtore që të veprohet në këtë mënyrë nga kuadrot? Jo, shokë, kjo nuk është as dëshira e anëtarëve të Partisë, as e kuadrove, as e masave, por veç nga kuadrot që drejtojnë, që çojnë nga lart poshtë vijën e Partisë dhe që kontrollojnë zbatimin e saj, ka që lëshojnë, që nuk janë ekzigjentë në zbatimin e detyrave, në radhë të parë, ndaj vetes, pastaj edhe ndaj të tjerëve.

Ka njerëz që vjedhin, prej tyre ka dhe kuadro. Po ku është kontrolli i Partisë dhe ai shtetëror? Përse këto organe lejojnë të bëhen lëshime ndaj vjedhësve? Kuptohet, për arsye se kanë qenë liberalë, se në ndër-

gjegjen e atyre që i drejtojnë këto organe nuk janë rrënjësor si duhet koncepte të drejta revolucionare të Partisë, bile çështja arrin deri atje sa ka nga këta që thonë se me këto akte antisocialiste duhet të merren organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Mirëpo Ministria e Punëve të Brendshme nuk mund t'i zbulojë dot vetë të gjitha veprimet antisocialiste pa ndihmën e Partisë, të kuadrove dhe të masave. Kjo ministri, me organet e saj vartëse, nuk mund ta kryejë si duhet detyrën, në qoftë se vetë Partia, dhe veçanërisht kuadrot, nuk vihen në pozita të drejta revolucionare për edukimin e komunistëve dhe të masave, në mënyrë që ata që shkelin normat jo vetëm të jenë sa më pak, por edhe të dalin në dritë, të zbulohen sa më parë. Po të veprohet kurdoherë kështu, organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme do ta kenë më të lehtë punën, se do të dinë ku të vënë gishtin, do të identifikojnë më lehtë armiqtë e keqbërësit, do të minimizohet e do të sqarohet kështu sfera e objekteve të ndjekjes, sepse puna e Partisë ua ka spastruar terrenin. Mirëpo në këtë drejtim ka organe dhe organizata partie që bien në gjumë. Por kam një vërejtje edhe për organet e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Kjo ministri dhe organet e saj duhet t'u japin edhe organeve drejtuese të Partisë e të pushtetit në rrethe herë pas here informacione për këto probleme, sepse kështu ato ndihmohen shumë.

Përse të lejohet, fjala vjen, në rrethin e Sarandës që keqbërësit të vjedhin? Kjo do të thotë se Komiteti i Partisë dhe Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të këtij rrethi duhet të punojnë më shumë. Po çfarë është Saranda, mos ka ndonjë terren të përhapur dhe me

një popullatë shumë të madhe? Jo, me një makinë mund t'i biesh përçark brenda ditës gjithë rrethit. Atëherë çfarë i shtyn disa kuadro të jenë kaq miopë? Mos është vallë mungesa e vullnetit? Ne nuk mund të themi në asnjë mënyrë se kuadrot drejtues të Partisë dhe të pushtetit tonë nuk kanë vullnet, as që nuk e duan Partinë. Megjithatë, në punën që bëjnë, vihet re se ka lëshime, pikërisht se në ndërgjegjen e tyre ekzistojnë koncepte liberale.

Kur janë diskutuar këto çështje, me aq sa kam përshtypjen, më duket se nuk është bërë një kritikë e rreptë ndaj kuadrove që kanë shkelur norma, kanë bërë lëshime ose kanë manifestuar shfaqje të huaja. Shpesh kritikën janë bërë në përgjithësi, duke u drejtuar konkretisht ndaj atyre njerëzve të thjeshtë që kanë kryer drejtpërdrejt faje e gabime dhe ka munguar kritika e duhur ndaj kuadrove drejtues që përgjigjen për ta. Natyrisht, kushdo që bën gabime, domosdo duhet të kritikohet, por duhet gjetur e luftuar edhe shkaku. Mos vallë kuadrot drejtues të Partisë, të pushtetit ose të bashkimeve profesionale, nuk kanë përgjegjësi për njerëzit që gabojnë? Përse nuk kanë punuar ata që t'i bënin njerëzit të ndërgjegjshëm për realizimin e detyrave, përse nuk kanë bërë si duhet propagandë për të gjitha këto probleme dhe pas kësaj të mos bënin lëshime, duke kërkuar me rreptësi të zbatohet disiplina në punë në të gjitha drejtimet?

Po ka edhe gjëra të tjera që nuk kuptohen sa duhet. Sekretari i Komitetit të Partisë të Kombinatit Metalurgjik në Elbasan thotë se nuk veprojnë mirë shokët e disa rretheve që u dërgojnë në metalurgji djem të

rinj «të pakontrolluar dhe të paedukuar». Po pse të mos i dërgojë rrethi të tillë njerëz? «Ju si ndërmarrje i edukoni ata në punë, — i thashë shokut të metalurgjisë, — ata janë qytetarë të republikës dhe do të venë diku, qoftë atje ose në një vend tjetër, ku ka punë». I thashë, gjithashtu, se, sipas këtij koncepti, ai dashka ajkën e punëtorëve të rretheve dhe, para se të dërgohen në Elbasan, të jenë edukuar. Jo, metalurgjia është një nga qendrat më të rëndësishme, ku do të edukohen edhe të tillë njerëz.

Ta vësh çështjen se të gjithë ata që thyejnë disiplinën dhe shkelin normat nuk janë të ngritur ideologjikisht e politikisht, kjo nuk është aspak e drejtë. Mund të mos jetë i kalitur, fjala vjen, një i ri, që porsa ka hyrë në punë, me të cilin, natyrisht, ka nevojë të punohet. Po kuadrot drejtues që punojnë në ndërmarrje, në kooperativa e në institucione të ndryshme, pa lëre ata të rretheve, si të Partisë, të organizatave shoqërore, ashtu edhe të pushtetit, shumica e të cilëve janë njerëz me eksperiencë shumëvjeçare, përse i bëjnë këto lëshime dhe nuk tregohen rigorozë, mos vallë se nuk janë të ngritur? Jo, shokë, kjo nuk mund të pranohet.

Atëherë, si lejojnë të shkelen ligjet e shtetit dhe normat e Partisë shokë me eksperiencë kaq të gjatë në punë? Përse nuk kërkojnë ata zbatimin me rreptësi të tyre? Mos vallë zbatim norme partie do të thotë vetëm të bësh një mbledhje në rregull? Një mbledhje formalisht mund të bëhet dhe të mos nxirret asgjë prej saj.

Pse tejkalohen normat në prodhim? Përpjekjet për tejkalimin e normave nga punëtorët janë diçka normale. të ligjshme. s'ka e s'duhet të ketë asnjë pengesë që

punëtorët të mos i tejkalojnë ato. Punëtorët e ndërgjegjshëm vënë të gjitha forcat dhe i tejkalojnë normat. Në këtë rast atyre u bëhet thirrje që t'i ngrenë dhe ata dakord janë dhe ngrihen aq sa shihet e arsyeshme, megjithatë, pas ca kohe, ato prapë tejkalohen. Mos faji qëndron këtu te punëtorët? Jo, aspak! E meta është se korrigjimi i normave nuk është bërë i studiuar mirë, me baza. Po përse nuk janë studiuar ato me kujdes? Nuk kemi ne normistë të ngarkuar pikërisht me këtë punë? Sigurisht që kemi. Po ç'është normisti? Ai është kuadër. Veç këtij në ndërmarrjet tona ne kemi edhe sa e sa kuadro të tjerë, inxhinierë, ekonomistë, drejtorë, kryeinxhinierë, nga të gjithë, bile ka ndërmarrje që kanë deri 20 inxhinierë. Përveç këtyre, në çdo rreth kemi komitetin ekzekutiv të këshillit popullor që qëndron mbi të gjitha ndërmarrjet e institucionet e rrethit. Po i ndjekin si duhet problemet të gjitha këto hallka? Ja, pikërisht këtu qëndron dobësia.

Partia dhe Qeveria bëjnë mbledhje, udhëzojnë, instruktojnë se si të zbatohen këto norma, po në fakt nxirren shumë pengesa për t'i vënë ato në jetë. Po kush i nxjerr këto pengesa? Unë mendoj se këto i nxjerrin disa kuadro dhe arsyeja është pikërisht se kritika atyre nuk u është bërë me forcën e duhur, se ata vetë u kanë shkuar këtyre problemeve në sipërfaqe. Pra, fajet nuk i kanë vetëm ata që i kryejnë dhe që janë drejtpërdrejt përgjegjës për shkeljen e ligjeve, udhëzimeve, normave të Partisë, po faj kanë edhe ata që bëjnë lëshime. Prandaj këtu duhet parë edhe ndërgjegjja e atyre kuadrove që nuk janë në rregull, mbasi as këta nuk e kanë kryer detyrën për të ndjekur çdo ditë e vazhdimisht zbatimin

me rreptësi të ligjeve, të vendimeve, të udhëzimeve, të normave.

Në goftë se vazhdojmë të punojmë e të jetojmë me euforinë e një metode e stili pune të vjetruar, që nuk japin rezultatin e dëshiruar dhe si pasojë nuk kryhen deri në fund detyrat, fjalët që themi e përsëritim në mbledhje, nuk kanë shumë vlerë. Metodë e stil revolucionar në punë do të thotë të zbatosh detyrën, ta marrësh ligjin, vendimin apo direktivën, ta studiosh mirë e ta zbërthesh, por jo të flesh mendjen me kaq, duke kujtuar se çdo gjë mbaroi, përkundrazi, të ndjekësh e të kontrollosh çdo ditë nëse zbatohen apo nuk zbatohen detyrat. Është e domosdoshme të punohet me këmbëngulje derisa të kuptohen dhe të zbatohen të gjitha detyrat nga ata që janë ngarkuar me këtë ose atë punë. Kjo do të thotë t'i futësh të tjerët në rrugën e zbatimit të normave të Partisë. Këtë nuk e bëjmë kurdoherë si duhet, shokë, prandaj na ngjasin dobësitë e të metat që po kritikojmë.

Kuadrot drejtues të Partisë shpesh merren me di-sa gjëra që nuk u takon të merren drejtpërdrejt. Përse u dashka të merren ata me organizimin praktik të fushatës së mbjelljeve? A nuk kemi theksuar ne vazhdimisht që organizatat-bazë të Partisë të kenë iniciativë e vetëveprim? Atëherë le të mblidhet në kohën e duhur organizata-bazë e Partisë e kooperativës apo e ndërmarrjes bujqësore, të diskutojë dhe të vendosë se çfarë masash organizative duhet të merren për fushatën e mbjelljeve, çfarë pune duhet bërë për këtë qëllim nga komunistët dhe nga kuadrot e kooperativës. Ka rëndësi ajo që duhet futur në kokën e punëtorëve



të ndërmarrjeve bujqësore apo të anëtarëve të kooperativave, të dihen cilat janë të metat e punëtorëve dhe të kooperativistëve dhe, kur flasim për këto të meta, kemi parasysh të gjitha ato që po luftojmë dhe që kanë të bëjnë me ngritjen e ndërgjegjes dhe me zbatimin e normave. Ja, kjo është puna që duhet të bëjë Partia. Në qoftë se ajo e bën këtë mirë, ne do të kemi suksese, secili do të ketë të qartë ç'punë do të bëjë, gjithçka do të realizohet në kohën e caktuar. Mirëpo pikërisht këtë që duhet të kryejë Partia, disa nuk e kuptojnë drejt, bile duke u marrë me këtë, atyre u duket sikur nuk po e kryejnë detyrën, prandaj lënë pas dore atë që është kryesorja dhe merren me punën e të tjerëve.

Disa kuadro të pushtetit, pasi marrin në duar e studiojnë statistika e materiale të tjera, shkojnë në bazë për të parë si po punohet, japin atje ndonjë udhëzim të vogël dhe mendojnë sikur me kaq e kanë kryer detyrën, sikur nuk u takon të merren me punë politike dhe ideologjike me njerëzit. Zbatimi i ligjeve dhe i vendimeve u duket se nuk u përket atyre. Krijohet kështu përshtypja se për detyrat që nuk realizohen në sektorët që mbulojnë ose për shkeljen e ligjeve e kanë fajin vetëm ata që dënohen, kurse drejtuesit qenkan në rregull me normat e Partisë.

Kjo është një çështje që duhet të kuptohet seriozisht nga Partia, por duhet të kuptohet mirë edhe nga kuadrot e pushtetit, të ekonomisë etj. dhe secili të kryejë detyrën që i përket. Është e domosdoshme të kuptohet se, ashtu sikurse kuadrot e Partisë, që duhet të kenë njohuri të përgjithshme për problemet ekonomike, se ndryshe nuk e bëjnë mirë detyrën, edhe

kuadrot e pushtetit dhe ata të ekonomisë nevojitet të kenë, së pari, dijëni të plota për çështjet administrativo-ekonomike, por të kenë njohuri edhe ç'është puna politike e Partisë, sepse, pa pasur të qartë këtë, nuk do të kenë të qartë ku shkojnë, do të ishin kështu vetëm teknokratë dhe teknokratizmi i tyre, bashkë me shumë mbeturina të tjera, do t'i bëjnë që edhe detyrat si administratorë dhe teknikë të mos i kryejnë si duhet. Mua më duket se është e nevojshme ta theksojmë fort këtë çështje, pse ka rëndësi shumë të madhe për çdo sektor qoftë: për bujqësinë, për industrinë, për kulturën, për ushtrinë e për çdo sektor tjetër, ndryshe të metat e dobësitë nuk do të luftohen me rrënjë.

Le të marrim çështjen përse ka shfaqje të liberalizmit në ushtri. Duke e diskutuar këtë çështje, do të gjejmë se normat që kemi vendosur, kërkesat për disiplinën e ndërgjegjshme etj. i kemi drejt, megjithëkëtë nuk përjashtohen raste shkeljesh, ndaj të cilave duhet vepruar për të mos u përsëritur. Kjo ndodh se në këtë drejtim janë bërë lëshime. Po mos vallë do të thotë që tani, për t'i korrigjuar të metat në ushtri, në pushtet etj., duhet të merren vetëm masa administrative ndaj cilitdo që bën një shkelje e lëshim duke u rënë njerëzve kokës? Jo, shokë, kjo nuk është dhe nuk mund të jetë në rrugën e Partisë.

Për Partinë është shqetësues fakti përse ngjasin këto shfaqje në ushtri. Dhe përgjigjja është e qartë: këto ngjasin se ka oficerë, kuadro të ushtrisë, që nuk janë në pozita luftarake. Këtu duhet kërkuar burimi i kësaj së keqeje. Shumë nga këta kuadro janë shokë të vjetër, që i duan me kokë popullin dhe Partinë dhe që

janë gati të sakrifikohen në çdo kohë për mbrojtjen e fitoreve të arritura. Ata edhe dituri kanë, por duhet njohur se nuk janë të mobilizuar në shkallën që e kërkojnë momentet për t'u qëndruar çështjeve mbi kokë e gjer në fund. Atëherë, në rast se vëmë re që deklarojnë se popullin dhe Partinë i duan shumë, por në fakt nuk janë të mobilizuar në shkallën që kërkohet, t'u bëhet e qartë se dashurinë për popullin e Partinë duhet ta tregojnë me punë për zbatimin e detyrave, të normave e jo me qëndrime të buta e liberale, me lëshime që u bëjnë shkelësve, me nënvleftësimin e shfaqjeve e të gabimeve «të vogla», nga të cilat populli dhe Partia dëmtohen.

Meqë erdhi fjala për ushtrinë, të kihet shumë kujdes në gazetën «Luftëtari» për ruajtjen e sekretit, sepse nga shkrimet e këtij organi armiku mund të marrë të dhëna jashtëzakonisht të rëndësishme, bile edhe emrat e kuadrove dhe të oficerëve mund të shfrytëzohen prej tij për të nxjerrë të dhënat që kërkon.

Edhe një kuadër që punon në pushtet ose në ekonomi mund të flasë se e do shumë Partinë, por në qoftë se lejon të shkelen ligjet e pushtetit, të mos realizohen detyrat çdo ditë, ai, gjithashtu, e dëmton rëndë Partinë dhe republikën. Pra, interesat e përgjithshëm nuk i dëmtojnë vetëm punonjësit që shkelin drejtpërdrejt normat dhe ligjet, por edhe kuadrot që janë në drejtim të tyre dhe që i shikojnë, po nuk reagojnë si duhet. Këtë gjë duhet ta kemi të gjithë të qartë, shokë. Asnjë nuk mund të thotë se e ka kryer detyrën në mënyrë të përsosur dhe pa gabime; të tërë, në një masë ose në një tjetër, kemi gabime në këtë drejtim, prandaj

të shtrydhemi, t'i korrigojmë këto qëndrime. Një gjë të tillë e kërkon situata e rrethimit të vendit tonë, e kërkojnë interesat e popullit dhe të Partisë.

Euforitë e rreme duhet të luftohen, sepse tek ato e ka burimin optimizmi jorealit e pa baza që lind nga një analizë jo e thellë e si duhet e situatave. Por kjo vjen edhe nga një mendjemadhësi që ekziston te disa njerëz. Nuk mund të themi se ata nuk i studiojnë materialet e Partisë, por fakt është se Partia këto çështje nuk i ka ngritur një herë, ajo i ka ngritur e i ngre vazhdimisht dhe i sheh lidhur ngushtë me situatat, por disa njerëz, kur diskutojnë për këto probleme, lënë përshtypjen sikur këto ngrihen për herë të parë. Në fakt, për këto çështje Partia ka folur gjithnjë. Këto përsëritje janë të nevojshme të bëhen, sepse situatat ndryshojnë kohë pas kohe, prandaj mësimet e Partisë duhet të lidhen konkretisht me gjendjen e re që krijohet.

Situatat, natyrisht, nuk ndërrojnë qind për qind çdo muaj. Gjendja jonë e brendshme zhvillohet, ajo ecën përpara, përmirësohet vazhdimisht jeta e popullit e të tjera, por situata e jashtme, përkundrazi, shkon duke u vështirësuar, gjë që nuk mund të mos ushtrojë refleksin e vet negativ edhe brenda vendit tonë. Këtij refleksi ne duhet t'i vëmë gjoksin, ta përballojmë, po kjo nuk mund të bëhet me përralla, me slogane e me mburrje, por me punë sulmuese, revolucionare, duke zbatuar normat, kudo që punojmë.

Në këtë drejtim ne duhet ta shohim situatën më realisht e më me kujdes, bazuar në të vërtetën e madhe se gjendja jonë e brendshme është e shëndoshë, gjë që i dedikohet edhe autoritetit e besimit të madh që

ka Partia në popull. Shfaqjet e huaja dhe të metat që ekzistojnë kemi bindjen se do t'i kalojmë, ato nuk janë të pakapërcyeshme, por kjo do të arrihet me një luftë të shtrënguar. Ne duhet ta bëjmë këtë luftë me të gjitha mundësitë kundër ndikimeve e propagandës së huaj, të cilat duhet t'i pengojmë, duke zënë mirë të gjitha shtigjet nga mund të kalojnë, siç janë radioja, televizioni, botimet e deri te hyrje-daljet e njerëzve në vendin tonë.

Së pari, doja të thosha se duhet parë puna e radios, të forcohet më shumë, se është me rëndësi për Partinë. Të bëhet një propagandë më e mirë e më e dendur. që njerëzit tanë të mos dëgjojnë emisione të radiove të huaja, pse, në fakt, asnjë fitim nuk kanë me dëgjimin e tyre. Shtypi i Partisë, radioja dhe televizioni ynë i japin popullit shqiptar një pasqyrë shumë të qartë, të përpunuar e reale të situatës ndërkombëtare, në rrugën marksiste-leniniste. Atëherë ç'është nevoja që disa hapin dhe dëgjojnë emisione të huaja? Është e domosdoshme të bëhet nga Partia një punë e dendur propagandistike e me baza të shëndosha në këtë drejtim. Partia ta bëjë të kuptueshme për të gjithë se shtypi, radioja dhe televizioni ynë, që trajtojnë konkretisht çdo ngjarje në botë dhe flasin me objektivitet nga pozita marksiste-leniniste, janë plotësisht të mjaftueshme për ta informuar drejt çdo njeri te ne për ngjarjet ndërkombëtare. Po të bëhet mirë kjo punë nga Partia, populli do të sqarohet dhe çdo njeri nuk ka përse t'i hapë stacionet e huaja radiofonike.

Së dyti, puna e televizionit. Punonjësit tanë të televizionit kanë marrë masa kohët e fundit që t'i for-

cojnë e t'i përmirësojnë emisionet, po kjo nuk mund të arrihet menjëherë. Puna që po bëjmë është akoma në fillim. Dëshira jonë është e madhe që të kemi një përmirësim të dukshëm e të shpejtë, po duhet pasur parasysh se mundësitë tona janë të kufizuara, se që të japësh emisione televizive tërë ditën, të japësh filma të zgjedhur e mundësisht filma shqiptarë çdo natë, siç kërkohet disa, të jemi realistë, të tilla mundësi nuk i kemi akoma dhe nuk i krijojmë dot shpejt. Prandaj të përpiqemi që të kullandrisemi me «gjalpin» tonë, sepse ky është i kulluar, jo i prishur, nga ai që të djeg «grykën». Ne do të përpiqemi edhe në këtë drejtim të bëjmë më shumë, do të mundohemi t'i përmirësojmë akoma emisionet tona televizive, po përmirësimi nuk arrihet me një ditë, as me një muaj, prandaj duhet pasur durim. Populli e kupton këtë.

Së treti, çështja e shtypit dhe e botimeve që vijnë nga jashtë. Mua më duket se edhe në këtë drejtim kemi qenë ca dorëlëshuar. Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë dhe Qeveria nuk kanë qenë asnjëherë liberalë në këto çështje, përkundrazi, kanë qenë të drejta dhe objektive në vijë, por këtë e kanë shkelur e liberalizuar të tjerë.

Çfarë shtypi e botimesh duhen lejuar të vijnë në vendin tonë? Është e qartë se te ne duhet të vijnë tekste shkencore e teknike, se në to ka më pak rrezik depërtimi ideologjik armik, pasi përgjithësisht përmbajtja e tyre kufizohet në teknike, ndërsa tërheqja nga jashtë e disa botimeve letraro-artistike dhe e shtypit duhet të jetë e kontrolluar dhe më e kufizuar. Ne s'kemi ç'u bëjmë lidhjeve e marrëveshjeve që ekzistojnë ndërmjet

institucioneve shkencore e bibliotekave tona me institucionet shkencore e bibliotekat e vendeve të tjera. Ne do t'i marrim këto botime dhe organet tona të mos tremben. Puna është të mos lejohet që ato të përdoren në masë, të mos përhapen e të mos i këndojë kushdo teoritë dekadente. Prandaj t'u japim direktiva të prera gjithë institucioneve e bibliotekave, të cilave u vijnë libra, revista e gazeta nga jashtë, që në asnjë mënyrë dhe asnjë prej tyre të mos u jepet lexuesve pa u kontrolluar më parë nga njerëz të kualifikuar, që këta të gjykojnë me përgjegjësi, duke parashtruar pikëpamjet se cilët libra e botime mund të kalojnë për shfrytëzim. Duhet të caktohet cilët libra e revista mund t'u jepen teknikëve e specialistëve, cilët do të jenë për profesorët dhe cilët për studentët. Kështu veprohet kudo, në çdo vend të botës. Aspak nuk veprohet keq, kur nuk lejohet të çarkullojë te ne çfarëdo literature me përmbajtje reaksionare e armiqësore ose pornografike. Demokracia jonë proletare ka normal e saj, zbatimimi i të cilave është në interesat e lartë të republikës, në interesin e socializmit.

Doja të shfaqja mendimin edhe për hyrjet e daljet në vendin tonë. Në këtë drejtim duhet forcuar puna e Partisë, sepse te disa nga njerëzit tanë krijohen sentimentalizma, prej të cilëve mund të kalohet në veprime që i shfrytëzon armiku.

Sa të jetë e mundur, ne duhet të shikojmë edhe numrin e atyre që vijnë nga jashtë, që të dimë cilët janë këta që vijnë, po të dimë edhe sa herë vijnë, se kam dëgjuar se ky apo ai person ka ardhur deri edhe 8 herë.

Ne duhet ta shohim më shtrënguar, gjithashtu, dër-

gimin e ekipeve sportive jashtë shtetit, se më duket e kemi lëshuar shumë dorën. Në ndeshjet sportive ndërkombëtare dërgojmë ekipe që vazhdimisht humbasin. Atë që ne presim prej tyre, që të bëjnë propagandë në favor të vendit tonë dhe të lënë përshtypje sa më të mira në opinionin e vendit ku bëjnë ndeshjen (ashtu siç na ndodh me ansamblet e këngëve e të valleve, shfaqjet e të cilave bëjnë efekt shumë pozitiv, prandaj mendoj se këto duhen dërguar më shumë), nuk po e realizojnë, përkundrazi, duke mos u mobilizuar si duhet në ndeshjet, ato bëjnë të kundërtën. Atëherë për ç'qëllim i dërgojmë, apo që t'u bëjmë qejfin sportistëve, apo që të tregojmë se kemi edhe ekipe sportive? Kështu gënjejmë veten, shokë, pse, në fakt, me nivelin që paraqitemi, i tregojmë botës së jashtme se ne jemi dobët. Prandaj është e domosdoshme të shtrohet çështja që ekipet tona, para se të paraqiten për ndeshje ndërkombëtare, të përgatiten e të mobilizohen që të bëjnë lojë të nivelit të lartë, pra të gjykohet mirë dërgimi i tyre. Pastaj të mos shkohet siç po vepron, po vetëm në disa nga aktivitetet më të rëndësishme.

Si përfundim, ne duhet të punojmë që ta forcojmë situatën e vendit tonë dhe për këtë i kemi të gjitha mundësitë. Të metat që përmendëm, kemi forca t'i zhdukim dhe do t'i zhdukim e me siguri do ta përmirësojmë më tej gjendjen. Të luftojmë nënvleftësimin që u bëhet shfaqjeve të huaja dhe lëshimet e qëndrimet liberale të disa shokëve të komiteteve të Partisë. Shokët e organeve të Punëve të Brendshme duhet të raportojnë herë pas here në komitetet e Partisë, prandaj kryetarët e degëve të Punëve të Brendshme bëjnë pjesë në byrotë



ose në komitetet e Partisë në rrethe. Luftimi i gjithë atyre shfaqjeve, të metave e dobësive për të cilat flitet në raport, më duket mua, varet më shumë nga kujdesi i shokëve të Partisë në rrethe, të cilët duhet ta kombinojnë më mirë punën me atë të organeve të Punëve të Brendshme. Edhe këta, siç e dimë dhe siç e kemi vënë në dukje edhe herë të tjera, kanë të metat e tyre, sidomos atë të familjaritetit, që, siç thashë, duhet t'i eliminonjë.

Unë kam bindjen se situatën që analizuam do ta kapërcejmë dhe fakt është që kohët e fundit ka ulje, si në shkëljen e ligjeve, ashtu edhe në veprimtarinë armiqësore, por vërehen edhe disa shfaqje që akoma vazhdojnë të ekzistojnë. S'ka dyshim se me një punë më të shëndoshë dhe këmbëngulëse nga Partia ne do t'i rritim akoma sukseset në këtë fushë.

*Botuar për herë të parë,  
me shkurtime, në librin:  
Enver Hoxha, «Për Parti-  
në» (Përmbledhje veprash),  
vëll. i 3-të, f. 115*

*Botohet sipas tekstit të nxjerrë  
nga procesverbali i mbledhjes  
së Byrosë Politike të KQ të  
PPSH, që gjendet në AQP*

# PUNA E PARTISË SYNON RRRITJEN DHE FORCIMIN E NJË SHOQËRIE GJITHNJË TË PASTËR E TË SHËNDETSHME

*Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit  
Popullor të RPSH<sup>1</sup>*

29 maj 1973

Në përgjithësi jam dakord me çështjet që ngrihen në materialin e paraqitur nga Gjykata e Lartë, si dhe me vërejtjet e aparatit të Presidiumit, të cilat më duken të drejta.

Gjendja e brendshme moralo-politike në vendin tonë është e shëndoshë. Megjithëkëtë ne duhet të shqyrtojmë objektivisht disa fenomene dhe ngjarje negative.

Në raport vihet në dukje edhe ky fakt: në numrin e përgjithshëm të krimeve bien në sy më tepër «krime të vogla», si mashtrime, përvetësime me vleftë të vogël të pasurisë socialiste ose të qytetarëve, akte të rruçërisë, rrahje e goditje kundër shtetasve dhe personave zyrtarë etj. Këto të dhëna nxjerrin në plan të parë

---

1. Në këtë mbledhje u shqyrtua raporti i paraqitur nga Gjykata e Lartë për krimet.

nevojën e përmirësimit të punës organizative dhe propagandistike për luftimin e tyre.

Partia e ka bërë vazhdimisht të qartë se këto fenomene nuk janë produkt i marrëdhënieve shoqërore socialiste, mbasi në vendin tonë nuk ka bazë ekonomike e politike për lindjen e krimeve, siç ndodh në vendet borgjeze e revizioniste, te ne ato janë refleksi i zhvillimit të luftës së klasave. janë rrjedhim i presionit ideologjik imperialisto-revizionist dhe i mbeturinave të ndryshme të trashëguara nga e kaluara në ndërgjegjen e njerëzve tanë, prandaj janë të gjitha mundësitë për t'u vënë fre, për t'i luftuar dhe për t'i kufizuar gjithnjë e më tepër. Këtij qëllimi mund t'i arrihet vetëm me punë të organizuar mirë për edukimin ideopolitik e revolucionar të njerëzve tanë me mësimet e Partisë e, në radhë të parë, të rinisë, së ardhmes së vendit.

Për të luftuar dhe për të arritur në përfundime të kënaqshme kundër kriminalitetit e sidomos kur ai shfaqet në mosha të reja, sikurse e kam theksuar edhe herë të tjera, është e domosdoshme të vihen para përgjegjësisë morale, bile, kur është nevoja, edhe materiale e penale, disa prindër, pakujdesia dhe indiferentizmi i të cilëve ka bërë që fëmijët e tyre të marrin rrugë të gabuar. Prandaj, kur kolektivat punonjës ose shkollat analizojnë sjelljet e padenja të atyre të rinjve që i kanë shqetësuar, është e këshillueshme të thërriten për të qenë të pranishëm në diskutimin e çështjes edhe vetë prindërit. Një punë e tillë bën efekt të madh te vetë fajtorët dhe te prindërit e tyre, ajo ndihmon fuqimisht edhe për edukimin e pjesëtarëve të tjerë të kolektivit, pra dhe të shoqërisë.

Është shumë e dëmshme dhe e palejueshme t'i fshihen kolektivit apo opinionit shoqëror shfaqjet që bien në kundërshtim me normat e moralit tonë socialist. Përkundrazi, duhen bërë përpjekje që ato të zbulohen, të vihen në dukje e të demaskohen publikisht dhe, kur formojnë krim, t'u jepen organeve të drejtësisë për gjykim dhe dënim.

Shpeshherë lexojmë në informacionet ose raportet që na jepen se opinioni shoqëror i dënon krimet. Kjo është e vërtetë, por sukcesi i dënimit të veprimtarisë keqbërëse nga opinioni shoqëror duhet të matet me rezultatin që arrihet, domethënë, me parandalimin e kësaj veprimtarie. Për arritjen e këtij synimi kërkohet që, kur kryhet një krim ose çdo akt tjetër antishoqëror, është e domosdoshme, së pari, të bëhet problem, të vlerësohet si një ngjarje e jashtëzakonshme në kolektivin ku vërtetohet, pse ky qëndrim ndihmon për edukimin e fajtorit dhe për parandalimin e rasteve analoge në të ardhmen. Vlerësimi i shpejtë dhe vënia në lëvizje e masave, kur vërtetohen ngjarje të tilla, duhet të bëhet metodë pune kudo. Qëndrimet pasive dhe indiferente e nënvleftësuese ndaj veprave të kësaj natyre të mos lejohen as nga organizatat e Partisë, as nga organizatat shoqërore, as nga ato të pushtetit. Tërë shoqëria duhet të ngrihet në këmbë, ta analizojë ngjarjen thellë dhe të mbajë qëndrim të ashpër. Opiniioni shoqëror ta dënojë rreptë elementin e prirë për veprimtari antishoqërore dhe, kur kemi të bëjmë me një person të pandreqshëm, të merren pa hezitim edhe masa ndëshkimore.

Kjo është njëra anë e problemit. Ajo që ka shumë rëndësi dhe vlerë është puna që duhet bërë për të mos

u përsëritur shfaqje të tilla të shëmtuara, pra, puna parandaluese që lyqset të bëjë Partia dhe masat. Kësh-tu, pasi të jenë zbuluar shkaqet që i kanë çuar disa elementë të kryejnë krime apo akte rrugaçërie, sipas kushteve që paraqiten dhe kolektivit ku ka ndodhur ngjarja, është e domosdoshme të organizohet puna edukative e. paralelisht me të, të merren edhe masa që ndihmojnë për pakësimin dhe zhdukjen e këtyre feno-meneve negative. Format e kësaj pune duhet të jenë të tilla që të ndihmojnë në mënyrë efektive për paranda-limin e së keqes. Në raste të tilla, për edukimin e nje-rëzve e parandalimin e krimeve ndihmon edhe nxjerrja e mësimëve nga ngjarje negative, që ndodhin në kolektivat punonjës përreth, për të tërhequr opinionin dhe për ta mbajtur vazhdimisht lart vigjilencën shoqërore në këto drejtime. Partia dhe të gjitha levat e saj, kra-has marrjes së masave edukative, duhet të përpiqen, gjithashtu, që, brenda mundësive dhe në bazë të plane-ve ekzistuese, të sigurojnë edhe mjete e kushte mate-riale që rinia të merret me veprimtari të dobishme për shoqërinë dhe për vete, si dhe për t'u argëtuar.

Puna edukative e propagandistike e organizatave të Partisë, e organeve të pushtetit dhe e organizatave sho-qërore, kundër krimeve dhe të gjitha shfaqjeve të tjera të huaja, më të shumtën e rasteve, ka qenë e përgjith-shme dhe formale. Me gjithë porositë e dhëna ajo nuk është bërë e diferencuar, sipas llojit të shfaqjes antisho-qërore apo të krimin, si dhe të vendit ku ky është kryer, duke e vënë mirë gishtin në plagë. Në këtë drejtim ka formalizëm. Puna edukative e propagandistike me ele-mentët e shthurur nuk mund të jetë e njëllajtë, fjala

vjen, si në një fabrikë apo kantier ndërtimi, edhe në një kooperativë bujqësore ose shkollë, ku kushtet e punës dhe të mësimit dhe llojet e shfaqjeve të huaja mund të jenë të natyrës krejt të ndryshme. Për ç'arsye të bëhet, ta zëmë, në një shkollë e njëjta punë propagandistike, ku problem mund të jenë një apo dy të rinj që sillen keq ndaj mësuesve, vajzave ose shokëve të tyre, me atë punë që është e nevojshme të bëhet në një uzinë, ku vihet re ndonjë i ri i paedukuar që ka përvetësuar disa sende të vogla, ose në një kooperativë bujqësore, ku ndonjë mendjelehtë ndez zjarr pranë mullarëve me bar ose stallave të bagëtive, gjë që mund të rrezikojë pasurinë e kooperativës? Puna e diferencuar dhe e lidhur konkretisht me vendin e punës dhe me llojin e aktit të kryer, kuptohet më mirë nga masat, ajo bën efekt më tepër dhe jep rezultatin e dëshiruar në edukimin e drejtë të tyre.

Subjekte të krimeve «të vogla» përgjithësisht janë njerëzit e shturur në jetë, dembelë e parazitë, të parregullt e të edukuar keq, të cilëve u pëlqen të breddhin lart e poshtë, të livadhisin pa fre, të mos u shtrihen kërkesave të moralit tonë socialist dhe normave ligjore, të mos shkojnë në punë ose në shkollë ose të vënë formalisht sa për të mashtruar opinionin shoqëror, sikur gjoja edhe ata duan të jetojnë me djersën e tyre. Të tillë njerëz që sillen në mënyrë të urryer, shihen rrugëve orë e pa kohë, prishin qetësinë, thyejnë rregullat e rendit publik dhe për të gjitha këto që bëjnë nuk u skuqet fytyra edhe kur dikush i këshillon. Ca më keq, kur ndonjëri u kundërvihet, qoftë ky edhe person zyrtar i autorizuar për mbrojtjen e rendit dhe të qetë-

sisë publike, ata janë gati të ngatërrohen me të, bile të kryejnë dhe krime «të vogla» që shqetësojnë opinio- nin shoqëror, duke ngjallur ndjenjën e pasigurisë së shtetasve për shëndetin, pasurinë, nderin dhe dinjitetin, që mbrohen nga ligjet e shtetit të diktaturës së prole- tariatit.

Reagimi në mënyrë krejt të pakulturuar, disa herë me egërsi, nga ana e këtyre elementëve të pandërgjegj- shëm kundrejt këshillave mirëdashëse të të tjerëve, që nuk u duan të keqen, përkundrazi, që përpiqen me du- rim t'i korrigojnë, bën të nevojshme marrjen e masave administrative bile dhe penale kundër tyre.

Këto masa janë të domosdoshme, pse të bësh lë- shime ndaj të tillë njerëzve që, për qëllimet e tyre të errëta dhe dëshirat egoiste e të mbrapshta, nuk përfi- llin të drejtat dhe interesat e ligjshëm të shtetasve të ve- çantë dhe të shoqërisë në tërësi, nuk është shfaqje e de- mokracisë socialiste, por një aspekt i liberalizmit borgjez dhe në fakt mohim i masave shtetërore me karakter shtrëngues. Shteti i diktaturës së proletariatit ka li- gjjet e tij, që duhet të zbatohen me rreptësi ndaj cilitdo që nuk dëgjon t'i respektojë ato në mënyrë të ndërgjegj- shme. Nuk është aspak e drejtë të lihen gati krejt pas- dore masat shtrënguese, natyrisht të diferencuara, siç ka ndodhur në disa raste, gjoja nën pretekstin e punës bindëse dhe edukative, pse te ne edhe këto kanë ka- rakter edukativ. Zbatimi i këtyre masave nuk ka asnjë synim tjetër përveç korrigjimit të keqbërësit, shpëtimit të tij nga thellimi i mëtejshëm i veprimtarisë kriminale, si dhe shpëtimit të shoqërisë nga elementët që e shqetë- sojnë dhe e dëmtojnë.

Doja të shprehja edhe një herë, me këtë rast, shqetësimin e Partisë e të shtetit për krimet e kryera sidomos nga elementët e moshave të reja dhe nevojën e përpjekjeve serioze që këto të vijnë vazhdimisht duke u pakësuar. Siç e thashë, që të arrihet kjo, duhet të gjejmë shkakun që e bën të lindë këtë ose atë fenomen në këto moshë, siç është nënvleftësimi i punës edukative nga familja, shkolla, qendrat e punës dhe organizatat shoqërore.

Partia ka tërhequr vazhdimisht vëmendjen për kujdesin e madh që duhet të tregojë tërë shoqëria jonë për edukimin e shëndetshëm të masave e, në radhë të parë, të rinisë e të pionierëve. Por, në praktikë, në mjaft raste nuk i kushtohet vëmendja e duhur kësaj detyre të dorës së parë, prandaj aty-këtu disa elementë i shpëtojnë këtij kujdesi. Kjo do të thotë, pra, se këto krime ndodhin për arsye se edukata shoqërore dhe familjare me të rinjtë nuk është në lartësinë e duhur.

Disa shfaqje negative në fillim duken «të vogla», «të parëndësishme», prandaj edhe nënvleftësohen, mirëpo, në rast se nuk luftohen menjëherë, me t'u vënë re nga shoqëria dhe familja, ato rriten e, dalngadalë, kthehen në zakone e vese të këqija, që çojnë në krime shumë të rrezikshme. Duke analizuar «krimet e vogla» të kryera nga disa të rinj, siç vihet në dukje në raport, del qartë përgjegjësia e madhe që mban familja për ata që vihen në rrugë antishoqërore. Merret me mend ç'indiferentizëm e pakujdesi tregon familja ndaj një pjesëtari të vet që është vënë në rrugën e kimit. Mos vallë ajo kujton se e ka kryer detyrën, duke u kujdesur vetëm për sigurimin material të fëmijëve e jo edhe



për edukimin e tyre, sikur kjo detyrë të ishte krejt e tjetërkujt? Mos vallë mendohet se me këtë punë duhet të merret vetëm shkolla dhe organizata e rinisë? Kush harron këtë detyrë të dorës së parë, ai bën një gabim të pafalshëm, që i rëndon së ardhmes së atdheut tonë socialist. Familja, baza e shoqërisë sonë, duhet të bëhet kudhra e parë ku njeriu merr bazat e edukatës socialiste. Prandaj ashtu si kujdesen për ushqimin, veshmbathjen e shëndetin e fëmijëve, prindërit e kanë për detyrë të tregojnë po aq kujdes edhe për mbarëvajtjen në mësimet e, në radhë të parë, për edukimin e tyre me virtytet më të mira të popullit dhe me tiparet e moralit socialist. Duke u nisur nga ky qëllim i lartë, është e domosdoshme të mos lihen pa u vënë re e të nënvleftësohen shfaqjet negative, sado të vogla që mund të duken në fillim, te fëmija që në moshën më të njomë. Ndjenjat e dashurisë së verbër të mos e bëjnë prindin të tërhiqet para korrigjimit të tekave dhe të veseve të fëmijës, po, për hir të dashurisë së vërtetë, të punojë me durim të madh në interes të edukimit të shëndoshë të fëmijës për t'ia luf-tuar të metat që në krye dhe për t'ia zhdukur. Kjo ka rëndësi të madhe, pse sa më vonë të merren masa, aq më shumë do të rriten shfaqjet negative dhe aq më e vështirë do të bëhet lufta kundër tyre.

Jo vetëm kaq, por është e domosdoshme që prindërit të bashkëpunojnë ngushtë me shkollën, t'ua bëjnë të njohur mësuesve dobësitë dhe ndonjë shfaqje jo të mirë të fëmijës, në mënyrë që bashkërisht të koordinojnë punën edukative për mirërritjen e brezit të ri. Mbeturinat mikroborgjeze për t'ia fshehur shkollës këto dobësi të fëmijës ose, për më tepër, për t'ia mbuluar

kur këto zbulohen nga mësuesit e ca më keq akoma për t'ia justifikuar e «për ta mbrojtur» fëmijën, janë shumë të dëmshme. Atë mesim që disa prindër nuk e kuptojnë sot, me siguri do ta ndiejnë nesër si një pësim të hidhur.

Të njëjtin kujdes për edukimin e rinisë shkollore duhet të tregojë edhe shkolla, gjithë personeli mësues, që nga kopshti e deri në shkollën e lartë. Të kufizuarit vetëm me dhënien e njohurive mësimore, pa i lidhur këto vazhdimisht me edukatën, është një punë krejt e pamjaftueshme. Detyra e shkollës sonë të re është shumë më e gjerë, ajo bashkë me organizatën e rinisë, organizatat e tjera shoqërore dhe me familjen, nën udhëheqjen e Partisë, ka për detyrë të përgatitë të rinjtë e të rejtat, në radhë të parë, me bindje të thella ideologjike marksiste-leniniste, me një moral të shëndoshë revolucionar, pastaj me një horizont të gjerë arsimor e kulturor. I gjithë ky sistem pune, i parë në tërësi, do t'i pajisë të rinjtë tanë me virtyte të larta: të thjeshtë, trima, të guximshëm, të ndershëm, me respekt të madh për njerëzit, me dashuri për punën dhe për pronën shoqërore dhe të gatshëm për t'i shërbyer me të gjitha forcat Partisë, popullit, atdheut dhe ndërtimit të plotë të socializmit në Shqipëri.

Prandaj edhe shkolla e ka për detyrë të jetë, gjithashtu, e vëmendshme ndaj çdo shfaqjeje të huaj që vihet re te nxënësit e studentët e që bie në kundërshtim me normat e moralit tonë proletar dhe me interesat e ndërtimit socialist të vendit. Çdo lëshim, në këtë drejtim, është me rrjedhime të dëmshme e të rënda për vetë personin dhe për shoqërinë.

Për edukimin revolucionar të nxënësve e studentëve, të rinisë punëtore e fshatare, të rinjve që janë duke kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak etj., jo më pak përgjegjësi kanë organizata e rinisë dhe gjithë organizatat e tjera shoqërore. Këto duhet të tregojnë kujdes për të edukuar të rinia jonë ato veti e ndjenja fisnike që përmenda më lart. Në këtë drejtim rëndësi ka edhe organizimi sa më frytdhënës i kohës së lirë, aktivitetet e ndryshme që organizohen me të rinjtë e të rejtat pas punës, pas mësimit, pas shërbimit, ku krahas kujdesit për zhvillimin e zbulimin e anëve pozitive, duhet treguar vëmendja edhe ndaj të metave e dobësive dhe ndaj çdo shfaqjeje tjetër të dënueshme të individëve të veçantë, për pakësimin sa më shumë të të cilave është e domosdoshme të bëhet një punë e menduar dhe e organizuar mirë, përndryshe nuk do të kemi rezultatet që presim.

Dënimi me kusht duhet të zbatohet vetëm atëherë, kur gjykata krijon bindjen se shkalla e rrezikshmërisë së të dënuarit, që natyrisht nuk mund të shkëputet nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të veprës, është e tillë sa nuk çmohet i nevojshëm veçimi i tij nga shoqëria. Gjykatat të mbajnë gjithnjë në qendër të vëmendjes se dënimi me kusht mund të zbatohet vetëm në përputhje me qëllimet e dënimit, domethënë me edukimin e fajtorit dhe të pjesëtarëve të lëkundshëm të shoqërisë. Për të dhënë një dënim me kusht, siç e kam kuptuar unë dispozitën përkatëse të Kodit Penal, gjykata duhet të niset nga shkalla e rrezikshmërisë së të dënuarit, duke pasur parasysh personalitetin e tij, origjinën dhe gjendjen shoqërore, punën dhe sjelljet shu-

më të mira para kryerjes së krimit, rrethanat e kryerjes së krimit dhe qëndrimin thellësisht e me të vërtetë të penduar pas kryerjes së tij. Në këto rrethana gjykatat nuk kanë arsye ta teprojnë dhënien e dënimeve me kusht duke nënvleftësuar «rrezikshmërinë shoqërore të krimeve të ashtuquajtura të vogla». Ky qëndrim i gjykatave popullore është shfaqje e liberalizmit në punën e tyre.

Një nga shkaqet e këtij liberalizmi, në punën e gjykatave, është idealizimi i punës edukative, e cila vërtet ka rëndësi të dorës së parë, por, në të njëjtën kohë, nuk mohon aspak kombinimin me masat penale dhe vuajtjen e dënimit. Në dhënien e dënimeve me kusht gjykata nuk duhet të humbasë ekuilibrin, por ta zbatojë ligjin në kuptimin e vërtetë të tij.

Shkaku tjetër që ka ndikuar në teprimin e dhënies së dënimeve me kusht, siç del nga raporti i Gjykatës së Lartë, janë ndërhyrjet e shumta që bëhen nga të gjitha anët për «krimet e vogla»! Gjykata nuk duhet të pranojë asnjëherë dhe nga kurrkush ndërhyrje për shkeljen e ligjit dhe zbutjen e politikës penale. Si organ i shtetit tonë socialist, ajo zbaton me këmbëngulje politikën e Partisë të shprehur në ligje dhe jo kërkesat e padrejta, ndërhyrjet për përkrahjen e miqve, të shoqëve apo të afërmeve të njërit dhe të tjetrit. Në raste të tilla gjyqtari nuk duhet të bjerë në sentimentalizëm, ai lypset të jetë i pakorruptueshëm dhe t'i tregojë vendin personit, që me shumë marifete e dredhi ndërhyjnë me pretekste të ndryshme se fajtori «rrjedh nga familje me të kaluar të mirë», se «babai ose xhaxhai i tij ka qenë me Partinë» etj. Gjykata në këto raste duhet të

ngrejë zërin me forcë para organeve të Partisë dhe të pushtetit për t'u prerë rrugën atyre që përpiqen të shtrembërojnë drejtësinë tonë, në vend që t'u vijë turp për këtë qëndrim të tyre dhe të bëjnë autokritikë të hapur, se nuk kanë punuar me kohë dhe në mënyrë të vazhdueshme për edukimin e të afërmeve të tyre.

Shpejtësia në hetimin dhe gjykimin e «krimeve të vogla», siç del nga të dhënat që na raportohen, nuk është në nivelin e kërkesave tona. Zvarritja e hetimeve dhe e gjykimeve vjen për shumë arsye, siç janë: mosorganizimi i mirë i punës, mungesa e kualifikimit të nevojshëm të të gjithë hetuesve dhe gjyqtarëve etj. Por, pa mohuar këto arsye subjektive, është e vërtetë se, këtu, ndikojnë për keq edhe disa dispozita të Kodit të Procedurës sonë Penale. Kërkesat e tepruara formalo-juridike, që shkaktojnë vetëm zvarritje burokratike në procesin e hetimit dhe të gjyimit, janë tipike për të drejtën borgjeze, që në disa drejtime është kopjuar edhe nga e drejta e vendeve revizioniste. Për të përligjur burokratizmin juridik «teoricienët» proceduralistë të këtyre vendeve «argumentojnë» se gjoja afatet te për të zgjatura procedurale i shërbejnë «hetimit dhe gjykit shumë të drejtë», se hetimi dhe gjykimi mund të zgjaten, që «të mos i mohohen të drejtat të pandehurit» etj. Mbi bazën e këtyre teorizimeve, borgjezia dhe revizionistët shpeshherë mundohen të përligjin mbajtjen nëpër qeli për një kohë të gjatë të njerëzve, të cilët, edhe kur deklarohen të pafajshëm për «krimet e vogla», e kanë vuajtur dënimin shumë më tepër se të deklaroheshin fajtorë.

Për disa krime, që për karakterin dhe natyrën e tyre mund të hetohen dhe të gjykohen shpejt ose mund të shkojnë për shqyrtim drejtpërdrejt në gjykatë, pa pasur nevojë për hetime paraprake, është e nevojshme të parashikohet një procedurë e veçantë, më e shpejtë, me qëllim që, pa u cenuar aspak drejtësia, vendimet e dhëna të ndikojnë më shumë e më mirë në edukimin e fajtorëve dhe të pjesëtarëve të tjerë të shoqërisë. Vonc-sat në hetime dhe në gjykime e zbehin shumë rolin edukativ të vendimit gjyqësor, prandaj mendoj të shikohet shpejt ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale për hetimin dhe gjykimin në afate sa më të shkurtra që të jetë e mundur të disa krimeve të natyrës që përmenda.

Përgjithësisht, siç e thashë në fillim, unë jam dakord me raportin e Gjykatës së Lartë dhe me masat që propozohen në këtë raport për ndryshimet e ligjit, si dhe për detyrimin ligjor për punë të elementëve parazitë e vagabondë, për të cilët Qeveria ka përgatitur projektin përkatës.

Për sa u përket ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale, kjo punë, e përsëris, është e domosdoshme të bëhet shpejt, por pasi të merret edhe mendimi i hetuesve, i prokurorëve dhe i gjyqtarëve në bazë, sepse ata, që ndeshen çdo ditë me zbatimin në praktikë të këtyre normave, mund të japin mendime shumë të vlefshme për ndryshimin e ligjeve proceduriale.

Këto kisha për të thënë rreth problemit që analizojmë, duke qenë i bindur se me masat që do të merren në shumë drejtime, me luftën tonë kundër kriminalitetit

dhe shkeljes së rregullave të shoqërisë socialiste, do të arrijmë rezultatet e dëshiruara.

*Botohet për herë të parë, me  
ndonjë shkurtim, sipas tekstit  
të nxjerrë nga procesverball i  
mbledhjes së Presidiumit të  
Kuvendit Popullor që gjendet  
në AQP*

## FITORJA SIGUROHET KUR LUFTËS I SHIKOHET DERI NË FUND

*Nga biseda me Norodom Sihanukun*

5 qershor 1973

*Në fillim të bisedës që u zhvillua në selinë e Komitetit Qendror të PPSH, pas përshëndetjeve të rastit, Norodom Sihanuku falënderoi për ndihmën e dhënë nga populli, Partia dhe Qeveria Shqiptare luftës së popullit kamboxhian dhe, pasi foli për zhvillimin dhe rezultatet e kësaj lufte, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Në emër të popullit shqiptar, të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë, ju falënderoj dhe ju shpreh gëzimin tonë për vizitën që po na bëni.

Nga shkrimet tuaja, nga fjalimet që keni mbajtur dhe intervistat e ndryshme që keni dhënë, kemi mësuar se ju keni marrë kontakt me udhëheqjen kamboxhiane në zonën e brendshme të çliruar të Kamboxhias. Jemi gjithashtu, në dijeni se ju, megjithëse në luftë, keni gjetur kohë t'u flisni luftëtarëve kamboxhianë për Shqipërinë dhe për popullin e saj.

Ardhjen tuaj në vendin tonë ne e gëzojmë si një



ngjarje të rëndësishme që i shërben forcimit të luftës për çlirimin e popullit kmer, luftës kundër imperialistëve amerikanë, kundër socialimperialistëve sovjetikë, kundër neokolonialistëve të çdo ngjyre. Mirëpo ka nga ata që nuk i pëlqejnë takimet tona, sepse pëlqejnë dhe çmojnë takimet e drejtuesve intrigantë të shteteve kapitaliste.

Populli dhe Partia jonë jetojnë me ndjenja pranë luftës së popullit kamboxhian dhe vlerësojnë lart heroizmin e tij. Ata i ndjekin me interesim përpjekjet e mëdha që ai bën duke derdhur gjak në fushën e betejës. Ata do të jenë me të në çdo kohë, në momente të mira e të vështira. Lufta e popullit kamboxhian u jep kurajë dhe besim edhe popujve të tjerë, që luftojnë për çlirim, për nder dhe dinjitet kombëtar. Popujt e botës, duke marrë këtë shembull, duhet ta kuptojnë se uniteti është një vepër, e cila e ndihmon shumë çlirimin e tyre, prandaj, imperialistët dhe neokolonialistët nuk e duan unitetin e popullit dhe përpiqen me çdo mjet e mënyrë që ta përçajnë.

Amerikanët nëpërmjet CIA-s dhe revizionistët sovjetikë ndërhyjnë me paturpësi në luftën e popujve për çlirim dhe synojnë ta shuajnë atë. Ata janë përzier në punët e brendshme të luftës së popujve arabë, të popujve të Lindjes së Mesme, duke intriguar me shumë forma, për t'i përçarë në mënyrë që ata të mos jenë kurrë në një mendje me njëri-tjetrin. Rezultatet e kësaj pune të ndyrë po duken në marrëdhëniet në mes shteteve arabe, ku ç'thotë njëri, nuk thotë tjetri, kur atë që ndërton njëri, e prish tjetri. Si dy skifterë grabitqarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi

Sovjetik futin pyka midis popujve që këta të mos mundin të bashkohen dhe të fitojnë kundër planeve të errëta imperialiste. Po e theksoj përsëri se bashkimi, i bazuar në vullnetin e popullit, është një shembull, që, nga njëra anë, siguron fitoren dhe, nga ana tjetër, inkurajon popujt e tjerë në luftën çlirimtare kundër armiqve. Prandaj imperialistët dhe revizionistët luftojnë për ta zhdukur këtë bashkim.

Të jeni të sigurt se populli shqiptar, me atë që ka pasur mundësi dhe me zemër të pastër, e ka ndihmuar popullin tuaj në mënyrë që ai ta fitojë sa më shpejt luftën.

Shikojmë me kënaqësi se populli heroik vëlla kamboxhian ka korrur dhe po korr fitore të mëdha në luftën kundër fuqisë më të madhe ekonomike dhe ushtarake imperialiste në botë, Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Me trimërinë e tij, me luftën e tij për fitore, ai i ka treguar gjithë botës, në radhë të parë imperialistëve amerikanë, se është e pamundur të nënshtrohet një popull që lufton, se herët a vonë ai do t'u shkaktojë pushtuesve, sado të fuqishëm qofshin, disfatë të plotë e të turpshme. Të gjithë e shohin se imperialistët amerikanë dhe shërbëtorët e tyre në Pnom-Pen, në fakt, janë imposhtur nga rezistenca dhe lufta e popullit kmer dhe presin disfatën skandaloze të këtyre armiqve të Kamboxhias. Sukseset që ka arritur në luftë populli kamboxhian na inkurajojnë dhe na japin forca të reja edhe neve që kemi kaluar në këtë rrugë, nëpër të cilën po kaloni edhe ju.

Nga sukseset tuaja merr më shumë fuqi, vrull e kurajë edhe populli ynë për të përmbushur detyrat e mëdha e të shumta të caktuara në bazë të vijës së drejtë

të Partisë së Punës të Shqipërisë dhe të situatave aktuale të krijuara sot në botë si rezultat i politikës komplotuese e intervencioniste të imperialistëve amerikanë e të revizionistëve sovjetikë, që është drejtuar kundër pavarësisë dhe sovranitetit të popujve.

Ne jemi të bindur se lufta juaj çlirimtare do të përfundojë me fitoren e popullit kamboxhian mbi armiqtë e tij, por njëkohësisht jemi të ndërgjegjshëm se, pas fitores në luftë, populli juaj do të ndeshet me vështirësi për ndërtimin e vendit, me vështirësitë e shkaktuara nga lufta, prandaj populli shqiptar do të jetë me të e do ta ndihmojë në kapërcimin e tyre. Ne bëjmë dhe do të bëjmë gjithçka për kauzën e popujve. Në këtë kuadër, edhe shtypi e radioja jonë do të flasin për luftën e popullit kamboxhian, sepse çështjen e tij ne gjithmonë e kemi quajtur si çështje edhe të popullit shqiptar. Diplomtatët tanë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe gjetkë kanë luftuar dhe kurdoherë do të luftojnë për të drejtat e popullit tuaj.

Përfaqësuesit diplomatikë të shumë shteteve kanë simpati për Republikën Popullore të Shqipërisë. Nëpërmjet diplomatëve tanë, ne përpiqemi t'i njohim përfaqësuesit e këtyre shteteve me mendimet dhe pikëpamjet tona. Popujt e botës e dinë që Shqipëria, megjithëse vend i vogël, nuk ka frikë nga armiqtë. Ajo ndjek një politikë të drejtë, joambicioze. Duke e admiruar për kurajën, ata duan të dëgjojnë zërin e saj për të mësuar çfarë thotë ajo lidhur me problemet që shqetësojnë botën. Prandaj edhe kur përkrahim e mbrojmë Kamboxhian, popujt dhe qeveri të ndryshme nuk mund të mos dëgjojnë e të interesohen se ç'thotë Shqipëria.

Ne shqiptarët, siç e shikoni, preferojmë të japim dhe të shpallim hapur mendimin tonë për problemet ndërkombëtare dhe nuk futemi në intrigat e fuqive imperialiste, të imperialistëve amerikanë e të socialimperialistëve sovjetikë. Na pyesin se për ç'arsye nuk marrim pjesë edhe ne në konferenca ndërkombëtare, që organizojnë imperialistët, për të thënë atje fjalën tonë. Ne përgjigjemi se vendi ynë do ta thotë më mirë fjalën e vet duke qëndruar jashtë këtyre konferencave, të cilat nuk janë gjë tjetër veçse fole grerëzash, ku vihen në veprim intrigat e kurdisura nga amerikanët dhe nga sovjetikët.

Për sa i përket Rumanisë, mund të themi se ajo bën shumë zhurmë në arenën ndërkombëtare për ato që thotë, duke i paraqitur sikur të ishin mendimet e veta origjinale. Në qoftë se do të jetë «pllakë gramafoni», ajo mund të vazhdojë të mbajë këtë qëndrim. Edhe propozimi që ju bëri Çausheku për t'ju ndihmuar që t'ju njihnin sovjetikët, tregon se ai është thjesht një transmetues. Ai vajti i bëri vizitë papës së Vatikanit dhe duhet t'ju ketë folur për të.

Ne mendojmë që ju bëni shumë mirë kur nuk merrni pjesë në mbledhjet e kurdisura nga fuqitë e mëdha, të cilat kanë për qëllim të mashtrojnë opinionin publik botëror dhe të shuajnë vigjilencën e popujve që nuk janë dakord dhe kundërshtojnë planet e tyre të ndyra. U thoni atyre që ju «këshillojnë» të merrni pjesë në to, t'ju lënë të qetë. Vetëm me pushkë në dorë do të çlirohet vendi juaj, vetë populli do ta ndërtojë Kamboxhian dhe do të zhvillojë ekonominë. Pjesëmarrja në konferencat e tyre nuk sjell asgjë të mirë.

*Pasi princ Norodom Sihanuku shprehu aprovimin e tij për qëndrimin e mbajtur nga vendi ynë ndaj konferecave që organizojnë fuqitë imperialiste dhe foli për qëndrimin kamboxhian ndaj kësaj çështjeje, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Mendimin tonë për pjesëmarrjen në konferenca të tilla ua kemi shprehur, gjithashtu, edhe shokëve vietnamezë. Ne gjithmonë kemi aprovuar luftën e tyre të drejtë dhe i kemi ndihmuar e do t'i ndihmojmë edhe në të ardhmen për rindërtimin e vendit. Në këto momente, u kemi thënë vietnamezëve, imperialistët amerikanë janë futur në vështirësi të mëdha ekonomike, prandaj me vazhdimin e luftës ata do të munden me siguri.

Marrëveshja për mbarimin e luftës dhe rivendosjen e paqes në Vietnam është nënshkruar, por imperialistët amerikanë vazhdojnë të mbajnë akoma njëzet mijë ushtarë në Vietnamin e Jugut dhe të dërgojnë akoma atje armë. Populli vietnamez u ngrit në luftë që të çlirohej Jugu, të merrej në dorë pushteti dhe të ribashkohej vendi, por Thieu është përsëri atje, kurse forcat çlirimtare vazhdojnë të qëndrojnë në zonat e çliruara prej tyre më parë. Vetëm lufta do t'i sjellë fitore të plotë dhe përfundimtare popullit vietnamez.

Fitorja sigurohet kur luftës i shkohet deri në fund. Për këtë do t'ju duhet të përballoni jo vetëm mizoritë e imperialistëve amerikanë, por edhe intrigat e shumta të revizionistëve sovjetikë. Në qoftë se komunistët kamboxhianë shkojnë pas sovjetikëve, sipas mendimit tonë nuk do të ketë sovranitet dhe pavarësi të vërtetë për Kamboxhian. Ata që sot janë në udhë-

heqje të Bashkimit Sovjetik, s'janë komunistë, por shokët e Niksonit. Prandaj, siç thatë ju, gjatë luftës, së bashku me amerikanët, ata do të përpiqen të pengojnë popullin kamboxhian të arrijë çlirimin e përgjithshëm të vendit, por edhe pas mbarimit të saj, ata do të përpiqen t'i rrëmbejnë atij fitoren. Prandaj, lidhjet me sovjetikët si tani e në të ardhmen nuk janë e nuk do të jenë në të mirën e vendit tuaj. Edhe në qoftë se do t'ju njohin si qeveri dhe ju pranoni të keni marrëdhënie diplomatike me ta, prapë duhet bërë kujdes.

Shqipëria nuk i ka lejuar asnjëherë fuqitë e mëdha të ndërhyjnë në punët e saj të brendshme dhe tani ajo jeton shumë-shumë mirë, e qetë dhe po lulëzon. Ne shqiptarët jetojmë të qetë edhe se nuk kemi marrëdhënie me revizionistët sovjetikë, të cilët janë shumë të rrezikshëm dhe të ngjiten si sëmundja e murtajës. Brezhnjevi disa herë ka kërkuar të vendosë marrëdhënie diplomatike me ne, por ne kemi mbyllur veshët ndaj thirrjeve të tij. Për këtë qëllim u drejtohen edhe ambasadorëve tanë jashtë shtetit, por më kot. Republika Popullore e Shqipërisë nuk ka dhe nuk lidh marrëdhënie me ta, sepse ata janë tradhtarë, janë armiq. Ky qëndrim i drejtë dhe pa asnjë lëshim i vendit tonë u djeg shumë sovjetikëve.

Kurrë nuk duhet t'u zihet besë revizionistëve sovjetikë. Në qoftë se e shikojmë situatën objektivisht, ashtu si është, mund të themi se askush nuk ka besim te Bashkimi i sotëm Sovjetik.

Le të marrim, për shembull, marrëdhëniet midis vendeve revizioniste që bëjnë pjesë në Traktatin e Varshavës. Udhëheqësit polakë, hungarezë, gjermanë, çekë

nuk janë më të mirë nga sovjetikët për sa u përket pikëpamjeve të tyre ideologjike, por e vërteta është se as ata, megjithëse janë të lidhur në Traktatin e Varshavës, nuk kanë besim te Bashkimi Sovjetik. Udhëheqësit bullgarë janë plotësisht të nënshtruar ndaj revizionistëve sovjetikë.

Bashkimi Sovjetik është shndërruar nga një vend socialist që ishte më parë, në një vend revizionist, imperialist, sepse udhëheqësit e tij e kanë tradhtuar çështjen e socializmit, por popujt sovjetikë kanë mbetur ashtu siç ishin, popuj të mirë. Ne e shikojmë qartë ndryshimin midis qëndrimit të popujve sovjetikë ndaj udhëheqjes në të kaluarën, në kohën e Leninit e të Stalinit dhe qëndrimit që ata mbajnë ndaj udhëheqësve që sot janë në fuqi. Dikur ata ushqenin dashuri të zjarrtë ndaj udhëheqësve, kurse sot qëndrimi i këtyre popujve ndaj atyre që kanë pushtetin është i ftohtë; ata i urrejnë sundimtarët e sotëm revizionistë.

Udhëheqësit sovjetikë mbajnë qëndrim armiqësor dhe të pabesë ndaj nesh, ndaj jush, ndaj Vietnamit e ndaj vendeve të tjera. Qëndrimet që kanë mbajtur dhe veprimet që kanë kryer ata në Evropë, në vendet arabe e gjetkë, janë shumë të rrezikshme. Ata duan të vendosin hegjemoninë e tyre në Evropë.

Edhe imperialistët amerikanë, përveç sovjetikëve, me ndërhyrjet e tyre në punët e të tjerëve, paraqesin një kërcënim serioz për Evropën, sepse duan të vendosin mbi të hegjemoninë e tyre. Këtë rrezik e shikojnë në Francë, në Angli dhe në shumë vende të tjera, popujt e të cilave do të pësojnë nga hegjemonia e Shteteve të Bashkuara dhe e Bashkimit Sovjetik. Prandaj,

Franca (megjithëse në sipërfaqe duket sikur marrëdhëniet e saj me SHBA janë të qeta, ngaqë udhëheqësit e këtyre dy shteteve takohen herë pas here me njëri-tjetrin), në të vërtetë ka grindje e mosmarrëveshje me amerikanët, sepse ajo nuk mund të pranojë nënshkrimin ndaj tyre.

Titoja, ashtu sikurse ka vepruar kurdoherë, edhe tani mban qëndrim të rrezikshëm. Ai hiqet si asnjans, por «asnjanësia» e tij nuk i pengon sovjetikët të sjellin anije në Jugosllavi për vizita «paqësore», «për t'i riparuar» dhe «për të ndihmuar Egjiptin», të cilit i thonë: «Merri armët, por mos qëllo me to!». Pavarësisht nga pretekstet e vajtjes së anijeve sovjetike në portet e Jugosllavisë, qëllimi i revizionistëve sovjetikë është të zënë porte në detin Adriatik për ta shtrirë hegjemoninë e tyre në Ballkan dhe në Mesdhe. Natyrisht, kjo politikë e sovjetikëve ndaj Jugosllavisë i shqetëson imperialistët amerikanë, të cilët duan të ruajnë ndikimin e vet mbi këtë vend.

Kundër armiqve duhet luftuar me armë dhe me propagandë. Nuk mund të mbahen marrëdhënie të një-llojta, si me miqtë edhe me armiqtë, përkundrazi, dallimi midis tyre duhet bërë mirë. Ne gjithmonë kemi qenë dhe do të jemi me popullin e Kamboxhias, me të gjithë popujt. Lufta kundër armiqve të përbashkët na ka lidhur me njëri-tjetrin, e ka forcuar miqësinë tonë, e cila është dhe duhet të jetë gjithmonë e pastër dhe e singertë.

*Po këtë ditë shoku Enver Hoxha bëri edhe një bisedë tjetër me Norodom Sihanukun, me rastin e një pritjeje të organizuar në Pallatin e Brigadave nga Presidiumi i Kuvendit Popullor dhe Këshilli i Ministrave i RPSH,*



*për nder të ardhjes së tij në vendin tonë, ku, ndër të tjera, tha:*

Shqipëria ka pasur në historinë e saj një princ të madh, i cili ishte gjithmonë me popullin, luftoi për popullin, prandaj ka qenë dhe vazhdon të jetë i dashur për popullin. Ky ishte Gjergj Kastrioti. Sulltani, duke parë tek ai cilësitë e një komandanti trim e të zgjuar, ashtu siç ishte dikur Aleksandri i Madh i Maqedonisë, e quajti Skënderbeg. Kur erdhi në Shqipëri, pas braktisjes së oborrit të sulltanit, Skënderbeu mbledhi gjithë popullin dhe kalorësit e vet në Krujë dhe, midis të tjerash, u tha: «Lirinë nuk jua solla unë, por e gjeta këtu në mes tuaj». Me luftën e tij ai jo vetëm mbrojti truallin e atdheut të vet, por shpëtoi edhe Evropën nga pushtimi osman. Megjithatë, ata që përfituan nga luftërat e shqiptarëve të udhëhequr nga Skënderbeu, si mbreti i Napolit e papa i Vatikanit, nuk e ndihmuan, por e lanë vetëm. Edhe pse i vetëm, ai luftoi gjer në fund, prandaj ka mbetur i madh në histori. Gjatë Luftës partizane Nacionalçlirimtare ne i flisnim popullit edhe për Skënderbeun, për historinë e luftërave të tij në krye të shqiptarëve dhe populli frymëzohej, e mbante fort në zemër si diçka të shtrenjtë figurën e tij të madhe. Udhëheqësit, qofshin ata edhe princër e mbretër, mbeten në zemrën e popullit kur lidhen ngushtë me popullin e tyre dhe shkrijnë jetën për interesat e tij.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore fuqitë e mëdha imperialiste bënë gjithçka për të shpartalluar Luftën tonë Nacionalçlirimtare, për ta shtypur e për ta skllavëruar popullin shqiptar, po nuk ia dolën dot, sepse populli e Partia u lidhën ngushtë. Uniteti midis udhëheqjes

dhe popullit, lidhjet e ngushta në mes tyre janë vendimtare për fitoren. Kjo është më se e qartë.

*Pastaj, princi Norodom Sihanuk e prezantoi shokun Enver Hoxha me aviatorin, anëtar i delegacionit kamboxhian, i cili kishte bombarduar pallatin ku banonte Lon Noli, dhe foli për vendosmërinë e popullit kamboxhian për të vazhduar luftën deri në fitore. Pasi përgëzoi aviatorin për aktin e tij heroik dhe shprehu besimin në fitoren e popullit të Kamboxhias, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Ardhja juaj në Shqipëri tregon edhe një herë se nuk jemi të izoluar, siç thonë disa. Ne kemi marrëdhënie dhe jemi miq me popujt dhe vendet që luftojnë dhe jo me klikat tradhtarë. Kur lidhim marrëdhënie diplomatike me vende të ndryshme, njerëzit e thjeshtë të këtyre vendeve na thonë se janë ata që i duan Shqipërinë dhe marrëdhëniet me të.

Të vini kur të doni dhe të qëndroni sa të doni në Shqipëri. Shkoni ku të dëshironi për të pushuar, në Durrës, në Pogradec ose në Vlorë. Shpresojmë se vitin e ardhshëm Kamboxhia do të jetë çliruar. Ne do t'ju ndihmojmë dhe do ta mbështetim gjithmonë luftën e popullit kamboxhian.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## ÇËSHTJA E DREJTË MBROHET DUKE VEPRUAR ME GUXIM DHE HAPUR KUNDËR ARMIQVE

*Nga biseda me Norodom Sihanukun*

8 qershor 1973

*Pasi u shkëmbyen përshëndetjet, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Lufta e popullit kamboxhian për çështjen e tij të drejtë nuk ka vetëm rëndësi për Kamboxhian, por ka influencë edhe jashtë saj. Ajo tregon se edhe një popull i vogël, kur lufton për çështjen e tij të drejtë, për lirinë, për interesat e tij, nuk trembet, nuk ka frikë nga asgjë. Sot edhe shumë nga ata që nuk janë me ju, janë të detyruar të njohin luftën dhe kauzën tuaj të drejtë.

Siç e dini, unë jam komunist, pra udhëhiqem nga doktrina marksiste-leniniste, që na mëson të mbështetemi kurdoherë te populli. Nga lidhjet që mbajnë me popullin varet edhe vlerësimi ynë për udhëheqësit e ndryshëm. Marksi thotë se duhen mbështetur ata udhëheqës të luftës, të cilët, megjithëse nuk janë përfaqësues të klasës punëtore, luftojnë me gjithë shpirt për këtë klasë, për interesat e popullit. Edhe ju e keni treguar se jeni me popullin. Kjo dukej edhe në filmin për vizitën tuaj nëpër Kamboxhia, që na dhuruat.

Do të jetë vetë populli ai që do ta çlirojë Kamboxhian. Bashkimi në male, në zjarrin e luftës, përbën forcën e tij, prandaj bashkëpunimi me forcat e rezistencës së brendshme është i nevojshëm, vendimtar, sepse qëllimet e luftës arrihen së bashku, në harmoni të plotë, në rrugën e drejtë të popullit.

Është kënaqësi e madhe të jesh me popullin, të punosh për të dhe me të, të ndiesh zemrën e popullit që lufton. Kurse borgjezia reaksionare është kundër popullit, ajo është gati të veprojë si Lon Noli, të të futë thikën sa kthen kurrizin. Ne, komunistët e revolucionarët dhe klasa punëtore, që luftojmë kundër imperializmit dhe armiqve të tjerë, e mbështetim luftën e popullit kamboxhian kundër imperialistëve amerikanë dhe tradhtarëve të vendit. Ne konstatojmë se edhe në çështjen e luftës kundër revizionistëve sovjetikë, qëndrimi që mbani ju është i drejtë. Ne jemi plotësisht dakord me këtë qëndrim.

Marrëdhëniet tona me Bashkimin Sovjetik në kohën e Stalinit ishin krejt ndryshe nga ç'janë sot. Pas Çlirimit ne iu drejtuan sovjetikëve për armë. Në një nga takimet që kam pasur me Stalinin, ai më tha se armatimet do të na jepeshin falas, sepse armët që u jepen shoqëve, nuk paguhen me pare.

Pas vdekjes së Stalinit ne kemi pasur eksperiencë të hidhur me revizionistët sovjetikë, që mendonin se na kishin satelitët e tyre të vegjël. Me qëndrimet tona ne u përpoqëm që ata të kuptonin se ne nuk ishim e nuk do të bëheshim vegla të tyre, derisa këtë ua bëmë të qartë hapur. Për të na nënshtruar, revizionistët sovjetikë u munduan në fillim të na merrnin me të mirë, duke na

premtuar se do të na jepnin traktorë etj. Kur lajkat dhe premtimet gjoja për ndihma nuk u shkuan, filluan të na kërcënonin. Por edhe kur na kërcënuan, ne u treguam vendin. Ata nuk guxuan të na sulmonin, përndryshe Shqipëria do të ishte bërë një Vietnam ose një Kamboxhia tjetër në Evropë dhe, ashtu si po e pësojnë amerikanët te ju, ashtu do ta pësonin edhe te ne revizionistët sovjetikë. Shqipëria do të bëhej varri i tyre. Çështja e drejtë mbrohet duke vepruar me guxim dhe hapur, duke luftuar heroikisht kundër armiqve.

Siç thatë vetë, qëndrim të ngjashëm kanë mbajtur revizionistët sovjetikë edhe ndaj jush. Kur të fitoni, sovjetikët do të përpiqen të vendosin marrëdhënie me ju. Do të bëjnë sikur do të gëzohen, do t'ju buzëqeshin, dhe s'do të harrojnë t'ju thonë: Ne ju ndihmuam.

Ne shikojmë se në rrugën tonë të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit nuk jemi vetëm. Në të ardhmen do të bëhemi më shumë, sepse radhët tona do të vazhdojnë të rriten. Njerëzit po e shohin e po e kuptojnë gjithnjë e më qartë politikën reaksionare të amerikanëve e të sovjetikëve. Ata e shohin që kjo politikë s'ka asgjë të përbashkët me politikën që ndjekim ne, prandaj medoemos do të vijnë në rrugën tonë. Në luftën kundër armiqve duhet të jemi gjithmonë të bashkuar dhe, siç thotë populli, edhe kafshatën e vetme duhet ta ndajmë me miqtë, pasi kështu do të afrohemi më tej e do të bëhemi akoma më të afërt me njerëzit.

Ju do të vizitoni edhe Jugosllavinë. Popujt e Jugosllavisë kanë luftuar vazhdimisht gjatë gjithë kohëve, ata janë popuj heroikë dhe inteligjentë, mirëpo politika

që ndjek Titoja ka qenë dhe është shkatërruese për Jugosllavinë në çdo drejtim.

Ju uroj udhëtim të mbarë dhe mirë se të vini në Shqipëri!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

**TE JU PARTIA SHEH JO VETËM NDËRTUESIN,  
POR EDHE NJERIUN ME NDËRGJEGJE  
TË LARTË SOCIALISTE**

*Nga biseda me punonjës e specialistë  
në Hidrocentralin e Vaut të Dejës*

**12 qershor 1973**

*Në digën e Zadejës shoku Enver Hoxha u prit nga drejtori i kantierit të ndërtimit dhe nga sekretari i komitetit të Partisë të veprës. Pasi soditën liqenin e bukur, shoku Enver Hoxha dhe personat që e shoqëronin vizituan sallën e turbinave, ku u pritën nga punonjës të hidrocentralit. Drejtori i shfrytëzimit të hidrocentralit, shoku Enver Dibra, foli për veprën dhe punën që bëhej atje.*

**SHOKU ENVER DIBRA:** Përgjithësisht kolektivi i hidrocentralit tonë është i përbërë nga punëtorë dhe kuadro që kanë punuar në vepra të tjera. Edhe këtu ne hapëm dy shkolla të mesme teknike profesionale. Inxhinierët, që ishin përpara, krahas punës që bënin, jepnin edhe mësim. Po kështu bënin edhe punëtorët, punonin dhe njëkohësisht merrnin mësim. Kolektivi ynë ngjan si një ekip anijeje që është gjithmonë në gatishmëri.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Sa veta mendoni të qëndrojnë tani këtu?

*SHOKU ENVER DIBRA:* Do të qëndrojnë 4 inxhinierë të turneve dhe 3 të tjerë që do të punojnë normalisht.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Domethënë do të qëndrojnë 7 veta. Kur isha para disa vjetësh në Hidrocentralin e Bisticës, në kohën kur ai po përfundonte, na u duk se atje ishin mjaft inxhinierë, por tani thonë se nuk duhet të jenë aq, kërkohet të shkurtohet ca numri i tyre.

*SHOKU ENVER DIBRA:* Gjersa të përfundojë hidrocentrali i Fierzës, edhe këtu te ne do të lehtësohet puna. Kështu që nuk ka arsye përse të qëndrojnë gjithë këta kuadro të lartë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ndërtimi i këtij hidrocentrali i detyrohet punës së punëtorëve dhe inxhinierëve që kanë punuar dhe punojnë këtu me vetëmohim, me heroizëm, me shpirt të lartë sakrifice. Natyrisht, kur ndërtohen vepra të tilla të mëdha për kushtet e vendit tonë, kërkohen edhe përpjekje të mëdha. Dhe në fakt të gjitha këto përpjekje ju i keni bërë, duke treguar kështu besimin që keni te Partia dhe te populli, si dhe duke justifikuar besimin që edhe këta kanë te ju. Të tilla vepra të mëdha si ky hidrocentral që kanë shumë vështirësi e gjithfarë pengesash, ju i ndërtoni me një qëndrim shembullor. Në këto vepra të periudhës së ndërtimit të socializmit në Shqipëri fitohet një eksperiencë e madhe që ka ndihmuar të përgatiten forca të konsiderueshme, në të cilat Partia mund të bazohet për ndërtimin e objekteve të reja në të ardhmen, sado të vështira e të ndërlikuara të jenë ato.



Ju, shokë, që morët pjesë në ndërtimin e kësaj vepre, natyrisht, jeni specializuar për ndërtimin e hidrocentraleve, por jeni në gjendje të punoni edhe në sektorë të tjerë. Partia dhe Qeveria kanë nevojë për njerëz të tjerë të rinj të specializuar që industria jonë e re, minierat që po hapim, gjithë degët e tjera të ekonomisë, vazhdimisht e më shumë, të prodhojnë për popullin. Ato edhe aktualisht janë të zhvilluara, por në të ardhmen do t'u hapen perspektiva më të mëdha, sepse ekonomia jonë do të zhvillohet akoma më shumë. Ju jeni ata që do të vini në lëvizje makineritë e panumërta në hidrocentralet e reja që do t'i shtohen vendit tonë. Të tjerë kuadro e specialistë do të na duhen për to në të ardhmen dhe ata duhet e do t'i përgatitni ju.

Ju jeni njerëz me eksperiencë, me kalitje të shëndoshë morale dhe me dituri të thella. Kini parasysh të ardhmen e atdheut, që do të jetë më e begatshme, por që do të kërkojë akoma më shumë njerëz, më të kualifikuar e më të zotë, prandaj tok me veprat, ju duhet të edukoheni edhe për vete, ashtu siç keni bërë gjer më sot. Njëkohësisht, të punoni me durim të madh që të përgatitni, siç thashë, të rinjtë që do t'ju zëvendësojnë.

Ju keni parë çfarë interesimi të madh kanë treguar dhe tregojnë Partia e Qeveria për edukimin e kuadrit. Siç e thatë vetë, që në fillim, kur u ndërtuan barakat e para, u mendua edhe për shkollën, dhe për kurset që do të hapeshin këtu. Djemtë dhe vajzat që kryen shkollën e kurset tashmë kanë shkuar në Fierzë. Por për ndërtimin e veprave më të mëdha e më moderne në të ardhmen ne duhet të përgatitim më shumë kuadro për t'i çuar edhe më përpara forcat prodhuese, që, nga ana

e tyre, do ta zhvillojnë akoma më shumë ekonominë e vendit tonë. Kjo është një detyrë e dorës së parë për ne.

Ne socializmin po e ndërtojmë me luftë e përpjekje, sepse vetëm kështu arrihet në komunizëm. Në fund të fundit fitorja do të jetë jona, pavarësisht se do të kemi edhe vështirësi, pengesa e të meta. Ju e lexuat fjalën e 15 marsit që mbajta unë në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë sonë. Si ushtarë të marksizëm-leninizmit, të revolucionit, të socializmit që jemi, në këtë material ne kritikojmë të metat, sepse dihet, kush punon, mund të bëjë edhe gabime.

Prandaj, rëndësi të madhe ka kalitja e njeriut me ndërgjegje të pastër dhe me frymë revolucionare, sepse vetëm kështu arrihen sukseset, përvetësohet dituria. Kur humbet perspektivën, kur gjërat e vogla mikroborgjeze mbulojnë mendjen e njerëzve, ndërgjegjja errësohet, prandaj Partia kujdeset që njerëzve tanë të mos u prishtet ndërgjegjja nga mbeturinat mikroborgjeze, por t'u kalitet në kudhrën e punës, që ata të jenë të çeliktë, të kuptojnë se puna është nder e lavdi, se në punë formohet njeriu ynë i ri. Të ju Partia shikon jo vetëm ndërtuesin, por edhe njeriun me ndërgjegje të lartë socialiste. Prandaj, në emrin tim dhe të shokëve të tjerë, ju uroj akoma më shumë suksese për të ngritur më lart lavdinë e Partisë, lavdinë e popullit, për të rritur çdo ditë e më shumë begatinë e forcën e tij të madhe.

Ju kërkoi ndjesë që s'mund të qëndroj më gjatë, me gjithë dëshirën time të madhe. Siç e thatë ju vetë, hidrocentrali punën e ka të madhe, prandaj duam të mos

Ju pengojmë, fjalët të jenë sa më të pakta, kurse punë të bëjmë sa më shumë.

Ju përgëzoj nga zemra dhe, në emër të Partisë, të Qeverisë dhe të gjithë popullit tonë ju uroj jetë të gjatë e shëndet që t'i shërbeni vazhdimisht dhe kurdoherë atdheut dhe Partisë. Ata ju janë mirënjohës për veprat e mëdha e të pavdekshme që keni ndërtuar e do të ndërtoni.

Të rrojë Partia!

*Pastaj udhëheqësi i dashur doli në fotografi me punonjësit e hidrocentralit dhe, duke u ndarë, midis brohoritjeve për Partinë e Punës dhe për shokun Enver Hoxha, ai u përçoll ngrohtësisht nga të gjithë, pasi u përçafua dhe i dha dorën secilit.*

*Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## ËR SHËNDETIN DHE LUMTURINË E POPULLIT TË MBISHKODRËS

*Fjala në mitingun në Koplkun e Sipërm<sup>1</sup>*

13 qershor 1973

Në ditë feste dhe gëzimi, populli ynë i shpreh ndjenjat e tij duke ngritur dolli me një gotë raki, kurse sot, këtu te ju, në këtë ditë kaq të gëzuar, nderi i takon ujit, prandaj edhe unë jam shumë i lumtur ta pi këtë gotë ujë për shëndetin, për lumturinë dhe për përparimin e popullit të krahinës së Mbishkodrës.

Uji është një pasuri e madhe, një element i domosdoshëm për jetën, për njerëzit, për tokën, për bagëtinë, për bimët. Atje ku ai mungon, njerëzit vuajnë, ndërsa toka thahet e bëhet zhur. Përkundrazi atje ku ka ujë, njerëzit janë plot shëndet, lulëzon jeta, zbukurohet toka, zhvillohen më së miri e plot gjallëri bimët, rriten bagëtitë, shtohet begatia e popullit.

Banorët e krahinës suaj kanë luftuar tërë jetën e tyre për këtë tokë; ata kanë luftuar këtu për një jetë

---

1. Ky miting u organizua me rastin e përrimit të fazës së parë të ujësjellësit të ri të zonës së Mbishkodrës.

më të mirë dhe për këtë kanë derdhur gjak. Përveç shumë të tjerave, në të kaluarën, këtu ka pasë munguar edhe uji, po edhe buka ka qenë e paktë. Mirëpo erdhi dita e madhe, kur nga gjiri i popullit tonë heroik u krijua Partia Komuniste e Shqipërisë. Nën udhëheqjen e drejtë të saj populli fitoi çdo gjë, lirinë dhe pavarësinë e aldit, për të cilat derdhi aq shumë gjak, përmbysi pushtetin e vjetër, ngriti pushtetin e vet dhe nisi të ndërtojë një jetë me të vërtetë të re, pa të huaj dhe tradhtarë, pa shtypës e shfrytëzues që e kishin skllavëruar tërë kohën. Këto të mira, tani s'ia merr dot kush, por edhe sikur të orvatet dikush të prekë Republikën tonë Popullore, ai do të gjejë vdekjen. Ne nuk duam të flasim për vdekjen, se jemi luftëtarë të jetës, të lumturisë së popullit, por vuajtjet e mjerimet që kemi hequr na kanë bërë të mos i harrojmë asnjëherë të këqijat që kanë luajtur mbi kurrizin tonë armiqte e popullit.

Ne, që kemi ardhur sot këtu, të dashurit e mi, ndiejmë një gëzim të jashtëzakonshëm për këtë dhuratë të çmuar që ju solli Partia, ujin e pijshëm të bjeshkëve të bukura të kësaj ane. Edhe unë kam t'ju them diçka për ujin, motra dhe vëllezër, pse vuajtjet për një pikë ujë nuk i keni ndier vetëm ju, ato i kanë ndier populli i shumë qyteteve e fshatrave të vendit tonë. Unë kam lindur e jam rritur në një qytet që ka vuajtur tërë jetën për një pikë ujë. Në qytetin tim dikur një pikë ujë ishte flori. Kur do të fejojeshin vajzat në atë kohë, pyetja e parë që bënin prindërit, ishte: «A ka muslluk shtëpia e burrit?» Në qoftë se ajo ishte me muslluk ose me sterë, atëherë e jepnin më lehtë vajzën për nuse. Me këtë dua të tregoj se uji atëherë ishte shumë i çmuar, ishte i

shtrenjtë si edhe buka, sepse vajzës që do të vinte nuse në një shtëpi pa sterë, do t'i duhej të robtohej duke mbartur ujë nga larg.

Në Gjirokastër, në ato kohë të vështira, populli i vuajtur e fukara i qytetit, duke hequr kafshatën nga goja e kalamanëve, arriti të mbledhë disa qindra napolona për të sjellë ujë nga Sopot, një vend sipër në mal, mbi qytet. Mirëpo a e dini ç'u bënë këto para? Krerët e qytetit ia blenë peshqeshe satrapit Ahmet Zogu. Kështu, populli i shumëvuajtur mbeti prapë në vuajtje dhe pa ujë. Të tilla vuajtje e mjerime i keni hequr edhe ju, pse i tillë ishte regjimi i Ahmet Zogut, që e shtypi dhe më në fund e shiti vendin tonë tek imperializmi fashist italian.

Por ato kohë kaluan një herë e përgjithmonë. Tani pushteti është i popullit. Këtë pushtet populli ynë e ngriti me gjak e me sakrifica, me Luftën Nacionalçlirimtare që bëri nën udhëheqjen e ndritur të Partisë. Tashmë ju, shoqe të kësaj zone, nuk do të vuani më si më parë, duke shkuar me orë të tëra larg shtëpive ngarkuar me gjyma, buccela apo me vedra për të mbushur ujë. Jo! Ujin, këtej e tutje, ju do ta keni në prag të shtëpive tuaja.

Mungesa e ujit rëndonte më shumë sidomos në kurriz të grave, pse duke u quajtur turp bartja e ujit nga burrat, gratë ishin të detyruara ta sillnin atë në krahë nga larg për të gjithë pjesëtarët e familjes. Tani Partia ua hoqi këtë barrë të rëndë, por s'duhet harruar se në punët e shtëpisë ka edhe shumë barrë të tjera të rënda që akoma bien kryesisht mbi kurrizin e grave. Prandaj, Partia na ka mësuar, ne burrat, t'i ndihmoj-

më gratë dhe të mos e kemi aspak për turp t'i marrim vetë përsipër punët e rënda, jo se gruaja nuk dëshiron të punojë, përkundrazi, ajo punon dhe punon si heroinë, jashtë dhe brenda shtëpisë, por çështja është që ne burrat të luftojmë vazhdimisht në ndërgjegjen tonë konceptet dhe pikëpamjet e vjetra që kemi trashëguar. Në qoftë se të gjithë burrat e vendit tonë e kuptojnë drejt dhe sa më shpejt këtë çështje, në qoftë se ata e kuptojnë drejt se gruaja duhet konsideruar e barabartë, dhe për këtë t'i jepen të gjitha ndihmat dhe përkrahja e nevojshme, atëherë lulëzimi i Shqipërisë socialiste do të ecë me vrull të jashtëzakonshëm.

Komiteti i Partisë i rrethit tuaj, Komiteti Qendror dhe Qeveria bënë shumë mirë që çështjen e dhënies së ujit gjithë zonës së Mbishkodrës e lidhën me Kongresin e 7-të historik të Bashkimit të Grave të Shqipërisë. Ky është një kongres me të vërtetë i mrekullueshëm, që ka ngritur peshë zemrat heroike, mendjet e kthjellëta, guximin dhe pjekurinë e grave shqiptare, të cilat, krahas burrave, vëllezërve e bijve të tyre po mësojnë, po realizojnë dhe po ndërtojnë Shqipërinë socialiste me një zotësi të madhe. Kjo nuk na çudit aspak ne komunistët, sepse ne kemi pasur që në fillim një besim të patundur tek aftësitë krijuese të gruas shqiptare, te guximi i saj i pathyeshëm.

Komiteti Qendror i Partisë u rekomandoi shoqeve të organizatës së gruas të vijnë këtu, në Shkodër, për të zhvilluar punimet e Kongresit të tyre të 7-të, për arsye se ky qytet është një nga qendrat më në zë të patriotizmit dhe të kulturës së vendit tonë, që ka nxjerrë nga gjiri i vet njerëz të shquar, të cilët kanë luftuar

me penë e me mendje, me pushkë e me djersë për atdheun, që nga kohët e lashta dhe deri në ditët e sotme. Komiteti Qendror i Partisë sugjeroi të zhvilloheshin këtu punimet e këtij kongresi, pranë motrave shkodrane, se këto, si gjithë gratë e vendit tonë, janë luftëtare të paepura, janë në pararojë të luftës së madhe që ka udhëhequr dhe po udhëheq Partia për ndërtimin e socializmit. Dhe në të vërtetë, si kurdoherë, jo vetëm gjatë këtyre katër ditëve, që po mbahet kongresi, por qysh një dhe dy muaj më përpara është bërë një ndryshim i madh në rrethin e Shkodrës, si në qytet, ashtu edhe në kooperativat bujqësore e deri në malësitë më të largëta. Janë shumëfishuar forca dhe besimi te njerëzit, janë shumëfishuar gëzimi dhe lumturia në çdo familje, është forcuar më tej uniteti në mes burrit dhe gruas, në mes prindërve e fëmijëve. Kështu, si në çdo qytet e fshat të vendit tonë, edhe në qytetin e fshatrat e Shkodrës, brenda në çdo shtëpi, qeshin zemrat e njerëzve, se të gjithë e shohin që e tashmja është e bukur dhe e ardhmja e tyre do të jetë edhe më e lumtur. Këtë forcë, këtë besim dhe unitet te ne e solli Partia jonë e Punës.

Unë kam ardhur edhe herë të tjera në Shkodër me shokë të udhëheqjes dhe dëshiroj t'ju them se kësaj radhe të tërëve na ka bërë shumë përshtypje fakti që fushat që keni punuar e mbjellë, duken shumë të bukura, sikur t'i kishit qëndisur me dorë. Ja ç'bën, motra dhe vëllezër, besimi dhe dashuria e madhe që keni për Partinë. Ju e ndieni plotësisht se çdo gjë që bëni, çdo hap që hidhni, çdo fjalë që thoni, i shërben interesit tuaj, interesit të popullit, interesit të përgjithshëm, fu-



qizimit të atdheut tonë socialist, përmirësimit të jetës së mbarë popullit shqiptar.

A mund të ketë vallë lumturi më të madhe se kjo? A mund të ketë kënaqësi më të madhe për Partinë, sesa kur sheh që në vendin tonë spikatin ndjenjat e pastra, kënaqësia dhe aprovimi i plotë ndaj vijës së drejtë të saj, saqë akoma pa hapur gojën, vetëm me një vështrim, duket qartë që të gjithë i thonë Partisë: «Prina përpara, drejt perspektivave të reja, se të gjithë jemi në këmbë, që të realizojmë e do të realizojmë vepra të mëdha!». Gjithë këto vepra të mëdha që po ndërtohen në vendin tonë, i realizoni ju, motra dhe vëllezër, të udhëhequr nga Partia, i realizon populli, pikërisht ky popull, mbi 80 për qind e të cilit para Çlirimit nuk dinte të shkruante e të lexonte e që tani ndërton çdo gjë me duart dhe me mendjen e tij dhe është gati e i aftë të zbatojë çdo projekt, deri më të ndërlikuarit. Njerëzit tanë, gratë dhe vajzat, në radhë të parë, dinë të përdorin sot vegla dhe mjete të çfarëdo lloji dhe nga më modernet. Për këto arsye të gjithë ndiejmë kënaqësi të jashtëzakonshme kur shikojmë gratë dhe vajzat të punojnë në torno, në fabrika, në shkolla, në ushtri etj. Ato janë trime, të zgjuara, punëtore, të thjeshta, të pastra e të ndershme, ashtu siç i ka mësuar të jenë kurdoherë Partia. Prandaj, motra dhe vëllezër, ta dëgjojmë me vëmendje Partinë tonë, t'i ndjekim me besim të madh mësimet e saj, të cilat nuk janë veçse dëshirat tuaja. Çdo gjë që vendos Partia dhe Komiteti i saj Qendror, mos mendoni se del nga koka jonë. Jo, ato dalin më parë nga kokat tuaja, nga mendjet tuaja, ato janë fryt i urtësisë së popullit.

Forca e popullit, gjykimi i tij i shëndoshë, zemra e fortë e njerëzve tanë, e rritin fuqinë e Partisë. Parti e popull në vendin tonë janë një, ata mendojnë, punojnë e veprojnë të bashkuar si një grusht, ata sulmojnë kurdoherë përpara për ndërtimin e jetës së lumtur socialiste.

Kur të ktheheni sot në shtëpitë tuaja, para së gjithash, mbushni ujë, «dehuni» me ujë. Ardhja e ujit në zonën tuaj, siç thanë shokët Spiro Koleka<sup>1</sup> dhe Bilal Parruca<sup>2</sup>, nuk është as e para, as e fundmja fitore. Ne vazhdimisht do të korrin fitore të reja në të ardhmen. Prandaj, në emër të shokëve, ju uroj nga zemra shëndet, lumturi dhe gëzim në jetë dhe me Partinë kurdoherë në zemër. Përvishjuni me zell punëve bujqësore për të marrë rendimente sa më të larta, për të mirën tuaj dhe për të mirën e gjithë atdheut tonë socialist!

Rroftë Partia!

Rroftë populli ynë!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura, që gjenden në AQP*

---

1. Në atë kohë anëtar i Byrosë Politike dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave.

2. Në atë kohë kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit të Shkodrës.

## POPULLI YNË MERITON LUMTURI MË TË MADHE

*Nga biseda në sallën e shtëpisë së kulturës  
në Koplík*

13 qershor 1973

*Pas mbarimit të mitingut, që u bë me rastin e përrimit të ujësjellësit të ri<sup>1</sup>, shoku Enver Hoxha u drejtua për në sallën e shtëpisë së kulturës dhe u takua e bisedoi me kooperativistë.*

**SHOKU SAIT CAFI<sup>2</sup>:** Mirë se na ke ardhë, o Enver Hoxha, e të paçim me jetë! Nuk ka gëzim e lumturi ma të madhe për ne. Mirë se na ke ardhë e na ke ardhë si gjithmonë me duart plot, na solle ujin mu në shtëpitë tona.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Si jeni shokë, me shëndet? Urime, ta gëzoni ujin e kulluar të bjeshkëve tua-ja! Jemi shumë të gëzuar për këtë, se keni vuajtur gjithë jetën për ujë.

**SHOKU MUSTAFA BISHJA:** Për mikun e kemi

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 209.

2. Pensionist.

pasur sofrën plot, veç për ujë edhe mund të jemi koritë ndonjëherë.

*SHOKU COL CUFI*<sup>1</sup>: Në çdo lagje fshati kemi ndër-tuar nga një çezmë, prandaj ujë tani kanë kudo të gjithë me bollëk.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Avituni, uluni afër nesh, o burra. Dua t'ju kem të gjithë pranë.

Sa vjeç je, zotrote?

*SHOKU MUSTAFA BISHJA*: Jam 74 vjeç, pensio-nist.

*SHOKU ENVER HOXHA*: Edhe 100 të bëhesh!

*SHOKU MUSTAFA BISHJA*: Më duket se përtë-rihem edhe një herë që po takohem me ju; bahem ma i ri, o Enver Hoxha.

*SHOKU SAIT CAPI*: Me mësimet e Partisë, me fjalët e udhëheqjes së saj, s'kemi pse plakemi, përkun-drazi bahemi të rinj. Tash që na erdhi uji, jemi shumë të lumtur, se pa ujë as buka nuk bahet dhe as nuk ha-het. Më parë shkonim një herë ose dy herë në ditë për ta marrë ujin e shkrepave, kurse sot e kemi te dera e shtëpisë dhe për këtë i jemi borxhlinj Partisë. Nuk dimë si t'ia shpërblejmë Partisë, se nuk kemi bërë asgjë përpara asaj që ajo ka bërë për ne. Këtu, më parë na është djegur një familje me 7 veta brenda, pse as ujë nuk kishim për t'i shpëtuar njerëzit. Ne shkonim një orë e gjysmë e më tepër larg për të mbushur ujë dhe jo vetëm kaq, por uji shpesh ishte me shtrema. Prandaj themi se Partia, edhe me ujin, na solli jetën dhe nuk

---

1. Në atë kohë kryetar i kooperativës së bashkuar të Koplikut.

kemi si me ia shpërbly. Ne duhet të punojmë pleq e të rinj, se kemi luftuar boll me qeveritë tradhtare e asgjë s'patëm fitue. Sot luftojmë, punojmë e gëzojmë të lumtur në sajë të Partisë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Na gëzon zemra në udhëheqësve kur na flisni kështu. Na jepni kurajë të madhe, me këto fjalë, or Sait Cafi.

**SHOKU SAIT CAFI:** Zemra ime dhe e gjithë popullit sot është ndez flakë për Partinë.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Partia ka bërë shumë për popullin, por ne themi se duhet të bëjë akoma dhe akoma të shumëfishojmë forcat, t'i vëmë në shërbim të tij, ta bëjmë edhe më të lumtur e më të mirë jetën e tij, se populli ynë meriton lumturi më të madhe.

Fjalët tuaja na inkurajojnë shumë e na bëjnë të lidhemi edhe më ngushtë me popullin, se forca e Partisë qëndron në popull. Ai që ka popullin me vete, është kurdoherë i pamposhtur dhe do të përparojë gjithnjë. Prandaj është e fortë Partia jonë, sepse është e lidhur me popullin si mishi me thoin. Po cilët janë në Parti? Vajza jote, djali yt, i këtij, i atij tjetrit e me radhë dhe kështu do të jetë brez pas brezi. Brezi i ri, me Partinë në krye, luftoi që populli të marrë fuqinë dhe, pas kësaj, ç'ka dashur populli ka bërë Partia. Populli dëshiron të ndërtohet kjo ose ajo vepër, të sigurohet uji i pijshëm, të nxirren minerale të dobishme etj. Dhe këto bëhen e i kthehen popullit në të mira materiale. Kush i bën? I bëjnë djemtë dhe vajzat e popullit, që Partia i mësoi e do t'i mësojë të ecin vazhdimisht në këtë rrugë.

Të meta në punë kemi, edhe gabime bëhen nganjë-

herë. Partia mëson që kur i shikoni ato duhet t'i thoni; t'i thoni djalit: «Ku po shkon, djalë? Eja në rrugën e drejtë të popullit», se komunistët janë djemtë dhe vajzat tuaja. Kur nuk na shkon mirë puna, si prindër, si patriotë të vini e të na thoni: «Dale o Enver, mendja ime thotë se kjo është e mirë, kurse kjo tjetra jo». Dhe unë e kam për detyrë të mbledh shokët e udhëheqjes e t'u them se filan fshatar nga Kopluku më tha këto gjëra, prandaj si gjykoni ju? Dhe kur Partia i gjen të drejta, merr masa dhe i ndreq. Kështu na mëson Partia të veprojmë, kështu kemi vepruar dhe kështu do të ecim gjithmonë.

Populli tha të pastrojmë kishat e xhamitë që të mos kenë mundësi të veprojnë në dëm të tij e të atdheut priftërinjtë, hoxhallarët, shehlerët, dervishlerët dhe u bë ashtu, siç deshi populli. E çfarë na sollën ata në shekuj? Asgjë. Ujë nuk na sollën, bukë nuk na sollën, mjekë për të shëruar sëmundjet nuk sollën, pra shëndet për njerëzit nuk sollën. Ata nuk thanë asnjëherë që cucat tona të mësojnë shkrim e këndim, pale pastaj të bëhen inxhinierë, elektrikistë, mjekë, mësuesë e të tjera. Jo, ata kurrën e kurrës as e thanë, as e bënë një gjë të tillë. Kurse Partia jo vetëm i tha, por edhe i bëri realitet. Sa gjëra të mrekullueshme ka bërë ajo! Ja, tani po pimë ujë çezme nga burimet që janë aq larg prej këtejt. Shoku Sait tha që ka pirë ujë me shtrema. Edhe unë në Gjirokastër kam pirë ujë me shtrema në të kaluarën, bile vinim në grykën e shtamës një napë të bardhë, në mënyrë që ujët të kullonte, po veç napa bëhej e kuqe nga shtremat dhe nga balta.

Gjithashtu ne jemi shumë të gëzuar për sukseset

e kooperativës suaj. Kooperativistët, organizata-bazë e Partisë dhe kryesia e kooperativës, punojnë me zotësi për zbatimin e porosive të Partisë, të pushtetit dhe të rregulloreve agroteknike. Ata kanë arritur rezultate të mira, po duhet punuar akoma edhe më mirë, që ta rregulloni edhe më shumë gjendjen e të merrni të ardhura edhe më të kënaqshme.

Në duhan ju jeni specialistë të zotë dhe, siç e pamë e siç më thanë shokët drejtues të Shkodrës, edhe këtë vit jeni shumë mirë dhe parashikohet të merrni rendimente të kënaqshme. Por rëndësi ka për ju edhe për ne që të siguroni edhe bukën, se jeni brezi i parë i mbrojtjes, mbi tokat tuaja do të godasin armiqtë në rast se do të na sulmojnë. E lufta kërkon të kemi edhe bukën. Por ne nuk do t'i lëmë ata të shkelin mbi tokën tonë. Shoku sekretar i Partisë është shumë i kënaqur nga puna e shokëve kooperativistë dhe e shokëve komunistë.

*SHOKU MUHO ASLLANI:* Komunistët bëjnë një pjesë të mirë të fuqisë punëtore.

*SHOKU PROKOP MURRA:* Këtu punëtorët bëjnë mesatarisht 300 ditë-punë në vit.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Mendoj që kështu siç jemi, të ndahemi dhe të shkojmë në shtëpitë e kooperativistëve. Unë me Shefqetin [Peçi], si më pleq që jemi, të shkojmë bashkë në një familje, kështu ndahuni dhe ju të tjerët. Ngrihuni, shokë, të vemi që tani.

*Sheshi para shtëpisë së kulturës buçiste nga këngët e vallet e kooperativistëve. Gëzimi i tyre u shtua kur me ta u bashkua edhe udhëheqësi i shtrenjtë, i cili hodhi*

*valle e mori në dorë një çifteli. Pastaj shoku Enver Hoxha dhe shokët e tjerë u drejtuan për vizitë në shtëpitë e disa kooperativistëve.*

*Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*



# JETËN E POPULLIT E BËRI TË RE E TË BUKUR PARTIA

*Nga biseda në shtëpinë e kooperativistit  
Sylo Muço në Koplík<sup>1</sup>*

13 qershor 1973

*SHOKU ENVER HOXHA:* Jam shumë i gëzuar që erdha në shtëpinë tënde! Lumturi dhe gëzim paç gjithmonë në familje.

*SHOKU SYLO MUÇO:* Edhe unë ndiej një gëzim të madh për këtë nder që më bëre, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Kë ke në shtëpi?

*SHOKU SYLO MUÇO:* Kam gruan, një djalë dhe tri vajza.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shtëpinë e paske të mirë, sidomos këtë dhomë të lyer bukur, të pajisur me lule, të pastër e me dritë. Dyshemeja e saj qenka me dërrasa dhe ato janë të pastra. Shumë mirë qenkeni, në

---

1. Në këtë vizitë shoku Enver Hoxha shoqërohej nga shoqja Nexhmije Hoxha, nga nënkryetari i Presidiumit të Kuvendit Popullor, Shefqet Peçi, nga sekretari i parë i Komitetit të Partisë të Rrethit të Shkodrës Prokop Murra e të tjerë.

radio, me biçikletë, me tavolinë, me të gjitha ç'duhen.

*SHOKU SYLO MUÇO:* Partia na bëri kështu: Po të mos ishte ajo, ne do të ishim akoma në varfëri. Kryetari i kooperativës e di sa keq kam qenë unë përpara. Në vend të kësaj shtëpie të re, kam pasur një kasolle, ruaja bagëtinë, kurse krijimi i kooperativës na solli gjithë këto të mira. Gruaja ka kryer një kurs mjekësie për mami në Vlorë, tani është me punë në maternitet, këtu në fshat.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë mirë.

Cigaren time po e lë, se dua të pi një nga të zotit të shtëpisë, Sylos. Pa bjere këtu, ta dredh një herë një cigare me duhanin tënd! Po ti e pi duhanin, o Sylo?

*SHOKU SYLO MUÇO:* Jo, shoku Enver, unë nuk e pi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Shumë mirë bën, unë e di se nuk është mirë të pish cigare, po nuk e lë dot. Këtë e ke fëmijën e vogël? E paske të qeshur e të zgjuar, duket që në fytyrë që është i tillë.

*SHOKU SYLO MUÇO:* Po, shoku Enver, ky është djali. Kur lindi nuk ishte i shëndetshëm, por shteti më ndihmoi, e mbajti në çerdhe deri në 6 muaj dhe unë e mora në shtëpi të rritur e të shëndetshëm.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Keni këtu në kooperativë çerdhe, kopshte, shkolla?

*SHOKU SYLO MUÇO:* I kemi të gjitha.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Qenka i mirë duhani juaj dhe shoku kryetar i kooperativës më thotë të mos pi.

Ja, tani na erdhi dhe rakia. Sa gradë është kjo raki?

*SHOKU PROKOP MURRA:* Është e butë rakia e këtushme, shoku Enver.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Me Prokopin dhe me Nexhmijen nuk pi dot raki. Ja, që tani filloi shoqja ime të më flasë, se ajo për vete nuk e pi.

*SHOQJA NEXHMIJE HOXHA:* Jo, nuk e pi.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ta ngremë këtë gotë për shëndetin e të zotit të shtëpisë, të rrojë i gëzuar me gruan e me fëmijët. të jenë kurdoherë të lumtur. Për shëndetin tuaj dhe të fëmijëve! Gëzuar!

*SHOKU SYLO MUÇO:* Faleminderit shumë. Për shëndetin e shokut Enver, për nderin e madh që na bëri, duke na ardhur në shtëpi! Të na rrosh sa malet! Të paçim kështu, me shëndet ngahera!

*SHOKU ENVER HOXHA:* Ju faleminderit shumë.

*SHOKU SHEFQET PEÇI:* Këta. kooperativistët e Koplikut, janë kultivues të mirë të duhanit, shoku Enver, janë specialistë të zotë.

*SHOKU ENVER HOXHA:* Edhe në Gjirokastër është kultivuar duhani, jo brenda në qytet, por në fshatrat rreth qytetit.

Atje punojnë mirë kooperativat bujqësore, planet i realizojnë, kështu në Dropull, në Lunxhëri dhe në të gjitha krahinat e tjera. Nuk dua të mburrem, po për sa i përket çështjes së emancipimit të gruas, në Gjirokastër e kanë vënë punën përpara, po kështu atje punojnë mirë edhe për arsimin. Vdekjet e kalamanëve atje janë pakësuar shumë. Në këtë drejtim një rol të rëndësishëm luan nëna. Kyçi këtu qëndron te pastërtia, prandaj duhet të tregojmë më tepër kujdes për higjienën në familje dhe t'ua vëmë veshin këshillave të

mjekëve. Ja, shiko, sa të pastër e keni dyshe-menë ju! Po të kishte edhe një qilim, do të dukej edhe më bukur ambienti, por ne të erdhëm papandehur, kur ti nuk na prisje fare. Kur të vijë gruaja, do të të thotë: «Si nuk më lajmërove edhe mua?», po ti t'ia shpjegosh asaj që unë erdha pa ju lajmëruar. T'i thuash, gjithashtu, që ke shumë të fala nga Enveri, nga Nexhmija dhe nga shokët e tjerë që erdhën këtu. T'i thuash që të mos të të grindë për këtë që ndodhi.

Ne dëshirojmë që të rrimë akoma, por jemi me shokë të tjerë dhe nuk duam që ata të presin.

**SHOKU SYLO MUÇO:** Dëshira për t'ju pasur ju në gjirin tonë është e madhe, shoku Enver.

**SHOKU ENVER HOXHA:** Unë nuk do ta harroj kurrë mikpritjen tuaj.

**SHOKU SYLO MUÇO:** Vizita juaj në familjen time është një nder i madh që më bëhet. Vetë Enver Hoxha më shkeli në shtëpi!

**SHOKU ENVER HOXHA:** Tani të bëjmë një fotografi me pjesëtarët e familjes që janë këtu.

Bëji shumë të fala gruas nga unë dhe nga shoqja ime. Qofshi mirë, të lumtur e të gëzuar! Të rrojë Partia! Mbetshi me shëndet!

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

## TAKTIKAT E NDËRTUARA MBI BAZËN E PARIMEVE MARKSISTE-LENINISTE I SHËRBEJNË FITORES PËRFUNDIMTARE

*Nga biseda me një delegacion të Frontit Patriotik  
të Laosit*

13 qer-hor 1973

*Në fillim, shoku Enver Hoxha u uroi miqve laosianë mirëseardhjen dhe shprehu gëzimin për vizitën e tyre në vendin tonë. Pastaj, me miqtë u zhvillua një bisedë e përzemërt.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ne shqiptarët, pavarësisht se nga pikëpamja gjeografike jemi larg jush, me mendje dhe me zemër kemi qenë vazhdimisht me popullin laosian, me luftën e tij, të cilën e kemi ndjekur hap pas hapi, duke ndier vështirësitë dhe fitoret tuaja, të cilat i konsiderojmë si tonat. Gëzimi ynë ka qenë i madh kur arritët fitoren e parë në luftën për çlirim. Kemi bindjen e plotë se populli heroik i Laosit do t'i likuidojë shpejt edhe mbeturinat e fundit të armikut, që, në sajë të ndihmës ushtarake dhe ekonomike të imperializmit amerikan, është akoma në fuqi në një pjesë të truallit tuaj. Kjo ndihmë nuk mund t'i mbajë në këmbë armiqtë

e popullit laosian për një kohë të gjatë, dhe me siguri do të vijë dita që ata do të munden.

Lufta çlirimtare e popullit tuaj, e popullit të Vietnamit të Veriut dhe të Jugut, si dhe e popullit të Kamboxhias i ka shkaktuar armikut tonë të përbashkët, imperializmit amerikan, një disfatë të turpshme. Disfata të mëdha në luftë kanë pësuar më parë edhe nazizmi gjerman, fashizmi italian dhe militarizmi japonez, por në luftën kundër tyre qenë ngritur tërë popujt e botës. Në atë luftë të madhe kundër këtyre tri forcave ushtarake agresive fashiste, popujt, me partitë komuniste në krye, kishin përkrah Ushtrinë e Kuqe të udhëhequr nga Stalini i madh. Në anën e forcave antifashiste kanë qëndruar edhe populli e Partia jonë që luftuan me armë në dorë kundër fashizmit.

Aktualisht, popujt e botës nuk janë në një luftë të armatosur botërore kundër hitlerianëve të rinj amerikanë, por kundër këtyre janë ngritur në luftë të hapët, të zjarhtë dhe të rreptë të tre popujt e Indokinës. Është fakt historik që ju, popujt të vegjël, me luftën dhe me gjakun tuaj, i shkaktuat një disfatë shumë të madhe imperializmit amerikan, e thyes mitin e «pathyeshmërisë së amerikanëve». Natyrisht, në këtë luftë ju keni edhe ndihmën e sigurtë të popujve të tjerë të botës, midis të cilëve edhe ndihmën e popullit shqiptar. Ndihma e jashtme është faktor i rëndësishëm, megjithëkëtë ajo është e dorës së dytë, sepse faktori kryesor është faktori i brendshëm, jeni ju vetë.

Fitorja e arritur nga ju, popujt e Indokinës, është një ndihmë dhe inkurajim i madh për gjithë popujt e tjerë të shtypur. Kjo ndihmë është jo vetëm morale,

por edhe materiale, për arsye se imperializmi amerikan, që hyri në luftë kundër jush me arrogancë të shfrenuar dhe me besim se do t'ju thyente, nuk ia arriti qëllimit, nuk ju mundi dot. Nesër, sikur ai të ketë ndër mend t'i futet një aventure të re kundër popujve të tjerë, do të mendohet mirë, sepse mësimi që i dhatë ju duhet t'i ketë vlejtur. Imperializmi amerikan me luftën agresive kundër popujve të Indokinës e pësoi, dhe, siç thotë një fjalë e urtë e popullit tonë, «erdhi për lesh, por doli i qethur».

**KRYETARI I DELEGACIONIT:** I dashuri dhe i respektuari shoku Enver Hoxha! Sot, delegacioni ynë është jashtëzakonisht i gëzuar dhe i emocionuar për pritjen që i bëtë ju. Kjo pritje, në të njëjtën kohë, është një frymëzim i madh për ne. Ju falënderojmë thellësisht për fjalët shumë të mira, të ngrohta dhe vëllazërore që thatë për luftën e popullit laosian dhe për vlerësimin e drejtë që i bëtë asaj. Gjithashtu ju falënderojmë dhe ju jemi shumë mirënjohës për ndihmën e madhe vëllazërore që populli shqiptar, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë, i japin popullit tonë në arenën ndërkombëtare. Komiteti Qendror i Partisë sonë na ka ngarkuar të falënderojmë Partinë tuaj, Qeverinë dhe popullin vëlla shqiptar, dhe në mënyrë të posaçme ju personalisht, për përkrahjen dhe ndihmën e veçantë që i keni dhënë dhe po i jepni popullit laosian.

Jemi jashtëzakonisht të lumtur për vizitën miqësore që bëmë në Shqipëri dhe për pritjen e përzemërt nga gjithë shokët shqiptarë, duke filluar nga shokët e Komitetit Qendror dhe deri në bazë, në rrethe, ku u pritëm

ngrohtësisht nga drejtuesit e komiteteve të Partisë dhe të komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë.

*Pastaj kryetari i delegacionit laosian tha se do ta vazhdojnë luftën deri në fitoren e plotë dhe shprehu bindjen e thellë se Shqipëria do ta përkrahë dhe do ta ndihmojë si gjithmonë moralisht luftën e popullit laosian.*

**SHOKU ENVER HOXHA:** Ju faleminderit shumë për gjithëka që thatë për ne. Nuk ka asnjë dyshim që Partia dhe shteti ynë socialist do ta ndihmojnë me të gjitha mundësitë luftën e popullit tuaj. Ne i kuptojmë mirë vështirësitë e kësaj lufte për arsye se edhe vetë kemi kaluar nëpër këtë rrugë, bile duke qenë vetëm. Ndërsa ushtria e Stalinit na ndihmonte, duke u dhënë grushte dërrmuese ushtrive të Hitlerit, këtu, brenda në Shqipëri, ne luftonim vetëm, të rrethuar çdo ditë nga goditjet e armikut.

Kam mendimin se populli laosian i ngjan në shumë drejtime popullit tonë. Ashtu si Shqipëria, edhe Laosi është një vend malor. Laosianët janë malësorë si ne shqiptarët. Vuajtjet dhe mjerimet tuaja janë njëlloj si ato që kemi hequr ne në të kaluarën. Prandaj në asnjë moment nuk do ta ndërpresim ndihmën për luftën tuaj, por do ta përkrahim atë me të gjitha mjetet dhe mundësitë që disponojmë, nga ana morale dhe materiale. Komunistët dhe populli shqiptar e ndiejnë se e kanë për detyrë internacionaliste të ndihmojnë popujt që luftojnë, veçanërisht popullin laosian.

Bisedimet që zhvilluat ju me shokët tanë qenë të frytshme, sepse në të u bë shkëmbimi i dobishëm i mendimeve dhe u duk edhe një herë uniteti që ekziston



midis nesh. Kjo na i ngjall më tepër shpresat dhe na e shton më shumë besimin në luftën tuaj për konsolidimin e plotë të fitores. Ju keni të drejtë kur mendoni që me luftën tuaj i keni shkaktuar një disfatë të madhe imperializmit amerikan. Kjo humbje është diskredituese për të. Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pavarësisht nga manovrat që bëjnë, në sytë e botës janë diskredituar.

Ju duhet të luftoni akoma, jo vetëm se amerikanët, sado që ndoshta jo në shkallë të gjerë, i vazhdojnë akoma bombardimet mbi ju, por edhe sepse qëllimi i revolucionit, siç na mëson Lenini, është të çojë në çlirimin e plotë të atdheut dhe në marrjen e pushtetit në duart e popullit. Vetëm nëpërmjet luftës arrihet më shpejt dhe në mënyrë të plotë fitorja, sepse vetëm me luftë, nën udhëheqjen e partisë komuniste, populli është në gjendje t'i qërojë hesapet një herë e mirë me armiqtë dhe t'i mbrojë me guxim fitoret e arritura me gjak. Populli, që ka luftuar dhe ka derdhur gjak për plotësimin e aspiratave të veta, duke u kundërshtuar me heroizëm mizorive të mëdha të armikut, ka mundësi ta marrë pushtetin vetëm kur luftën e tij e udhëheq partia e proletariatit. Duke pasur në dorë pushtetin krijohen kushte që të fillohet nga reformat e dëshiruara dhe të ëndërruara në shekuj nga populli, i cili, kur të shikojë realizimin e tyre, do ta shtojë akoma më tepër besimin te komunistët dhe te patriotët revolucionarë. Duhet të jemi të vendosur në zbatimin e masave me karakter revolucionar, ndryshe populli do të deziluzionohet.

Natyrisht, në luftë dhe në revolucion përdoren taktika të ndryshme, për shkak të zigzageve dhe të situatave të ndryshme që krijohen, por këto taktika duhet t'i

shërbejnë kurdoherë arritjes së qëllimit përfundimtar. Taktikat e ndërtuara mbi bazën e parimeve të qarta marksiste-leniniste i shërbejnë fitores përfundimtare, e cila mund të arrihet vetëm nën udhëheqjen e partisë komuniste, sepse vetëm ajo është në gjendje të sigurojë zbatimin e të drejtave të popullit punonjës, vetëm ajo mund të përcaktojë drejt raportin e forcave të shoqërisë dhe rëndësinë që ka secila prej tyre në momente të caktuara, duke vlerësuar ato forca që janë të domosdoshme sot dhe ato që do të jenë të tilla nesër.

Aleancat janë të rëndësishme dhe të domosdoshme kur lidhen seriozisht dhe kur u qëndrohet me besnikëri çështjeve për të cilat ato janë përfunduar, ndryshe ato janë të destinuara të mbeten vetëm në letër, sepse me siguri shkelen nga reaksioni dhe nga borgjezia, që përpiqen të rrëmbejnë vetë pushtetin. Raste të tilla njih shumë historia.

Në kohën e Luftës sonë Nacionalçlirimtare njerëzit e thjeshtë të popullit pyesnin: Kush do ta ketë pushtetin pas luftës, bejlerët apo komunistët? Ne u përgjigjeshim atyre: Pushtetin do ta marrin në dorë populli me komunistët në krye dhe nuk duhet t'ua lëmë armiqtë, të cilëve nuk u zëmë besë, sepse ata e kanë shtypur, e kanë shfrytëzuar, gënjyer dhe gjakosur pa mëshirë popullin.

Reaksionarët laosianë përpiqen të mbajnë në dorë qeverinë dhe dokumentin e nënshkruar ta ruajnë vetëm në goftë se ai u shërben atyre për të mashtruar popullin dhe për të qëndruar në fuqi. Qëndrimi i tyre në fuqi, veç të këqijave të tjera, justifikon edhe ndërhyrjen e amerikanëve, të cilët pretendojnë se mbrojnë qeverinë

«e ligjshme» të princit Suvana Fuma, ashtu siç pretendojnë se mbrojnë qeverinë e Lon Nolit. Imperialistët amerikanë, në emër të mbrojtjes së «ligjshmërisë», mbrojnë në fakt paligjshmërinë dhe arbitraritetin në shkallë ndërkombëtare, prandaj ne e kemi për detyrë t'i gërryejmë «themelet juridike» ku mbështeten ata.

Unë nuk e dija nëse ekzistonte ndonjë marrëveshje midis jush dhe qeverisë së Vientianës, sepse, sipas mendimit tonë, asaj duhej t'i ishte futur pisha nga fundi e t'i kishte dalë në krye që të digjej e të bëhej hi. Populli duhet ta kuptojë mirë qëllimin e luftës që zhvillon. Ky qëllim është që ai të marrë tërësisht pushtetin në duart e tij. Populli duhet ta dijë se nuk mund të ketë aleancë midis tij dhe atyre që u bashkuan me imperialistët amerikanë dhe i hodhën mbi kurriz miliona tonelata bomba, që e vranë dhe e dogjën barbarisht. Prandaj ai, po të digjet ajo marrëveshje, do të lidhet më tepër me forcat e Frontit Patriotik dhe do të luftojë më ashpër kundër forcave reaksionare dhe imperialistëve.

Çështje tjetër me rëndësi mendoj se është ajo e pavarësisë dhe e sovranitetit kombëtar të Laosit.

Miqësia me popujt është e shtrenjtë për të gjithë ne. Në çdo aleancë që krijohet duhet të respektohen pa asnjë lëshim barazia dhe respekti reciprok në marrëdhëniet midis palëve. Pabarazia cenon parimin e madh të sovranitetit. Populli laosian lufton për një Laos të pavarur dhe sovran, ku qeverinë dhe ushtrinë të mos i kenë më në dorë armiqtë e tij, por vetë ai, ku diktatura të ushtrohet nga shumica e shfrytëzuar kundër pakicës shfrytëzuese. Aleancat që lidhen nuk duhet ta cenojnë pavarësinë dhe sovranitetin e një kombi.

E përmenda këtë anë të çështjes sepse kam parasysh eksperiencën tonë. Gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, që u zhvillua në vendin tonë, jugosllavët hiqeshin miq me ne. Ashtu si ne, edhe ata luftonin kundër pushtuesve nazifashistë, por më pas Titoja dhe grupi i tij punuan që Partisë Komuniste të Jugosllavisë, nëpërmjet normave antimarksiste që do të praktikonin dhe kongreseve të ndryshme që do të zhvillonin për t'i «përligjur» këto norma, t'i hiqnin shpirtin revolucionar dhe rolin udhëheqës në sistemin e diktaturës së proletariatit. Ata e dobësuan forcën udhëheqëse të proletariatit, me qëllim që të mos ndërtohej socializmi në Jugosllavi dhe ky vend të kthehej, siç u kthye, në një shtet borgjez kapitalist ku sundon konfuzioni. Ky ishte programi i Titos, që ai e zbatoi për dhjetëra vjet me radhë. Stalini e kritikoi drejt këtë veprimtari prej renegatësh, edhe ne, gjithashtu, e kritikuan. Të gjitha kritikët u bënë në mënyrë shoqërore, por udhëheqësit jugosllavë nuk nxorën mësimë për të hequr dorë nga kursi i tyre tradhtar. Klika e Titos është futur në një situatë jashtëzakonisht të rëndë, për arsye se është shitur tek imperialistët amerikanë dhe te revizionistët sovjetikë, duke iu nënshtruar atyre ideologjikisht, politikisht dhe ekonomikisht. Kur udhëheqësit jugosllavë filluan të «adërrojnë xhakëtën», të tradhtojnë komunistët dhe popullin, donin të na tërhiqnin edhe ne me vete. Për këtë, ndër të tjera, ata edhe na «këshillonin» që Partia jonë të fshihej, të ishte ilegale, e maskuar në organizatën e Frontit. Por komunistët e vërtetë shqiptarë u thanë: Jo! Partinë ne nuk e fshehim, se ajo ka qëndruar në ballë të luftës dhe ka fituar besimin e popullit. Këtë besim do ta shtoj-

më, duke e forcuar Partinë akoma më shumë, si udhëheqëse të Frontit dhe të masave popullore.

Pse vepronin kështu revizionistët jugosllavë ndaj nesh? Ata vepronin në këtë mënyrë për të sabotuar të ardhmen socialiste të Shqipërisë, për të krijuar në vendin tonë një regjim të tillë që t'i përngjiste pak a shumë, por në një formë më të avancuar, një demokracie borgjeze. Por ne nuk bëmë siç deshën revizionistët jugosllavë, ata le të qëndronin në shtëpinë e tyre dhe ne në shtëpinë tonë.

Është e vërtetë se duhet të koordinohen veprimet në arenën ndërkombëtare, të luftohet armiku i përbashkët, të mbrohen së bashku interesat e popujve etj., por çdo shtet e përcakton vetë qëndrimin e tij. Kështu, Shqipëria ka të drejtën e saj të fjalës siç e kanë edhe Jugosllavia, Bashkimi Sovjetik dhe shtetet e tjera. Në konferenca ndërkombëtare, Partia e Punës e Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë dërgojnë delegatët e vet dhe nuk përfaqësohen nga ndonjë fuqi e huaj.

Kur u formua Qeveria jonë në të nuk merrnim pjesë vetëm ne komunistët, por edhe njerëz të paorganizuar në Parti, që ishin patriotë, që e donin çlirimin e atdheut, që kishin besim në luftën dhe në vendosmërinë e komunistëve. Komunistët luftuan me vendosmëri dhe e merituan besimin e popullit. Me mijëra prej tyre bënë pjesë në këshillat nacionalçlirimtarë, të Frontit, me mijëra ishin komandantë të njësiteve partizane.

Të gjitha traktatet e padrejta të nënshkruara nga regjimi antipopullor i Ahmet Zogut me fuqitë imperialiste, si me Anglinë, me Shtetet e Bashkuara të Ame-

rikës etj. dhe që mbroheshin nga këto të fundit, aleatët tanë në luftën kundër nazizmit gjerman, ne nuk i njohëm aspak, por i hodhëm poshtë. E dinim mirë se aleatët, me përjashtim të Bashkimit Sovjetik, që udhëhiqej nga Stalini, synonin që, në pragun e Çlirimit të Shqipërisë, të mbeteshin përsëri në fuqi veglat e tyre, njerëzit e regjimit të kaluar. Por, ne, pavarësisht nga vullneti i aleatëve imperialistë, i fshimë të gjithë shërbëtorët e tyre që kishin tradhtuar interesat e popullit shqiptar. Ky qëndrim i vendosur dhe revolucionar që mbajtëm forcoi edhe më tepër besimin e popullit të Partia dhe të pushteti i ri popullor.

Anglezët dhe amerikanët nuk e njohën Qeverinë tonë, por ne nuk u shqetësuam fare për këtë qëndrim armiqësor të tyre, sepse atë e njihte dhe e përkrahte fuqimisht populli, prandaj vendi ynë ishte dhe është një kala e pamposhtur. Kanë kaluar rreth 30 vjet që ata vazhdojnë të mos na njohin, por neve s'na bëhet vonë, rrojmë si jo më mirë edhe pa njohjen e tyre.

Partia dhe populli ynë, që kanë derdhur gjak për pavarësinë dhe sovranitetin kombëtar, nuk mund të ndiqnin kursesi rrugën titiste dhe u rezistuan të gjitha presioneve të armiqve imperialistë amerikanë dhe të revizionistëve sovjetikë, të cilët, njëjloj si imperialistët amerikanë, luftojnë për zotërimin e botës, duke u fshehur nën maskën e marksizëm-leninizmit. Puna që bën revizionizmi sovjetik është armiqësore dhe djallëzore. Ata që nuk e kanë kuptuar akoma këtë të vërtetë dërrtojnë rëndë të ardhmen e popujve të tyre dhe të revolucionit.

Taktikat për arritjen e një objektivi të caktuar, për

realizimin e një plani të përgjithshëm, janë të lejueshme, por megjithëkëtë edhe ato kanë një kufi. Taktika jonë ndaj imperialistëve amerikanë e revizionistëve sovjetikë është e thjeshtë, e qartë dhe e drejtë. Sipas nesh, lufta kundër njërit armik, në të njëjtën kohë, është dhe luftë kundër tjetrit. Pse? Sepse si njëri dhe tjetri janë armiqtë tanë, të dy nuk e duan lirinë e popujve, të dy duan të krijojnë zona të ndikimit dhe të forcojnë pozitën e veta në dëm të lirisë, të sovranitetit dhe të vetëvendosjes së popujve. «Ndhimat» e amerikanëve dhe të sovjetikëve janë me helm. Ne nuk i kemi provuar dhe nuk do t'i provojmë kurrë ndihmat e imperialistëve amerikanë, kurse ndihmat e revizionistëve sovjetikë, që e heqin veten si dishepuj të Leninit, i kemi provuar, ato kanë qenë plot me helm. Revizionistët sovjetikë janë sjellë me Shqipërinë socialiste siç do të silleshin amerikanët. Nuk është e mjaftueshme koha për t'ju treguar se ç'kanë bërë ata kundër nesh, se për këtë do të duheshin orë të tëra. Luftën kundër tyre ne e bëjmë sepse është një luftë e domosdoshme, që mbështetet në arsye dhe në fakte të shëndosha, në argumente teorike marksiste, që janë vërtetuar konkretisht në fushat politike, ideologjike, ekonomike dhe ushtarake. Prandaj ne nuk mund të gënjehemi nga demagogjia e revizionistëve sovjetikë.

Sovjetikët bëjnë zhurmë dhe propagandojnë me të madhe për «ndihmën» që i kanë dhënë luftës së popujve të Indokinës, por dihet mirë se çfarë kanë dhënë dhe po japin ata për këta popuj, çfarë synimesh kanë pasur dhe çfarë roli kanë luajtur e kanë ndër mend të luajnë Brezhnëvi me shokë kundër tyre. Kot shpre-

sojnë këta armiq kur mendojnë se shqiptarët apo laosianët nuk i kanë kuptuar qëllimet e tyre të liga.

Ne e respektojmë partinë tuaj si një parti që lufton për fitore. Partia juaj është në gjendje të kuptojë më mirë se miqtë e vet situatën në vendin e saj dhe të përcaktojë drejt se si duhet të veprojnë. Megjithëkëtë eksperiencia e miqve mund të shfrytëzohet, kur ajo përshatet me kushtet e vendit tuaj. Ne duam t'ju themi se eksperiencia e Partisë sonë në marrëdhëniet me të ashtuquajturit aleatë të Luftës së Dytë Botërore dhe pastaj me revizionistët sovjetikë, që erdhën në fuqi pas vdekjes së Stalinit, ka qenë e hidhur.

Ne, këtu në Shqipëri, patëm bisedime me zotin Sihanuk<sup>1</sup>, i cili na ka lënë përshtypje të mira. Ai ka simpati për rezistencën e brendshme kamboxhiane dhe dëshiron që populli të vendosë vetë për fatet e tij. Sihanuku është princ përparimtar, që përpiqet për çlirimin e popullit dhe për vazhdimin e luftës kundër amerikanëve dhe klikës së Lon Nolit pa asnjë kompromis. Prandaj i thamë se, pavarësisht që jemi vend i vogël, popullin kamboxhian që po lufton do ta përkrahim me të gjitha mundësitë tona.

Me shokët vietnamezë ne, gjithashtu, kemi pasur dhe do të kemi lidhje të mira. Lufta e Vietnamit është madhështore dhe shembullore. Rezistenca e popullit vietnamez jo për një apo për 10 vjet, por për dekada të tëra, është frymëzim për të gjithë popujt e mëdhenj dhe të vegjël të botës. Heroizmi i këtij populli do të jetë i pavdekshëm në shekuj, prandaj kemi shumë për

1. Shih në këtë vëllim, f. 139, 200.



të mësuar nga lufta e tij, për arsye se ajo që po u ngjan vietnamezëve dhe juve, mund të na ngjasë neve nesër, sepse për sa kohë që ekziston rrethimi kapitalist, ekziston gjithmonë edhe rreziku i luftës.

Ushtarakët amerikanë u detyruan të largohen nga Vietnami. Kjo ishte një fitore, por në Vietnamin e Jugut ka akoma amerikanë të veshur «civilë», megjithëse jo me qindra mijëra si më parë, dhe SHBA paguajnë miliarda për realizimin e synimeve të tyre të poshttra. Përveç këtyre, sikurse u kemi thënë edhe shokëve vietnamezë, në Vietnamin e Jugut ekziston si pushteti i Thicut, ashtu dhe pushteti i Frontit Kombëtar të Çlirimit, prandaj fitorja e arritur nga populli nuk është e plotë. Krijimi i Republikës së Vietnamit të Jugut me Qeverinë e Përkohshme Revolucionare, me një front dhe me një parti është një avantazh në krahasim me më parë. Tani, Fronti Kombëtar i Çlirimit të Vietnamit të Jugut vepron dhe qëndron përballë forcave të Thicut. Por edhe sikur pushteti reaksionar i Thicut të thuhet, do të ekzistojnë si një gangrenë mbeturinat e tij, kundër të cilave duhet luftuar deri në fund.

Ju keni të drejtë kur thoni që lufta si në Vietnam edhe në Laos nuk ka mbaruar. Në këtë situatë edhe ndihma për ju duhet të jetë e madhe. Po në se konsiston ajo? Ndhma konsiston jo vetëm në forcimin e situatës së brendshme të vendit tuaj, në pajisjen me armë dhe në forcimin e pushtetit, por edhe në përkrahjen aktive nga të gjithë miqtë tuaj të vërtetë, të cilët duhet të bëjnë luftë të pamëshirshme kundër imperializmit amerikan. Në qoftë se do të bëhen pazarllëqe me imperializmin amerikan dhe me revizionizmin sovjetik, atë-

herë situata për vendin tuaj do të jetë e mbarsur me rreziqe të mëdha.

Ju jeni në dijeni të situatës në botë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë në krizë të thellë ekonomike. Amerikanët kanë pësuar disfatë të rëndë në Laos, në Vietnam e në Kamboxhia. Niksoni është në krizë lidhur me çështjen e Uotergejtit<sup>1</sup>. Pikërisht në këto momente Brezhnjevi vajti në SHBA<sup>2</sup> që të forcojë pozitën e dobësuar të Niksonit dhe të kërkojë prej tij edhe ndihmë! Ka 56 vjet që ka triumfuar revolucioni proletar në Bashkimin Sovjetik, por megjithëkëtë puna ka arritur sa Brezhnjevi të shesë tek imperializmi naftën, gazin dhe mineralin e Siberisë dhe t'i nderë atij dorën! Revizionistët hrushovianë e kanë katandisur Bashkimin Sovjetik gjer atje sa të marrë qindra milionë dollarë kredi nga Italia, nga Anglia dhe nga Gjermania Perëndimore. Ashtu si Brezhnjevi, për të njëjtat qëllime breçk edhe Kosigini, duke lypur në Norvegji dhe në vende të tjera. Derisa udhëheqësit revizionistë të Bashkimit Sovjetik përulen para autoritetit të një presidenti kriminal, siç është Niksoni, duke shitur interesat e atdheut

---

1. Skandal politik në SHBA gjatë fushatës së zgjedhjeve presidenciale në vitin 1972, që shpërtheu pas zbulimit të pajisjeve të përgjimit, vendosur në selinë e Partisë Demokrate në hotelin e Uotergejtit. Ky skandal, shprehje e rivalitetit midis dy klaneve kryesore të borgjezisë amerikane, zbuloi se në veprimet e kundërligjshme për të falsifikuar rezultatet e zgjedhjeve, si: vendosja e aparaturave të përgjimit, përdorimi i rryshfeteve, shantazhit, kërcënimeve etj., ishin implikuar komiteti i Partisë Republikane për rizgjedhjen e presidentit, zyrtarë të Shtëpisë së Bardhë si dhe vetë presidenti Nikson.

2. Më 16-25 qershor 1973.

të tyre, është e qartë se nuk u kushton asgjë të shesin çdo minutë interesat e Shqipërisë, të Laosit, të Kambodhias etj. Në këto përfundime mund të arrihet fare lehtë, sepse veprimet e tyre armiqësore duken sheshit.

Kur ne nuk iu nënshtruam diktatit të hrushovianëve dhe demaskuam me vendosmëri tradhtinë e tyre ndaj marksizëm-leninizmit, Hrushovi na akuzoi me paturpësi duke na thënë: «Ju jeni të shitur tek imperialistët për tridhjetë aspra», «ju nuk rroni dot asnjë orë pa marrë kredi nga imperialistët» etj.! Përkundrazi, ne jo vetëm që nuk kemi marrë asnjë grosh kredi nga imperializmi, por me gjithë bllokadën e egër imperialisto-revizioniste ndaj vendit tonë, vazhdojmë luftën të rrethuar dhe po e lulëzojmë Shqipërinë.

Partia jonë mendon se tezat e saj të mbështetura tërësisht te marksizëm-leninizmi janë të drejta dhe nuk i luan as topi. Mund të na thuhet: Pse ju shqiptarët nuk lëvizni asnjë çikë nga qëndrimet tuaja? Edhe ne kemi të drejtë të shtrojmë pyetjen: Nga të lëvizim, nga mbrojtja e parimeve dhe nga politika e drejtë marksiste-leniniste që kemi ndjekur e po ndjekim me vendosmëri? Ne jemi marksistë, jemi të matur, prandaj rrethanat, koniunkturat politike i studiojmë me kujdes, çapat i hedhim me pjekuri dhe parimet kurrë nuk i shkelim, sepse vetëm zbatimi me konsekuencë i tyre shpie në fitoren e revolucionit dhe në ndërtimin e socializmit. Për këtë klikat në fuqi në BS e në SHBA na urrejnë e na luftojnë. As ne nuk e duam «dashurinë» e tyre, bile jemi të lumtur që s'kemi marrëdhënie me ta, sepse nga «aleanca» e tyre popujt nuk mund të presin gjë tjetër veç thikën pas shpine. Këtë e vërteton historia. Por ne gëzohemi, inkur-

rajohemi dhe forcohemi, sepse na duan me gjithë zemër miqtë tanë të vërtetë, partitë marksiste-leniniste, popujt dhe revolucionarët kudo në botë.

Edhe një herë ju sigurojmë se ndihma jonë për luftën e popullit laosian do të jetë e vazhdueshme dhe si kurdohëre e sigurtë.

*Botuar për herë të parë në librin: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern» (Përmbledhje veprash) 1971-1975, f. 297*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern» (Përmbledhje veprash) 1971-1975, f. 297*

## KUR NJË POPULL MBRON ME VENDOSMËRI LIRINË E VET, INTRIGAT E ARMIQVE DËSHTOJNË

*Nga biseda me Norodom Sihanukan*

21 qershor 1973

*Pasi u përshëndetën dhe miku kamboxhian foli për përshtypjet nga qyteti i Vlorës<sup>1</sup>, e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Ju pamë në televizor që vizituat muzeun e qytetit të Vlorës. Me këtë rast ju u njohët me lëvizjen e pavarësisë së vendit tonë dhe me figurën e Ismail Qemalit, i cili ishte një patriot i madh, por njëkohësisht edhe një diplomat i zoti. Në momentet më kritike për Shqipërinë, kur luhej fati i saj, së bashku me disa patriotë të tjerë, Ismail Qemali u kthye në Shqipëri dhe, sa arriti në Vlorë, shpalli pavarësinë e atdheut e ngriti flamurin kombëtar. Shpallja e pavarësisë u bë në kundërshtim me dëshirat e fuqive të mëdha, të cilat nuk donin që Shqipëria të ishte e lirë, e pavarur dhe sovrane. Ato kishin përfunduar marrëveshje sekrete për

---

1. Samde Norodom Sihanuku qëndroi në qytetin e Vlorës nga 18 deri më 20 qershor 1973.

ta ndarë, bile edhe pas shpalljes së pavarësisë kombëtare, u përpoqën përsëri të realizonin copëtimin e saj. Meqenëse kjo ngjarje kaq e rëndësishme për Shqipërinë është e lidhur me Vlorën, ky qytet është i shenjtë për popullin tonë.

Sot ne jemi të pavarur, jetojmë në një vend të lirë e sovran, por na bie detyrë që këtë vend ta mbrojmë vazhdimisht, çdo ditë, nga intrigat e imperialistëve dhe të socialimperialistëve. Siç e keni thënë edhe ju në takimet tona të përbashkëta, kundër popujve të vegjël që duan liri, thuren shumë intriga. Pikërisht këtyre u duhet bërë ballë pandërprerë e me kurajë, sepse me kurajë mund të kapërcehet gjithçka, çdo vështirësi, bile edhe ato vështirësi që në pamjen e parë mund të duken të pakalueshme. Kur një popull mbron me vendosmëri lirinë e vet, intrigat e armiqve dështojnë. Përballë qëndrimit tonë të vendosur, orvatja e revizionistëve sovjetikë në vitin 1960, në kohën kur marrëdhëniet tona me ta po prisheshin, për të na grabitur nëndetëset tona në Vlorë, dështoi me turp. Në atë kohë erdhi vetë admirali Kasatonov dhe kërkoi të merrte anijet tona. Bile sovjetikët u përpoqën të na i merrnin ato edhe me forcë, por ne u drejtuam topat. Vetëm atëherë ata u detyruan të dilnin jashtë bazës së Vlorës dhe të largoheshin.

Forcat reaksionare dhe veçanërisht dy superfuqitë përpiqen me të gjitha mënyrat ta gjunjëzojnë popullin kamboxhian dhe ta shuajnë luftën e tij. Propozimi që bëjnë sot ata për një zgjidhje gjoja paqësore të problemit, duke formuar një qeveri koalicioni me tri kokë në Kamboxhia, është një kurth. Në qoftë se ju do të bini

në këtë kurth, atëherë do të bëheni pre e tyre. Prandaj ju nuk mund ta pranoni kurrë këtë zgjidhje, sepse keni një zgjidhje tjetër, të sigurt, që do të arrihet në sajë të luftës së popullit kamboxhian. Rezistenca e brendshme e popullit duhet të vazhdojë deri në fitoren e plotë. Kjo është rruga e vetme e sigurt dhe ne kemi besim se ju do ta ndiqni atë.

Me popujt që luftojnë, miqtë duhet të jenë gjithnjë të hapur dhe të sinqertë. Ky është parimi ynë i palëvizshëm. Ne shqiptarët Partia na mëson që me miqtë të jemi gjithmonë të hapur dhe t'u qëndrojmë pranë në çdo lloj situatë, në momente të mira, por edhe të vështira, sepse në çaste të vështira njihen miqtë e vërtetë. Kur je mirë dhe punët të shkojnë mbarë, ka nga ata që të afrohen, të bëjnë edhe lëvdata, por kur je në momente të vështira, të braktisin. Vetëm në fatkeqësi njihen ata që janë miq besnikë.

Një shprehje e urtë e popullit thotë: «Bashkimi bën fuqinë», por ne nuk duhet të harrojmë që çdorrezik e vështirësi na bie detyrë ta nposhtim gjithmonë dhe ta përballojmë, në radhë të parë, me forcat tona. sepse forcat e veta, forcat e popullit, janë më të sigurta. Populli nuk të tradhton kurrë. Miqtë e mirë mund të bëjnë gjithçka për të ndihmuar, sepse edhe ndihma e tyre duhet, por, në radhë të parë, secili duhet të mbështetet në forcat e veta.

Këto ditë nga një lajm i Agjencisë Frans Pres mësuam se të gjitha rrugët për në Pnom-Pen janë prerë, ushtria e Lon Nolit ka humbur shumë pozita në zonat në periferi të kryeqytetit, ndërsa ushtria juaj nacionalçlirimtare nuk ka pasur humbje.

*Pasi Norodom Sihanuku foli për bombardimet e egra të armikut dhe për aksionet e forcave të çlirimit, të cilat luftonin duke përdorur armët që i rrëmbenin kundërshtarit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Ju thatë se në aksionet e tyre forcat e çlirimit përdorin armët që i kanë zënë armikut. Ashtu duhet vepruar. Edhe në gjatë luftës nuk kishim ndonjë burim nga mund t'i siguronim armët që na nevojiteshin. Bashkimi Sovjetik nuk mund të na jepte armë, se fronti ishte shumë larg. Nga ana e forcave çlirimtare në Jugosllavi e në Greqi, gjithashtu, nuk na u dha asnjë pushkë, nuk na u dërgua asnjë ndihmë.

Anglezët, të cilët, natyrisht, ishin miq fals, por në atë kohë hiqeshin si aleatët tanë, kishin pasur plane djallëzore ndaj nesh që në fillim të luftës. Misionet angleze që erdhën në Shqipëri gjatë luftës, nuk kishin qëllime ndihme. Ata gënjenin me paturpësinë më të madhe dhe vetëm në fund na dhanë pak armatime që ishin fare pa rëndësi. Bile kur kapitulloi Italia fashiste. «aleatët» anglezë donin t'i merrnin për vete armët e garnizonit ushtarak armik në ishullin e Sazanit, por forcat tona partizane shkuan atje dhe i morën ato në kundërshtim me dëshirën e tyre. Pra, armët për të luftuar ne ua merrnim armiqve, kjo ishte e vetmja rrugë që na mësoi Partia për t'i siguruar ato. Me këtë dua të them se armët na «i dha» armiku ose, më mirë të themi, ia rrëmbyem armikut.

Gjatë kohës së luftës, pavarësisht se askush nuk na dha armë, nuk u dëshpëruam kurrë, në asnjë rast, sepse ishim të sigurt dhe kishim besim në fitore. Partizanët nuk shtronin atëherë pyetjen se si do të bënin.



për armë, sepse, siç e thashë, Partia ua kishte bërë të qartë si siguroheshin ato. Ne u hodhëm në luftë dhe dolëm prej saj fitimtarë dhe të armatosur mirë, duke ia marrë gjithëka armikut, i cili pësoi disfata të një-pasnjëshme në vendin tonë. Sigurisht, në këtë luftë ne patëm edhe humbje, por ato që u shkaktuam armiqve, ishin shumë më të mëdha. Prandaj edhe ju të jeni të sigurt për fitoren. Vështirësi, me siguri, keni, por këto do t'i kaloni.

Ju jeni të vendosur dhe mendoni drejt që të bëni gjithëka për t'u armatosur me armët që i rrëmbeni armikut. Por edhe miqtë, kur kanë mundësi, duhet t'ju ndihmojnë. Kush është në interesin e miqve tuaj, një Kamboxhia e pavarur, e çliruar dhe me qeverinë e saj popullore, apo një Kamboxhia ku të ketë një qeveri me tri kokë, e vënë nën sundimin e imperialistëve dhe të socialimperialistëve? Ne mendojmë se zgjidhja e parë është e drejtë dhe për këtë duhet vepruar sa më shpejt, duke ndihmuar me të gjitha mjetet popullin kamboxhian. Në asnjë mënyrë s'duhet hequr dorë nga përpjekjet për të ndihmuar miqtë. Të veprosh ndryshe është krejt e padrejtë.

Gjithë miqtë e Kamboxhias duhet të ndihmojnë luftën heroike të këtij vendi, se kjo është në interes të popullit të Kamboxhias, të Vietnamit, të Shqipërisë dhe të të gjithë popujve të tjerë të botës. Midis vendeve që luftojnë nuk duhet të ketë ndarje. Është në interes edhe të Vietnamit të Veriut që të fitojë populli kamboxhian, sepse kështu qeveria e Sajgonit do të likuidohet përfundimisht, jo për një ditë, por përgjithmonë dhe atëherë ky vend do të jetë i rrethuar nga

vende miq e vëllezër, si nga Vietnami i Jugut i çli-ruar, ashtu dhe nga Kamboxhia e lirë, sovranë dhe e pavarur. Vetëm kështu do të jetojnë të lumtur popujt e Indokinës.

*Duke shprehur vendosmërinë për të arritur fitoren, Samde Norodom Sihanuku theksoi se ashtu si populli shqiptar, edhe populli kamboxhian do t'i kalojë vështirësitë në luftën e tij çlirimtare. Midis të tjerave, ai vuri në dukje, gjithashtu, se imperialistët amerikanë po stërvitnin edhe mercenarë nga minoritetet kmere në Tajlandë e në Vietnamin e Jugut për t'i përdorur kundër forcave çlirimtare në Kamboxhia.*

*Fjalën e mori përsëri shoku Enver Hoxha:*

Kështu kanë dashur të vepronin ata edhe me ne, duke përgatitur për të ndërhyrë kundër shtetit tonë disa mbeturina të reaksionit shqiptar, që kanë shkuar si refugjatë në Amerikë. Forcat mercenare kamboxhiane do të shërbejnë vetëm si një maskë se në çdo 100 nga këta, amerikanët do të futin mijëra sajgonezë. Duhet menduar të gjitha gjërat me kohë.

Ju thoni se imperialistët amerikanë do të mundohen të futin trupa edhe nga Tajlanda. Me aq sa di unë nga historia e vendeve tuaja, Tajlanda ka qenë gjithnjë në luftë me Kamboxhian. Ajo mund të veprojë kundër jush edhe tani, se qeveria e këtij vendi është nën ndikimin e imperialistëve amerikanë dhe të revizionistëve sovjetikë dhe në këto kushte mund të bëjë atë që duan amerikanët dhe sovjetikët. Prandaj si të mos e ndihmohet Kamboxhian që lufton për liri e pavarësi? Këtë ne e deklarojmë hapur, u pëlqen apo nuk u pëlqen të tjerëve. Veriu ose Jugu i vendit tuaj mund

të infiltrohet nga armiqtë që ju rrethojnë, sepse këta kanë mundësi jo vetëm të veprojnë rreth Pnom-Penit dhe në zona të tjera, por mund të përdorin kundër jush, për t'i prerë krahët Kamboxhias dhe për të infiltruar forca, edhe Tajlandën e regjimin e Sajgonit. Prandaj miqtë kinezë me siguri do të reflektojnë, se ndihma për ju është edhe në interesin e tyre.

Kamboxhianët janë luftëtarë, ata kanë bërë e po bëjnë sakrifica të mëdha për të krijuar një shtet sovran, të lirë e të pavarur dhe kjo gjen aprovimin e të gjithë miqve të tyre të vërtetë. Amerikanët dhe sovjetikët duan t'ju ulin në gjunjë, po ju nuk e doni këtë, prandaj miqtë tuaj, ata që janë me të vërtetë të tillë, duhet t'ju ndihmojnë.

Ne e dimë mirë se cilët janë sovjetikët, prandaj ju themi të mos keni as më të voglin besim ndaj tyre, se po të lidhni me ta, ata do t'ju shkaktojnë dëme të mëdha. E themi këtë, sepse mendojmë që problemet duhen shtruar siç janë. Vetëm kështu mund të arrihet në konkluzione të drejta.

Ne po e ndjekim me vëmendje vizitën që po bën Brezhnjevi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ai flet atje si një reaksionar. Nuk mund të merret me mend që udhëheqësi i një shteti që e heq veten socialist, të japë llogari para një grupi sunduesish të një shteti që bombardon dhe gjakos popujt e botës. Kjo është e çuditshme! Të veprosh kështu, do të thotë të tradhtosh. Si është e mundur që populli sovjetik ta pranojë këtë tradhti? Brezhnjevi arriti deri atje sa u mburr se ishte veshur me një xhaketë që ia kishte dhënë Niksoni, dhe që mbante stampën e Shteteve të

Bashkuara të Amerikës! Ja kush është sekretari i parë i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik! Një njeri që shet vendin e vet, si të mos e shesë pastaj Kanboxhian?

Amerikanët dhe sovjetikët merren vesh shumë mirë dhe me shumë mënyra me njëri-tjetrin. Veprimtaria e tyre shqetëson edhe aleatët e tyre. Gjermania Lindore dhe Hungaria kanë shumë vështirësi për zhvillimin e industrisë së tyre, për arsye se sovjetikët nuk u japin lëndë të para për të cilat kanë nevojë, megjithëse për këtë kanë nënshkruar edhe marrëveshje. Vende ish-socialiste të Evropës tani po bëjnë përpjekje të shkëputen nga Bashkimi Sovjetik, por ku do të venë? Me siguri do të lidhen me amerikanët.

Sipas lajmeve të agjencive të ndryshme, edhe Italia, Franca e vende të tjera kapitaliste, janë shumë të shqetësuara nga manovrat e amerikanëve e të sovjetikëve. Ato e kanë të qartë se nga bisedimet e të dyja palëve asnjë rezultat i mirë nuk do të dalë, përkundrazi marrëveshjet që do të bëhen, do të jenë në disfavorin e tyre, sepse imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët e Moskës nuk i marrin fare parasysh interesat e «aleatëve». Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik përpiqen të krijojnë kudo zonat e tyre të influencës pa marrë parasysh as interesat e vendeve të tjera. Atëherë ne, popujt që jemi në pararojë, që luftojmë kundër intrigave të të dyja superfuqive, mund të kemi besim në bisedimet e tyre? Jo, aspak. Në asnjë mënyrë nuk duhet t'i lëmë imperialistët dhe shërbëtorët e tyre të intrigojnë në dëm të paqes dhe të sigurimit të popujve.

Ju tani keni çliruar pjesën më të madhe të vendit, prandaj mendojmë se duhet filluar menjëherë debati për njohjen e qeverisë së Kamboxhias në OKB, sepse, po të nisesh nga pikëpamja që duhen siguruar 90 për qind e shanseve, pastaj të shtrohet ky problem, do të thotë ta shtysh këtë çështje për më vonë. Ju e njihni më mirë se të tjerët veprimtarinë e OKB-së, se ju dhemb dhëmballa, por ne mendojmë se OKB-ja dominohet nga imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë, ata bëjnë çfarë të duan atje.

Çfarë po bën OKB-ja? Asgjë! Le të marrim, për shembull, çështjen e Lindjes së Mesme, shqyrtimi i së cilës para disa javësh u shty, sepse shefi i revizionistëve sovjetikë, miku i amerikanëve, na paska shkuar në Amerikë. Kjo është skandaloze!

Vallë mund të shpresohet në vullnetin «e mirë» të të dyja superfuqive për të zgjidhur çështjen e Kamboxhias, për të dhënë aprovimin që OKB-ja të njohë qeverinë e ligjshme të saj dhe pastaj të fillohet nga diskutimi? Ne nuk mund të presim, as të shpresojmë në këtë, prandaj do të fillojmë ta ngremë këtë problem. Në qoftë se sivjet do të ketë 10 përkrahës, vitin tjetër do të ketë me siguri më shumë dhe kështu, radhët e atyre që do t'ju përkrahin, do të shtohen vazhdimisht.

Kështu ndodhi dhe me pranimin e Kinës në OKB. Atje Shqipëria ishte e para që luftoi me të vërtetë për të, pastaj u shtuan edhe të tjerë. Vetëm 3-4 vota ishin në fillim në favor të pranimit të Kinës, më vonë ato u shtuan dhe, më në fund, Kina u fut në OKB. Ky rezultat u arrit me luftë kundër SHBA dhe në një kohë kur ato nuk e pritnin. Ne do të bëjmë të njëjtën luftë

edhe për Kamboxhian. Në qoftë se jeni dakord, ne do ta fillojmë këtë luftë dhe me siguri nuk do të jemi vetëm, dhe asgjë nuk do të humbasim. Do të vijë koha që armiqtë tanë, të cilët vazhdimisht po demaskohen, do të humbasin.

Jemi të bindur se në OKB do të na dëgjojnë, megjithëse në fillim këta mund të jenë të paktë. Por kjo s'prish punë, se rëndësi nuk kanë votat, por opinionin. Në OKB, në mbrojtje të vendit tuaj, do të dëgjohen edhe miq të tjerë të popujve tanë. Ka sot vende në botë që ju kanë njohur, ka edhe vende të tjera që nuk ju njohin, se janë në shërbim të imperialistëve amerikanë. Kur të shtrohet çështja juaj në OKB dhe ne të themi atë që mendojmë, ata që bëjnë dredha dhe u përkulen në mënyrë servile imperialistëve amerikanë dhe revizionistëve sovjetikë, do të vihen në pozita të vështira dhe nuk do të flasin dot.

Gjatë vizitës suaj në Jugosllavi, siç e theksuat vetë, ju i thatë Titos të mbante qëndrim të drejtë ndaj Kamboxhias dhe t'ju konsideronte si qeverinë e vetme të ligjshme të vendit tuaj në konferencën e vendeve «të paangazhuara». Ne kemi mendimin tonë për lëvizjen e «të paangazhuarve» dhe për vendet që marrin pjesë në të. Shumë nga këto vende varen nga superfuqitë dhe bëjnë lojën e tyre. Termi «mosangazhim» është zgjedhur për ta maskuar këtë varësi, për të krijuar iluzione në qëndrimin e këtyre vendeve ndaj imperializmit dhe socialimperializmit dhe për t'i bërë popujt të heqin dorë nga lufta kundër tyre. Përveç kësaj, kjo lëvizje, ku interesat e vendeve «të paangazhuara» bien në kundërshtim me njëri-tjetrin, është mjaft he-

terogjene. Prandaj, siç thatë edhe ju, nga konferenca e vendeve «të paangazhuara», nuk ka për të dalë gjë.

Lufta juaj, duke u drejtuar kundër imperializmit amerikan dhe klikës së tij, asaj të Lon Nolit në Kamboxhia, i kalon kufijtë, del jashtë kuadrit të vendit tuaj. Çështja juaj nuk është vetëm e Kamboxhias, por e gjithë popujve të shtypur, që luftojnë kundër imperializmit të egër amerikan dhe kundër socialimperializmit sovjetik. Për këtë arsye, populli shqiptar, Qeveria e tij, Partia e Punës e Shqipërisë, do të jenë gjithmonë me luftën e popullit kamboxhian, e cila do të çojë me siguri në fitoren e madhe, çlirimin e vendit. Kjo do të jetë disfatë e rëndë dhe e turpshme për imperialistët amerikanë dhe vdekje për klikën e Lon Nolit.

Lufta e popullit kamboxhian, ashtu si dhe lufta e popujve të tjerë, duhet përkrahur me të gjitha forcat nga popujt përparimtarë, nga lëvizjet çlirimtare dhe, në radhë të parë, nga komunistët e të gjithë botës. Komunistët e vërtetë aprovojnë me gjithë zemër këtë luftë që ka për qëllim të çlirojë vendin dhe t'i japë liri popullit, që ai të rrojë i lumtur dhe të ndërtojë vetë të ardhmen e tij.

Është detyrë e të gjithë njerëzve të ndershëm të flasin për luftën çlirimtare që është zhvilluar e po zhvillohet në Indokinë nga populli i Vietnamit, nga ai i Kamboxhias dhe ai i Laosit. Këta tre popuj e kanë tronditur politikën skllavëruese të fuqive të mëdha imperialiste. Është e vërtetë që gjithë popujt e tjerë jo vetëm e kanë aprovuar luftën heroike të popujve tuaj, por e kanë ndihmuar atë me mënyra të ndryshme.

Ne mendojmë se me gjithë marrëveshjen e Parisit,

lufta në Indokinë nuk ka mbaruar. Ajo nuk u ka siguruar fitoren përfundimtare as popullit të Vietnamit të Veriut dhe as atij të Jugut, por as edhe popullit të Laosit. Në qoftë se u besohet premtimeve të imperialistëve, sloganeve të tyre dhe flihet qelë, kjo nuk është shenjë e mirë. Nënshkrimi i marrëveshjes së Parisit nuk duhet ta dobësojë në asnjë mënyrë bashkimin që popujt tuaj kanë formuar në luftë e sipër. Përkundrazi, ky bashkim duhet të marrë zhvillim të ri, më të lartë. Ai duhet të vlejë edhe për të ardhmen. Dy janë rrugët e mundshme: ose t'u biesh në gjunjë fuqive imperialiste, ose të rezistosh për të siguruar çlirimin e plotë. Për të vazhduar luftën deri në fund, deri në fitoren përfundimtare, është e domosdoshme të ecet në mënyrë të organizuar dhe në unitet me njëri-tjetrin.

Konstatojmë se ju në Kamboxhia jeni të vendosur për të arritur fitoren përfundimtare. Ne kemi, gjithashtu, besim se ashtu si ju, edhe vietnamezët do të jenë të vendosur dhe vigjilentë në situatat e vështira që mund të krijohen në të ardhmen. Në qoftë se populli i Vietnamit dhe popujt e tjerë të Indokinës, që luftuan e po luftojnë me heroizëm, besojnë se ajo që është arritur është gjithçka, kjo nuk do të ishte e drejtë.

Lufta që bëjmë ne dhe ju, do të bëhet akoma më e ashpër në të ardhmen, sepse imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik do të bëhen gjithmonë e më shumë agresivë. Prandaj si për ne edhe për ju është e rëndësishme dhe jetike të jemi në çdo kohë të përgatitur për luftë me armë në dorë, natyrisht, pa lënë për asnjë çast pas dore luftën politike për demaskimin e armiqtve të popujve. Fitoret që korrim



janë të përbashkëta dhe jemi të sigurt se fitorja përfundimtare na përket neve.

Ka njerëz që besojnë se sot në botë ekziston një situatë paqeje dhe uljeje tensioni. Por kjo është një situatë false, sepse armiqtë tanë nuk e dëshirojnë paqen e vërtetë. Qoftë me luftë të armatosur, qoftë edhe politikisht, ata thurin vazhdimisht intriga kundër popujve. Deklaratat e tyre për paqe nuk janë gjë tjetër veçse përpjekje për të intriguar, për të krijuar iluzione dhe për t'u thënë popujve se asnjë rrezik nuk u kanozet. Qëllimet janë të qarta. Ata duan që popujt të humbasin vigjilencën dhe të pushojnë së luftuari kundër imperializmit dhe reaksionit; ata duan t'u shkaktojnë dëm revolucionit popullor, luftërave çlirimtare, lirisë e pavarësisë së vendeve, demokracisë së vërtetë, për të cilat ëndërrojnë popujt e botës. Me përhapjen e iluzioneve për paqe ata synojnë, gjithashtu, të forcojnë fuqinë e tronditur nga themelet të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Sovjetik, të cilët punojnë për të siguruar secili për vetë zona të tjera influence. Për të arritur këto qëllime, përveç demagogjisë, kur ua lejojnë kushtet, ata përdorin edhe forcën.

Ne shqiptarët nuk mund të bëjmë një luftë me dantella, nuk mund të flasim me doreza. Ka shefa shtetesh që për arsye të ndryshme në këtë situatë konfuze, me një dorë tërheqin litarin dhe me dorën tjetër marrin para, ka të tjerë që gjoja nxjerrin mjaltë nga goja ditën, kurse natën u futin thikën popujve. Këta janë armiqtë tanë, që bëjnë një politikë të rafinuar, të djallëzuar, kurse politika jonë është kurdoherë e hapur, e sinqertë.

Imperialistët amerikanë dhe revizionistët sovjetikë, kur vjen çështja për bisedime me njëri-tjetrin, përpiqen të gjejnë fjalë të zgjedhura për të maskuar shitjen e interesave të popujve të tyre. Gjersa vënë nën këmbë interesat e popujve të tyre, ne duhet të nxjerrim mësim, sepse ata përpiqen akoma më shumë për të nxjerrë fitime të mëdha nga djersa e popujve të tjerë. Prandaj, ata e maskojnë politikën e tyre me fjalë të zgjedhura. Kjo nuk është politikë e ndershme. Politika jonë duhet të jetë e tillë që kurdoherë të kuptohet nga populli, që populli të shikojë qartë dhe të dëgjojë nga ne gjithmonë të vërtetën, kurse imperialistët, socialimperialistët dhe reaksionarët nuk veprojnë kështu, ata e kanë në natyrë gënjeshtren.

Ne admirojmë vendosmërinë e luftëtarëve kamboxhianë, strategjinë, taktikat luftarake e politike të tyre dhe shprehim besimin e patundur në fitoren e popullit tuaj. Politikën për bashkimin e forcave të ndryshme politike e shoqërore në një front për çlirim kombëtar, e konsiderojmë të drejtë.

Partia e Punës e Shqipërisë, Qeveria dhe mbarë populli shqiptar do të jenë gjithmonë me zemër me luftën tuaj të drejtë dhe, ashtu si deri më sot, edhe në të ardhmen, do ta mbrojnë, do ta përkrahin e do ta ndihmojnë luftën tuaj çlirimtare me të gjitha mundësitë e forcat e tyre. Ne kemi besim të patundur se populli kamboxhian, duke ndjekur rrugën e luftës për liri e pavarësi, do të fitojë.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQP*

# SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I PK TË BASHKIMIT SOVJETIK BISEDON ME KREUN E IMPERIALIZMIT AMERIKAN

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

21 qershor 1973

Sekretari i përgjithshëm i PK të BS mbërriti në Amerikë dhe u prit me të gjitha nderimet e ceremonitë që u takojnë mbretërve e perandorëve. As protokollin amerikan, as ai i ndonjë vendi tjetër nuk parashikon që me solemnitete të tilla të priten kryetarët e partive, e aq më tepër kur ata e quajnë veten edhe komunistë. Por amerikanët, si afaristë që janë, nuk preokupohen shumë nëse shkelet protokollin kur këtë e kërkojnë interesat e biznesit. Dhe kështu topat e vendosur në kopshtet e Shtëpisë së Bardhë, me 21 të shtëna, lajmëruan Uashingtonin dhe tërë Amerikën se sundimtari i të gjithë Ruisë i ka ardhur për vizitë presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Por ceremoniali *somptueux*<sup>1</sup> nuk e ka vënë në pozitë të vështirë as mysafirin. Duke pranuar këtë ritual perandorak, ashtu siç kishte bërë më parë në Paris e

---

1. Frëngjisht — me salltanet, luksoz.

në Bon, ai kërkon t'u thotë jo vetëm amerikanëve të thjeshtë, por edhe pasardhësve të Makartit se ata nuk duhet të kenë frikë nga emri i funksionit që mban, pasi ai nuk përfaqëson ndonjë komunizëm. Niksoni, Amerika antikomuniste, gjithë reaksioni ndërkombëtar nuk duhet të kenë frikë nga «komunizmi sovjetik», sepse ai nuk është më leninist, por një lloj surrogati, që pajtohet plotësisht në të gjitha fushat e në të gjitha drejtimet me ta.

Propagandistët borgjezë e revizionistë e kanë reklamuar vizitën e Brezhnjevit në Amerikë si një ngjarje që shënon njohjen e nevojës së bashkekzistencës paqësore dhe vendosjen e saj midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik. Sigurisht, atyre u intereson të flasin kështu që të fshehin nga bota atë çka të dy «krerët e mëdhenj» do të vendosin në bisedimet sekrete kokë më kokë. Por ajo që akoma ata nuk e thonë është vendosja e bashkekzistencës ideologjike midis imperializmit amerikan dhe atij që quhet «komunizëm sovjetik». Është pikërisht kjo bashkekzistencë ideologjike, ose më mirë kjo bashkësi ideologjike, që ka bërë dhe po bën të mundur vendosjen e atij bashkëpunimi të gjerë sovjeto-amerikan në fushat më të ndryshme, përpunimin dhe adaptimin e strategjisë së përbashkët kundërrevolucionare të të dyja superfuqive.

Brezhnjevi ka shkuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si tregtar që ka vënë në ankandin publik imperialist pasuritë kryesore të vendit të tij. Ofertat janë kaq të mëdha sa dhe bankierëve të regjur të Uoll-Stritit nuk u ka shkuar ndonjëherë ndër mend. Dhe me të vërtetë, kush mund të mendonte se Bashkimi Sovjetik

do të katandisej deri në atë gradë sa të hapte dyert për një vërshim kaq të madh e kaq të shpejtë për kapitalet amerikane, të cilat, për nga përpjesëtimet e intensiteti, po ua kalojnë edhe vendeve kapitaliste më mikpritëse të dollarit? Por është fakt se klika revizioniste që sundon tani në Kremlin po e marshallizon Bashkimin Sovjetik, po ua shet vendin copë-copë industrialistëve e monopolistëve amerikanë, po i vë pasuritë e nëntokës sovjetike nën kontrollin e trusteve të Teksasit, Çikagos a Kalifornisë.

Ka njerëz që pretendojnë se Bashkimi Sovjetik është një shtet i madh, prandaj ai mund të marrë kredi pa ndonjë frikë dhe ngado që të dojë. Këto supozime sa janë boshe, aq janë edhe naive. Historia e imperia- lizmit amerikan e ka vërtetuar, dhe veprimtaria e tij e përditshme e konfirmon, se ai nuk jep asnjë cent pa marrë rehem tapitë. Një gjë e tillë po ndodh tani edhe me Siberinë, e cila, me hyrjen në masë të kapitaleve janki në këtë zonë dhe të planeve të gjera për shfrytë- zimin masiv të nëntokës së saj nga trustet e përtejat- lantikut, i ka të gjitha kushtet të kthehet në një pro- tektorat amerikan. Por klika e Brezhnjev-it e pranon këtë, sepse synon ta vërë Kinën në një rrethim të dy- fishtë, nga një anë me ushtritë e veta që i ka përqe- ndruar prej kohësh në kufirin sovjeto-kinez dhe, nga ana tjetër, me amerikanët, që po ngulin fort këmbët dhe po i shtrijnë mjaft duart në Siberi.

E kaluara dhe e tanishmja e imperializmit ameri- kan tregojnë se atje ku ai derdh kapitalet e tij, krijon edhe bazat ushtarake për mbrojtjen e pasurive të veta. Kështu ka bërë në Tajlandë, në Vietnam e në vende të

tjera të Azisë, kështu po bën edhe në mjaft vende në Evropë, ku Shtetet e Bashkuara të Amerikës jo vetëm që kanë zënë pozitë kyç të ekonomisë, por kanë dërguar atje edhe ushtritë e veta për t'i mbrojtur me forcë këto pozita po qe nevoja, për t'i pasur si mjet presioni dhe baza agresioni ndaj të tjerëve. Pse të mos ngjasë kështu edhe me Bashkimin Sovjetik?

Duket qartë se klika e Brezhnjevit mendon se, duke u dhënë koncesione të gjera Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe fuqive të tjera imperialiste, duke u krijuar atyre mundësi të pakufizuara për investime prej miliarda dollarësh në vendin e saj, të cilin ajo e ka lënë mjaft prapa, Bashkimi Sovjetik do të mund të kapërcejë prapambetjen teknologjike dhe do të mund të bëhet konkurrent e rival i barabartë në tregun kapitalist botëror. Ndërkaq, Brezhnjevi shkon me mendje se, ndërsa kapitali i huaj do të investojë në sektorin e ekonomisë «civile», kapitalet e veta kombëtare ai do t'i investojë në ato degë që lidhen kryesisht me zhvillimin e ushtrisë e të armatimit të saj. Në pamjen e parë duket sikur plani i revizionistëve sovjetikë është mjaft i hollë dhe sikur Shtetet e Bashkuara të Amerikës po futen në thes, sikur ato, me duart e tyre, po ndihmojnë konkurrentin e vet për sundimin botëror, të forcohet ekonomikisht e ushtarakisht dhe të krijojë epërsi në sektorë që janë vendimtarë në garën midis tyre. Por, në realitet, punët qëndrojnë krejt ndryshe. Imperializmi amerikan di t'i bëjë mirë llogaritë e veta, di ku dhe si i shpenzon paratë. Ai e njeh mirë potencialin e tanishëm dhe atë të ardhshëm të ushtrisë sovjetike, ashtu siç njeh edhe potencialin e ushtrisë së vet. Sigurisht,

nuk duhet menduar se ai nuk shqetësohet fare për influencën që investimet e tij në Bashkimin Sovjetik do të ushtrojnë në raportin e forcave midis të dy vendeve, në krijimin e një gjendjeje që mund të favorizojë në njëfarë mase edhe zhvillimin e armëve. Këto dizavantazhe ai i njeh, por ai llogarit edhe rëndësinë e infiltrimit të tij në Bashkimin Sovjetik, në ekonominë sovjetike dhe në tërë jetën e vendit, degjenerimin që do të shkaktojë derdhja e investimeve të kapitaleve, gjë që do të çojë patjetër edhe në dobësimin e shkatërrimin e fuqisë mbrojtëse të Bashkimit Sovjetik.

Por mos vallë populli rus dhe popujt e tjerë të Bashkimit Sovjetik do të qëndrojnë duarlidhur kur të shohin se ata koncesionarë e fajdexhinj të huaj që u përmbysën bashkë me carizmin më 1917, ata manjatë të Nju-Jorkut, Londrës, Tokios, Berlinit, Parisit, që u dërrmuan bashkë me intervencionin e huaj, ata bankierë të pangopur të metropoleve perëndimore që organizuan bllokadën e urisë dhe kordonin sanitar kundër Rusisë sovjetike, të kthehen tani me bastun në dorë dhe qetë-qetë në uzinat e kantieret prej nga u dëbuan 56 vjet më parë? Është e pamundur që në ushtrinë sovjetike, në popullin sovjetik të jetë shuar urrejtja për këto shushunja e këta ujq të pangopur që kishin thithur gjakun dhe kishin copëtuar për dekada të tëra mishin e proletariatit rus, të jetë harruar fare ajo politikë kapitulluese e fyese e carëve të vjetër e që carët e rinj të Kremlinit po e ringjallin, të jetë zhdukur krejtësisht nga ndërgjegjja e tyre ndjenja e rrezikut të madh që u kanoset interesave të tyre kombëtarë, së ardhmes së tyre si një vend e shtet i madh.

Imperialistët amerikanë mendojnë se me Brezhnjevin tani ata mund të bëjnë çdo pazarllëk, pasi ai është, siç e paraqesin ata, njeriu i fortë i Bashkimit Sovjetik. Ata mendojnë se Brezhnjevi, pasi futi në Byronë Politike Greçkon, Gromikon e Andropovin, që qëndrojnë në krye të aparatit të ushtrisë, të politikës së jashtme dhe të policisë, i ka forcuar shumë pozitat e veta dhe se pushteti i tij është bërë i plotfuqishëm dhe i palëkundshëm. Por ata që i njohin Bashkimin Sovjetik dhe popullin sovjetik nuk mund të pajtohen me të tilla arsyetime e vlerësime. Populli sovjetik nuk mund t'i aprovojë kurrë e aq më tepër t'i përkrahë planet aventurore të Brezhnjevit, sepse të gjithë e dinë se nuk mund të ketë as shtet, as ushtri të pastër atje ku kanë infiltruar ideologjia dhe kapitali i imperializmit, ata nuk mund të mos i brejë krimbi kapitalist, të mos kalbëzohen dhe të mos degjenerojnë.

Fuqia dhe pozita e Brezhnjevit janë të dobëta nga kundërshtimet që politika e tij gjen në popullin sovjetik dhe nga mungesa e përkrahjes së masave punonjëse për vijën e tij oportuniste e antipopullore. Është fakt i njohur, gjithashtu, se me gjithë përpjekjet për t'i fshehur kundërshtimet e kontradiktat e ashpra, në udhëheqjen e lartë sovjetike ka të tilla. Ato janë mbi baza antimarksiste dhe zhvillohen mbi bazën e luftës për pushtet, prandaj kanë edhe tendencën të thellohen gjithnjë e më tepër. Ishte një kohë, pas rrëzimit të Hrushovit, kur krerët sovjetikë flisnin shumë për një frymë kolegjiale që gjoja ekzistonte midis tyre dhe Brezhnjevin e quanin «të barabartë midis të barabartëve». Por kjo periudhë, kur kritikohej «subjektiviz-



mi» i Hrushovit, mbaroi shumë shpejt. Në krye mbi të gjithë doli Brezhnjevi, i cili e përqendroi çdo gjë në duart e veta, që nga ekonomia e deri te politika e jashtme. Siç rezulton, këtij nuk i pëlqeu as takimi i Kosiginit me Xhonsenin në Glasboro dhe tani e ka lënë krejtësisht mënjanë kryeministrin e tij, që dikur, si kryetar i qeverisë, trajtonte problemet e marrëdhënieve me jashtë. Me sa duket, popullariteti që po fitonte dhe hiza e tij e pengonin shumë «shkëlqimin» që Brezhnjevi kërkonte t'i jepte vetes si mbajtës i vetëm i pushtetit në Kremlin. Aktualisht Brezhnjevi e ka marrë në duar frerën, por edhe kolegët e tij në udhëheqjen revizioniste nuk janë më të mirë. Edhe atyre, po t'u ecte, si ai do të vepronin.

Faktet tregojnë se marrja e fuqisë nga hrushovianët qe katastrofike për Bashkimin Sovjetik. Ata e kantandisën vendin deri atje sa të kërkojë bukë, makineri e patenta teknike nga imperializmi amerikan, që është armiku i betuar i popujve të të gjithë botës. Tani Bashkimi Sovjetik revizionist është shndërruar në lypës në mënyrë kaq skandaloze sa edhe partnerët e tij të ashtuquajtur socialistë nuk i furnizon dot me lëndët e para, megjithëse ndaj tyre ka angazhime që janë të vullosura edhe nga organe ndërshtetërore të krijuara posaçërisht për këtë qëllim. Dhe nga këto vuajnë ekonomia e Hungarisë, e Çekoslovakisë, e Polonisë, pale ajo e Republikës Demokratike Gjermane. Klikat revizioniste të këtyre vendeve, që janë bërë qojle të revizionistëve sovjetikë, e pranojnë me servilizëm këtë gjendje tepër të vështirë në të cilën i ka vënë Moska. Tani, në shembullin e padronit të tyre, rrugëdaljen edhe ata

duan ta gjejnë duke u lidhur me imperializmin amerikan dhe me imperialistët e tjerë. Por a do ta lejojnë këtë popujt dhe komunistët e këtyre vendeve?

Klika pseudorevolucionare që sundon sot në Kremlin u vjen në ndihmë Shteteve të Bashkuara të Amerikës në kohën kur imperializmi amerikan po kalon një nga krizat më të rënda të historisë së tij. Ajo e ndihmon atë për të kapërcyer krizën në Vietnam, në NATO, të Uotergejtit, krizën valutore, të tregjeve, të lëndëve djegëse, të sferës së investimeve të kapitaleve, e ndihmon për të mbuluar disfatat që ka pësuar në Vietnam, në Indokinë e gjetkë, për të lustruar dështimet që po pëson kursi i politikës amerikane në të gjitha zonat e kontinentet.

Nuk është e rastit që Brezhnjevi nuk do të flasë me Niksonin për çështjen e Uotergejtit, ashtu siç e ka mbyllur gojën për këtë çështje edhe shtypi sovjetik. Dhe si mund të fliste ai për të treguar që partneri i tij është një gangster i klasit të parë? Por s'mund të fliste edhe për një arsye tjetër: vetë Brezhnjevi dhe klika e tij kanë vënë nën mbikëqyrjen e shërbimeve sekrete jo disa njerëz, por tërë popullin.

Vajtja e Brezhnjevit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pazarllëqet e tij të ulëta me Niksonin dhe me krerët e tjerë të imperializmit amerikan i kanë fyer e i kanë zemëruar të gjithë bolshevikët në Bashkimin Sovjetik, të cilët s'ka si të mos ngrihen në këmbë dhe si të mos ia hanë kokën këtij Hrushovi të dytë.

Populli sovjetik, që ka një përgjegjësi të madhe përpara vetvetes dhe popujve të tjerë të të gjithë botës, me siguri do të ngrihet për t'u ndalur dorën aventurier-

rëve politikë si Brezhnjevi e kompani. Dhe populli sovjetik lëviz. Atje bëhen manifestime e demonstrata, për shtypjen e të cilave më se një herë ka ndërhyrë edhe ushtria. Klika në fuqi përpiqet t'i quajë pjesëmarrësit e këtyre demonstratave psikopatë, matrapazë, huliganë, t'i diskreditojë me çdo mjet dhe t'u atribuojë lloj-lloj etiketash, me qëllim që të ulë në sytë e opinionit të brendshëm e të jashtëm përpjesëtimet dhe rëndësinë politike të aksionit të tyre. Por e vërteta është krejt ndryshe. Në Bashkimin Sovjetik ka rezistencë të madhe ndaj klikës së Brezhnjevit e të Kosiginit, ka pakënaqësi të dukshme ndaj politikës revizioniste dhe urrejtje të theksuar për veprimet e tyre praktike, sidomos për bashkëpunimin e ngushtë me imperializmin amerikan. Në krye të kësaj rezistence janë bolshevikët e vjetër e të rinj, të cilët populli sovjetik nuk i konfondon me plekura të tilla, si Solzhenicini dhe shokët e tij. Revolucionarët sovjetikë aktualisht janë në situata të vështira dhe lufta e tyre nuk është e lehtë. Por ata do t'i kalojnë me siguri me sukses të gjitha pengesat, pasi kanë tradita të shquara dhe një eksperiencë të gjatë të luftës revolucionare dhe do të dinë t'i përballojnë sakrificat e privacionet që kërkon ajo.

Propagandistët imperialistë e revizionistë tani po i bëjnë një reklamë të madhe vizitës së Brezhnjevit te Niksoni. Ata po e pikturojnë atë me ngjyrat më të ndezura dhe nuk kursejnë asgjë për ta paraqitur si të jashtëzakonshme, historike, shpëlimtare për botën e tanishme dhe për atë të ardhshme. Me anë të kësaj zhurme tepër të madhe ata kërkojnë t'i trullosin njerëzit e thjeshtë dhe të mos i lënë të dëgjojnë e të mësojnë

ç'manovra, ç'intriga e komplete kundër popujve po kurdisen në ranxhat e mënjanuara presidenciale të Merilendit dhe të Kalifornisë. Por reklama gjithnjë është reklamë, ashtu si realiteti mbetet realitet dhe popujt nuk duhet të gënjehen nga këto zhurma mashtruese.

Ajo që tanimë ka dalë në shesh është fakti i pamohueshëm se midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik ka një koordinim e marrëveshje të plotë për politikat që ndjekin në Evropë, në Azi, në Afrikë dhe për veprimtarinë që zhvillojnë në zonat e ndara të influencës.

Në rendin e tyre të ditës është vënë edhe gjendja në Vietnam, ajo e Lindjes së Mesme, e Evropës etj. Por ç'do të bisedojnë ata për Vietnamin? Mos vallë që amerikanët të ndërpresin shkeljet e marrëveshjes, të mos përkrahin Thieun. të tërhiqen definitivisht prej andej dhe ta lënë popullin e këtij vendi të vendosë lirisht e pa ndërhyrje të huaj për problemet dhe të ardhmen e tij? Mos do të bisedojnë, vallë, për ndërprerjen e bombardimeve amerikane në Kamboxhia, për ndalimin e agresionit amerikan në Indokinë, i cili vazhdon akoma pa ndërprerje? Revizionistët sovjetikë i kanë ndihmuar gjithnjë agresorët amerikanë në Vietnam të shpëtojnë lëkurën dhe «nderin» nga moçali ku ata ishin futur. Ato që kurdisin me Niksonin tani janë komplete për të bërë presione të reja mbi Vietnamin, që ky të pranojë kushtet amerikane. janë intriga të tjera për të sabotuar rezistencën antiimperialiste të popullit heroik të Vietnamit.

Asgjë nuk mund të ofrojnë krerët e dy superfuqi-

ve edhe për zgjidhjen e problemit në Lindjen e Mesme. Gjendja e tanishme «as paqe, as luftë» është produkt i marrëveshjeve dhe i kompleteve të të dyja superfuqive, i politikës dhe i vijës së tyre për të ruajtur pozitat ushtarake, politike e ekonomike që kanë në këtë zonë. Atyre nuk u intereson që popujve arabë t'u kthehen tokat e grabitura nga Izraeli, që palestinezët të gjejnë atdheun e tyre. Ajo çka ata bisedojnë për Lindjen e Mesme ka të bëjë me mohimin dhe më tej të lirisë e të pavarësisë së popujve arabë, me mbrojtjen e interesave të vet imperialistë në këtë rajon, me forcimin e zgjerimin e zonave të tyre të influencës.

Sigurisht do të bisedohet edhe për Evropën. Por çfarë? Nuk është e rastit që Bashkimi Sovjetik nuk ka shfaqur deri më sot asnjë shqetësim për «Kartën e re të Atlantikut», ashtu si dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk tregojnë asnjë preokupim për projektet sovjetike të sigurimit evropian.

Por të gjitha këto marrëveshje sovjeto-amerikane për ruajtjen e interesave të vet imperialistë bien mbi kurrizin e shteteve evropiane, ato prekin sovranitetin kombëtar të vendeve të ndryshme, shtojnë mundësitë e ndërhyrjes në punët e brendshme të popujve të tjerë, pengojnë vendosjen e marrëdhënieve të drejta e me të vërtetë të mira midis kombeve.

Jeta po i vërteton përsëri ato që me të drejtë ka theksuar Partia jonë se alcanca kundërrevolucionare sovjeto-amerikane përfaqëson sot rrezikun më të madh për të gjithë popujt e botës dhe se kundër saj është e nevojshme të bashkohen në një front të vetëm anti-imperialist e antisocialimperialist të gjithë popujt e bo-

tës. Kundërshtimi i politikës së tyre ekspansioniste e agresive është një kusht për ruajtjen e lirisë e të pa-varësisë, të secilit vend në veçanti dhe të paqes e të sigurisë ndërkombëtare në përgjithësi.

*Botuar për herë të parë në  
gazetën "Zëri i popullit",  
nr. 147 (7753), 21 qershor  
1973*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, "Kundër revizio-  
nizmit modern" (Përmbledhje  
reprash) 1971-1975, f. 310*

## TAKIMET JANË TË NEVOJSHME PËR T'U NJOHUR ME GJENDJEN E NJËRI-TJETRIT

*Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës*

23 qershor 1973

*Pasi u përshëndet me ambasadorin, fjalën e mori shoku Enver Hoxha:*

Kemi shumë kohë që nuk jemi parë. Është e vërtetë që punë kemi shumë, por edhe takimet janë të nevojshme për t'u njohur me gjendjen e njëri-tjetrit. Këtë takim menduam ta bënim me ju, sepse duam t'ju vëmë në dijeni për bisedimet që palëm me kryetarin e shtetit të Kamboxhias, princin Norodom Sihanuk, me delegacionin që kryesonte ai, si edhe me shokët e Laosit që erdhën në vendin tonë në emër të Frontit të Bashkuar Popullor të Laosit<sup>1</sup>. Të dy delegacionet,

---

1. Siç del edhe nga ky takim me ambasadorin kinez, Partia jonë gjithmonë e njihte PK të Kinës, në mënyrë shoqërore, me qëndrimin e vet ndaj çështjeve të ndryshme ndërkombëtare dhe me situatën e brendshme në vendin tonë, duke u nisur nga pozita internacionaliste dhe nga interesi i përbashkët i të dyja palëve. Faktet dhe shumë shkrime të shokut Enver Hoxha

siç mund ta keni marrë vesh nga shtypi, i prita edhe unë.

Ardhjen e delegacionit kamboxhian, të kryesuar nga princi Norodom Sihanuk, në Shqipëri, ne e konsideruam të dobishme për vendin tonë, për Kamboxhian që lufton heroikisht kundër imperializmit amerikan dhe klikës tradhtarë të Lon Nolit.

Natyrisht, gjatë bisedimeve që patëm me delegacionin kamboxhian, u vumë në dijeni mbi situatën e brendshme, mbi zhvillimin e luftës në Kamboxhia dhe mbi perspektivën e saj, kurse ne, me mundësitë tona, u përpoqëm të ndihmonim për forcimin e situatës në Kamboxhia, të inkurajonim princin dhe shokët e tjerë kamboxhianë për të vazhduar deri në fund luftën e tyre kundër imperializmit amerikan dhe klikës së Lon Nolit. Brenda këtij kuadri ne u përpoqëm të forconim besimin në fitore jo vetëm te princi Sihanuk, po sidomos te masat e gjera të popullit kamboxhian, që janë ngritur në luftë kundër armiqve okupatorë, të forconim tek ata bindjen se lufta që bën Fronti i Bashkuar Kombëtar i këtij vendi, është e drejtë. Pa këtë luftë populli i Kamboxhias nuk mund të arrijë sukseset dhe objektivat e dëshiruar.

Objektivi tjetër ishte që të konsolidonim në mes të të dyja qeverive, popujve dhe fronteve tanë dashurinë

---

vërtetojnë se udhëheqësit kinezë tregoheshin të ftohtë në kontaktet politike me PPSH dhe nuk bënë as orvatjen më të vogël për të shkëmbyer mendime e për ta informuar atë për qëndrimin kinez ndaj ngjarjeve në botë dhe për problemet e brendshme që haste Kina në atë kohë.



dhe miqësinë që është krijuar midis nesh, që ne mendojmë se është e shëndoshë.

Me bisedimet që zhvilluam ne kishim, gjithashtu, si objektiv të ndihmonim në forcimin e unitetit midis popujve të Kamboxhias, të Vietnamit të Veriut, të Vietnamit të Jugut dhe të Laosit në luftën e tyre për arritjen e fitores së plotë kundër armiqve të përbashkët.

Këto çështje ne i prekëm gjatë një varg bisedash që patëm me Sihanukun dhe delegacionin kamboxhian. Dua të vë në dukje se gjatë bisedave ne folëm haptazi, por konstatoam se edhe miqtë folën haptazi me ne dhe ramë dakord për të gjitha çështjet që diskutuam.

*Pasi i tregoi ambasadorit kinez se si i shtroi Sihanuku çështjet e luftës për çlirimin e vendit, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Për mendimin tonë këto çështje ai i shtroi drejt dhe ne i thamë se rruga që ka zgjedhur populli kamboxhian është e vetmja që të çon në liri, në demokraci dhe në pavarësi të vërtetë të vendit. Ne i thamë se që të shporren imperialistët amerikanë, të likuidohet klika e Lon Nolit, si dhe të mos lejohen që të rifuten në Kamboxhia përfaqësuesit e borgjezisë kapitaliste franceze dhe revizionistët sovjetikë, populli jua, që ka luftuar dhe po lufton, duhet të bëjë sakrifica më të mëdha.

Sihanukut i vura në dukje se unë i flisja hapur si komunist dhe se e respektonim atë përderisa është bashkuar në një front me luftëtarët e çlirimit, me partizanët dhe me popullin kamboxhian. Me këtë rast i përmenda se Marks, mësuesi ynë i madh, na mëson se komunistët duhet t'i respektojnë të gjithë ata që shkëputen nga klasa e tyre dhe luftojnë për interesat e

popullit, pavarësisht nga prejardhja e tyre klasore.

Për sa u përket Shteteve të Bashkuara të Amerikës ç'nuk i thamë, por dhe ai na tha shumë gjëra për këtë shtet imperialist. Pastaj vazhduam t'i flisnim për sovjetikët, për poshtërsitë e tyre, për lidhjet e tyre me imperialistët amerikanë, për intrigat që bëjnë në Azinë Juglindore, për traktatin gjoja të sigurimit të Azisë etj.

Si konkluzion i të gjithë këtyre, i thamë të mos kenë asnjë fije besimi te revizionistët sovjetikë, të cilët janë socialimperialistë, janë armiq të tërbuar të popujve, të veshur me maskën e komunistit, por që nuk janë aspak komunistë, përkundrazi, janë imperialistë të rrezikshëm.

I thamë, gjithashtu, se në këtë rrugë që po ecën dhe me këto qëndrime të drejta që mban, të gjitha vështrësitë do të kapërcehen, sepse ata nuk janë vetëm, se kanë përkrah gjithë popujt përparimtarë të botës. Shfrytëzova rastin për t'i folur për vijën e Frontit, që ai ndjek, për zbatimin e reformës agrare, për hapjen e shkollave, ndërtimin e spitaleve, për pjesëmarrjen e njerëzve të popullit në qeveri etj.

*Pasi foli për probleme ushtarake e për furnizimin me armatime që i kishte trajtuar Norodom Sihanukku, shoku Enver Hoxha vazhdoi:*

Një Kamboxhia e çliruar është një ndihmë e madhe për vazhdimin me sukses të luftës në Vietnamin e Jugut kundër klikës së Thieut. Prandaj interesi ynë i përbashkët e kërkon që të ndihmohet Kamboxhia, sepse kështu u jepet një grusht i rëndë imperialistëve amerikanë. Këta e kuptojnë rrezikun, prandaj duan që Kamboxhia të mos çlirohet, përkundrazi, përpiqen të

krijohet atje një qeveri surrogato, nën sundimin e tyre dhe të sovjetikëve, sepse kështu do të dobësohen e pas-taj do të likuidohen forcat çlirimtare të Frontit të Viet-namit të Jugut dhe do të fitojë kështu përfundimisht Van Thieu.

Shoku ambasador, mendojmë që t'u transmetoni udhëheqësve tuaj dëshirën tonë që të ndihmojnë për ta zgjidhur këtë çështje në favor të Kamboxhias, që ndihmat, armatimet të venë në kohë dhe të plotë në Kamboxhia. Ata i kuptojnë mirë këto probleme, sepse e njohin situatën që po zhvillohet në gadishullin indo-kinez, por ne jemi të shqetësuar, se këtë e kërkojnë interesat tanë të përbashkët. Ne nuk mund ta lëmë Kamboxhian që lufton me heroizëm, të bjerë në thonjtë e imperialistëve amerikanë, të Thieut, të sovjetikëve dhe të reaksionarëve të Tajlandës.

Këto ishin me pak fjalë ato që biseduam me Noro-dom Sihanukun. Ne dolëm me konkluzionin se rruga më e drejtë që duhet ndjekur me të është të flitet haptazi, sepse ai çdo gjë e kupton. Përse t'ia themi çështjet në mënyrë indirekte dhe të mos ia themi haptazi? Ne kështu bëmë me të dhe kërkuam që edhe ai të na fliste haptazi.

Ne nuk kemi kontakte me komunistët kamboxhianë, por një vërejtje kishim, të cilën ia kemi thënë një përfaqësuesi të Partisë Komuniste të Kamboxhias, anëtar i delegacionit, dhe dëshirojmë t'ia themi edhe Partisë Komuniste të Kinës. Shokët kamboxhianë dinë vetë si të veprojnë, por ne i vumë atij në dukje nevojën e një bashkëpunimi të ngushtë me princin Sihanuk, qëndrimi i të cilit ka evoluar në favor të luftës nacionalçlirimtare të popullit kamboxhian.

Kur e pyetëm herën e parë përfaqësuesin e Partisë Komuniste të Kamboxhias nëse princi e dinte që ai ishte komunist, na u përgjigj se Sihanuku nuk e njihte si të tillë. Ne i thamë se kjo na dukej jo e drejtë, sepse mendojmë që Sihanuku e merr me mend një fakt të tillë, prandaj asgjë të keqe nuk ka sikur ta dijë hapur.

Kur e pyetëm përsëri, pas kthimit të delegacionit kamboxhian nga Jugosllavia, nëse princi e kishte marrë tashmë vesh që ishte komunist, ai na u përgjigj: Po. Vihet pyetja: Po përse t'i thuhej sivjet dhe jo që vitin e kaluar ose që kur u krijua Fronti i Bashkuar Kombëtar i Kamboxhias? Kjo, mendojmë ne, duhej të ishte bërë me atë që shokët kamboxhianë po bashkëpunojnë. Atyre u bie detyra të influencojnë mbi Sihanukun dhe të mos lënë të tjerët të influencojnë mbi të, se ka rreziqe. Princi vjen nga një klasë tjetër, prandaj duhet bërë një punë me të vërtetë intensive dhe shumë serioze me të për ta mbajtur në anën tonë.

Edhe për sa i përket çështjes së ilegalitetit të Partisë Komuniste të Kamboxhias, vihët pyetja: Duhet të jetë ajo në ilegalitet në kushtet aktuale, apo jo? Kjo, natyrisht, është puna e shokëve kamboxhianë dhe jo jona, por ne mendojmë që e rrugës dhe e drejtë duhet të jetë që partia në Kamboxhia të mos jetë ilegale. Mendojmë se disa gjëra të tilla është e nevojshme të sqarohen dhe qëndrime kaq të ngurta të mos mbahen.

Gjatë bisedave, Sihanuku ngriti edhe çështjen e njohjes së qeverisë së tij në OKB. Për këtë qëllim ai kërkoi që ne të luftojmë atje. Unë i thashë që ne shqiptarët jemi dakord të luftojmë në OKB për çështjen kamboxhiane dhe, me këtë rast, do të vazhdojmë të de-

maskojmë njëkohësisht amerikanët e sovjetikët dhe do të përpiqemi të forcojmë pozitën e të lëkundurve.

Për sa i përket delegacionit laosian, shokët tanë patën disa herë bisedime me të. Në takimin që pata edhe unë me këtë delegacion, u njohëm me situatën e përgjithshme në Laos, që ju e dini dhe s'është nevoja ta përsëris. Kryetari i delegacionit foli shkurt për situatën plot kontradikta që është krijuar në vend. Ai na tha se është fitore e madhe marrëveshja që u arrit, se lufta do të vazhdojë, dhe në fakt vazhdon, dhe se palët pëgoditen me njëra-tjetrën. Amerikanët, për t'u maskuar, janë veshur tani si civilë. Kështu, në zonat fushore të Laosit janë reaksionarët vendës dhe bashkë me ta edhe amerikanët.

Kryetari i delegacionit tha se dy-tre vjet më parë me palën e Suvana Fumës kishin nënshkruar një marrëveshje, së cilës ata i qëndrojnë, kurse pala tjetër jo. Pastaj na foli për Frontin, për partinë që është në ilegalitet, e padeklaruar. Ne i pyetëm shokët nga Laosi nëse kanë qeveri në një kohë kur reaksionarët laosianë kanë qeverinë e tyre, të drejtuar nga princi Suvana Fuma. Ata u përgjigjën se nuk e kanë krijuar akoma qeverinë.

Bisedat tona u zhvilluan në mënyrë shumë shoqërore dhe të ngrohtë. Ne mendojmë se nga takimet që bëmë me miqtë kamboxhianë dhe laosianë në vendin tonë, të dyja palët u larguan të kënaqura nga Shqipëria. Edhe ne mbetëm të kënaqur prej tyre.

Siç ju kemi vënë në dijeni, ka më se tre muaj që pozien situata në Shqipëri në lidhje me punimin e materialeve të kohëve të fundit të Partisë. Kjo ka qenë

një punë jashtëzakonisht e nevojshme dhe shumë frytdhënëse në Parti dhe në popull. Tani ka një mobilizim më të madh në të katër anët e vendit.

Situata jonë e brendshme ka qenë dhe është shumë e shëndoshë, por shfaqjet e huaja, qofshin të vogla, Partinë e kanë preokupuar dhe e preokupojnë vazhdimisht. Për arsye të rrethimit kapitalisto-revizionist të vendit tonë, këto shfaqje negative janë aktivizuar sidomos nga presioni i propagandës së madhe armiqësore që na bën bota e jashtme kapitaliste, si dhe mbeturinat e klasave të përmbysura brenda vendit. Prandaj e mbajmë dhe duhet ta mbajmë kurdoherë të ngritur vigjilencën revolucionare dhe t'i luftojmë vazhdimisht këto fenomene, që të mos zënë vend në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Natyrisht, që të mundim ta mbajmë të pastër «dhomën», kërkohet një punë e përditshme, e vazhdueshme, politike dhe ideologjike, kërkohen masa organizative dhe ekonomike sa më të përshtatshme, një shtjellim sa më harmonik e shkencor të politikës dhe të ideologjisë, të ligjeve dhe të formave të organizimit. Në këtë luftë të vazhdueshme ne përpiqemi të gjejmë edhe mjetet më të mira të punës, të cilat janë të shumta, por edhe format më të mira të përdorimit të tyre.

Ja, për shembull, kjo punë që po bëhet jo vetëm ndihmon për revolucionarizimin e mëtejshëm të masave, por edhe për përgatitjen e mbledhjes së Plenumit të Komitetit Qendror, që do të bëjmë më 26 qershor<sup>1</sup>. Tezat që ka dhënë Partia në popull, kanë ndihmuar e po ndihmojnë për përgatitjen e komunistëve dhe të

---

1. Shih në këtë vëllim, f. 277.

masave të popullit në luftën konkrete që po bëjnë kundër shfaqjeve të huaja dhe për forcimin e situatës në të gjitha drejtimet e fushat, në Parti, në ekonomi, në art, në kulturë etj. Këto teza, që na kanë ndihmuar të nxjerrim konkluzione për punën e kryer, janë një eksperiencë e madhe që do t'ia sjellim Komitetit Qendror për ta përpunuar dhe t'ia çojmë pastaj përsëri Partisë. Plenumi i Komitetit Qendror që do të mbahet së shpejti, nuk është përgatitur në zyra, por në jetën e gjallë. Raporti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror që më është ngarkuar ta mbaj unë, do të jetë sinteza e gjithë eksperiencës së madhe të Partisë dhe të popullit. Ai do të bëhet objekt i diskutimeve në Plenum.

Këto kisha për t'ju thënë, shoku ambasador. Më falni se ju lodha, por, meqenëse kisha shumë kohë pa ju parë, dëshiroja të bisedonim më gjatë bashkërisht.

*Botohet për herë të parë sipas shënimeve të mbajtura në këtë takim, që gjenden në AQF.*

# TË THELLOJME LUFTËN IDEOLOGJIKE KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA E QËNDRIMEVE LIBERALE NDAJ TYRE

*Raport në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH<sup>1</sup>*

26 qershor 1973

Shokë dhe shoqe,

Ky Plenum i Komitetit Qendror i kushtohet një problemi të madh e jetik për Partinë dhe për çështjen e ndërtimit socialist: problemit të luftës kundër ndikimeve të ideologjisë së huaj borgjeze e revizioniste, për rrënjosjen e ideologjisë proletare në të gjitha frontet, në çdo kohë dhe veçanërisht në kushtet e tanishme të rrethimit armiqtësor imperialisto-revizionist të vendit.

Këto probleme, me të cilat ne jemi ndeshur vazhdimisht, kohët e fundit janë bërë më të mprehta, prandaj edhe kanë tërhequr në mënyrë të veçantë vëmendjen e Partisë dhe të të gjitha masave punonjëse. Par-

---

1. Ky Plenum, që i zhvilloi punimet nga 26-28 qershor 1973, diskutoi rreth raportit të Byrosë Politike të KQ të PPSH "Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre".



tia kritikoi me guxim e me principialitet marksist-leninist mjaft shfaqje të huaja, që ishin dukur në disa sfera të jetës sonë shoqërore, si rezultat i ndikimeve të shoqërisë së vjetër e sidomos i presionit të botës kapitaliste e revizioniste. Masat që janë marrë për të luftuar këto fenomene negative përbëjnë një hap të mëtejshëm me rëndësi në thellimin e procesit të revolucionarizimit të të gjithë jetës së vendit.

Megjithëse ka kaluar një kohë relativisht e shkurtër, që kur Partia ngriti përpara gjithë popullit këto probleme, vërehet me kënaqësi se është bërë një punë e madhe dhe janë arritur rezultate mjaft pozitive në të gjitha fushat. Në radhë të parë, duhet vënë në dukje kuptimi i thellë, aprovimi unanim dhe gatishmëria që shprehën me këtë rast komunistët, klasa punëtore, rinia dhe të gjithë punonjësit. Tani kudo është krijuar një atmosferë e gjallë debati e ballafaqimi për të kritikuar të metat, për të zbuluar dobësitë e shfaqjet e huaja në qendrat e punës, në institucionet kulturore artistike, në shkolla e në familje, për të përcaktuar rrugët efektive të kapërcimit të tyre. Në qytet e në fshat po krijohet një frymë e shëndoshë mobilizimi për realizimin e planit e për kryerjen e detyrave, për forcimin e disiplinës proletare në punë dhe për mbrojtjen e pasurisë së popullit. Është ngritur në një shkallë të re më të lartë vigjilenca ideologjike e politike ndaj armiqve të brendshëm e të jashtëm dhe përgatitja luftarake për mbrojtjen e atdheut.

Në këtë atmosferë revolucionare kanë shpërthyer një varg iniciativash të vlefshme në sferën e prodhimit, të ideologjisë e të kulturës etj. Ato janë një shprehje

je konkrete e kuptimit të drejtë të situatave të brendshme e të jashtme në të cilat jetojmë, e vetive të larta morale që ka rrënjosur Partia në popullin punonjës, e unitetit të çeliktë të tij rreth Partisë dhe e vijës së saj të drejtë marksiste-leniniste.

Të gjitha këto janë një premisë dhe garanci për suksese edhe më të mëdha në të ardhmen. Por ne nuk mund të kënaqemi me këtë që është arritur dhe as mund të mendojmë se problemet e ngritura kohët e fundit nga Partia tanimë janë zgjidhur plotësisht. Përkundrazi, është e domosdoshme të ndalemi e të thellohemi akoma më tej në disa drejtime të rëndësishme të luftës klasore për të shkatërruar të gjitha ndikimet e ideologjisë së huaj, të së kaluarës dhe të së sotmes, borgjeze e revizioniste, për të forcuar edhe më shumë diktaturën e proletariatit, për të çuar përpara pa ndërprerje revolucionin dhe ndërtimin tonë socialist.

Shokë,

Lufta kundër ideologjisë së huaj për rrënjosjen e ideologjisë socialiste në të gjithë punonjësit e në të gjitha frontet ka qenë kurdoherë një ndër preokupacionet kryesore në tërë veprimtarinë e Partisë. Këtë luftë ajo e ka parë gjithnjë si një ndër kushtet themelore për zhvillimin e pandërprerë të revolucionit dhe për ndërtimin e socializmit, për formimin dhe kalitjen e njeriut të ri të shoqërisë së re. Ajo e ka parë këtë, gjithashtu, si një kusht të domosdoshëm për vetë ekzistencën dhe zhvillimin e saj si parti marksiste-leniniste, për të qenë

e aftë të kryejë qoftë detyrën e saj kombëtare, ashtu edhe detyrën e saj internacionaliste.

Lindja dhe ardhja në fuqi e revizionizmit në Bashkimin Sovjetik, e në disa vende të tjera, ku nënvleftësimi i luftës kundër ndikimeve të ideologjisë borgjeze u bë një ndër shkaqet e rëndësishme të degjenerimit të rendit socialist dhe të vetë partisë, na e forcon edhe më tepër bindjen tonë të drejtë se, pa një luftë këmbëngulëse për çrrënjosjen e ndikimeve të ideologjive të huaja, qoftë të vjetra feudale e mikroborgjeze, qoftë të sotme borgjeze e revizioniste, pa arritur fitoren vendimtare të revolucionit socialist edhe në frontin ideologjik, nuk mund të jenë të sigurta fitoret e tij as në frontin ekonomik e politik.

Të gjithë ne jemi dëshmitarë për sukseset e mëdha e me rëndësi historike që janë arritur në luftën e vendosur që Partia, në krye të masave punonjëse, ka zhvilluar kundër ideologjisë borgjeze e revizioniste, ideologjisë fetare, patriarkale e feudale. U krye një hop i madh cilësor për emancipimin e plotë të gruas, u morën masa të rëndësishme për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës, për çrrënjosjen e burokratizmit etj. Rezultate të mëdha janë arritur në edukimin revolucionar të njeriut të ri, janë krijuar te punonjësit bindje të thella ideologjike socialiste për punën, për pronën, për shoqërinë dhe familjen. Parulla e Partisë «të mendojmë, të punojmë, të luftojmë e të jetojmë si revolucionarë» frymëzon e mobilizon të gjithë njerëzit tanë.

Kongresi i 6-të i Partisë, duke thelluar më tej këtë proces revolucionarizimi, e vuri theksin më me forcë te nevoja e një lufte frontale, jo vetëm kundër mbe-

turinave e gjurmëve konservatore të së kaluarës, por sidomos edhe kundër ndikimeve të rrezikshme të ideologjisë së sotme borgjeze, revizioniste e liberale, e cila ushtron pa ndërprerje e intensivisht presionin e saj mbi ne. Këtë luftë në dy fronte, me shumë të drejtë, ai e quajti si një kusht vendimtar për të siguruar fitore të qëndrueshme në luftën kundër ideologjive të huaja.

Fitoret e arritura në luftën kundër shfaqjeve e ndikimeve të huaja janë të mëdha. Por ne nuk mund të mos mbajmë parasysh se, në kushtet aktuale të rrethimit dhe të një presioni të gjithanshëm imperialisto-revizionist, jemi shumë larg asaj që të mendojmë se jemi të imunizuar nga rreziqet. Sukseset që ka arritur Partia jonë në luftën për demaskimin e imperializmit dhe të revizionizmit në plan politik e teorik, sidomos në polemikën e madhe me revizionizmin modern, nuk duhet të na çojnë të mendojmë në asnjë rast se ato përbëjnë, në të njëjtën kohë, edhe një barrierë të pakapërcyeshme për depërtimin e ideologjisë së huaj në fusha të ndryshme të jetës së vendit dhe në ndërgjegjen e njerëzve tanë. Fakt është se armiqtë nuk e kanë pushuar aspak luftën që bëjnë kundër nesh. Ata kanë ndryshuar vetëm taktikën, duke i përqendruar përpjekjet e tyre sidomos në frontin ideologjik. Për t'i hapur rrugën degjenerimit të njerëzve e të rendit tonë socialist, më shpesh dhe me më shumë dëshirë, ata shfrytëzojnë vatrat dhe gjurmët e ideologjive të vjetra në ndërgjegjen e punonjësve, veçanërisht konceptet e shprehita individualiste mikroborgjeze. Armiqtë e brendshëm e të jashtëm inkurajojnë e përkrahin njëri-

-tjetrin në rrugë e në forma të ndryshme, bashkërendojnë veprimtarinë e tyre kundër pushtetit popullor e socializmit.

Nga ana tjetër, ka situata në botë që vetvetiu të shtyjnë drejt një mobilizimi të madh për të rritur vigjilencën e për t'i grumbulluar të gjitha forcat kundër ideologjisë e politikës, qëndrimeve e veprimeve të armikut.

Një erë pacifiste e kapitullimit po mbyllet atmosferën. Një frymë pajtimi e kompromisi përpiqen imperialet amerikanë e revizionistët sovjetikë të përhapin në Evropë e në Azi, në Afrikë e në Amerikë. Tani po përfundon lufta në Vietnam, po flitet se edhe gjendja në Lindjen e Mesme mund të rregullohet në mënyrë paqësore, po bëhet fjalë për njëfarë sigurimi e pakësimi trupash në Evropë, po reklamohen gjerësisht rezultatet e përmirësimit të marrëdhënieve midis fuqive të mëdha dhe po propagandohen shumë takimet e bisedimet e shpeshta midis burrave të shtetit etj. Këto situata mund të krijojnë një frymë çmobilizimi, mund të krijojnë opinionin se lufta është larg, se «bota po qetësohet».

Taktika e përhapjes së kësaj psikoze paqësore të rreme, si mjet për të përçarur më mirë agresionin ushtarak e ideologjik, mbështetet tani nga një mori teorish e doktrinash, që imperialistët e revizionistët i kanë krijuar posaçërisht për këtë punë. Ata flasin shumë për «bashkekzistencë paqësore», për «ulje tensioni», për «bisedime» etj. Të gjitha këto nuk janë parulla të thjeshta propagandistike, por edhe mekanizma ideologjikë, mjete për krijimin e një psikologjie të përgjithshme fataliteti ndaj ngjarjeve që ndodhin në botë, janë përpjekje për

t'i përgatitur popujt edhe ideologjikisht që të pranojnë arbitraritetin e super të mëdhenjve dhe fatin që u caktojnë ata.

Këtë frymë pacifiste imperialistët e revizionistët orvaten ta futin edhe te ne me anë të lajkave, të propozimeve për «marrëdhënie normale», duke u përpjekur të na mbushin mendjen se asnjë rrezik s'na kërcënon dhe se mund të jetojmë të çmobilizuar e të shkujdesur. Kjo taktikë djallëzore e shumë e rrezikshme synon të na mbyllë vigjilencën dhe të nxitë e të inkurajojë liberalizmin e shturjen. Për ne duhet të jetë e qartë se edhe në qoftë se aktualisht ekziston njëfarë uljeje tensioni, kjo mund të jetë e vërtetë vetëm midis superfuqive imperialiste, por nuk ka e nuk do të ketë ulje tensioni midis atyre e nesh, midis popujve nga njëra anë dhe imperialistëve e socialimperialistëve nga ana tjetër. Ne e kemi krejtësisht të qartë se strategjia imperialisto-revizioniste për të shuar luftërat e lëvizjet revolucionare, çdo rezistencë kundër hegjemonisë së tyre, për të shkatërruar e shtypur çdo forcë, shtet apo parti që kundërshton sundimin e superfuqive, ka mbetur e pandryshuar. Kanë ndryshuar vetëm taktikat si dhe mjetet që përdorin, të cilat janë bërë më të shumta e më të përsosura.

Marrëveshjet e bashkëpunimi midis fuqive të mëdha, para së gjithash midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës e Bashkimit Sovjetik, të cilat sa po vijnë e zgjerohen, nuk mund të mos shprehen dhe të mos përfundojnë në një rritje të presionit të tyre ndaj vendeve të vogla të pavarura, në shtimin e përpjekjeve për të ndërhyrë në punët e brendshme të vendeve sovrane,

në intensifikimin e luftës për t'i detyruar të tjerët të pranojnë diktatin e tyre në çështjet e marrëdhënieve ndërkombëtare, në zgjerimin e veprimtarisë për t'u imponuar popujve e kombeve mënyrën e tyre të të menduarit e të të jetuarit. Është e natyrshme që në këtë situatë të re të bëhet edhe më i madh presioni i gjithanshëm ekonomik, politik e ushtarak imperialisto-revizionist mbi vendin tonë, me qëllim që të mbytetë të vetmin zë në Evropë që ngrihet me guxim kundër politikës së tyre agresive ekspansioniste, që u çjerr maskën me guxim planeve të errëta, demagogjisë e mashtrimeve të superfuqive kundër popujve e revolucionit.

Imperialistët e revizionistët kanë dashur e duan likuidimin e socializmit në Shqipëri. Këtë ne e dimë. Por ajo që duhet të mbajmë më mirë parasysh është se për ne nuk ekziston vetëm rreziku i drejtpërdrejtë ushtarak, por edhe agresioni ideologjik. Për më tepër, presioni dhe lufta ideologjike, që na bën armiku, është parapërgatitje e pararendëse edhe për një sulm të mundshëm ushtarak. Ne nuk duhet të harrojmë për asnjë çast se jemi një vend i vogël dhe, për shkak të qëndrimeve parimore revolucionare, ndodhemi në qendër të presioneve të gjithanshme ideologjike të botës kapitaliste e revizioniste. Nga ana tjetër, ne nuk mund të jetojmë të izoluar nga bota e jashtme, ndikimet e së cilës me anën e mjeteve të ndryshme të informacionit e të propagandës, që sot janë masivizuar e përsosur si asnjëherë më parë, si dhe nëpërmjet kontakteve, që s'mund të shmangen, depërtojnë në vendin e në njerëzit tanë nëpër shumë kanale. Prandaj, Partia e ka theksuar shumë herë se krahas përgatitjes serioze ushtarake dhe

ekonomike për çdo të papritur, duhet të merren të gjitha masat e të mobilizohen të gjitha forcat për të shpartalluar edhe agresionin ideologjik të armikut. Në këtë luftë për jetë a vdekje ne duhet të mbajmë parasysh se presioni ideologjik është i përhershëm, se kundër tij nuk luftohet e fitohet vetëm një herë, por duhet luftuar e fituar çdo ditë, çdo muaj, çdo vit.

Thelbi i këtij agresioni ideologjik dhe synimi kryesor i armikut të klasës në kushtet e sotme për degjenerimin e rendit socialist, të politikës së brendshme e të jashtme të Partisë e të shtetit tonë, është nxitja e liberalizmit në të gjithë frontin.

Është pikërisht kjo rruga nëpër të cilën në Bashkimin Sovjetik e në disa vende të tjera u arritën ato rezultate kundërrevolucionare, që imperializmi nuk kishte mundur t'i arrinte as me intervencionin e armatosur e as me anën e agresionit fashist. Nën parullën e liberalizmit u hodh baltë mbi Stalinin e veprën e tij dhe u shkatërrua diktatura e proletariatit. Nën këtë parullë u hap rruga për reformat ekonomike revizioniste, që çuan në likuidimin e marrëdhënieve socialiste në prodhim e në zëvendësimin e tyre me marrëdhënie të reja kapitaliste. Në jetën shpirtërore liberalizmi u bë kyçi që hapi dyert për vërshimin e kulturës e të mënyrës së degjeneruar perëndimore të jetesës. Dhe përsëri po nën këtë parullë u hodh poshtë vija e luftës së vendosur kundër imperializmit, vendin e së cilës e zuri politika hrushoviane e hapjes drejt Perëndimit dhe e bashkëpunimit të gjithanshëm me imperializmin amerikan.

Liberalizmi mund të shfaqet në fushat e në format më të ndryshme. Por sido e kudo që të paraqitet, ai



është në thelb shprehje e oportunizmit ideologjik e politik, heqje dorë nga lufta klasore konsekuente kundër armiqve të jashtëm e të brendshëm, kundër njollave të shoqërisë së vjetër dhe ndikimeve të sotme të ideologjisë së huaj, është pranim i bashkëjetesës paqësore me ideologjinë armike. Duke nxitur liberalizmin, armiqtë kërkojnë që ne të heqim dorë nga qëndrimet e lufta jonë parimore kundër revizionizmit modern, të heqim dorë nga lufta e vendosur kundër imperializmit dhe të hapim kufijtë «për qarkullimin e lirë të njerëzve, të ideve e të kulturave». Ata duan të përhapin një kupim liberal e anarkist të demokracisë socialiste, me qëllim që të shthurin disiplinën proletare në punë, të ninojnë diktaturën e proletariatit. Ata dëshirojnë që njerëzit tanë të kulturës e të arteve të braktisin partishënerinë proletare për t'i hapur rrugën lulëzimit të gjithfarë rrymave dekadente borgjeze e revizioniste. Ata kërkojnë që njerëzit tanë, rinia e të gjithë punonjësit, të përqafojnë mënyrat e degjeneruara të sjelljes, të shijesë të jetesës së botës së kalbur borgjezo-revizioniste.

Karakteristikë e diversionit të sotëm ideologjik të borgjezisë e të revizionizmit kundër socializmit është bashkimi në një front të vetëm i rrymave themelore kundërrevolucionare, që nga ideologjia e mirëfilltë borgjeze me karakter të hapët antikomunist deri tek oportunizmi i vjetër tradicional, që nga revizionistët modernë deri te rrymat e sotme oportuniste të ashtuquajtura të majta. Të gjithë këta, pavarësisht nga ç'pozitë e goditin marksizëm-leninizmin e socializmin, pavarësisht me ç'parrulla e «argumente» dalin kundër tyre, bashkohen në synimin kryesor, në qëllimin për të tre-

guar se kapitalizmi i ka kapërcyer kontradiktat e tij, se shoqëria borgjeze është përmirësuar, se tanimë kapitalizmi e socializmi po konvergjojnë drejt një shoqërie të njëjtë, se s'ka më vend për luftë klasore, s'ka më vend për përmbysje revolucionare, s'ka më vend për ideale komuniste etj.

Për të propaganduar këtë tezë thellësisht reaksionare, për të trulllosur mendjen e njerëzve, për të çoroditur psikikën e tyre dhe për të futur degjenerimin, borgjezia dhe revizionistët kanë ngritur në këmbë një industri tepër të fuqishme të helmimit të opinionit publik, e cila, për nga kapitalet e vëna dhe njerëzit e zënë në të, i kalon edhe degët më të mëdha të ekonomisë. Në dispozicion të tyre ndodhen mjete të shumta të komunikimit masiv, me ta janë të lidhura ngushtë letërsia dhe arti, moda e reklama, shtypi e radioja, televizioni dhe filmi.

Kjo valë e madhe propagandistike përplasat edhe në brigjet tona. Ajo plekset ngushtë me shumë njolla të së kaluarës në ndërgjegjen e punonjësve, veçanërisht me shfaqjet e individualizmit mikroborgjez. Këto dy anë ushqejnë njëra-tjetrën, e vjetra dhe modernistja shkrihen në një front të vetëm luftime kundër socializmit e diktaturës së proletariatit. Për pasojë, edhe lufta jonë kundër këtyre dy të këqijave përbën një front të vetëm kompleks e të pandarë. Detyra jonë është që ta përballojmë me të gjitha forcat e mjetet presionin e ndikimeve të huaja ideologjike, që ushtrohet pikërisht në këto rrethana të reja të jashtme e të brendshme dhe të kundërsulmojmë aktivisht. Këtë luftë duhet ta konsiderojmë si një nga aspektet më të rëndësishme të luftës klasore për fitoren e rrugës socialiste mbi atë kapitaliste.

Diskutimi i gjerë në Parti e në masa për luftën kundër ndikimeve të huaja e shfaqjeve liberale vërtetoi se shqetësimet e Partisë dhe ato të punonjësve ishin plotësisht me vend. Gjatë këtij diskutimi dolën mjaft probleme të karakterit ideologjik që kanë të bëjnë me zhvillimin në rrugë të drejtë të artit e të letërsisë, të arsimit e të kulturës, me edukimin e rinisë, me forcimin e disiplinës, që kanë të bëjnë me përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë së vetë Partisë dhe rritjen e rolit udhëheqës të saj. Të gjitha këto probleme ne duhet t'i analizojmë në këtë Plenum në frymë kritike e autokritike dhe të përcaktojmë rrugët e masat për ta mbajtur gjallë atmosferën revolucionare që është krijuar dhe për ta çuar akoma më përpara luftën e Partisë në të gjitha frontet.

### **Forcimi i partishmërisë proletare — kusht i domosdoshëm për zhvillimin në rrugë të drejtë të letërsisë e të arteve**

Partia ka treguar një kujdes të vazhdueshëm për zhvillimin në rrugë të drejtë të letërsisë e të arteve dhe i ka konsideruar ato gjithmonë si mjete të fuqishme për edukimin komunist të masave, veçanërisht për formimin ideoestetik të tyre. Letërsia dhe artet kanë ecur në një hap me tërë zhvillimin e jetës së vendit, me thellimin e revolucionit ideologjik e kulturor dhe kanë dhënë një kontribut të madh për formimin e edukimin e njeriut të ri, për ngritjen në një shkallë më të lartë të kulturës sonë të re socialiste.

Shkrimtarët dhe artistët tanë, të udhëhequr nga mësimet e Partisë, besnikë ndaj marksizëm-leninizmit, kanë krijuar vepra të frymëzuara dhe me brendi të shëndoshë. Arti ynë me përmbajtje socialiste dhe revolucionare ka vulën kombëtare, shpreh ndërgjegjen e popullit tonë në momentet e mëdha historike që kemi kaluar dhe po kalojmë. Ky art pëlqehet nga masat dhe është një ushqim shpirtëror për to. Populli i do dhe i respekton shkrimtarët dhe artistët e vet.

Sukseset e letërsisë e të artit flasin qartë për gjallërimin e metodës së realizmit socialist, të parimit të saj themelor, partishmërisë proletare, për harmonizimin e saj me frymën popullore e kombëtare dhe traditën e shëndoshë realiste. Zhvillimi i arteve, ashtu si ai i gjithë jetës shpirtërore të shoqërisë sonë, është bërë në luftë me ndikimet e huaja ideologjike të vjetra e të reja, konservatore e moderniste, sidomos me ato borgjezo-revizioniste. Një rëndësi të veçantë në këtë luftë kanë pasur orientimet e Plenumit të 15-të të vitit 1965 të Komitetit Qendror.

Por vitet e fundit, si rezultat i presionit të ideologjisë së huaj, e sidomos i dobësive të karakterit subjektiv, në letërsi, në art e në kulturë janë vërë re disa ndikime të hapëta të ideologjisë borgjeze e revizioniste, janë mbajtur qëndrime liberale ndaj tyre. Ato i kanë sjellë dëm zhvillimit të letërsisë e të arteve tona. Në të gjitha diskutimet që janë zhvilluar është vënë në dukje rreziku që përbëjnë këto ndikime të huaja, si mjet i diversionit ideologjik imperialisto-revizionist, për t'i larguar letërsinë e artin nga rruga e drejtë revolucionare e realizmit socialist dhe nga tabani i shëndoshë kombë-

tar, për t'i shmangur ato nga vija e Partisë dhe nga orientimet e saj të drejta.

Në përhapjen e këtyre ndikimeve një rol të dorës së parë kanë luajtur imitimet e modeleve të huaja, të rrymave të vjetra e të reja dekadente e moderniste, kopjimet e hapëta e mekanike të modës së sotme artistike borgjeze e revizioniste, si dhe konceptimet e gabuara të proceseve të zhvillimit tonë të brendshëm, të cilat e kanë burimin edhe te boshllëqet në formimin politik, ideologjik e profesional të disa krijuesve.

Në disa vepra të letërsisë e të artit, drama, poezi e poema, tregime e novela, në ndonjë film etj., është shtrembëruar realiteti. Kontradiktat e ndryshme dhe lufta që zhvillojnë Partia e populli kundër fenomeneve negative, pengesave e vështirësive janë pasqyruar jo nga pozitat e Partisë, por nga pozita të kundërta me to. Kështu, në mjaft raste lufta kundër burokratizmit jepet e gabuar në thelbin e saj, organet e pushtetit tonë paraqiten të mbytura nga burokratizmi dhe masat punonjëse krejt të pafuqishme në luftën kundër burokratëve. Në disa drama e vepra të tjera letrare kontradiktat në gjirin e popullit trajtohen, gjithashtu, shtrembër. Në emër të «së resë», synohet të mohohet e sotmja dhe lufta midis së vjetrës e së resë paraqitet si luftë e pashmangshme midis brezave. Ndikimet e huaja kanë çuar deri atje sa në ndonjë tregim të errësohen madhështia e Luftës Nacionalçlirimtare dhe heroizmi partizan.

Pasojë e ndikimeve të huaja është edhe kapja e tepruar pas temave të vogla intime, largimi nga problemet e mëdha shoqërore, tema e vetmisë së njeriut, kur

ky na u shndërruaka në kërmill, në fik deti e absurditete të tjera, fenomene që lidhen me ndikimin e filozofisë e të estetikës ekzistencialiste, si dhe të rrymave letërnare, si simbolizmi etj. Këto fenomene, që janë vërejtur në disa poezi e tregime, në tekste këngësh, në disa piktura etj., janë në kundërshtim me frymën militante revolucionare të letërsisë e të artit tonë, me patosin qytetar dhe me karakterin epik të tyre.

Në poezi është shfaqur prirja e përdorimit të një figuracioni të errët në kundërshtim me traditën e poezisë aq të qartë shqipe. Disa të paktë poetë të rinj, filluan të adoptonin në poezitë e tyre hermetizmin. Kjo është fare e huaj për letërsinë tonë, për njerëzit tanë të një vendi socialist me një demokraci proletare. Shkrimet e errëta nga brendia e forma janë pjellë e mendimit dhe e ndjenjave të çoroditura të njerëzve ku sundon regjimi i kapitalit, i shtypjes dhe i shfrytëzimit të njeriut, i shtypjes kombëtare dhe i mungesës së lirisë së shprehjes së mendimeve.

Fenomene të kësaj natyre janë vënë re edhe në muzikën e lehtë, sidomos në atë ritnike, ku ka pasur deformime të vijës së qartë melodike dhe u është hapur rrugë ritmeve të shfrenuara. Kjo u duk sidomos në festivalin e 11-të të këngës në Radiotelevizion. I tërë opinioni ynë shoqëror e refuzoi me indinjatë atë muzikë vulgare, ato këngë të përçmuara dhe atë paraqitje snobiste që ky festival na nxori në skenë. Ai me të drejtë e konsideron dhe e dënon atë si një ofendim që i bëhet traditës më të mirë kombëtare, frymës popullore dhe partishmërisë së artit tonë.

Shfaqje të tilla të huaja janë dukur edhe në disa

piktura, në paraqitjen skenike të ndonjë vepre teatrale e operistike, në kopertinat e librave etj. Shmangie të tilla kanë ndikuar drejtpërsëdrejti si në formën, ashtu edhe në brendinë e letërsisë e të artit tonë.

Këto prirje të shtrembra janë në kundërshtim me partishmërinë e letërsisë e të artit, me rolin formues dhe edukues, me karakterin popullor e kombëtar të tyre. Ato vënë një barrierë midis artit dhe popullit, zbehin natyrën demokratike që duhet të ketë arti ynë, prishin shijet e masave punonjëse.

Shkaku themelor i përhapjes së këtyre ndikimeve të huaja është moszbatimi me konsekuencë dhe largimi nga orientimi i drejtë i Partisë për zhvillimin e një lufte ideologjike frontale, në të dy krahët, si kundër konservatorizmit, ashtu edhe kundër liberalizmit. Nga disa punonjës e kuadro drejtues të sektorit të kulturës, të letërsisë e të arteve është nënvleftësuar rreziku i ndikimeve të sotme të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Si i vetmi rrezik aktual në praktikë janë konsideruar vetëm disa shfaqje e tradita të vjetra të karakterit konservator, kurse ai liberal është parë vetëm si mundësi. Thjeshtësimi i rrezikut të ndikimeve borgjezo-revizioniste, sidomos kur kjo bëhet nga njerëzit «e mësuar» intelektualë, nuk është një harresë, por një prirje, një tendencë që, po nuk u luftua, trashet e bëhet e rrezikshme. Ndikimi shturës liberalo-modernist nuk është një rrezik në potencë, por një rrezik real.

Disa elementë, të infektuar nga modernizmi dekadent, duke e hequr veten si njerëz «kompetentë», nën maskën e luftës kundër konservatorizmit, u përpoqën t'u hapnin dyert liberalizmit antiproletar, rrymave të huaja

borgjezo-revizioniste. Këta me trup ishin këtu, por mendjen e zemrën e kishin jashtë. Jetën dhe zhvillimin e vendit tonë ata e shikonin së prapthi dhe rrymat dekadente kërkonin t'ia përshtatnin gjendjes sonë. Këta elementë hodhën tezën përçarëse se letërsia e vërtetë fillon gjoja me vitet 60-të, duke denigruar e mohuar kështu krijimtarinë artistike të mëparshme. Në emër të kritikës kundër konservatorizmit e zhvendosën tehun e luftës kundër disa krijuesve si persona, sidomos kundër më të vjetërve, duke dëmtuar rëndë atmosferën shoqërore në rrethet letraro-artistike.

Teorizimet kundër të ashtuquajturit konservatorizëm, në gjinitë e ndryshme të artit janë shfaqur në forma të ndryshme. Në artet figurative shpesh me parullat e luftës kundër shkollarizmit, akademizmit, natyralizmit etj., jo vetëm për ligjeshin, por merreshin edhe si modele guximi krijues e novatorizmi vepra me ndikime të huaja moderniste, të vjetra e të reja, bile edhe me huazime nga impresionizmi e kubizmi. Në muzikë është quajtur shfaqje konservatorizmi mbizotërimi i melodisë, ashtu siç është quajtur arkaizëm e folklorizëm mbështetja në krijimtarinë muzikore të popullit. Ky i ashtuquajtur folklorizëm shpesh është paraqitur si një gogol dhe si pengesë kryesore për zhvillimin e muzikës së kultivuar.

Vitet e fundit është ndier një nënvleftësim i traditave më të mira të muzikës popullore, gjë që duket edhe në ekzekutimin e pamjaftueshëm të saj nga artistët më të mirë e veçanërisht në mungesën e një pune serioze për përgatitjen e talenteve të reja. Ky nënvleftësim nuk mund të merret i shkëputur nga një prefe-



rim që kanë pasur disa njerëz për të ashtuquajturën muzikë dinamike e ritmike, e cila gjoja na qenka muzika moderne e fjalës së fundit, e vetmja që iu përgjigjka «kërkesave të kohës e të rinisë». Jo, neve nuk na duhet një muzikë e tillë. Ajo u duhet vetëm borgjezisë e revizionistëve si një narkotik për t'i trullosur masat, veçanërisht të rinjtë. Rinia jonë ka nevojë për një ushqim shpirtëror të pastër, vërtet të kohës, por të mburitur me ideale të larta e frymë të shëndoshë. Dhe kompozitorët tanë të talentuar kanë krijuar shumë vepra të bukura e origjinale me frymë revolucionare, kombëtare dhe të kohës. Ata u këndojnë me frymëzim e dashuri atdheut e popullit, natyrës shqiptare, jetës socialiste dhe ndjenjave të pastra të njerëzve tanë.

Në spekulimet rreth arkaizmit, folklorizmit etj., kemi të bëjmë me një qëndrim të hapët përbuzës përgjithësisht ndaj folklorit, ndaj vlerave të mëdha artistike e shoqërore të tij, ndaj raportit të tij me artin e kultivuar. Pikërisht qëndrime e teorizime të tilla kanë qenë një nga shkaqet e largimeve nga tabani i shëndoshë kombëtar dhe kanë shërbyer si argumente për t'i përligjur këto largime. Çdo gjëje të mirë e të bukur popullore këta pseudoteoricienë i ngjisnin etiketa përçmuese, shumë herë të pakuptueshme edhe nga ata vetë, ose ishin terma e korrente borgjeze në literaturë e në art, që vetë rrjedha e kohës i kishte hedhur në kanale. Këta të ashtuquajtur estete modernë i vinin rëndësi formës dhe aspak ideologjisë, politikës, brendisë.

Elementët me prirje liberale shpeshherë e kanë identifikuar konservatorizmin me traditën. Ata, në mënyrë mekanike, fenomenet e sotme letraro-artistike i

ndanin në «tradicionale» ose «novatore». Konfondime dhe ndarje të tilla i hapin rrugën mohimit të traditës, anëve të shëndosha të saj. Mbi këtë shtrat u përhapën më lehtë ndikimet e huaja. Këta njerëz natyrisht nuk mund të mbështeteshin në traditën, që e quanin regres, por në të ashtuquajturin novatorizëm, të cilin e quanin progres.

Partia ka theksuar vazhdimisht nevojën që të mbështetemi në traditat e shëndosha e t'i kultivojmë ato më tej. Ajo ka nxjerrë në pah vlerat e mëdha të traditave më të mira kulturore, frymën patriotike e demokratike popullore të tyre. Por për ne traditë nuk është vetëm tradita e fuqishme e letërsisë patriotike të Rilindjes Kombëtare, e letërsisë përparimtare demokratike e revolucionare të paraçlirimit, por edhe tradita tashmë tridhjetëvjeçare shumë e pasur dhe e larmishme e letërsisë dhe e artit tonë të realizmit socialist.

A nuk shërbejnë krijimet e çmuara të poetëve tanë më të njohur, që nga këngët e Luftës Nacionalçlirimtare, «Epopëja e Ballit Kombëtar» e Shevqet Musarajt, poezitë e Llazar Siliqit etj., ashtu si edhe krijimtaria e pasur dhe e shëndoshë e shumë poetëve të rinj, si një shembull i qartë kundërvënies ndaj çoroditjeve që janë vërejtur kohët e fundit në poezi e që me të drejtë po i kritikojmë me forcë? Sa shumë ia kanë rritur vlerën poetët tanë fjalës gjithmonë të fuqishme e të mrekullueshme të poezisë më të mirë shqipe! Nuk ka shumë kohë që kam lexuar përmbledhjen e fundit të krijimtarisë poetike të Dritëro Agollit. A nuk është krijimtaria e këtij poeti një traditë e re, një shembull i harmonizimit të frymës socialiste revolucionare me frymën

popullore kombëtare, të brendisë së pasur e të formës së qartë, të partishmërisë e të mjeshtërisë së lartë artistike?

Shumë vepra të tjera të shquara letraro-artistike janë krijuar gjatë periudhës së fundit. Në romanet më të mira të Sterjo Spases e të Ismail Kadaresë, të Fatmir Gjatës e të Jakov Xoxes, si dhe të prozatorëve të tjerë, pasqyrohet me madhësi të vërtetë epike lufta e popullit për çlirimin nga shtypja e të huajve e shfrytëzimi shekullor, për ndërtimin e shoqërisë së re socialiste, për formimin dhe edukimin e njeriut të ri. Edhe dramaturgët e kineastët, bashkë me artistët e talentuar të skenës e të ekranit, i kanë pasqyruar shumë bukur këto transformime kolosale në dramata, filmat e shfaqjet e tyre më të mira. Këtë madhësi dhe këtë frymë heroike lufte e shohim edhe në veprat më të shquara të skulptorëve e të piktorëve tanë të talentuar, si: Odhise Paskali, Kristaq Rama, Guri Madhi e të tjerë. Vepra shumë të bukura të gjinive më të ndryshme muzikore të mëdha e të vogla me brendi të shëndoshë, me vlera edukative, me nivel të lartë profesional kanë dhënë edhe kompozitorët, si: Çesk Zadeja, Tish Daija, Feim Ibrahimi e të tjerë. Ne kemi të drejtë të krenohemi me krijimet e mira të letërsisë e të artit tonë që shquhen si për frymën militante, ashtu edhe për një mjeshtëri me të vërtetë të lartë artistike.

Duke theksuar këto arritje të mëdha në këto fusha nuk mund të mos pranojmë se kritika dhe shkenca jonë letraro-artistike janë borxhlinj ndaj përgjithësisë së kësaj përvoje të re të kulturës artistike socialiste, të këtyre sukseseve e traditave të reja të fuqishme të

letërsisë dhe të artit të realizmit socialist. Ne duhet të luftojmë që kjo traditë të bëhet pronë e krijuesve të rinj dhe e masave të gjera artdashëse, që ajo të popullarizohet me botime e ribotime, me incizime, riprodhime etj. Krijuesit e rinj duhet të mësohen e të edukohen që të mbështeten në rezultatet e në përvojën tonë të re, që të ndjekin këtë traditë të pasur socialiste. Mënjanimi i boshllëqeve dhe i nënvleftësimeve në këtë fushë është edhe një mjet për t'i mbyllur shtigjet përhapjes së ndikimeve dhe imitimeve të huaja.

Partia ka qenë dhe është për një art novator, që të mbështetet fort në traditën e shëndoshë të vjetër e të re dhe në partishmërinë proletare. Por edhe në këtë çështje ka pasur shtrembërime e teorizime të karakterit liberal. Shpesh, në mënyrë mekanike, çdo gjë që del si e re, pa e analizuar në prizmin klasor dhe në mënyrë shkencore se ç'përfaqëson, është quajtur novatore, duke krijuar edhe pështjellime teorike, siç ndodhi me një «të famshëm» diskutim për heroin pozitiv në letërsi, të zhvilluar në gazetën «Drita». Disa herë novatorizmi është konsideruar si pronë vetëm e të rinjve në moshë. Herë të tjera ai nuk është shikuar kryesisht e në radhë të parë në përmbajtje, por vetëm në formë. Pikërisht në emër të një «novatorizmi» të tillë janë përligjur edhe ato krijime formaliste e moderniste në poezi, në muzikën e lehtë, në pikturë, në regjisurë, në skenografi etj., për të cilat fola më sipër. Në mënyrë të veçantë është spekuluar në emër të përkrahjes së të rinjve, gjoja të mbajtjes së një qëndrimi dashamirës e me takt ndaj tyre. Një qëndrim i tillë u ka sjellë vetëm dëm të rinjve, pasi në të vërtetë këta ndihmohen jo duke i përkëdhe-

lur, por duke i inkurajuar kur duhet dhe duke i kritikuar, kur kjo është e domosdoshme.

Për ne, marksistë-leninistët, e re është ajo që i shërben shkatërrimit të çdo gjëje të vjetruar, regresive e reaksionare, të çdo gjëje të huaj për shoqërinë dhe për ideologjinë tonë, është ajo që i shërben afirmimit të çdo gjëje progresive e revolucionare, zhvillimit të shoqërisë socialiste, të bazës e të superstrukturës së saj, të prodhimit e të jetës shpirtërore. Të renë ne e shohim gjithmonë, në radhë të parë, në brendi e pastaj në formë. Kështu e shohim atë edhe në letërsi e në art.

Partia jonë, që është novatore e madhe dhe e guximshme, revolucionare sypatrembur, që ka shkallmuar e vazhdon të shkallmojë vjetërsirë pas vjetërsire, që udhëheq një revolucion të pashembullt në jetën materiale e shpirtërore të shoqërisë, nuk do t'ia lejojë kurrë vetes të mashtrohet nga novatorizmi i rremë, nga cipa e bukurisë së jashtme të artit e të kulturës borgjeze e revizioniste, me të cilën ata e veshin helmën e ideve të tyre reaksionare, nga reklama e bujshme që ata u bëjnë të ashtuquajturave novacione të kësaj kulture. Partia jonë është për një zhvillim me të vërtetë modern të të gjithë jetës sonë shoqërore, të ekonomisë e të kulturës, të letërsisë e të artit. Por kjo nuk ka asgjë të përbashkët me modernizmin çoroditës të botës së sotme kapitaliste e revizioniste.

Shumë shmangie që po kritikojmë kanë ardhur nga largimi prej frymës kombëtare, nga injorimi e mohimi i saj. Në emër të së resë, të kërkesave të kohës, të asaj që jetojmë në Evropë, përkrahësit e liberalizmit filluan të shtrembërojnë orientimet e Partisë për qëndrimin e

diferencuar kritik ndaj kulturës së huaj dhe të na servirin si të reja e novatore shëmtirat e kulturës së sotme dekadente e moderniste borgjezo-revizioniste.

Përmes shumë rrebeshesh të kohës, betejash të ashpra e pa mbarim populli ynë krijoi një kulturë e art me fizionomi të qartë kombëtare që përbën një pasuri të paçmueshme. Këto vlera të artit përparimtar të kombit tonë janë për ne objekt i një krenarie të ligjshme, janë kontributi ynë në thesarin e kulturës botërore përparimtare. Nëse në shekuj populli ynë ruajti e zhvilloi më tej këtë kulturë, atëherë neve, brezave të shoqërisë socialiste, na bie barra të luftojmë me pasionin e militantit komunist, për ta ruajtur të pastër atë dhe për ta zhvilluar më tej.

Borgjezia imperialiste gjithnjë është përpjekur të denigrojë apo të zhdukë traditat kulturore të popujve të vegjël, frymën kombëtare të artit e të kulturës së tyre. Kjo është një nga rrugët për realizimin e agresionit të saj kulturor e të nënshtrimit të popujve. Koncepti reaksionar borgjez mbi «ndërkombëtarizimin» e kulturës e të artit, mendimet se «tanimë u kapërcye faza e shkollave kombëtare», kanë për qëllim zhdukjen e kulturave të popujve të tjerë. Në këto kushte për ne bëhet edhe më imperative lufta për të ruajtur fizionominë kombëtare të artit, pasurinë kulturore të popullit.

Duke luftuar për mbrojtjen e frymës kombëtare të letërsisë e të artit, ne gjithmonë theksojmë me forcë karakterin e tyre revolucionar e socialist. Brendia socialiste është tipari dallues e më esencial i letërsisë dhe i artit tonë. Kjo brendi ka një karakter të qartë klasor

proletar. Si e tillë ajo duhet të realizohet në unitet me formën kombëtare, gjë që e shohim edhe në praktikën e krijimtarisë sonë letraro-artistike.

Edhe herë të tjera Partia ka folur për qëndrimin tonë kritik revolucionar ndaj kulturës së huaj, si ndaj asaj të së kaluarës, ashtu edhe ndaj kulturës së sotme. Detyrohemi t'i kthehemi përsëri këtij problemi, sepse në praktikë, me gjithë orientimet e drejta të Partisë, ka pasur keqkuptime e shtrembërime, të cilat kanë qenë një nga shkaqet e gjallërimit të ndikimeve të huaja.

Sot fenomenet e kalbëzimit e të degjenerimit të kulturës borgjeze bëhen gjithnjë e më të theksuara. «Izmat» e saj, që mbijnë si kërpudhat, janë shenja më e qartë e këtij kalbëzimi. Çdo ditë dalin shkolla e shkollëza «të reja» që u përngjasin sekteve e herezive të panumërta fetare. Megjithëkëtë, ato kanë një bazë të përbashkët filozofike që është idealizmi me të gjitha stërhollimet e pafund të tij. Ky është thelbi edhe i atyre rrymave që në pamje të parë dalin gjoja si protesta të majta, radikale, kundër shoqërisë zyrtare borgjeze, kundër kulturës dhe moralit të saj.

Nën maskën e një arti, i cili gjoja nuk njihet para-gjykime sociale e angazhime ideologjike, krijohet kulti i brendisë boshe e i formës së shëmtuar, i së ultës dhe së llahtarshmes. Temat dhe heronjtë kryesorë të artit dekadent modernist janë vrasësit, prostitutat, imoraliteti, patologjia sociale. Flamuri i tij është irracionalizmi, çlirimi i tij nga «arsyeja». Ideali i tij është primitivizmi i njeriut të shpellave.

Pikërisht kjo kulturë e veshur me një shkëlqim të jashtëm, e shoqëruar me një reklamë të bujshme, e traj-

tuar në mënyrën më komerciale dhe që përkrahët e financohet nga borgjezia, vërshon në ekranin e kinemasë e të televizionit, në revista, në gazeta e në radio, në të gjitha mjetet e informacionit e të propagandës masive. Qëllimi i saj është ta kthejë njeriun e thjeshtë në një konsumator pasiv të ideve të helmatisura borgjeze, t'ia bëjë këtë konsum një nevojë e zakon. Nga kjo kulturë ne jo vetëm që nuk kemi ç'të mësojmë, me të ne jo vetëm nuk kemi pse t'i njohim masat dhe rininë, por atë duhet ta flakim me përbuzje dhe ta luftojmë me vendosmëri.

Ne kemi vlerësuar e vlerësojmë vetëm artin revolucionar, përparimtar e demokratik të huaj, qoftë ky i së kaluarës ose i shekullit tonë. Ne do ta shfrytëzojmë atë edhe në të ardhmen në mënyrë kritike, sepse kjo është e nevojshme për zhvillimin kulturor të masave, për edukimin ideoestetik të tyre, si dhe për formimin e atyre shijeve që i rezistojnë ndikimit degjenerues e vulgar borgjezo-revizionist.

E tërë kjo kërkon një punë të kujdesshme nga ana jonë, të pjekur dhe të shkallëzuar, kërkon mënjanimin e qëndrimeve ekstreme që kanë për bazë ksenomaninë ose ksenofobinë, liberalizmin ose sektarizmin, mungesën e qëndrimit kritik ose të të qenit brenda.

Partia ka qenë gjithnjë kundër çdo lloj shtrembërimi e nënvleftësimi të orientimeve të saj për një luftë ideologjike e konsekuente në të dy krahët, si kundër liberalizmit, ashtu edhe kundër konservatorizmit. Ajo ka qenë dhe është kundër çdo lloj spekulimi që, në emër të luftës kundër njërit krah, të lihet pas dore ose të harrohet lufta kundër krahut tjetër. Prandaj do të ishte shu-



më e gabuar në qoftë se sot ndokush do të mendonte se kritikaf e drejta që janë bërë kundër shfaqjeve të konservatorizmit nuk qëndrojnë dhe se konservatorizmi nuk përbën më ndonjë problem për letërsinë dhe artet. Në fakt, letërsia dhe arti në rrugën e zhvillimit të tyre, krahas ndikimeve të ideologjisë së sotme borgjeze e revizioniste, janë ndeshur e ndeshen edhe me trashëgime e prirje të ndryshme të karakterit frenues konservator, të cilat shfaqen si në brendi, ashtu edhe në formën e tyre. Karakteri konservator ose përparimtar, regresiv ose reaksionar i një vepre letrare e artistike varet, në radhë të parë, nga tendencioziteti i saj klasor, nga idetë që ajo bart, nga idealet për të cilat militon. Konservatorizmi në këtë fushë ka specifikën e vet dhe shfaqet në forma e mënyra të ndryshme, të cilat mendimi kritik, teorik e historiko-letrar duhet t'i zbulojë e t'i luftojë pandërprerë.

Partia ka treguar vazhdimisht bazën e gjerë politike, sociale dhe ideologjike të konservatorizmit. Për ne qëndrim konservator është ai që justifikon, mbështet e mbron çdo gjë të vjetruar, që është kundër ndryshimeve progresive, kundër së resë, që frenon hovin revolucionar të masave, emancipimin e gjithanshëm të tyre, që pengon ecjen tonë përpara në rrugën e socializmit. Nga pozita e një kuptimi të tillë klasor revolucionar, në vështrimin më të gjerë politik e social, karakter konservator kanë jo vetëm ideologjitë e vjetra që vijnë nga thellësitë e shekujve, por edhe ideologjia e kultura e sotme e degjeneruar borgjeze e revizioniste, i gjithë liberalizmi e modernizmi i tyre.

Një rol shumë të madh në zhvillimin e drejtë të

letërsisë e të arteve luan kritika letraro-artistike, zhvillimi i një debati serioz e shkencor për problemet themelore ideoestetike. Por kritika jonë letraro-artistike nuk ka mbajtur kurdoherë qëndrime të qarta për këto probleme, ajo nuk ka zbuluar dhe goditur me kohë fenomenet negative, sidomos ndikimet formaliste e moderniste dhe në ndonjë rast është përpjekur t'u vërë edhe bazë teorike këtyre shfaqjeve të huaja. Në të njëjtën kohë do theksuar se nuk ka ekzistuar gjithmonë edhe atmosfera e përshtatshme që kritika letraro-artistike ta thotë lirshëm fjalën e saj.

Ne kemi nevojë për një kritikë shkencore e të kualifikuar e cila ka brenda edhe patosin e domosdoshëm revolucionar, aq të nevojshëm për zbulimin e vlerave të shquara të letërsisë e të artit, edhe frymën e papajtueshmërisë me asnjë shtrembërim, me asnjë shfaqje të huaj në zhvillimin e tyre. Ne kemi nevojë për një kritikë të atillë, e cila ta thotë me guxim e me kompetencë fjalën e vet për çdo fenomen letrar e artistik. Por kritika letrare profesionale nuk është i vetmi gjykues i veprintarisë letraro-artistike. Mendimi i lexuesve, i publikut, i gjithë opinionit shoqëror në fund të fundit është gjykatësi më i drejtë i kësaj krijimtarië. Këtë të vërtetë duhet ta mbajnë kurdoherë parasysh si krijuesit, ashtu edhe kritikët.

Për zhvillimin e mendimit kritik e ideoestetik është e nevojshme të merren masa për zgjerimin e punës kërkimore-shkencore në lëmin e teorisë e të historisë së letërsisë e të arteve, të estetikës, duke forcuar bërthamat ekzistuese, si dhe duke krijuar bërthama të reja. Kjo punë nuk mund të kryhet me sukses

pa marrë masa të shpejta për përgatitjen sistematike të kuadrove të rinj shkencorë për estetikë, teori e histori të letërsisë e të arteve, për kritikë letrare e artistike.

Kritika, si dhe letërsia e gjithë arti ynë, duhet të udhëhiqen kurdoherë nga parimet e metodës së realizmit socialist, të cilat kanë lindur nga përvoja botërore e artit revolucionar të proletariatit, janë përpunuar nga estetika marksiste-leniniste dhe janë konfirmuar edhe nga praktika letrare e artistike e vendit tonë. Këto parime janë të patundshme dhe besnikëria ndaj tyre është e domosdoshme, sepse ndryshe biem në ndikime të huaja dhe largohemi nga traditat revolucionare. Novatorizmi nuk ka të bëjë me shkeljen e parimeve, por me zbatimin e tyre të drejtë.

Zhvillimi krijues i realizmit socialist ka ndeshur edhe në disa interpretime të gabuara e teorizime me prejardhje të ndryshme. Sidomos këto janë shfaqur në trajtimin e problemit të kontradiktave e të heroit në art. Ka ndodhur që kontradiktat e shoqërisë sonë janë paraqitur pa rrugëdalje, me një ndjenjë të errët pesimizmi, që është tipike për konceptimet borgjezo-revizioniste. Nuk është treguar kurdoherë si duhet epërsia e forcave dhe e idealit socialist. Ka pasur edhe raste të konfondimit të kontradiktave në gjirin e popullit me kontradiktat midis nesh e armiqve tanë. Kjo të çon në gabime të rënda parimore, ku përpiquej ta fuste artin tonë Fadil Paçrami, kur thoshte se mjaft jemi marrë deri tani me luftën midis «nesh dhe armiqve» e se këtej e tutje duhet të flasim kryesisht për luftën «midis nesh». Pra, t'i lëmë të qetë armiqtë dhe të trajtojmë si të tillë njerëzit tanë.

Partia ka theksuar se zbulimi i kontradiktave e pasqyrimi i tyre në art, duke përfshirë këtu edhe kritikën e fenomeneve negative, duhet bërë drejt, nga pozitativat e partishmërisë proletare, nga qëllimi që ato të kapërcehen dhe shoqëria të shkojë përpara dhe jo të mbetet në darën e kontradiktave.

Nga ana tjetër, ato teorizime që janë bërë për heroin pozitiv, për copëzimin e tij, për identifikimin e tij me gjithçka, për ndarjen artificiale në «hero tradicional» dhe «hero novator» etj., nuk janë gjë tjetër veçse pikëpamje që të shpien te deheroizimi në letërsi e në art, të largimi nga jeta dhe nga njeriu. Edhe teorizimet skematike për heroin, të konceptuar në mënyrë idilike dhe sentimentale, janë, gjithashtu, të dëmshme dhe e largojnë artin nga vërtetësia dhe realizmi. Duke kritikuar kuptimin skematik të një heroi të idealizuar në mënyrë libeske, pa u mbështetur në realitetin tonë, në të njëjtën kohë ne nuk mund të pranojmë në asnjë mënyrë skemën e re për një hero të lëkundur, e cila në fakt është një ndikim i hapët borgjezo-revizionist. Këto pikëpamje e qëndrime nuk kanë asgjë të përbashkët me parimet tona, ato tregojnë një konfuzion teorik.

\*

\* \* \*

Këto ishin disa probleme që kanë shqetësuar Partinë, punonjësit e gjithë krijuesit, lidhur me zhvillimin në rrugë të drejtë të letërsisë e të arteve tona, në luftë kundër ndikimeve të ideologjisë së huaj. Në diskutimet që janë zhvilluar kohët e fundit midis punonjësve të

letërsisë e të artit, në frymën e një kritike e autokritike të shëndoshë, është shprehur me forcë bindja dhe vendosmëria për kapërcimin e të metave e të dobësive që janë konstatuar. Detyra e Partisë është të ndihmojë shkrimtarët e artistët që të kryejnë me nder detyrat e larta fisnike që kanë përpara popullit.

Duhet pranuar se mosinteresi sa duhet i komiteve të Partisë dhe i organizatave-bazë për këto fusha të rëndësishme, siç janë artet e letërsia, është edhe një nga shkaqet që kundër ndikimeve të huaja nuk është luftuar që në fillim me forcën dhe konsekuencën e duhur. Organizatat e Partisë nuk merren me problemet e kulturës, me edukimin e gjithanshëm të punonjësve të letërsisë e të arteve në atë shkallë, siç merren me fusha të tjera të jetës shoqërore e ekonomike. Ato duhet të mbajnë gjithnjë parasysh se letërsia dhe artet vërtet nuk japin drejtpërsëdrejti të mira materiale, por ndikimi i tyre mbi masat është i madh dhe pasqyrohet fuqimisht jo vetëm në gjendjen shpirtërore të punonjësve, por edhe në punë e në prodhim.

Nuk kanë luftuar me këmbëngulje e konsekuencë edhe ata organizma që janë ngarkuar posaçërisht të merren me zbatimin e vijës së Partisë në fushën e arteve e të letërsisë. Sektorët ideologjikë të aparatit të Komitetit Qendror nuk kanë ndihmuar sa duhet që letërsia dhe artet t'u bënin ballë ndikimeve të huaja. Ata, në njëfarë mase, u janë nënshtruar presioneve e teorizimeve liberale dhe nuk kanë reaguar me forcën e nevojshme kundër shmangieve nga vija e orientimet e Partisë.

Shkarjet në letërsi e në art kanë lidhje edhe me punën e pamjaftueshme të Komitetit të Partisë të Rrethit

të Tiranës, ku militojnë shumica e shkrimtarëve dhe e artistëve dhe ndodhen institucionet kryesore artistike të vendit, në të cilat, më shumë se kudo, ishte përhapur fryma e liberalizmit. Në këtë drejtim ka ndikuar në mënyrë shumë të dëmshme veçanërisht ish-sekretari për propagandën, Fadil Paçrami, i cili për problemet e letërsisë, të arteve dhe të institucioneve artistike të qytetit, kishte arritur t'i imponohej Komitetit të Partisë të Tiranës.

Fadil Paçrami për këto probleme ka pasur pikëpamje të huaja, në kundërshtim me vijën e Partisë, të cilat janë shfaqur edhe në krijimtarinë e tij letrare. Me predispozicionet e tij të theksuara liberale, me teorizimet e huaja, ai i mohonte dhe i luftonte traditat e shëndosha të letërsisë e të arteve, nxiste ndarjen artificiale midis brezave të krijuesve dhe predikonte luftën midis tyre, inkurajonte dhe përkrahte përhapjen e ndikimeve e të shfaqjeve të huaja moderniste. Me prirjet e tij liberalo-anarkiste, të shprehura në konceptimet e djathta të problemeve dhe në përdorimin e metodave agresive, të zbatuara me mendjemadhësi e arrogancë, ai ka ushtruar një ndikim shumë negativ në Lidhjen e Shkrimtarëve e të Artistëve dhe në jetën letraro-artistike të kryeqytetit. Pikëpamjet antiparti të Fadil Paçramit janë shfaqur jo vetëm në moszbatimin e vijës së Partisë për luftën në të dy krahët, por edhe në kundërshtimin e hapur të saj, duke luftuar nga pozita të huaja vetëm kundër konservatorizmit. Në fakt, si deviator i djathtë, ai ka luftuar për t'i hapur rrugën liberalizmit. Në punën e tij ai ka shkelur normat e Partisë. Kritikkat që i janë bërë herë pas here nga komunistë, nga aparati dhe Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë, ai me fodu-

llëk nuk i ka marrë parasysh. Duke qenë kundër vijës së Partisë dhe kundër vetë Partisë, ai ka spostuar organizatat-bazë të sferës së kulturës dhe ka zbatuar një politikë personale kuadri, duke synuar që drejtimi këtu të kryhej jo nga Partia, por nga njerëzit që i shkonin atij për shtat. Fadil Paçrami e Todi Lubonja, si elementë antiparti, në fakt kanë pasur qëllime të njëjta dhe kanë ndjekur një rrugë për të goditur Partinë e udhëheqjen e saj.

Një përgjegjësi të madhe për shkarjet nga vija e Partisë në art e në letërsi mban Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, sepse e ka nënvleftësuar rrezikun e liberalizmit dhe është tërhequr para presioneve liberale. Prandaj, ajo duhet ta rishikojë punën e saj në këtë drejtim dhe të marrë masa për zbatimin e plotë e të saktë të detyrave të ngarkuara për drejtimin e gjithë jetës kulturore e artistike të vendit, pa bërë asnjë lëshim ndaj kujtdo që shkel vijën e Partisë në çështjet e letërsisë, të artit e të kulturës sonë socialiste.

Veçanërisht përgjegjësi të madhe për shkarjet nga vija e Partisë në lëmin e arteve e të letërsisë mban Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve, mbajnë shokët kryesorë drejtues të saj. Shumë koncepte e teorizime që u kritikuan më lart kanë gjetur strehë në veprimtarinë e lidhjes, në organet e shtypit të saj, veçanërisht në gazetën «Drita». Duke pretenduar se vetëm ata i njohin problemet e letërsisë e të artit e specifikën e tyre, shokët drejtues të lidhjes jo vetëm nuk kanë luftuar kundër ndikimeve të huaja, por shpesh, me qëndrimet e tyre, i kanë ushqyer ato.

Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve duhet të

analizojë thellë punën e vet, të zbulojë çdo shtrembërim të vijës së Partisë në letërsi e në art, të marrë masa serioze e me përgjegjësi për të mos lejuar më shfaqje të ideologjisë borgjeze e revizioniste në sferën e veprimtarisë së saj.

Për të luftuar me sukses kundër ndikimeve e shfaqjeve të huaja, Partia duhet të bëjë një punë të madhe me shkrimtarët e artistët jo vetëm për ngritjen e mëtejshme ideoestetike të tyre, por edhe që ata të bëjnë një jetë ideologjike intensive, që të jetojnë afër masave, të lidhen ngushtë me shqetësimet e luftën e tyre, të marrin pjesë aktive në aksionet e mëdha ekonomiko-shoqërore të punonjësve. Kontaktet me masat janë absolutisht të domosdoshme për njerëzit e artit e të kulturës, por këto nuk duhet të kuptohen si slogane, si letërsi, si shëtitje, por si punë ku ata do të bazojnë krijimtarinë e tyre, e cila duhet të jetë pozitive, brenda vijës së Partisë, brenda normave. Në këtë proces bëhet edhe edukimi e kalitja revolucionare e krijuesve, luftohen intelektualizmi e megalomania, individualizmi e sedra mikroborgjeze, mendimet e gabuara që «ne jemi mbi të tjerët», se «jemi të lirë të krijojmë ç'të duam dhe kur të duam», jashtë çdo kërkese e disipline shoqërore, jashtë çdo kontrolli, jashtë çdo norme. Në këtë mënyrë edhe gabimet ndreqen jo vetëm me fjalë, jo vetëm me autokritikë, por me krijimtari, me punë, me vullnet dhe me besim të shumëfishuar në forcat e veta dhe në drejtësinë e vijës së Partisë.

Organizatrat e Partisë duhet të bëjnë një punë serioze për të krijuar një atmosferë të shëndoshë ve-



primtarie dhe marrëdhëniesh shoqërore në gjirin e punonjësve të letërsisë e të arteve. Ato dhe vetë shkrimtarët e artistët duhet të luftojnë me vendosmëri kundër pasioneve të sëmura, njëanshmërisë në gjykimin e krijimtarisë së njerit apo të tjetrit, që çojnë në thasetheme, në ndarje e grupime të dëmshme të krijuesve. Nuk duhet të lejohet ndarja në «të rinj» e në «të vjetër», ashtu si nuk duhet lejuar që tani të përhapen mendimet: «Ju keni gabuar, ne nuk kemi gabuar», «ju na keni akuzuar si konservatorë dhe tash ne ju akuzojmë si liberalë». Natyrisht, gabimet e të metat duhen zbuluar dhe njohur, ato duhen kritikuar. Por, siç na mëson Partia, është e domosdoshme që kritika të jetë gjithnjë e drejtë, konstruktive dhe asnjëherë denigruese. Gabimet, kudo ku janë shfaqur, duhet të shikohen kurdoherë me sy partie dhe të ndreqen me përpjekje të përbashkëta. Ne, komunistët, gabimet nuk i ndreqim duke u hakmarrë e me inat mikroborgjez, por në frymën e partishmërisë e të principialitetit komunist. Njerëzit duhen ndihmuar e inkurajuar, veçanërisht krijuesit e rinj, ndaj të cilëve duhet treguar ngrohtësi, takt e kujdes në rrugë të drejtë partie.

Partia kërkon shumë në këtë drejtim sidomos nga shkrimtarët dhe artistët komunistë të cilët duhet të jenë shembull partishmërie, principialiteti, etike komuniste e disipline shoqërore. Për komunistët nuk ka dy lloj qëndrimesh, një në organizatën-bazë dhe një tjetër jashtë saj. Normat e Partisë në vijë, në punë, në jetë janë të domosdoshme për të gjithë dhe askujt nuk mund t'i lejohet t'i shkelë ose t'u bëjë bisht atyre.

Ne kemi besim të plotë se shkrimtarët dhe artistët tanë, të gjithë krijuesit e punonjësit e kulturës e të artit, duke luftuar kundër ndikimeve të huaja, si kurdoherë, do t'i shtrëngojnë akoma më shumë radhët e tyre rreth Partisë, me të cilën ata janë të lidhur si mishi me kockën. Me ndihmën e Partisë dhe me përpjekjet e tyre revolucionare ata do të pastrojnë ato barrëra të këqija, që janë dukur në jetën tonë letraro-artistike e kulturore dhe do ta çojnë përpara me guxim çështjen e madhe të kulturës, të letërsisë e të artit tonë socialist.

Duke trajtuar në këtë Plenum ndikimet e huaja ideologjike dhe shfaqjet e tyre në letërsi e në art, është e domosdoshme të theksojmë edhe një herë se përgjithësisht trupi i letërsisë e i artit tonë është i shëndoshë, se ata janë zhvilluar në rrugë të drejtë, janë frymëzuar nga vija e Partisë e interesat e popullit e të socializmit. Këtë e vërteton realiteti i gjallë i zhvillimit të letërsisë e të arteve tona në përgjithësi e konkretisht edhe gjatë periudhës së fundit.

Veprat e mira të shkrimtarëve e të artistëve tanë pëlqehen shumë dhe ndiqen me interesim të madh nga masat, ato kanë dhënë e japin një kontribut të çmuar në edukimin e përgjithshëm të rinisë e të mbarë popullit. Këto vepra që kanë rritur fondin e artë të kulturës së re socialiste, janë një pasqyrim tepër i vlefshëm i krijimtarisë shpirtërore të popullit shqiptar, i përmbajtjes së saj patriotike, përparimtare e demokratike. Duke pasqyruar epokën e lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, të transformimeve të mëdha revolucionare dhe të ndërtimit të socializmit, duke qenë

pjesëmarrëse aktive në këto beteja madhështore, letërsia dhe arti ynë i tanishëm do të jenë me siguri burim frymëzimi për brezat e rinj dhe për ata që do të vijnë pas.

Ne jemi të sigurt se ashtu si deri tani, edhe në të ardhmen, veprimtaria krijuese e shkrimtarëve dhe e artistëve tanë do të frymëzohet nga realiteti ynë i mrekullueshëm socialist, nga lufta heroike e popullit tonë, e klasës punëtore dhe e fshatarësisë punonjëse, nga idealet e larta revolucionare të Partisë. Ajo do të marrë kurdoherë vlagë nga lufta shekullore e popullit tonë për liri e dritë, nga tradita e tij e fuqishme demokratike e përparimtare, nga gurra e pashtershme e përvojës dhe e gjenisë së tij artistike. Të udhëhequr nga parimi i madh i partishmërisë komuniste, shkrimtarët dhe artistët do të na japin me siguri vepra edhe më të denja për këtë luftë heroike që bëjnë sot Partia e populli ynë për çështjen e revolucionit e të socializmit, vepra të qarta e të kuptueshme për masat, me ide të larta komuniste, me një fytyrë të qartë kombëtare, me një nivel artistik gjithnjë e më të përsosur.

## **Të formojmë koncepte revolucionare për shijen, sjelljen dhe mënyrën e jetesës**

Revolucioni socialist ka sjellë shndërrime rrënjësore në jetën shpirtërore të shoqërisë e të njerëzve tanë, në ndërgjegjen, psikologjinë dhe mënyrën e jetesës së tyre. Partia u ka kushtuar një kujdes të vazhdueshëm

formimit dhe kalitjes së njeriut të ri me botëkuptimin marksist-leninist, me frymën e lartë të patriotizmit e të internacionalizmit proletar, të kolektivizmit socialist, me shpirtin e sakrificës e të heroizmit, me koncepte të reja për punën, për jetën, me ideale të larta revolucionare. Ne mund të flasim sot për një jetë shpirtërore të pasur të popullit, një jetë që zhvillohet e pastër, e vrullshme, në të cilën spikatin devocioni ndaj çështjes së revolucionit e të socializmit, aktet heroike, virtytet e larta morale, shijet e shëndosha. Ky është një proces i ndërlikuar dhe i pandërprerë që zhvillohet nëpërmjet një lufte klasore ideologjike kundër çdo ndikimi të huaj. Partia jonë ka luftuar gjithmonë dhe frontalisht kundër të gjitha ideologjive të klasave shfrytëzuese.

Por vitet e fundit, kur iu dha një goditje e fortë koncepteve e paragjyqimeve të vjetra fetare, feudale e patriarkale-konservatore, u la disi pas dore dhe u nënvleftësua lufta kundër ndikimeve të sotme të ideologjisë borgjeze e revizioniste, kundër shfaqjeve të tyre në jetën tonë. U dukën koncepte e qëndrime liberale, që u hapën rrugën disa fenomeneve të dëmshme që filluan të shfaqen në disa njerëz e sidomos në disa të rinj.

Ato ndikime, për të cilat folëm në letërsi e në art, nuk mund t'i shohim të shkëputura nga disa shfaqje të huaja, që janë vërejtur në shijet e disa të rinjve, në sjelljet dhe në veprimet e pahijshme të tyre. Këto, si dhe presioni i vazhdueshëm i jashtëm, janë shkaqet themelore të përhapjes së disa shijeve të huaja e vulgare për muzikën dhe artin, të ndjekjes së modave ekstravagante e të shëmtuara, të sjelljeve të papëlqyeshme në kundërshtim me etikën socialiste dhe traditat poziti-

ve të popullit. Me të drejtë opinioni ynë shoqëror goditi me forcë «importimet» e bastarduara të flokëve të gjatë, të veshjeve ekstravagante, të britmave të muzikës së xhunglës, të harbutllëqeve, të sjelljes pa cipë etj. Po të mos luftohen që në embrion ndikimet e shfaqjet e mënyrës së jetesës borgjezo-revizioniste, ato u hapin shtegun shthurjes e degjenerimit të njerëzve, që janë aq të rrezikshme për çështjen e socializmit.

Zhvillimi i gjithanshëm shpirtëror e figura morale e njeriut tonë të ri nuk mund të kuptohen pa formimin e shijeve ideoestetike të shëndosha për të bukurën në art, në natyrë, në punë e në jetë. Çështja e shijeve nuk është një çështje thjesht personale e individëve, për të cilën gjoja as që mund të diskutohet. Me gjithë praninë e elementit individual në to, shijet kanë gjithmonë karakter shoqëror, formohen nën ndikimin e drejtpërdrejtë të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore, të ideologjisë e të kulturës, të psikologjisë shoqërore. Këtej del i qartë edhe karakteri klasor që kanë ato. Prandaj, shijet tona në thelbin e vet janë krejtësisht të kundërta me ato borgjezo-revizioniste. Shija jonë komuniste është e mbujtur me idealin revolucionar, me thjeshtësinë proletare, me ndjenja të larta fisnike, me virtyte morale të pastra.

Duke luftuar kundër depërtimit të shijeve të ulëta e banale borgjezo-revizioniste, në të njëjtën kohë ne kemi luftuar e vazhdojmë të luftojmë kundër shijeve të vjetruara e anakronike të lëna trashëgim nga pushtimet e huaja dhe shoqëria e vjetër feudalo-borgjeze, të pleksura me mënyrën e vjetër të jetesës dhe me zakonet e traditat patriarkale e prapanike. Ne jemi përkrahës

të çdo evoluimi të natyrshëm të shijeve në kushtet e zhvillimit të vullshëm socialist, të kërkesave të reja që shtron ky zhvillim, në frymën e ideologjisë sonë marksiste-leniniste e të traditave tona të shëndosha kombëtare. Ne jemi kundër atyre qëndrimeve konservatore që nuk e kuptojnë këtë proces dhe që e shikojnë atë si fenomen negativ e ndikim të huaj.

Formimi i shijeve të shëndosha me brendi të qartë socialiste kërkon edhe një zhvillim të gjithanshëm kulturor të njeriut të ri, sidomos një punë sistematike për edukimin ideoestetik të tij. Këto pikësynime arrihen edhe nëpërmjet një lufte të vazhdueshme kundër cektësisë e horizontit të ngushtë kulturor, për një njohje më të thellë të vlerave të shquara të kulturës kombëtare e botërore.

Te ne sot janë krijuar mundësi të mëdha për ngritjen e vazhdueshme të nivelit kulturor dhe ideoestetik të të gjitha masave punonjëse e veçanërisht të rinisë. Krahas shkollës, janë shtuar e fuqizuar shumë si institucionet e posaçme kulturore-artistike, ashtu edhe mjetet e tjera të propagandës masive, që luajnë një rol të dorës së parë në këtë proces. Por këto mjete, që janë përhapur në të gjithë vendin deri në skajet më të largëta të tij, nuk shfrytëzohen në mënyrë intensive e të kualifikuar.

Komitetet e Partisë dhe organet e pushtetit duhet të bëjnë përpjekje për të ngritur vazhdimisht nivelin ideor e artistik të veprimtarisë së institucioneve kulturore dhe të luftojnë kundër çdo prirjeje për ta parë këtë veprimtari si një mjet thjesht zbavitës, duke u larguar nga qëllimi themelor edukativ i tyre.

Gjithashtu duhet të tërheqim këtu vëmendjen se shfaqje të huaja kanë depërtuar sidomos në institucionet kulturore e artistike. Ndikimet e huaja liberalo-moderniste nga krijimtaria letraro-artistike kanë kaluar edhe në skenat e teatrove e të estradave, në ekranet e kinemasë e të televizionit, në aktivitetet e ndryshme të klubeve, shtëpive e vatrave të kulturës. Në mjaft institucione kulturore që shtrihen edhe në bazë është vërejtur, gjithashtu, prirja e nënvleftësimit të mbështetjes në traditat e shëndosha kombëtare e popullore në aktivitetin kulturor.

Puna e filluar për spastrimin e programeve nga ndikimet e huaja, për gjallërimin dhe intensifikimin e veprimtarisë së institucioneve kulturore-artistike duhet të jetë e vazhdueshme dhe në ngjitje. Është e domosdoshme të rriten kërkesat ndaj zgjerimit dhe përmirësimit të cilësisë së gjithë punës kulturore masive, për ta vënë atë më mirë në shërbim të edukimit komunist të masave.

Fenomene shqetësuese kemi pasur edhe në mënyrën e sjelljes e të jetesës. Janë vënë re mjaft shkelje të disiplinës shoqërore në punë e në shkollë, mospërfillje të normave të moralit socialist dhe të ligjeve të shtetit, çenime të rendit publik dhe të personit, shfaqje imoraliteti, injorime të detyrimeve shoqërore që kanë njerëzit si punonjës, si qytetarë, si prindër e familjarë. Veçanërisht në një numër të rinjsh filluan të duken disa fenomene shumë negative, si braktisja e shkollës, qëndrimi pa punë, rrugaçëria, vjedhjet etj. Të gjitha këto ushqyen prirjet e parazitizmit, prirjet individualiste e zhvatëse në kurriz të shoqërisë, si dhe pretendimet e

padrejta. Bartësit e këtyre shfaqjeve të huaja, që bënë një jetë jashtë luftës së popullit, kanë qenë kontingjenti më i predispozuar për aktet e vagabondazhit e krimet, pasi dihet që parazitizmi dhe prirjet zhvatëse janë një burim i degjenerimit moral të njerëzve.

Natyrisht, po të kemi parasysh se ç'ndodh në botën kapitaliste e revizioniste, këto fenomene të ne janë mjaft të kufizuara. Por shoqërinë tonë të shëndoshë e shqetësojnë dhe duhet ta shqetësojnë gjithnjë fenomene të tilla, edhe sikur këto të jenë fare të pakta, qoftë dhe në individë të veçuar, për arsye se ne luftojmë që të ruajmë të pastër e të shëndoshë ndërjegjen dhe figurën morale të çdo punonjësi, për të ruajtur të pastër tërë shoqërinë tonë socialiste.

Në gjallërimin e këtyre shfaqjeve një rol negativ kanë luajtur disa teorizime të shtrembra të një karakteri të hapur liberal. Thelbi i tyre është kuptimi i njëanshëm krejtësisht i gabuar nga pozita borgjezo-revizioniste i demokracisë së gjerë që ekziston në shoqërinë tonë socialiste, i luftës për emancipimin e njerëzve e sidomos të grave, i raportit midis të drejtave dhe detyrave, midis lirisë së personit dhe disiplinës shoqërore.

Për ne, marksistë-leninistët, mënyra e jetesës është një pjesë e pandarë e tërë jetës shoqërore socialiste, që zhvillohet në lidhje të ngushtë me gjithë revolucionin tonë, në përshtatje me ideologjinë socialiste e me normat e moralit komunist. Kështu e kuptojmë ne edhe mirëqenien materiale e botën shpirtërore të njeriut, edhe afirmimin e individualitetit të tij, edhe emancipimin e lumturinë personale, edhe jetën familjare. Ideali revolucionar komunist është një dhe i vetëm dhe



ai na udhëheq në gjithë veprimtarinë e jetën tonë. Për ne është krejtësisht i huaj kuptimi borgjezo-revizionist i jetës, shfaqjet më tipike të të cilit janë individualizmi e egoizmi i shfrenuar, boshllëku e vaniteti, rendja pas luksit dhe plotësimit të gjithfarë tekash, shthurja e degjenerimi, parazitizmi e kriminaliteti, që janë bërë plagë të pashërueshme morale e sociale të shoqërisë së sotme kapitaliste e revizioniste.

Edhe mënyrën e jetesës ne e shohim në zhvillim të pandërprerë, të kushtëzuar nga të gjitha transformimet shoqërore, ekonomike e kulturore, nga rritja e mirëqenies së përgjithshme. Sidomos transformimet e vrullshme sociale-demografike, rritja e qyteteve e krijimi i qendrave të reja të banimit, shtimi i klasës punëtore, zhvillimi i gjithanshëm, veçanërisht social-kulturor i fshatit, shpërbërja e familjes patriarkale, zhvillimi i madh i arsimit e i kulturës, evolucioni i psikologjisë shoqërore kanë çuar në ndryshime rrënjësore në mënyrën e jetesës.

Një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim kanë luajtur aksionet e mëdha ideologjike kundër fesë, zakoneve prapanike e traditave të vjetruara, të cilat kanë goditur rëndë shumë koncepte e praktika anakronike. Këto zhvillime pozitive e revolucionare janë shoqëruar edhe me lindjen e problemeve të reja, me rritjen e kërkesave të masave në jetën materiale e shpirtërore, sidomos për kulturë dhe edukim. Për t'iu përgjigjur këtyre kërkesave e për t'i plotësuar ato gradualisht, sipas kushteve e mundësive reale, është e domosdoshme të zgjerojmë kuptimin tonë për jetën e kulturuar, në të

gjitha pamjet e saj, që nga zhvillimi intelektual i njeriut e deri tek ambientet ku ai jeton e punon.

Nga ana tjetër, Partia godet ashpër të gjitha ato synime e përpjekje që, në emër të luftës kundër konservatorizmit, të kërkesave të kohës e të rinisë, të lirisë e të demokracisë, duan të sjellin te ne frymën e korrupsionit e të degjenerimit borgjez. Tani masat punonjëse dhe rinia janë hedhur në luftë kundër këtij ndikimi korruptues, kundër çdo qëndrimi liberal që i hap shtigjet depërtimit të tij. Kjo luftë po bëhet duke revolucionarizuar opinionin shoqëror, duke rritur vigjilencën e ndjeshmërinë e tij. Qëndrimet liberale ndaj ndikimeve të huaja nuk mund të mënjanohen pa luftuar kundër shfaqjeve të indiferentizmit në opinionin shoqëror, kundër pasivitetit, tolerancës, neglizhimit. Këto të fundit janë qëndrime të hapëta e tipike mikroborgjeze dhe nuk kanë asgjë të përbashkët me frymën revolucionare të papajtueshmërisë komuniste ndaj çdo fenomeni negativ e shfaqjeje të huaj.

Por fakt është se ne ndeshim indiferentizëm jo vetëm në radhët e punonjësve, por edhe të komunistëve e të kuadrove. Si mund të heshtin e të bëjnë sehir njerëzit tanë, kur shohin se shkelen normat e moralit komunist e ligjet e shtetit, dëmtohet e shpërdorohet pasuria e popullit, kur shohin se disa të rinj, pa punuar, kërkojnë të jetojnë në kurriz të familjes e të shoqërisë, kur vënë re akte rrugaçërie, imoraliteti e vagabondazhi, shfaqje të modës e të mënyrës së huaj të jetesës? Konceptet se «ka kush merret me këto punë», se «ç'më duhet mua», «pse të prishem me shokun apo komshiun», janë krejt të huaja dhe duhen luftuar fort.

Ne duhet të krijojmë një atmosferë mbytëse kundër çdo shkeljeje të ideologjisë, të moralit, të legjislacionit tonë, të krijojmë një front unik edukimi, ku të shkrihen në një të vetme përpjekjet e përbashkëta të shkollës, të të gjitha mjeteve të kulturës e të propagandës masive, të organizatave shoqërore, të familjes, të mbarë opinionit shoqëror.

Rezultatet e arritura në luftën që po bëjnë tani Partia dhe masat kundër ndikimeve dhe shfaqjeve të huaja, janë një hap i rëndësishëm përpara. Por detyra e Partisë është që, duke u mbështetur në këto rezultate, të vazhdojë luftën kundër liberalizmit në të gjitha frontet, të rrënjosë thellë në ndërgjegjen e masave konceptet revolucionare, t'i bëjë ato pjesë të botëkuptimit të tyre.

Punën për edukimin komunist të punonjësve, për formimin e shijeve dhe të sjelljeve të tyre komuniste, për fitoren e moralit socialist dhe të mënyrës së re të jetesës, ne e shohim dhe duhet ta shohim gjithmonë si një aspekt shumë të rëndësishëm të luftës së klasave në frontin ideologjik. Nga ky prizëm duhet të vlerësojmë gjithë veprimtarinë edukative që zhvillohet nën drejtimin e Partisë, gjithë aktivitetin e levave të saj e të mjeteve të ndryshme edukative e kulturore.

Për edukimin komunist të masave një rol veçanërisht të madh luajnë shtypi dhe Radiotelevizioni, që kanë dhënë kontribut të shquar në edukimin politik, ideologjik e kulturor të masave dhe për organizimin e mobilizimin e tyre në luftën për ndërtimin socialist të vendit.

Pastërtia ideologjike ka qenë dhe mbetet parimi bazë i shtypit tonë popullor e të partishëm. Por kohët

e fundit në disa organe, si në gazetën «Drita» e «Zëri i rinisë», në revistën «Nëntori» e «Ylli», në disa botime të shtëpisë botuese «Naim Frashëri» kanë dalë një sërë krijimesh letraro-artistike e shkrimesh kritike me ide, koncepte e teorizime të huaja, me prirje liberale moderniste e dukuri të tjera dekadente, të papajtueshme me ideologjinë dhe kulturën tonë. Këto kanë krijuar përshtjellim në mendjet, ndjenjat e shijet e masave punonjëse e sidomos të rinisë. Lëshimet që janë bërë në organet e ndryshme të shtypit sjellin një dëm shumë të madh, sepse nëpërmjet tyre ndikimet e huaja borgjezo-revizioniste të futura kontrabandë, jo vetëm që fitojnë, si të thuash, «të drejtën e qytetarisë», po përhapen në mënyrë të shpejtë e masive në të gjitha kategoritë e popullsisë.

Në organet e shtypit duhet të zbatohen me intran-sigjencë dhe konsekuencë vija dhe direktivat e Partisë. Çdo shkrim, çdo material i botuar në faqet e gazetave, të revistave e të librave duhet të përshkohet nga ideologjia marksiste-leniniste, t'i shërbejë edukimit të gjithanshëm komunist të masave, formimit të njeriut të ri të shoqërisë socialiste. Shtypi, ashtu si deri sot, duhet të frymëzojë masat për qëllimet e larta të ndërtimit të socializmit dhe mbrojtjes së atdheut. Ai duhet të rritë frymën militante revolucionare dhe të goditë me forcë ndikimet e huaja të çfarëdo lloji dhe nga çdo krah që të vijnë ato. Ai duhet të demaskojë rendin borgjez e revizionist, politikën e tyre antipopullore e agresive, ideologjinë e kulturën e tyre dekadente, të zbulojë plagët sociale dhe të tregojë kalbëzimin e gjithanshëm të sistemit të tyre.

Njihet vendi i posaçëm që zënë radioja dhe televizioni në sistemin e propagandës së Partisë. Radiotelevizioni ynë, i udhëhequr nga Partia, ka bërë nga viti në vit përparime të dukshme. Në tërësinë e vet puna e tij është karakterizuar nga përpjekjet e komunistëve dhe të të gjithë punonjësve për rritjen e rolit të këtij institucioni në jetën politike, kulturore e artistike të vendit për propagandimin e vijës e të qëndrimeve marksist-leniniste të Partisë, të përparimeve të Shqipërisë socialiste.

Megjithëkëtë, duhet vënë në dukje se, vitin e fundit sidomos, në programet muzikore, kulturore e artistike të Radiotelevizionit u dobësua dalngadalë fryma revolucionare, brendia socialiste dhe karakteri kombëtar. Këto shmangie u pasqyruan në kopjimin e mënyrave dhe të formave të huaja të ndërtimit e të paraqitjes së programeve të ndryshme televizive, në transmetimin pa kriter politik e ideoestetik të këngëve të huaja, në inkurajimin e krijimit dhe në propagandimin e këngëve moderniste, që imitonin muzikën perëndimore. Kështu programet e Radiotelevizionit filluan të shkëputeshin nga kërkesat shpirtërore të masave të gjera punonjëse, sidomos të rinisë, dhe të bëheshin përçuese të shijeve dhe të një morali të huaj, që u pëlqenin vetëm një kategorie snobistësh. Ky produkt i huaj për jetën, për ideologjinë e kulturën tonë u shpreh në mënyrë të sintetizuar në festivalin e 11-të të këngës në Radiotelevizion.

Një përgjegjësi të madhe për këto shmangie nga vija e Partisë në Radiotelevizion mban Todi Lubonja, ish-drejtor i këtij institucioni, i cili si deviator i djath-

të ka manifestuar dhe ka përkrahur pikëpamje të theksuara liberale oportuniste, shije estetike moderniste dhe ka zbatuar metoda të huaja drejtimi. Ai u orvat t'i jepte Radiotelevizionit një drejtim thjesht informativ e kulturor-argëtues, drejtim ky që ishte në kundërshtim me orientimet e Komitetit Qendror të Partisë, për karakterin politik, ideologjik e kulturor-edukativ të tij. Todi Lubonja edhe si ish-sekretar i Komitetit të Partisë të Rrethit të Korçës, edhe si drejtor i Radiotelevizionit është karakterizuar nga mendjemadhësia. Ai, duke qenë në të njëjtën rrugë antiparti si Fadil Paçrami dhe, duke ndjekur të njëjtat qëllime kundër Partisë, ka qenë kundër vijës së Partisë dhe ka punuar për shtrembërimin e saj. Ai ka mënjanuar organizatën-bazë të Radiotelevizionit nga udhëheqja ideologjike, politike e organizative e këtij institucioni, ka ndjekur një politikë personale kuadri, duke grumbulluar rreth vetes njerëz që vetë gjykonte se ishin të përshtatshëm për zbatimin e pikëpamjeve dhe të shijeve të tij. Në këtë mënyrë ai dëmtoi rëndë veprimtarinë e këtij institucioni të rëndësishëm dhe përgjithësisht punën e Partisë për edukimin ideoestetik të masave, veçanërisht të rinisë.

Partia ka marrë masa për zhdukjen e ndikimeve të huaja në Radiotelevizion. Gjendja atje është përmirësuar, por mbetet akoma shumë për të bërë që radioja e sidomos televizioni të zbatojnë plotësisht detyrat e mëdha që i ka besuar Partia kësaj qendre të madhe propagandistike e kulturore për edukimin e gjithanshëm të masave dhe formimin e tipareve të tij si një televizion revolucionar, socialist e shqiptar.

Këto tipare televizioni ynë i ri do t'i krijojë jo duke imituar e kopjuar programet dhe format e parqitjes të televizioneve të huaja. Një vijë e qartë demarkacioni duhet të ndajë televizionin tonë nga ai i vendeve borgjezo-revizioniste. Rruga e zhvillimit të tij është ajo e Partisë, e popullit, e socializmit dhe e revolucionit.

Partia dhe Qeveria do të përkrahin e do të inkurajojnë si kurdoherë përpjekjet e punonjësve të Radio-televizionit për të renë, për të bukurën, të larmishmen, për programe që të pasqyrojnë me të vërtetë zhvillimin e vullshëm dinamik të shoqërisë sonë, për programe që t'u përgjigjen kërkesave arsimore-kulturore e shijeve estetike gjithnjë në rritje të masave punonjëse e sidomos të rinisë.

Përmirësimi i gjithanshëm i edukimit komunist të brezit të ri lidhet ngushtë edhe me punën e shkollës, të mësuesve dhe të pedagogëve. Këto vitet e fundit, duke luftuar për zbatimin e orientimeve të Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të saj, shkolla jonë ka bërë hapa të rëndësishëm përpara. Krahas një masivizimi të paparë të arsimit, po duken gjithnjë e më qartë përpjekjet për realizimin e boshtit ideologjik marksist-leninist në gjithë punën mësimore-edukative, për zbatimin në unitet të mësimit me punën prodhuese dhe edukimin fizik e ushtarak, për revolucionarizimin e metodave të mësimit e të edukimit, për demokratizimin e mëtejshëm të jetës shkollore. Një punë me të vërtetë e madhe është bërë e vazhdon të bëhet për hartimin e për përsosjen e teksteve të reja shkollore.

Megjithatë rendimenti i përgjithshëm i punës më-

simore-edukative të shkollës nuk i përmbush akoma kërkesat tona. Në shkolla dhe në universitet ka dobësi të theksuara, si nga ana e trupit mësimor, ashtu edhe nga nxënësit e studentët. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës nuk e ka kryer si duhet detyrën e vet në këtë drejtim. Ajo, duke qenë e ngarkuar shumë me punën e madhe që kërkonte riorganizimi i shkollës, sipas vendimeve të Komitetit Qendror të Partisë, harroi dhe nuk ndoqi si duhet gjënë kryesore të këtij riorganizimi, forcimin e anës edukative të shkollës. Në veprimtarinë e shkollës ka akoma mjaft formalizëm dhe kjo e metë bie në sy veçanërisht në aktivitetin edukativ të saj.

Formimi ideoestetik dhe etiko-moral i nxënësve dhe i studentëve është një nga ato aspekte themelore të edukimit komunist që po realizohet më dobët në shkollën tonë. Këtu nuk është fjala vetëm për ato dobësi që vërehen në këtë fushë në mësimin e lëndëve përkatëse, por sidomos për punën e pamjaftueshme që zhvillohet brenda e jashtë mësimin për zhvillimin e zgjerimin e horizontit kulturor të nxënësve e të studentëve, për formimin e shijeve të tyre ideoestetike, të qëndrimit kritik ndaj vlerave të ndryshme kulturore, për formimin e vetive të reja morale dhe edukatës qytetare.

Nuk mund të mos vërejmë se lufta për demokracizimin e jetës shkollore, për aktivizimin më të madh të nxënësve e të studentëve, për marrëdhënie të drejta mësues-nxënës nuk është bërë e lidhur ngushtë me forcimin e disiplinës proletare në jetën e shkollës. Këtu ka pasur shumë lëshime, një frymë të theksuar mungese përgjegjësie e liberalizmi. Organizatat e rinisë shpesh e kanë vënë theksin në mënyrë të njëanshme tek «të



drejtat» e të rinjve, pa i parë ato në unitet me detyrat. Organet e arsimit, gjithashtu, dobësuan shumë kërkesat e drejta të rregulloreve shkollore e shumë mësues e pedagogë mbajtën qëndrime pasive e konformiste. Duke e vënë theksin në mënyrë të njëanshme në luftimin e prirjeve të konservatorizmit në metodat e punës edukative, nuk u luftuan me forcën e duhur qëndrimet indiferente e liberale. Janë të gjitha këto arsye serioze që ndikojnë në disiplinën akoma të ulët shkencore e pedagogjike të punës në shkollë.

Tani në shkolla po luftohet kundër këtyre të metave e dobësive. Por nuk duhet kurrësi të kënaqemi me ato masa të drejta që janë marrë për rregullimin imediat të gjendjes. Për më tepër, duhet të ruheni që këto masa të mos marrin vetëm karakter të thjeshtë-suar administrativ. Pa hequr dorë nga masat e drejta organizative e administrative për forcimin e rregullit e të disiplinës në shkolla, bile duke luftuar me këmbëngulje për zbatimin e plotë të tyre, është e domosdoshme të punohet edhe për një zgjidhje më të thelluar e perspektive të këtyre problemeve. Programi i Partisë për revolucionarizimin e mëtejshëm të shkollës nuk mund të realizohet plotësisht pa intensifikuar luftën për ngritjen e rendimentit e të cilësisë së gjithë veprimtarisë së saj, pa përmirësimin rrënjësor të të gjithë sistemit të punës së saj edukative. Nga problemet më të mprehta e më aktuale të kësaj sfere janë forcimi i edukimit ideoestetik, i edukatës qytetare, i shijeve e i sjelljeve komuniste, i frymës së disiplinës shoqërore komuniste.

Dëshiroj të ndalem pak më gjerë në punën e organizatës së rinisë. Ajo, si levë e rezervë luftarake e

Partisë, gjatë gjithë jetës së saj ka luajtur një rol shumë të madh në edukimin dhe mobilizimin e brezit të ri për ndërtimin e mbrojtjen e atdheut. Partia gjithmonë i ka besuar organizatës së rinisë detyra me përgjegjësi dhe ajo e ka justifikuar kurdoherë plotësisht këtë besim me luftën e punën e saj të palodhur në shërbim të popullit e të revolucionit.

Megjithëkëtë, nuk na lejohet të mos shohim të metat në punën e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, shtrembërimet e gabimet që janë vërtetuar sidomos këto vitet e fundit e që lidhen drejtpërsëdrejti me ato shfaqje e fenomene të huaja liberale moderniste që kritikojnë sot Partia.

Organizatat e rinisë, posaçërisht në shkolla, por edhe në fshatra e qendra pune, nuk kanë qenë si duhet në krye të situatës, për dobësi të udhëheqjes së rinisë, ndër ta edhe të Agim Meros, kur ishte sekretar i parë i Komitetit Qendror të Rinisë. Agimi është një kuadër i ri, që rrëshqiti në liberalizëm, që iu rrit mendja dhe krijoi pikëpamje jo të drejta për rininë, që dobësoi normat që udhëhiqnin jetën organizative të organizatës së saj. Edhe mbasi vajti në universitet, ai ruajti disa koncepte të gabuara liberale për sa u përket të drejtave të studentëve, pa vënë theksin siç duhet edhe në detyrat e tyre<sup>1</sup>.

Zbulimi dhe autokritika që bënë organizatat e ri-

---

1. Faktet treguan se edhe më vonë Agim Meroja mbajti qëndrim negativ ndaj gabimeve e fajeve të tij të rënda. Prandaj në vitin 1976 Plenumi i 9-të i KQ të PPSH e përjashtoi nga radhët e tij si kandidat, si edhe nga Partia.

nisë për gabimet e vërtetuara janë një shenjë mjaft e mirë që tregojnë se ato, nën drejtimin e Partisë, do të shëndoshin shpejt gjendjen e tyre dhe do të qëndrojnë në krye të vrullit të rinisë si reparte luftarake të saj. Por, nga ato gabime që janë vërtetuar, gjithë Partia dhe kuadrot e militantët e rinisë duhet të nxjerrin mësimë që të mos i lejojnë më të përsëriten.

Udhëheqja e rinisë nuk e kuptoi dhe nuk e zbatoi drejt direktivën e Partisë për të luftuar njëkohësisht në të dy krahët. Ky ishte burimi i shumë gabimeve në punën e organizatës së rinisë. Duke luftuar me të drejtë kundër patriarkalizmit e konservatorizmit, që ndrydhin e frenojnë zhvillimin e energjive krijuese të rinisë, nuk u vlerësua si duhet edhe rreziku i ndikimeve të ideologjisë borgjeze e revizioniste. Bile shumë shfaqje e fenomene të këqija janë justifikuar e minimizuar, duke thënë se «nuk ka gjë për t'u shqetësuar» dhe se «ato janë kalimtare e që lidhen me moshën e rinisë». Megjithëse thuhej që «nuk duhet parë guna, por puna», udhëheqjen e rinisë nuk e kanë shqetësuar rezultatet e dobëta mësimore në shkollë, fakti që mijëra të rinj përsëritnin vitin ose braktisnin shkollën, që të rinjtë punëtorë e kooperativistë bënin shumë mungesa në punë, që krimet nga të rinjtë vazhdonin të rritejshin etj.

Në udhëheqjen e rinisë ka pasur një prirje për t'u marrë më tepër me të drejtat e kërkesat e rinisë, të cilat gjithnjë Partia ka porositur të shihen me kujdes. Po, në të njëjtën kohë, nuk shikohej e nuk theksohej se rinia duhet të kryejë me përpikëri edhe detyrat në mësim e në punë, se çdo gjë ajo nuk duhet ta kërkojë

të gatshme, por duhet të punojë e të lodhet shumë edhe vetë për të krijuar kushtet për një jetë të gjallë kulturore, sportive e argëtuese, se ajo duhet t'i ruajë dhe të përpiqet t'i shfrytëzojë mjetet që ka vënë shteti në dispozicion të saj.

Rinia duhet të edukohet që ajo vetë, në radhë të parë, të jetë aktive dhe luftarake dhe të mos ndodhë që për dobësitë e saj në mësim, për shembull, t'ua hedhë fajin «paaftësisë së pedagogëve», që për mosplotësimin e planeve në aksione fajin t'ua ngarkojë «teknikëve e drejtuesve» etj. Ajo duhet të luftojë kundër vetëkënaqësisë e mendjemadhësisë, të cilat çojnë në një punë për zhurmë e për bujë.

Nënvleftësimi i punës edukative në rini, bile pas punimit të Historisë së Partisë, heqja dorë nga format e organizuara për edukimin e masave të rinisë, duke menduar se me nxënësit këtë e bën shkolla, se në qendrat e punës rinia edukohet në bashkimet profesionale, ndërsa në fshat në Frontin Demokratik, ishte, gjithashtu, një gabim tjetër serioz.

Shfaqje të liberalizmit prekën edhe jetën e brendshme të Bashkimit të Rinisë, format dhe metodat e punës së tij. Direktiva shumë e drejtë e Partisë për të luftuar shfaqjet e zyrtarizmit, të burokratizmit, format e ngurta, për të aplikuar një punë të zhdërvjellët me rininë, u interpretua në mënyrë liberale. Ajo u kuptua si një çlirim i organizatës nga çdo rregull i domosdoshëm, gjë që çoi në shkeljen e disa normave më themelore të përcaktuara në statutin e Bashkimit të Rinisë. Në fakt, mbledhjet filluan të bëheshin të rralla, kurse mungesat në to bëheshin më të shpeshta, jeta e orga-

nizatave-bazë dhe e forumeve, si dhe lidhjet midis tyre filluan të dobësohen.

Përveç udhëheqjes së rinisë, për dobësitë që janë shfaqur në punën organizative të saj, përgjegjësi të madhe kanë edhe organizatat e komitetet e Partisë, të gjithë komunistët.

Komiteti Qendror i Partisë me të drejtë ka theksuar gjithnjë nevojën për t'u lënë më shumë iniciativë e vetëveprim organizatave të rinisë. Por mos vallë kjo do të thotë se Partia duhet të kujdeset më pak për rininë, se nuk është e nevojshme udhëheqja e vazhdueshme e saj mbi organizatat e Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë? Te Partia gjen forcën, orientimin dhe frymëzimin e saj rinia. Kuadrot më të mirë të Partisë duhet të ngarkohen t'i flasin rinisë, t'i shpjegojnë asaj qartë direktivat dhe vendimet që merr Partia. Dhe të mos ngjasë që edhe kandidati që, porsa pranohet në Parti nga radhët e rinisë, të largohet nga organizata e rinisë ose edhe kur merr pjesë, të mos japë atje asnjë ndihmë.

Të mos harrojmë kurrë se rinia ka qenë dhe mbetet gjithnjë objekt i veprimtarisë së të gjithë armiqve. Prandaj duhet kalitur e brumosur ajo vazhdimisht si revolucionare, si duke i folur për të kaluarën, për luftën e për vështirësitë e kapërcyera, ashtu dhe duke e hedhur në aksione, duke e bërë që të angazhohet seriozisht në punë, sa kohë që e reja ose i riu është nxënës e student, në mësim, ndërsa kur del në jetë, në punën prodhuese apo kudo që të caktohet. Në tërë punën që po bën sot Partia për forcimin e përgjithshëm të gjendjes, një vend të veçantë duhet të zërë forci-

mi i Bashkimit të Rinisë së Punës të Shqipërisë, përgjithësisht forcimi i punës me rininë. Të kujdesemi që shkolla, institucionet artistike e kulturore, tërë mjetet e propagandës, sporti etj., të vihen më mirë në shërbim të edukimit revolucionar të rinisë.

Rinia, si kurdoherë edhe këtë radhë, i ka kuptuar drejt dhe po i vë në jetë me të tëra forcat e saj këshillat dhe mësimet e Partisë. Kjo është një dëshmi tjetër që tregon lidhjen e ngushtë të rinisë me Partinë. Çështja tani është që të thellojmë punën me rininë për t'i kuptuar akoma më mirë edhe nga ana ideologjike këto probleme, që ajo të angazhohet sa më gjerë e aktivisht në luftën klasore, në mësim për përvetësimin e teorisë marksiste-leniniste, të shkencës dhe të teknikës, në punë e në aksione për ndërtimin e socializmit, në përgatitjen fizike ushtarake për mbrojtjen e vendit dhe mbi këtë bazë të shëndoshë ta kalitim atë më tej si forcë e pamposhtur revolucionare në luftën që po udhëheq Partia për ndërtimin e socializmit në vendin tonë.

## **Për një kuptim të drejtë të centralizmit e të demokracisë në drejtimin e ekonomisë**

Deri tani folëm për problemet e artit e të letërsisë, si dhe të edukimit ideoestetik e moral të masave. Por fronti i luftës kundër liberalizmit, siç e vërtetoi edhe diskutimi që u bë, është shumë më i gjerë. Me shfaqje të tilla ne ndeshemi edhe në një fushë të tillë të rëndësishme siç është ekonomia.

Karakteristikë e përgjithshme e ekonomisë sonë është zhvillimi i saj i shpejtë e i pandalshëm. Edhe në këta dy vjetët e fundit prodhimi industrial është rritur me një ritëm mesatar prej 10,5 për qind, pra, me ritëm më të lartë nga sa ishte parashikuar në planin pesëvjeçar. Një rritje dinamike e prodhimit është ruajtur edhe në bujqësi. Sukseset e arritura deri tani dhe mobilizimi e entuziazmi i punonjësve tregojnë qartë se edhe sivjet detyrat e caktuara do të realizohen.

Fitoret e arritura deri sot përbëjnë një bazë të shëndoshë për të plotësuar detyrat që lindin nga nevoja historike e ndërtimit të socializmit, për të përballuar pasojat që na imponon rrethimi imperialisto-revizionist. Por, duke e parë punën tonë me sy kritik, në praktikën e drejtimit e të administrimit të ekonomisë ka edhe anomalitë e të meta, të cilat nuk janë as të reja, as edhe të panjohura. Kështu, mjaft herë janë vërejtur qëndrime të njëanshme e lëshime ndaj detyrave, përgjegjësive e ligjeve shtetërore, dobësim të kontrollit e të kërkesës së llogarisë, tulatje të vigjilencës revolucionare dhe të luftës së klasave. Të tilla shfaqje të karakterit liberal nuk mund të mos ndikojnë për keq në çështje kaq të rëndësishme, siç janë disiplina e planit dhe e punës, drejtimi ekonomik i ndërmarrjes dhe kontrolli me anën e lekut, normimi e shpërblimi, administrimi i pasurisë së përbashkët socialiste etj.

Natyrisht anomali të të meta në fushën e ekonomisë nuk rrjedhin as nga sistemi ynë i drejtimit, as edhe nga politika ekonomike e Partisë, parimet themelore të të cilave kanë qenë kurdoherë e mbeten të drejta, gjë që e ka provuar koha, vetë realiteti ynë. Por ato e kanë

burimin në ndikimin dhe presionin që ushtron mbi njerëzit tanë rrethimi kapitalisto-revizionist, në mentalitetet e vjetra mikroborgjeze, në kuptimin e ngushtë të direktivave të Partisë.

Në disa nga çështjet, që kanë të bëjnë me drejtimin e administrimit e ekonomisë, vihet re një liberalizëm që më tepër anon nga njëfarë voluntarizmi e subjektivizmi. Jo rrallëherë ndeshen nënvleftësime të ligjeve ekonomike, nuk mbahen parasysh sa duhet kërkesat e tyre nga organet përkatëse ekonomike e shtetërore. Posa rendimenti i punës u përcaktua në metodologjinë e re të planifikimit si tregues llogaritës, filloi të pakësohet edhe vëmendja ndaj tij. Si rrjedhim, në mjaft ndërmarrje, rrethe e ministri u dukën shenjat e fryrjes së planeve të fuqisë punëtore, duke e quajtur një gjë normale mbajtjen ose kërkesën e punëtorëve të tepërt e mbi planin. Së këtejmi u shfaq fenomeni tjetër negativ që, ndërsa fondi i pagave tejkalohet, plani i prodhimit në disa ndërmarrje nuk plotësohet, ose plotësohet jo në masën e duhur, duke shkaktuar në këtë mënyrë shpërpjesëtime midis rritjes së fuqisë blerëse dhe fondit të mallrave që duhen për mbulimin e saj. Me mosmbajtjen sa duhet parasysh të kërkesave të ligjeve ekonomike shpjegohet dobësimi i drejtimit ekonomik të ndërmarrjes, dobësimi i kontrollit mbi përdorimin e fondeve themelore e të mjeteve të xhiros, kujdesi i pamjaftueshëm për të llogaritur me hollësi e deri në fund leverdinë ekonomike për çdo prodhim, për çdo shpenzim e investim, duke u nisur nga mendimi: «Të prodhojmë një herë, pa të tjerat rregullohen, vijnë pas». Në nënvleftësimin e levave ekonomike e ka burimin



heqja për një kohë dhe dobësimi i kontrollit mbi fondin e pagave dhe mbi investimet.

Komisioni i Planit, Ministria e Financave dhe dikasteret e tjera është e domosdoshme të rishikojnë thellësisht e në mënyrë kritike praktikën e derisotme të punës së tyre. Organet financiare duhet ta fuqizojnë kontrollin financiar për shpenzimet që caktohen nga buxheti në ekonomi e në çdo fushë tjetër, me qëllim që të rritet efikasiteti i tyre. Dikasteret qendrore, gjithashtu, duhet të përcaktojnë masa konkrete për forcimin e mëtejshëm të drejtimit ekonomik të ndërmarrjes, për të rritur rentabilitetin në përgjithësi e sidomos në degët e ndërmarrjet e prapambetura, ose që punojnë me humbje. Vitin e kaluar 208 ndërmarrje nuk plotësuan planin e fitimit, ose i tejkaluan humbjet e planifikuar. Tre vjetët e fundit, mesatarisht çdo vit kanë dalë nga prapambetja 100-110 ndërmarrje, ndërsa kanë rënë në prapambetje 90 deri në 100 të tjera. Dikasteret, gjithashtu, duhet të forcojnë kërkesat për rritjen e rendimentit të punës dhe për përdorimin racional të fuqisë punëtore, sidomos në sektorët ndihmës të prodhimit e në ata social-kulturorë, duke përsosur vazhdimisht normimin e shtrënguar të punës dhe vetë organizimin e saj.

Vendi ynë është një vend i vogël, por që i ka vënë vetes detyra e pikësnyime të mëdha për ndërtimin e plotë të shoqërisë socialiste. Po të kemi parasysh edhe faktorët e njohur politikë dhe ekonomikë, që rrjedhin nga rrethimi kapitalisto-revizionist, atëherë bëhet edhe më e qartë domosdoshmëria e asaj norme të lartë akumulimi që zbatohet te ne, e investimeve shumë të më-

dha që jemi të detyruar të bëjmë, e ritmeve të larta që duhet të ruajë ndërtimi ynë socialist, nevoja e vendosjes së një regjimi të rreptë e të gjithanshëm kursimi.

Shumë fakte e të dhëna flasin se mbeturinat në ndërgjegjen e njerëzve dhe ndikimet e huaja borgjezo-revizioniste për ta parë ngushtë interesin e çastit, personal, dikasterial, lokal e të grupit, edhe kur ai bie në kundërshtim me interesin e përgjithshëm e perspektiv, u kanë hapur rrugë në praktikën e përditshme mjaft veprimeve të shtrembra e që pengojnë kombinimin e drejtë e revolucionar të këtyre interesave.

Shikimi i ngushtë, jo me syrin politik, i interesave lokalë e dikasterialë i shtyn disa kuadro të bëjnë kërkesa të tilla për investime, për fuqi punëtore e materiale, të cilat nuk mund të përballohen nga ekonomia jonë, ose nuk justifikohen me shtimin përkatës të prodhimit, me rritjen e rendimentit të punës dhe të të ardhurave.

Mjaft ndërmarrje dhe organe drejtuese në rrethe e në qendër, në kohën kur hartohen planet, paraqitin shumë arsyetime e llogaritje mbi gjoja nevojën e këtij apo të atij investimi. Por, pa u tharë mirë boja e aprovimit të tyre, fillojnë kërkesat për ndryshimin e fondëve ose zëvendësimin e njërit objekt me një objekt tjetër të paparashikuar fare në plan. Vitin e kaluar 9 rrethe, si: Tirana, Durrësi, Korça, Fieri, Gjirokastra etj., për të realizuar një numër objektesh të planifikuara, kërkuan një shtesë fondesh prej rreth 30 për qind më shumë nga sa ishte aprovuar në fillim. Vetëm rrethet e Peshkopisë e të Gramshit në tremujorin e katërt të vitit të kaluar kërkuan shtesë ose pakësim fondesh për 65 objekte. Nuk mund të lejohet më tej që investuesit,

projektuesit dhe zbatuesit të marrin nëpër këmbë planet e aprovuara dhe të ndryshojnë fondet e caktuara për çdo objekt, si dhe kufijtë e tyre të financimit.

Ndodh edhe ndryshe. Fillohet një punë me mendimin e mirë e zotimin se ajo do të kryhet me forcat e veta dhe pastaj vërshojnë kërkesat e presionet deri në Qeveri për materiale e pajisje nga importi, duke e vënë shtetin para alternativës: ose t'i plotësojë këto kërkesa, ose të pranojë si fakt të kryer bllokimin e fondeve monetare e materiale në një objekt të papërfunduar.

Ka ndërmarrje, komitete ekzekutive rrethesh dhe dikastere qendrore që, si pa të keq, kërkojnë ose mbajnë për vete materiale në sasi më të mëdha nga sa janë nevojat e tyre ose nga sa u janë planifikuar. Kush i dha të drejtën Ministrisë së Industrisë e të Minierave, e cila në vitin 1972, pa autorizim të Qeverisë, ka përdorur për ndërmarrjet e veta mbi sasi të planifikuara naftë, në një kohë kur mjaft ndërmarrjeve të dikastereve të tjera nuk iu plotësua plani i furnizimit? Këto veprime e këto praktika janë jo vetëm një shkelje flagrante e disiplinës së planit dhe e kërkesave të ligjeve ekonomike, por ato dëshmojnë edhe për një kuptim liberal të situatave politike dhe ekonomike të brendshme e të jashtme, në të cilat jetojmë dhe luftojmë për ndërtimin e socializmit. Pra, këto çështje duhen parë thellë dhe me sy politik partie. Fenomenet që po kritikojmë jo vetëm i sjellin dëme e çrregullime ekonomisë, por ndikojnë keq edhe në ndërgjegjen e njerëzve. Prandaj këtyre praktikave të dëmshme duhet t'u pritët rruga një herë e mirë dhe të merren masat e nevojshme për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen.

Klasa jonë punëtore punon dhe realizon detyrat me një frymëzim e entuziazëm gjithnjë e më të madh, me një ndërgjegje gjithnjë e më të lartë. Dhe këto cilësi të mrekullueshme të saj shihen në rezultatet madhështore që ka arritur dhe po arrin vendi ynë në industrializimin socialist, në përparimin e bujqësisë, në zhvillimin e kulturës, në ngritjen e pandërprerë të mirëqenies dhe të përmirësimit të vazhdueshëm të jetesës. Këto cilësi janë karakteristikë e përgjithshme për shumicën e punonjësve. Por ka edhe punonjës të prapambetur, të cilët, për shkak të prejardhjes së tyre sociale, të stazhit të paktë në prodhim ose të ndonjë arsyeje tjetër, nuk janë çliruar akoma nga mjaft koncepte mikroborgjeze, nuk kanë fituar akoma vërtetë e vërteta të klasës. Ndaj këtyre ndodh që disa drejtues të ekonomisë të mbajnë një qëndrim sentimental, gjë që është e huaj me frymën revolucionare e parimore. Në diskutimet e zhvilluara në qendrat e punës e të prodhimit janë bërë mjaft kritika e vërejtje në këtë drejtim. Përse u dashka të mbahen norma të ulëta pune që tejkalohen lehtë, pa shumë mund e djersë dhe që pastaj punëtorë e kooperativistë të veçantë të zhvatin nga shoqëria më shumë nga sa u takon dhe nga sa i kanë dhënë asaj në të vërtetë? Kujt i shërben ngritja në mënyrë artificiale e pa baza e kategorive të vendeve të punës, me qëllim që gjoja midis punëtorëve të ndërmerrijës apo të degës së tyre të mos ketë dallime të theksuara në shpërblimin e punës? Megjithëse janë marrë vendime të prera që të mos lejohen shtesa në rrogat e punonjësve të administratës derisa të bëhet studimi që është caktuar, ka ministri, të cilat, me qëllim që të ngrenë rrogat e puno-

njësve të administratës, i paraqitin propozime Qeverisë për të ngritur në kategori disa nga ndërmarrjet e tyre. Të tilla prirje duhen goditur si të dëmshme për ekonominë, si të papranueshme për shoqërinë tonë socialiste.

Shfaqjet e huaja në ekonomi janë jo rrallë rezultat i një kuptimi e zbatimi të pathelluar të raportit ndërmjet centralizmit e demokracisë, drejtimit unik dhe vijës së masave. Këto kanë çuar në dobësimin e kërkesës së llogarisë dhe të kontrollit të rreptë për zbatimin e detyrave, në shkeljen flagrante të disiplinës. Këto janë edhe pasojat më evidente e më të përhapura të liberalizmit në ekonomi.

Jo një herë Komiteti Qendror ka ngulur këmbë që planet të plotësohen jo vetëm si sasi, por edhe për çdo asortiment dhe në përputhje të plotë me kërkesat e standardeve e të kushteve teknike. Dhe përgjithësisht tani nga viti në vit vihet re një përmirësim i dukshëm, janë shtuar përpjekjet për t'iu përmbajtur me rreptësi planit të shtetit dhe kërkesave të tij, është vënë re një kuptim më i drejtë i nevojës së përmbushjes deri në fund të të gjitha zërave e treguesve të planifikimit e të prodhimit. Por në praktikë ndodh që prodhimi të ndiqet e të realizohet vetëm në shifra globale, ndërsa disa mijëra tonë krom e qymyr, disa mijëra metra linear tekstile dhe disa mijëra palë këpucë e konfeksione janë prodhuar në kundërshtim me kushtet teknike e standardet, duke rënduar ekonominë me mallra stoqe, me mbinormativa, me prodhime skarco. Megjithëse në strukturën e mallrave të tregtisë ndihen edhe mungesa, në fillim të këtij viti ndërmarrjet tregtare kishin mbi normativë rreth 250 milionë lekë mallra. Tekstilet, kon-

feksionet dhe këpucët e pashitura në tregti kanë tendencë rritjeje. Edhe pse dy vjetët e fundit janë zhvlef-tësuar mbi 46 milionë lekë mallra, prodhimi i tyre me cilësi të dobët vazhdon akoma në disa ndërmarrje e reparte.

Njerëz të pandërgjegjshëm, duke spekuluar në demokracinë tonë socialiste, shkelin rëndë disiplinën në punë. Ata vijnë e ikin nga puna kur t'u dojë qejfi, ndërpresin punën sa herë të duan, sorollaten nëpër ndërmarrje pa pyetur fare për rregullat në punë. Vitin e kaluar rreth 3 000 punëtorë mungonin pa arsye mesatarisht çdo ditë; me mijëra fshatarë nuk dilnin në punë, ndërsa një e katërta e gjithë kooperativistëve kryen më pak se 200 ditë-punë, kur në bujqësi shumë punime nuk bëhen në kohë e me cilësi. Koha e punës nuk shfrytëzohet plotësisht as në administratat shtetërore.

Ka njerëz që përpjekjet e drejtuesve të Partisë, të pushtetit e të ekonomisë për të vendosur rregull e disiplinë orvaten t'i kundërshtojnë në emër të demokracisë e të vijës së masave. Centralizmi demokratik kërkon, siç e ka shpjeguar Lenini dhe siç e ka theksuar kurdoherë Partia jonë, që gjërat të vendosen bashkërisht pas një diskutimi e shkëmbimi të lirë mendimesh, në mënyrë më demokratike e me frymë revolucionare. Por, pasi ato të jenë vendosur, secili duhet të përgjigjet deri në një për detyrën e ngarkuar, të zbatojë e të respektojë disiplinën e planit, atë teknike e të punës. Në kërkimin e kësaj llogarie centralizmi demokratik kalon me doemos nëpër veprimin e pandashëm të drejtimit unik, të bindjes ndaj urdhrit të eprorit, të drejtuesit, që është

i ngarkuar i shtetit, i klasës në fuqi, për realizimin konsekuent dhe pa të çara të politikës ekonomike të Partisë. Çdo qëndrim tjetër liberal e sentimental është i dëmshëm dhe i huaj. Sa më shumë shtohen të drejtat e kompetencat, aq më shumë rriten edhe detyrat dhe përgjegjësitë për zbatimin e tyre nga cilido.

Këta muajt e fundit, kur klasa punëtore u ngrit në këmbë dhe kritikoi me ashpërsi të metat e dobësitë e konstatuara, rezultoi se kudo u vu një rregull më i mirë, u forcua mjaft disiplina në punë, kontrolli dhe kërkesa e llogarisë u rritën, përgjithësisht u shtua mobilizimi dhe këmbëngulja për të arritur objektivat e caktuar. A nuk tregon kjo se ekzistojnë të gjitha mundësitë dhe të gjitha kushtet objektive e subjektive që shpejt dhe me vendosmëri të mënjanojnë vështirësitë e pengesat, që e gjithë puna jonë të ngrihet në një nivel më të lartë, që ekonomia jonë të ecë kurdoherë përpara me ritme të shpejta dhe pa u ndalur?

Klasa punëtore përbën në çdo pikëpamje themelin e ndërtimit tonë socialist, faktorin vendimtar të tij. Asaj i përket të drejtjës, të ushtrisë kontrollin e ndikimin e vet, si në kuadrin e përgjithshëm shtetëror, ashtu edhe drejtpërdrejt në të gjitha hallkat e ekonomisë e të administratës shtetërore. Rezultatet e arritura në këtë drejtim janë të dukshme. Lufta e Partisë kundër burokratizmit nuk do të kishte pasur atë gjerësi e thellësi, po të mos që ngritur me guxim revolucionar klasa punëtore, po të mos kishte shpërthyer kontrolli i saj masiv, i drejtpërdrejtë, kudo e mbi cilindo. Prandaj është absolutisht e domosdoshme që këtë kontroll të zgjerojmë e ta forcojmë edhe në luftën kundër shfaq-

jeve të liberalizmit në ekonomi. Siç ka theksuar Partia, kontrolli punëtor duhet të përfshijë gjithë sferat e veprimtarisë sonë shoqërore. Por ai duhet të zhvillohet edhe si vetëkontroll në gjirin e klasës. Sa më e fuqishme dhe e papajtueshme të zhvillohet lufta e klasave brenda radhëve të saj kundër liberalizmit dhe çdo shfaqjeje tjetër të ideologjisë së huaj, aq më efikas do të jetë edhe kontrolli punëtor nga poshtë-lart brenda ndërmarrjes e jashtë saj.

Vënia e theksit mbi kontrollin e drejtpërdrejtë punëtor as nuk e përjashton, as edhe nuk e zëvendëson kontrollin shtetëror, i cili është atribut i pandarë i veprimtarisë organizative drejtuese të diktaturës së proletariatit. Mirëpo kohët e fundit në hallka të ndryshme të aparatit shtetëror dhe të ekonomisë ka pasur jo pak shenja të nënvleftësimit të kërkimit të llogarisë dhe mungesës së vënies përpara përgjegjësisë. Kjo prirej sa e dëmshme, aq edhe e rrezikshme, u ka lënë shteg qëndrimeve e veprimeve të huaja në administrimin e ekonomisë, frymës së lëshimeve e dobësimit të disiplinës në kryerjen e detyrave dhe deri në njëfarë mase i ka inkurajuar ato.

Praktika tregon se veprimet ekonomike antishtetërore jo vetëm denoncohen shumë rrallë para organeve përkatëse, por edhe kur bëhet një gjë e tillë, faktorët e kalojnë lehtë e lehtë, ndaj tyre nuk merren masa në rrugë administrative dhe mbahen qëndrime të buta, oportuniste. Pse ndonjë drejtues i ekonomisë i mbyll sytë kur njerëz të pandërgjegjshëm dëmtojnë pasurinë socialiste, marrin më tepër nga sa u takon dhe përveçtojnë mallin e popullit? A nuk e kupton ky se me lë-



shime e qëndrime të tilla liberale u sjell një dëm të madh interesave të socializmit dhe vetë atyre që kryejnë këto dëmtime e shpërdorime?

Duhet thënë, gjithashtu, se edhe organet e drejtësisë nuk e kanë kryer kurdoherë mirë detyrën e tyre për zbatimin e legjislacionit ekonomik kundër çdo veprimi antisocialist. Ato kanë bërë lëshime, janë treguar sentimentale e të pavendosura, duke lënë shtigje për veprime të përsëritura në dëm të ekonomisë e të shoqërisë sonë.

Partia gjithnjë na ka porositur të mos harrojmë për asnjë çast se ndërtimi ynë socialist zhvillohet në prani të luftës së klasave, të kontradiktave, të vështirësive dhe pengesave të ndryshme. Kapërcimi i tyre kërkon me doemos forcimin e diktaturës së proletariatit, organizim, rregull, disiplinë e përgjegjësi. Prandaj kontrolli shtetëror, i kombinuar sa më mirë me kontrollin punëtor, të fuqizohet në të gjitha hallkat nga qendra deri në bazë, në të gjitha format e tij administrative, juridike, financiare, bankare etj. Ai duhet të jetë sistematik, i thellë dhe i efektshëm për të luftuar shfaqjet e huaja e për të parandaluar të metat e gabimet.

Një parim themelor i ndërtimit tonë socialist është mbështetja në forcat e veta. Ky parim ka hyrë thellë në shpirtin e në gjakun e punonjësve tanë, të cilët i karakterizon një besim i pafund në energjitë, në iniciativën dhe në veprimin e tyre revolucionar. Punëtorët, kooperativistët, kuadrot inxhiniero-teknikë dhe drejtuesit e ekonomisë, duke zbatuar me guxim parimin e mbështetjes në forcat e veta, kanë përballuar me nder detyra të rënda e të ndërlikuara dhe kanë kapër-

cyer jo pak vështirësi. Ky parim i madh dhe kjo frymë revolucionare po shprehen me forcë edhe gjatë zbatimit të detyrave të pesëvjeçarit të pestë. Duke filluar nga veprat e mëdha e duke përfunduar te repartet e vogla, janë shtuar përpjekjet për thjeshtësimin e projekteve e të punimeve, ngritjen e makinave e të mekanizmave të rinj në vend, shkurtimin e importeve. Mbështetja në forcat e veta shprehet sidomos në rritjen e përgjithshme të frymës krijuese të racionalizimeve e të kurtimeve, në rritjen e emulacionit për të ndërtuar e prodhuar shpejt, mirë dhe lirë. Nuk ka dyshim se përvoja e fituar në këtë drejtim do të pasurohet edhe paskëtaj, ajo do të mbahet mirë parasysh, sidomos gjatë hartimit të projektplanit të pesëvjeçarit të gjashtë për periudhën 1976-1980.

Por ne do të na mbulonte ndjenja e pafalshme e vetëkënaqësisë, sikur prapa atyre gjërave që janë arritur të mos shihnim edhe ato shfaqje të huaja, që janë dukur në çështjen e kuptimit e të zbatimit të drejtë të parimit të mbështetjes në forcat e veta.

Në emër të tejkalimit të planit të prodhimit, konsumohen lëndë të para e materiale mbi planin duke përdorur, në kundërshtim me rregullat e caktuara, rezervat e sigurimit. Me gjithë porositë e Komitetit Qendror dhe të Qeverisë, sipas të cilave lufta dhe përpjekjet e kolektivave punonjës duhet të përqendrohen, në radhë të parë e mbi të gjitha, për tejkalimin e planit në ata artikuj, lënda e parë e të cilëve sigurohet në vend e nuk është deficitare, në mjaft raste veprohet ndryshe. Përse të lejohet që mundësitë e krijuara nga ulja e normave të konsumit të materialeve deficitare

ose të importit të përdoren për tejkalimin e planit të prodhimit dhe jo për të shtuar e fuqizuar rezervat operative, ashtu siç ka theksuar vazhdimisht Partia? Është e tepërt të thuhet se ata drejtues të ekonomisë dhe ato organizata partie, që lejojnë veprime të tilla, nuk e kanë kuptuar në thelb parimin e mbështetjes në forcat e veta, si dhe kushtet e veçanta që na imponon rrethimi kapitalisto-revizionist.

Me këtë sy duhen parë edhe ato raste dhe ata njerëz që për çdo pajisje apo makineri që u duhet, për çdo problem që u shtrohet për të zgjidhur në ndërmarrje, në kooperativë, në rreth apo në ministri, pa e vrarë mendjen shumë, gjejnë rrugën më të shkurtër, i drejtojnë sytë nga jashtë, e kanë në majë të gjuhës të kërkojnë valutë ose të shkojnë jashtë shtetit, gjoja që të njihen me eksperiencën e përparuar, në vend që t'u drejtohen mundësive e përvojës së brendshme, në vend që të rritin përpjekjet për t'i zgjidhur me forcat e veta problemet që dalin. Është shqetësues sidomos fakti kur prirje të tilla përkrahen pa u thelluar edhe nga disa kuadro në organet drejtuese të ekonomisë e të shtetit. Përveç dëmit ekonomik, harxhimit pa kriter të valutës, dashje pa dashje ata kultivojnë te njerëzit edhe koncepte të gabuara, përhapin një frymë çmobilizuese, frymën e mbajtjes së syve nga importi, e dorës së lëshuar, kur është fjala për paratë e shtetit.

Qeveria ka marrë masa, ka caktuar edhe fonde që njerëzit tanë të kenë mundësi të njihen në një mënyrë apo në një tjetër me arritjet e shkencës e të teknikës jashtë vendit. Por këto fonde duhet të përdoren në mënyrë sa më racionale, të merren e të mëso-

hen, në radhë të parë, ato gjëra për të cilat ka nevojë më shumë ekonomia jonë, që kanë mundësi të zbatohen në kushtet tona dhe që sigurojnë një efekt ekonomik të shpejtë e të madh. Në këtë kuptim duhet t'u pritet rruga iniciativave të atyre njerëzve që, pa njohur realitetin e mundësitë tona, vetëm pse kanë parë ndonjë gjë diku në ndonjë libër, paraqitin relacione e «projekte të mëdha», pa menduar mirë se për t'u bërë ato duhen disa qindra mijëra e nganjëherë edhe miliona dollarë.

Analiza e këtyre të metave e dobësive tregon se në një masë të konsiderueshme ato janë edhe rezultat i lëshimeve të mjaft kuadrove drejtues nga baza deri në qendër. Shkelja e ligjeve dhe e normave që rregullojnë gjithë veprimtarinë e shoqërisë sonë dhe që mbështeten fuqimisht në ideologjinë tonë marksiste-leniniste, është e dënueshme për këdo. Por, kur këto nuk respektohen e nuk zbatohen me përpikëri nga kuadrot, i bëhet një dëm i madh ekonomisë dhe gjithë punës së Partisë. Prandaj kuadrot tanë të dalë nga gjiri i masave, të mburjtur me ideologjinë marksiste-leniniste, të kalitur në kudhrën e Partisë, duhet të kuptojnë e të vlerësojnë si duhet rolin e përgjegjësive të tyre, të nxjerrin konkluzione e detyra të drejta e rigorozë për veten dhe për masat dhe të vënë çdo ditë në balancë të ndërgjegjes klasore gjithë veprimtarinë e vet.

Vendosja kudo e në çdo gjë e rregullit dhe e disiplinës proletare është, në radhë të parë, çështje ndërgjegjeje, edukimi, bindjeje e kalitjeje të masave punonjëse, çështje organizimi dhe zbatimi të rreptë të ligjeve e të normave shtetërore. Në këtë kuptim lind

nevoja që edhe bashkimet profesionale të shikojnë e të përsosin më tej punën e tyre. Përparimet në këtë drejtim janë të njohura. Por edhe të metat që janë shfaqur duhen parë në sy, të vlerësohen drejt dhe pa hezitim të luftohen.

Në veprimtarinë e bashkimeve profesionale vihet re një ndjenjë vetëkënaqësie, gjë që ka ushqyer disa shfaqje formalizmi në punën e tyre. Detyra themelore e bashkimeve profesionale është edukimi i klasës, ngritja e ndërgjegjes politike e ideologjike të saj, organizimi dhe mobilizimi i punonjësve në luftë për ndërtimin socialist, tërheqja e tyre aktive në qeverisjen e vendit. Bashkimet profesionale nuk duhet të lejojnë që t'u nënshtrohen presioneve të ndryshme për t'u marrë me çështje korrente ekonomike në një plan tekniko-administrativ, sepse kjo do t'i largonte, siç ka ndodhur në disa raste, nga përmbushja e detyrave të tyre kryesore. Nga kjo pikëpamje organizatat e bashkimeve profesionale nuk duhet të kënaqen vetëm me rezultatet e përgjithshme që arrin klasa punëtore në prodhim, por të preokupohen seriozisht e të luftojnë edhe më mirë kundër qëndrimeve të huaja ndaj punës e ndaj pronës, siç janë thyerjet e disiplinës, dëmtimet e shpërdorimet e pasurisë së përbashkët, prodhimet me cilësi të dobët, mbajtja e normave të ulëta etj., që shprehin edhe mungesën e një pune efektive edukative.

Nga ana tjetër, bashkimet profesionale punonjësve duhet ta shikojnë jo vetëm në marrëdhëniet e tij me punën, por edhe në jetën shoqërore-familjare, si qytetar e si prind. Punëtori duhet të jetë shembullor jo

vetëm në fabrikë e në punë, por edhe jashtë saj, në shtëpi, në rrugë, në shoqëri e kudo.

Zgjidhja e këtyre detyrave kërkon një punë të thelluar e të diferencuar. Ajo nuk duron as formalizmin, as punën me bujë. Duke luftuar për t'u shkrirë me masat, organet e bashkimeve profesionale nuk duhet t'u nënshtrohen në asnjë rast presioneve mikroborgjeze të punëtorëve apo të grupeve të veçanta punëtorësh të paformuar, por të luftojnë për të ngritur masat në lartësinë e misionit të klasës. Partia ka theksuar se klasën punëtore duhet ta marrim ashtu siç është. Në radhët e saj ka edhe njerëz që akoma nuk i kanë fituar tiparet e vërteta të klasës, që shkelin rregullat e punës e normat e shoqërisë. Prandaj bashkimet profesionale, pa hequr dorë në asnjë rast nga metoda e bindjes dhe e edukimit, si e vetmja metodë në të tëra veprimet e tyre, duhet të luftojnë për respektimin e zbatimin me rreptësi të ligjeve të shtetit dhe të rregulloreve të vendosura. Nga ana tjetër, ato duhet të mbrojnë më mirë e më me vendosmëri interesat themelore të klasës punëtore. Në këtë kuadër të luftojnë çdo shtrembërim burokratik që shkel të drejtat e punonjësve, të ngrihen me vendosmëri kundër kujtqo që cenon ligjet e shtetit, qoftë ky drejtues apo punëtor.

Në mënyrë të veçantë, nga bashkimet profesionale kërkohet që ato të mënjanojnë të metat dhe të përsosin më tej punën edukative për kalitjen ideopolitike të klasës punëtore. Krahas forcimit të sistemit të edukimit të punëtorëve, duhet të gjallërohet më tej jeta politike në organizatat profesionale, të lidhet më mirë puna edukative me problemet që nxjerr praktika, të

zhvillohet gjerësisht fryma e papajtueshmërisë me të metat, kritika dhe autokritika në gjirin e organizatës. E gjithë kjo punë duhet të shërbejë që të zhvillohet i vrullshëm emulacioni socialist, të fuqizohen iniciativat dhe aksionet politiko-ideologjike, ekonomike, kulturore e shoqërore, duke përdorur një larmi formash.

Diskutimet që janë bërë kohët e fundit rreth këtyre problemeve kanë qenë një nxitje e re për organizatat e Partisë e të masave, për organet e ekonomisë e të pushtetit, për të gjithë punonjësit e qytetit e të fshatit, që ata të reflektojnë thellë e të dënojnë me frymë të shëndoshë kritike e autokritike shfaqjet e huaja, prirjet e liberalizmit në ekonomi dhe të marrin masa e të forcojnë luftën kundër tyre.

Në mbarë vendin tonë, në qytet e në fshat, në gjirin e klasës punëtore e të fshatarësisë punonjëse, kritika ndaj të metave është shndërruar në një forcë mobilizuese dhe ka ngjallur entuziazëm dhe optimizëm. Një ngritje e përgjithshme vihet re në të gjithë sektorët e ekonomisë. Kudo shihet një përmirësim i ndjeshëm në punë dhe në zbatimin e detyrave. Rezultatet e deritanishme janë mjaft inkurajuese. Plani i shtetit po realizohet me sukses. Ndërsa në dy muajt e parë të këtij viti ishin krijuar nga shumë ndërmarrje deficite të ndjeshme, në fund të muajit maj plani i prodhimit industrial si pesëmuajor u realizua 101 për qind, ndërsa si gjashtëmuajor parashikohet të plotësohet 101,4 për qind. Të gjitha këto dëshmojnë për ndërgjegjen e lartë politike të punonjësve tanë, të klasës sonë punëtore e të fshatarësisë kooperativiste, që me vepra po i vënë në jetë vijën e qëndrimit e drejta të Partisë. Por të

gjitha këto, e të tjera rezultate të arritura, duhen parë vetëm si një hov i ri e inkurajues i asaj lufte të vazhdueshme që Partia dhe të gjithë punonjësit duhet të bëjnë pandërprerë për të çuar përpara ekonominë dhe gjithë ndërtimin socialist të vendit.

### **Organizatave e partisë dhe komunistët të qëndrojnë në ballë të luftës kundër shfaqjeve të ideologjisë së huaj**

Partia kurrë nuk i ka fshehur të metat e dobësitë, ajo nuk është druajtur t'i denoncojë ato hapur e me guxim para komunistëve dhe popullit. Kështu ka vepruar ajo në të kaluarën, kështu po vepron edhe sot. Kritikata tona nuk i errësojnë aspak sukseset e fitoret madhështore, që ka arritur Partia në të gjitha fushat e ndërtimit socialist të vendit. Ato janë një provë tjetër e seriozitetit të Partisë, e forcës së saj, e lidhjeve të ngushta me popullin. Autoriteti i Partisë dhe besimi i popullit ndaj saj kurrë nuk kanë qenë më të lartë dhe më të fortë se sa sot.

Vija e Partisë ka qenë dhe është e drejtë, revolucionare, marksiste-leniniste, por direktivat e saj për disa çështje të rëndësishme që trajtohen në këtë raport nuk janë kuptuar dhe nuk janë zbatuar kurdoherë drejt, bile ka pasur edhe shtrembërime. Të gjitha këto kanë ndodhur para syve të mjaft komunistëve, të kuadrove, të organizatave dhe të komiteteve të Partisë. Po pse janë lejuar këto? Përse disa shokë u prirën nga interpretimi i njëanshëm i direktivave të Partisë? Përse u



nënvleftësuan shumë shfaqje të huaja dhe u dobësua lufta kundër tyre? Burimin kryesor të së keqes duhet ta kërkojmë dhe ta gjejmë në liberalizimin e koncepteve dhe të qëndrimeve për një sërë çështjesh të rëndësishme. Dhe këtë të keqe duhet ta shkëlqojmë nga rrënjët.

Liberalizmi nuk bie nga qielli, ai është produkt i presionit ideologjik të armikut të jashtëm e të brendshëm, që ka për qëllim të minojë pushtetin popullor dhe socializmin. Por shfaqja e këtij fenomeni, dhe sidomos shkalla e përhapjes së tij, varen shumë nga puna e Partisë, nga kuptimi i rrezikshmërisë së tij dhe nga lufta që bën Partia për edukimin dhe kalitjen revolucionare të komunistëve dhe të punonjësve. Fakti që ky fenomen nuk është bërë kurrë një sëmundje e përgjithshme për Partinë tonë, flet qartë për vigjilencën dhe luftën e drejtë që ka bërë dhe bën ajo. Megjithatë, shfaqjet e liberalizmit që po kritikojmë sot në jetën e shoqërisë duhet t'i shikojmë të lidhura ngushtë me ato shfaqje të liberalizmit që janë dukur edhe në vetë jetën e Partisë e në veprimtarinë e saj. Por duhet theksuar se ky problem u trajtua pak në mbledhjet e organizatave-bazë.

Ku shprehet liberalizmi në jetën e Partisë?

Në radhë të parë, në faktin që në mjaft organizatave-bazë nuk ka gjithnjë një ndjenjë të plotë përgjegjësie si organizatë në tërësi dhe nga secili komunist në veçanti për të zbatuar vijën e Partisë në të gjitha sferat e jetës ku vepron ajo. Në disa sektorë, si në ato të artit, të kulturës e të arsimit, organizatat-bazë të Partisë nuk kanë qenë kurrë në rolin e tyre udhëheqës, në krye të punëve. Ato nuk janë marrë me problemet

themelore të përmbajtjes së veprimtarisë së këtyre institucioneve, nuk kanë ushtruar ndikimin dhe kontrollin e tyre për kuptimin dhe zbatimin e drejtë të vijës së Partisë. Kanë dëmtuar në këtë drejtim edhe konceptet e gabuara, sipas të cilave problemet e artit e të kulturës janë çështje që u përkasin kryesisht specialistëve dhe se organizatat e Partisë nuk kanë pse të përzihen shumë në këto punë.

S'ka dyshim se mendimi i specialistëve duhet të dëgjohet e të respektohet, sepse ata kanë dalë nga gjiri i popullit, janë njerëz të Partisë, të edukuar me mësimet e saj. Por organizata-bazë, në çdo rast, mban përgjegjësi të plotë për zbatimin e drejtë të vijës së Partisë. Nga komunistët mund të mos kërkohet të dinë me hollësi anët teknike dhe artistike, por mbrojtja e vijës është detyrë themelore e tyre. Për vijën e Partisë specialist duhet të jetë çdo komunist. Dhe fakti është se, kur organizatat e Partisë të institucioneve kulturore-artistike u angazhuan seriozisht në analizën e punës së këtyre institucioneve, ato treguan se janë plotësisht në gjendje t'i trajtojnë thellë e t'i zgjidhin drejt edhe problemet e përmbajtjes ideoestetike të veprimtarisë së sektorit të tyre.

Është e domosdoshme të kuptohet thellë në parim dhe të realizohet mirë në praktikë se forcimi i rolit udhëheqës të organizatave bazë është një detyrë e përhershme dhe jetike e Partisë, sepse roli i saj udhëheqës realizohet nëpërmjet tyre. Përmirësimet janë të mëdha, por ka akoma mjaft organizata që bëjnë jetë partie të vakët. Rutina dhe praktika e përditshme i bën disa organizata-bazë të merren me çështje korrente, si me

kalendarin bujqësor, ato nuk angazhohen kështu si duhet me problemet thelbësore idcopolitike, me edukimin e njerëzve.

Ka pastaj organizata-bazë që, edhe kur shqyrtojnë probleme, qofshin këto ideopolitike apo ekonomike, shpesh nuk i trajtojnë politikisht, nuk thellohen në shkaqet idcologjike kur vihen re të meta e dobësi dhe nuk përcaktojnë mirë masat për zhdukjen e tyre, nuk punojnë sa duhet për t'u çelur punonjësve perspektivën.

Liberalizmi në jetën e brendshme të organizatave-bazë e ka burimin edhe në moszbatimin e normave të Partisë. Nuk njihet mirë e nga të gjithë Statuti, në të cilin janë sintetizuar normat e parimet e Partisë. Pikërisht këtu e kanë burimin mungesa e një kritike e autokritike luftarake, preokupacioni e përgjegjësia e pamjaftueshme për mbledhjet e Partisë, dobësitë në kërkesën e llogarisë etj.

Puna me vendimet në mjaft raste është e dobët. Ka bile organizata-bazë që s'marrin fare vendime, ndërsa disa të tjera i marrin ato në forma të përgjithshme. Kjo bën që komunistët të mos aktivizohen dhe të mos nxjerrin detyra e për pasojë edhe disiplina e Partisë lë për të dëshiruar. Në këtë mënyrë edhe kontrolli për zbatimin e detyrave dobësohet së tepërmi.

Një ndryshim i dukshëm pozitiv vihet re tani që organizatat-bazë diskutuan për materialet e fundit të Partisë. Në mbledhjet e tyre u shtruan shumë probleme të rëndësishme, në to u bë një analizë e thellë e punës. Komunistët folën hapur e me kurajë, bënë autokritikë për të metat e gabimet e tyre dhe kritikuan me forcë shfaqjet e fenomenet e huaja. Kjo i shkundi shumë

organizata partie dhe i vuri ato në pozita të shëndosha revolucionare.

Por këtu duhet të na shqetësojë një gjë. Përse lejohen të grumbullohen shumë çështje, përse u dashka një mbledhje që të zbrazen të gjitha, përse duhet të pritët vetëm nxitja nga lart për kapjen dhe trajtimin e problemeve që na shqetësojnë? Shumë komunistë i kanë parë shfaqjet e huaja në letërsi e në art, në shkolla e në qendra pune, deri edhe në familjet e tyre. Por disa kanë mbajtur një qëndrim indiferent, nuk kanë ngritur zërin, nuk janë ndeshur me to, kanë pritur t'i zgjidhë dikush tjetër, ashtu siç ka pasur edhe të atillë që janë pajtuar me këto shfaqje.

Këto nuk janë qëndrime prej revolucionarësh, nuk pajtohen me normat e Partisë. Partia kërkon jo vetëm nga çdo komunist, por edhe nga çdo punonjës, që ta thotë hapur e pa frikë fjalën e tij, të mos jetë sehirxhi, por të reagojë e të veprojë kur shikon se shkelen e shtrembërohen direktivat e Partisë e ligjet e diktaturës së proletariatit, kur abuzohet e spekulohet me lirinë e demokracinë proletare.

Liberalizmi në punën e Partisë është shfaqur edhe në kuptimin jo si duhet të rolit pararojë të komunistit në zbatimin e detyrave. Në mjaft organizata-bazë komunistit nuk i kërkohet llogari se si e kryen ai detyrën si militant politik, si aktivist shoqëror, si e kryen ai detyrën në punën e caktuar dhe a dallohet nga punonjësit e paorganizuar në Parti, a jep shembullin personal dhe a i frymëzon punonjësit e paorganizuar në Parti që ka rreth vetes, që edhe ata të punojnë si duhet për realizimin plotësisht të detyrave.

Komunisti, qoftë ky punëtor, fshatar, ushtarak, nëpunës e intelektual duhet të jetë luftëtar i zjarrtë për mbrojtjen dhe zbatimin e vijës së Partisë. Asnjë komunist, i çfarëdo profesioni qoftë, nuk mund të jetë ndryshe nga të tjerët. Dhe kjo nuk mund të justifikohet me asnjë lloj specifike të punës apo të sektorit. Por ka komunistë, sidomos në sektorët e artit e të kulturës, që i lejojnë vetes lloj-lloj pretendimesh, ndryshe nga të tjerët, ata nuk japin llogari për punën e kryer, preken nga kritikak e tregohen hakmarrës. Ka edhe disa komunistë që punojnë në institucione qendrore, të cilët e reduktojnë punën e Partisë vetëm me pjesëmarrjen e tyre në mbledhjet e organizatës-bazë dhe mendojnë se janë në rregull vetëm me kryerjen e funksionit të tyre shtetëror.

Komunisti nuk mjafton të jetë korrekt e pararojë vetëm në punë. Ai duhet të jetë i tillë në tërë veprimtarinë e vet, në gjithë jetën e tij. Si mund të jenë në rolin pararojë e shembull për të tjerët ata komunistë, fëmijët e të cilëve kthehen në rrugaçë, vagabondë, përgues të modës e të shijeve borgjeze ekstravagante? Figura e komunistit është një dhe e pandarë dhe si e tillë ajo duhet të shfaqet kudo e kurdoherë.

Në radhët e Partisë, si rezultat i ndikimeve të huaja, i pranimeve të bëra disa herë pa kritere të shëndosha, i punës së pamjaftueshme edukative, ka komunistë inaktivë, që nuk i kryejnë detyrat e Partisë, që me qëndrimet e tyre ndikojnë për keq në masat, ulin figurën morale e revolucionare të komunistit. Këta komunistë duhet të shkunden nga plogështia, të kritikohen e të ndihmohen që të korrighohen në luftë e në punë

dhe ndaj atyre që do të vazhdojnë të hiqen zvarrë, të merren masa deri në largimin nga Partia, sepse ata molepsin jetën e Partisë, pengojnë revolucionarizimin e saj.

Partia ka rritur dhe edukuar një armatë të tërë kuadrosh të devotshëm ndaj çështjes së socializmit e të revolucionit, besnikë të popullit dhe të marksizëm-leninizmit. Kuadrot përbëjnë një thesar të madh të Partisë dhe të popullit. Ata mbajnë mbi supet e tyre barrë të rënda dhe kanë zgjidhur e zgjidhin me sukses probleme të mëdha të ndërtimit socialist e të mbrojtjes së atdheut. Partia edhe në të ardhmen duhet të tregojë një kujdes të vazhdueshëm për kuadrin, që ky të jetë kurdoherë i pastër politikisht e ideologjikisht, i lidhur ngushtë me masat dhe luftëtar i vendosur për përparimin dhe fuqizimin e atdheut tonë socialist.

Eksperienca e hidhur e Bashkimit Sovjetik tregon se rreziqet që vijnë nga dobësimi i frymës revolucionare të kuadrove janë shumë të mëdha. Ajo ka provuar, gjithashtu, se mundësitë e degjenerimit të kuadrove vijnë nga dy anë, si nga burokratizimi, ashtu edhe nga liberalizimi i tyre. Fenomene këto që janë të lidhura ngushtë dhe ndikojnë mbi njëra-tjetrën.

Duhet thënë se në diskutimin e materialeve të fundit të Partisë, në organizatat-bazë nuk i është kushtuar vëmendja që meriton analizës së punës së kuadrit, lidhur me gjithë këto shfaqje të liberalizmit që janë dënuar. Me të drejtë janë kritikuar fenomenet e huaja në ekonomi, në art e në kulturë, në jetën e Partisë e të shoqërisë etj. A kanë lidhje këto me punën e kuadrove? Mos vallë përgjegjësi ka vetëm punëtori që u

regua i padisiplinuar ose që përpiqet të mbajë norma të ulëta apo vetëm fshatari që nuk dilte në punë dhe nxënësi ose studenti që braktiste shkollën a mësimin? Jo, faj kanë edhe kuadrot, që i kanë lejuar e nuk kanë luftuar kundër këtyre shfaqjeve të huaja. Dhe ka ndodhur kjo, sepse fryma e liberalizmit, e lëshimeve dhe e tolerancës është shfaqur edhe në vetë kuadrot. Kjo është ajo që duhet të shqetësojë Partinë më shumë, sepse janë pastaj të rënda pasojat e pikëpamjeve, të qëndrimeve e të veprimeve të kuadrove në masat. Kur një kuadër bën një lëshim, kur ai tregohet liberal në një çështje, të tjerët i lejojnë vetes të bëjnë dhjetë. Nëse një kuadër, pavarësisht nga arsytet që e shtyjnë, vetë shkel ligjin, normat e shkruara e të pashkruara të Partisë, bën hatëre apo vepron me pronën e kooperativës si me mallin e vet, atëherë ai s'ka pse të çuditet kur edhe të tjerët kryejnë veprime të tilla të dëmshme. Faktet tregojnë se ndikimet e huaja zënë vend edhe në kuadrot, se edhe ndërgjegjja e tyre zë pluhur. Prandaj ky pluhur duhet shkundur. E mira është që kjo të mos bëhet një herë e me tërmet, por me furçë e përditë, ishtu siç pastrojmë rrobat çdo mëngjes.

Kuadrot tanë duhet të jenë kurdoherë korrekt ndaj ligjeve të shtetit e normave të Partisë, ata duhet të jenë shembull në punë e në jetën personale, të dëgjojnë zërin e masave e të jetojnë midis tyre. Partia ka propozitur gjithnjë që kuadrot të japin rregullisht llogaritë veprimtarinë e tyre para masave dhe që këto të ushtrojnë një kontroll të vazhdueshëm për punën, sjelljen e qëndrimin e kuadrove:

Duke marrë parasysh rolin e rëndësishme që ka kua-

dri për mbarëvajtjen e punës në të gjitha fushat e hallkat, duhet të luftohen me vendosmëri ato shfaqje të liberalizmit e të subjektivizmit që vihen re jo rrallë në zgjedhjen dhe vendosjen e kuadrit, kur për të shpesh gjykohet nga ndonjë kontakt i rastit apo nga ndonjë diskutim në mbledhje, kur mbizotërojnë shijet e prirjet personale të disa drejtuesve, të cilët i duan t'i kenë vartësit e tyre sipas fytyrës së vet, të predispozuar për të zbatuar çdo gjë që u thotë përgjegjësi apo kur kuadri zgjidhet në bazë të lidhjeve fisnore, familjare dhe të miqësisë.

Një kujdes i veçantë duhet treguar për zbatimin me rreptësi të direktivave të Partisë për qarkullimin e kuadrit dhe pjesëmarrjen e tij në punën prodhuese, sepse edhe këtu ka pasur shfaqje të liberalizmit. Duhet hedhur poshtë ato justifikime, pengesa e vështirësi, që nxirren për qarkullimin e punën prodhuese të kuadrit, nën pretekstin e specifikës e të karakterit të veçantë të disa punëve, të gjoja pamundësisë së zëvendësimit të disa njerëzve, që janë në fakt shprehje e koncepteve intelektualiste e teknokratike.

Në këtë raport folëm më lart për dobësitë e të metat në punën e organizatave të masave e sidomos të rinisë e të bashkimeve profesionale. Sigurisht, për këto të meta kanë përgjegjësi vetë organizatat e masave dhe organet e tyre drejtuese, por një përgjegjësi më të madhe ka vetë Partia që i udhëheq e i drejton këto organizata. Është realitet që asnjë organizatë dhe komitet partie nuk i ka dhënë Komitetit Qendror ndonjë raport apo informacion për gjendjen në organizatën e rinisë. Megjithëse direktivat e Partisë për punën me rininë



kanë qenë kurdoherë të drejta e të qarta, pse komitetet dhe organizatat e Partisë lejuan që ato të shkelen e të shtrembërohen? Pse lejuan ato që shumë organizata të rinisë të mos mblidhen për muaj të tërë, që të dështojnë mbledhjet e plenumeve e konferencat e rinisë, që pranimet në rini të bëhen formalisht, që të dobësohet puna edukative ideopolitike?

Nga këto duhen nxjerrë mësimet. Fakti që organizatat e masave kanë forumet e tyre drejtuese nga baza në qendër nuk përjashton aspak si detyrën, ashtu edhe përgjegjësinë e organizatave dhe të komiteteve të Partisë për drejtimin dhe udhëheqjen e këtyre organizatave. Partia është për zhvillimin e iniciativës dhe të vetëveprimit të organizatave të masave, por këto duhet të zhvillohen në vijën dhe nën udhëheqjen e Partisë. Ne jemi kundër tutelës dhe metodave të të diktuarit, por jemi edhe kundër çdo dobësimi sadopak të udhëheqjes së Partisë në organizatat e masave. Ashtu si në gjithë jetën e vendit, roli udhëheqës i Partisë duhet rritur e forcuar edhe në organizatat e masave.

Në mjaft organizata dhe komitete të Partisë duket se nuk ka akoma një kuptim të drejtë për vendin dhe rolin e organizatave të masave, për problemet që i shqetësojnë këto organizata dhe shtresat e kategoritë punonjëse të ndryshme që ato përfaqësojnë. Prandaj edhe kujdesi e ndihma që u jepet këtyre nga organizatat e Partisë shpesh nuk është në nivelin e duhur. Nuk u hapen horizonte, nuk u zbërthehen plotësisht direktivat e Partisë dhe nuk ushtrohet kontroll i nevojshëm mbi veprimtarinë e tyre.

Gjatë diskutimit të materialeve të fundit të Par-

tisë janë bërë njaft vërejtje edhe për aktivizimin e komunistëve në organizatat e masave. Në mbledhje të Frontit mungojnë njaft komunistë. Mjaft të rinj, me t'u bërë anëtarë partie, shkëputin lidhjet me organizatën e rinisë. Kemi mijëra shoqe komuniste, po ato nuk militojnë si duhet në organizatën e gruas. Ka edhe komunistë që kërkojnë t'u bëjnë bisht zgjedhjes së tyre në organet drejtuese të organizatave të masave.

Këtu kemi të bëjmë me një fenomen serioz, me shfaqje të indiferentizmit dhe me njëfarë ndjenje të epërsisë dhe të mendjemadhësisë që krijohet te disa komunistë me t'u bërë të tillë. Me sa duket nuk kuptohet thellë si nevoja e lidhjeve të Partisë me masat, ashtu edhe ajo që komunisti duhet të jetë një aktivist i shquar shoqëror. Puna shoqërore si një punë e papaguar është një element i komunizmit dhe pikërisht këtu duhet të dallohen, në radhë të parë, komunistët.

Kujdes të veçantë duhet të tregojë Partia për edukimin e aktivitetit të organizatave të masave, nga puna e të cilit varet shumë veprimtaria e këtyre organizatave. Këto përbëjnë një armatë të madhe aktivistësh shoqërorë që punojnë pa u lodhur e me devocion për çështjen e Partisë dhe që përbëjnë një burim të pashtershëm për shtimin e radhëve të Partisë e për përgatitjen e kuadrove të saj.

Udhëheqja e Partisë, siç e kemi theksuar dhe herë të tjera, është, para së gjithash, një udhëheqje politiko-ideologjike. Kjo do të thotë që Partia duhet të zhvillojë një punë të gjerë ideopolitike për kuptimin e drejtë të direktivave të saj dhe për t'i bërë punonjësit të ndërgjegjshëm për zbatimin e tyre. Kjo është një

fushë shumë e gjerë e punës së Partisë dhe me rëndësi vendimtare. Shumë dobësi e të meta që po kritikojmë e kanë burimin pikërisht te dobësitë e kësaj pune, te cektësia, njëanshmëria, mungesa e lidhjes me jetën, te formalizmi dhe karakteri i saj shpeshherë i përgjithshëm. Në qoftë se ka pasur kuptime të ngushta e të njëanshme të rrethimit gjeografik, kapitalist e revizionist, të centralizmit dhe të demokracisë, të kontrollit shtetëror e të kontrollit punëtor, të të drejtave e të detyrave, të emancipimit të gruas, në qoftë se ka pasur keqkuptime e shtrembërime për disa çështje në fushën e letërsisë dhe të artit, të arsimit e të kulturës, kjo tregon se në mjaft raste direktivat e Partisë nuk zërthehen në mënyrë të plotë e të gjithanshme, teorikisht e praktikisht, prandaj ndodh që ato nuk mishërohen si duhet në veprimtarinë e përditshme të komunistëve e të punonjësve, ka luhatje sa nga njëri krah në tjetrin, kapet njëra anë dhe lihet pas dore ana tjetër.

Këto kuptime e qëndrime të njëanshme dhe kalime sa nga njëra anë në tjetrën, sa nga konservatorizmi në liberalizëm dhe anasjelltas kanë te ne edhe një bazë reale në karakterin mikroborgjez të trashëguar nga e kaluara, që nuk mund të themi se është zhdukur plotësisht.

Mikroborgjezi është i privë të lërë një problem e të zërë një tjetër, të kapë njërën e të lërë pas dore tjetrën anë, të kalojë nga njëri ekstrem në tjetrin. Ideologjia e psikologjia mikroborgjeze, që ka rrënjë të thella te ne, është një bazë mbështetëse si për ideologjitë e vjetra patriarkale, feudale e fetare, ashtu edhe për ideologjitë e sotme borgjeze-revizioniste, është ajo urë

që lidh konservatorizmin e liberalizmin, që i ushqen e i nxit ata.

Kjo do të thotë që komitetet dhe organizatat e Partisë duhet të thellohen më shumë në problemet ideologjike e të merren më mirë me to, sepse shohim që në praktikë direktivat e Partisë nuk zbërthehen e nuk kuptohen deri në fund, problemet e fenomenet nuk analizohen thellë nga pikëpamja ideologjike e politike, pak çështje të këtij karakteri shtrohen e diskutohen, shpesh i tërheq rutina e punëve të vogla e të përditshme. Këtu duhet të shikojmë ne edhe një nga të metat kryesore të punës së Partisë për çështjet që po diskutojmë. Po nuk u kuptua thellë kjo e metë, është vështirë që të korrigjohen të metat e dobësitë që po kritikojmë dhe punët të na ecin mbarë.

Është e nevojshme të formojmë një kuptim më të drejtë për punën e Partisë përgjithësisht dhe për punën e saj edukative në mënyrë të veçantë. Me gjithë rolin e madh që luan edukimi, ky në asnjë mënyrë nuk mund të absolutizohet. Në fakt mbivlerësimi i punës edukative, i ndërgjegjes, çoi në shumë raste në dobësimin e masave organizative, administrative, teknike dhe ekonomike, që u bë shkak i shfaqjeve të ndryshme liberale në qëndrimin ndaj punës e pronës, mësimin, kryerjes së detyrës, organizimit të kontrollit, kërkesës së llogarisë etj.

Puna e Partisë është shumë komplekse, pse e tillë është vetë jeta që ajo drejton e udhëheq. Kjo do të thotë që problemet e ndryshme nuk mund të zgjidhen duke i bërë thirrje vetëm ndërgjegjes së njerëzve, bile edhe vetë edukimi nuk arrihet vetëm me leksione e

konferenca. Në jetë problemet zgjidhen me një kompleks masash politike dhe ekonomike, arsimore e kulturore, organizative e administrative. Në këtë kompleks bëhet dhe vetë edukimi i njerëzve, kalitet ndërgjegjja e tyre revolucionare.

Detyra e Partisë është të ngrejë masat në nivelin e ndërgjegjes së saj. Por ne duhet të jemi realistë, të kemi parasysh shkallën e arritur të ndërgjegjes së masave, të mos e konfundojmë atë me ndërgjegjen e pararojës dhe të kërkojmë prej tyre atë që mund dhe duhet të kërkojmë nga pjesa më e përparuar e klasës dhe e masave që është e organizuar në Parti. Kjo nuk duhet harruar në asnjë rast, sa herë që shtrojmë detyra të reja, ndryshe pararoja shkon shumë përpara, largohet e shkëputet nga masat, gjë që çon pastaj në pasoja të rënda.

Ashtu si gjithë puna e Partisë, edhe direktivat e saj formojnë një unitet të vetëm. ato nuk duhen marrë kurrë të shkëputura nga njëra-tjetra. Do të ishte gabim të mendohej se tani direktivat e mëparshme të Partisë për luftën kundër burokratizmit dhe zhvillimin e demokracisë, për kontrollin punëtor dhe luftën kundër arbitraritetit, për marrëdhëniet e drejta që duhet të ekzistojnë midis Partisë, klasës e masave, për revolucionarizimin e shkollës e të ushtrisë etj., bien dhe nuk janë më të vlefshme. Qëndrimet e Partisë janë konsekuente dhe në direktivat e saj nuk ka kontradikta. Do të ishte një praktikë krejt e gabuar në metodën e punës ajo që, kur del një direktivë e re, një vendim apo fjalim i ri, lihen mënjanë gjithë të mëparshmit. Kjo çon si në punën me fushata, ashtu edhe në shikimin e njëanshëm të problemeve.

Prandaj edhe lufta kundër liberalizmit dhe konservatorizmit duhet bërë në rrugë të drejtë. Elementët konservatorë do të donin që luftën kundër liberalizmit ta zhvillonin nga pozitat e tyre, ashtu si elementët liberalë u përpoqën ta shfrytëzojnë luftën kundër konservatorizmit për të përhapur liberalizmin. Qëndrimi i vetëm i drejtë në këtë çështje është që si lufta kundër liberalizmit, ashtu dhe kundër konservatorizmit mund të zhvillohet me sukses vetëm nga pozitat parimore marksiste-leniniste.

Po nuk u kuptua drejt ky problem, ka rrezik që tani, kur po luftojmë kundër shfaqjeve të ideologjisë borgjeze e revizioniste e të qëndrimeve liberale, të biem në gabime, të mbahen qëndrime sektare, të ngurta dhe ekstremiste. E theksojmë këtë se ka disa njerëz, edhe kuadro, që mendojnë se tani erdhi koha të shtrëngohen rripat, që priren pas masave administrative, që duan të ringjallin arrogancën e arbitraritetin dhe të zëvendësojnë me këto punën bindëse edukative të Partisë.

Duke folur për dobësitë e punës së Partisë, detyra të rëndësishme dalin edhe për aparatën e Komitetit Qendror të Partisë, për të gjithë sektorët e tij. Në punën e tij aparati ka pasur përmirësime të dukshme dhe rezultate të mira. Por shfaqjet e liberalizmit dhe përhapja e ndikimeve të huaja tregojnë se ai ka edhe mjaft dobësi. Shpesh, duke u rrëmbyer pas punëve korrente, aparati i Komitetit Qendror nuk ka treguar kujdesin e nevojshëm për të parë në plan të gjerë se si zbatohet politika e Partisë në fusha të ndryshme. Në këtë çështje ka ndikuar moszberthimi i thellë e i gjithanshëm i direktivave të Partisë, sidomos në aspektin po-

litik e ideologjik, si dhe mosorganizimi i një kontrolli sistematik e të kualifikuar për zbatimin e vendimeve të Partisë. Ashtu si përpara gjithë organizatave e komiteteve të Partisë, edhe para sektorëve të ndryshëm të aparatit të Komitetit Qendror shtrohet detyra që të përmirësojnë në mënyrë efektive metodën e stilit e punës.

Çështjet që po shtrojmë në këtë Plenum lidhen ngushtë me një problem të madh e kardinal, me kuptimin dhe zhvillimin e drejtë të luftës së klasave. Partia e ka bërë të qartë prej kohësh se lufta e klasave është një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë sonë socialiste, se ajo është një luftë shumë e gjerë që zhvillohet në të gjitha fushat, si kundër armiqve të brendshëm e të jashtëm, ashtu edhe në gjirin e popullit e të Partisë, se një rëndësi të veçantë në kushtet aktuale merr lufta klasore në frontin ideologjik.

Në vendin tonë lufta e klasave është zhvilluar drejt, prandaj kanë dështuar të gjitha planet e armiqve dhe revolucioni ynë ka ecur gjithnjë përpara. Në këtë luftë është forcuar e kalitur Partia, është forcuar diktatura e proletariatit, është çelikosur më tej uniteti i Partisë me klasën dhe masat punonjëse, është rritur ndërgjegjja revolucionare e popullit. Por kjo nuk do të thotë që në kuptimin e zhvillimit të luftës së klasave nuk ka të meta e dobësi. Në praktikë ne jemi ndeshur me mjaft kuptime të cekëta, të ngushta dhe të njëanshme, me zbutje të luftës së klasave e nënvleftësim të armiqve, me mosnjohjen e thellë të taktikave të tyre aktuale, me qëndrime indiferente dhe oportuniste.

Janë konstatuar mjaft pakujdesi në punën për përgatitjen ushtarake. Shumë mungesa bëheshin në stër-

vitjet dhe shumë formalizëm kishte në to, si nga pjesëmarrësit, ashtu edhe nga oficerët që i drejtonin ato. Tani kjo detyrë e dorës së parë duhet të jetë kuptuar më mirë, sepse në stërvitjet e këtyre kohëve të fundit pjesëmarrja i ka kaluar kudo të 90 për qind. Në disa rrethe ato punime për mbrojtje, që s'ishin bërë për vite të tëra, u plotësuan me aksion brenda disa ditëve. Ky interesim e mobilizim duhet të mbahet edhe në të ardhmen dhe të shkojë duke u rritur.

Ndërsa në fushën e vigjilencës ndaj armikut të brendshëm të klasës ka pasur në disa raste shfaqje krejt të pafalshme. Nga diskutimet ka dalë se janë mbajtur qëndrime oportuniste ndaj elementëve me qëndrim të keq politik. Ka pasur raste që, sapo kthehet nga burgu një i dënuar për veprimtari armiqësore, i kanë shkuar këtij në shtëpi deri edhe komunistë «ta urojnë»! Dikur, sidomos në zonat kufitare, çdo të huaji që kalonte i kërkoheshin dokumentet, tani në shumë raste as interesohet njeri për këtë punë etj.

T'i përmbahesh apo të mos i përmbahesh luftës së klasave, të kesh për të një kuptim të plotë apo të cekët, ta zhvillosh atë frontalisht apo në mënyrë të njëanshme, ta zbatosh atë drejt në rrugë revolucionare, apo ta dobësosh e të bësh lëshime, kjo është një çështje jetike, nga e cila varet fati i socializmit. Armiaqtë tanë atë duan, që ne të dobësojmë vigjilencën dhe të shuajmë luftën e klasave. Po ne ç'duhet të bëjmë? Të kundërtën. Të forcojmë vigjilencën e të zhvillojmë me konsekuencë luftën e klasave për të mbrojtur fitoret e arritura, për ta bërë atdheun tonë, Shqipërinë socialiste,



edhe më të fortë, edhe më të pathyeshme, për të mirën e popullit dhe çështjen e komunizmit.

\*  
\*     \*

Problemet që ngriti Partia nuk i shpiku, por ato qenë shqetësimet e vetë klasës e të të gjithë punonjësve. Partia nuk bëri gjë tjetër veçse këto shqetësime, që klasa dhe masat i kishin shprehur në forma të ndryshme, i përgjithësoi dhe ua shtroi atyre duke u treguar si rrezikshmërinë, ashtu edhe rrugët për kapërcimin e fenomeneve negative që qenë vënë re në jetën e shëndoshë të shoqërisë sonë socialiste.

Gjatë këtyre muajve u zhvillua një punë e madhe nga Partia. Diskutimi për këto probleme u bë një shkollë e vërtetë për edukimin e komunistëve dhe të masave. Por të mos kujtojmë se tani gjithçka është zgjidhur e ka marrë fund. Po të gjykonim kështu, do të mendonim shumë gabim. Lufta kundër shfaqjeve të ideologjive të huaja nuk është fushatë, por një luftë e vazhdueshme dhe e gjatë. Partia, klasa punëtore e gjithë punonjësit nuk duhet ta ndërpresin kurrë këtë luftë. Në qoftë se do të dobësohet vigjilenca jonë, këto ose shfaqje të tjera të huaja nesër do të gjallërohen prapë. Boshllëk ideologjik nuk ka dhe nuk mund të ketë. Po nuk zuri vend ideologjia jonë, boshllëku do të mbushet nga ideologjia e huaj.

Lufta që po zhvillojmë kundër shfaqjeve të ideologjisë së huaj dhe qëndrimeve liberale ndaj tyre, po

e pasuron më tej eksperiencën e Partisë, metodën dhe stilin e punës së saj. Edhe në të ardhmen problemet që na shqetësojnë t'i shtrojmë hapur para masave dhe t'i zgjidhim bashkë me to, ashtu siç kemi bërë vazhdimisht. Në asnjë mënyrë të mos mbetemi në diskutime të gjata, por të marrim masa konkrete dhe të ushtrojmë kontroll të rreptë për zbatimin e tyre. Të ngremë në këmbë masat dhe t'ia nënshtrojmë veprimtarinë e Partisë kritikës dhe autokritikës së hapur të komunistëve dhe të punonjësve.

E gjithë kjo eksperiencë të na shërbejë që të mbajmë kurdoherë lart frymën revolucionare në Parti dhe në masa, vigjilencën dhe gatishmërinë e tyre luftarake, hovin dhe mobilizimin në punë për të realizuar me sukses detyrat e mëdha që kemi përpara, për të forcuar pavarësinë, për të mbrojtur atdheun, për të zhvilluar ekonominë dhe kulturën kombëtare, për të çuar gjithnjë përpara çështjen e revolucionit e të socializmit.

*Botuar për herë të parë në broshurën: Enver Hoxha, «Të thellojmë luftën ideologjike kundër shfaqjeve të huaja e qëndrimeve liberale ndaj tyre», Tiranë, 1973*

*Botohet sipas librit:  
Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1972-1973», f. 297*

## ÇËSHËTJA E POPULLIT DHE E PARTISË QËNDRON MBI TË GJITHA

*Fjala e mbylljes në Plenumin e 4-t  
të KQ të PPSH*

28 qershor 1973

*Në Plenum Fadil Paçramit e Todi Lubonjës iu bënë një sërë pyetjesh, por ata ose u shmangeshin përgjigjeve të sakta, ose, me demagogji, përpiqeshin të justifikonin apo të mohonin veprimtarinë e tyre antiparti. Duke iu drejtuar atyre, shoku Enver Hoxha tha:*

Këto nuk janë vetëm pyetje, por edhe çështje me përmbajtje të thellë ideologjike e politike. Mos i merrni se shokët ju pyesin sikur jeni përpara gjyqit. Jo. Në qoftë se gjërat që ju kërkohen i keni thënë, dhe pa dyshim që i keni thënë, atëherë duhet t'i njihni këto gabime haptas e ndershmërisht.

Nuk është çështja për një rast e nuk është puna e një konsulte. Këtu janë me dhjetëra e dhjetëra fakte, ku ju keni nënvleftësuar udhëheqjen e Partisë dhe këto nuk mund të mohohen. Nuk mund të nxirrni gënjeshtarë shokët udhëheqës të Partisë që janë këtu,

anëtarë të Komitetit Qendror ose jo, që i kanë dëgjuar këto pohime me veshët e tyre dhe nuk kanë asnjë arsye që t'ju ngarkojnë ju për gjëra që nuk i keni thënë. Por çështja është se ju i keni thënë këto. Pse nuk ka shfaqur mendime të tilla edhe ndonjë shok tjetër? Pse nuk ngrihemi të themi, për shembull, edhe për këtë apo për atë person se nuk ka respekt për udhëheqjen, të cilin ajo e kritikon vazhdimisht? Nuk themi asnjë fjalë për të tjerët, sepse janë komunistë, shokë partie, luftëtarë e në rrugë të drejtë.

Shiko, Fadil, në qoftë se ti i ke shkruar këto gjëra, këtë mbrojtjen tënde, dhe do që t'i vësh në arkiv, të sigurojmë që do të mbeten në arkiv. Por, siç po e shohim, Komitetit Qendror nuk i intereson shumë mbrojtja që po u bën gjërave në këtë formë që ke përgatitur ti, prandaj, në qoftë se në diskutim mund të bësh një shkurtim të këtyre çështjeve dhe të vësh gjëra konkrete, do të jetë më mirë. Kërkesat po të bëhen, në radhë të parë, për çështje politike.

Ke besim tek udhëheqja e Partisë ti Fadil? «Kam besim», thua. Por ne po vërtetojmë këtu, përpara Komitetit Qendror, me sa thonë shokët e shoqet, se të kanë dëgjuar me veshët e tyre, që ti nuk ke qenë dakord me vijën e udhëheqjes për sa i përket çështjes së shkurtimit të oborreve kooperativiste dhe politikës së Partisë me fshatarësinë. Ti, Fadil, thua që nuk ke thënë kështu. Mirëpo ne nuk jemi të bindur për këtë gjë, sepse besojmë më mirë shokët e tjerë që nuk kanë gabuar në vijën politike, sesa të të besojmë ty. Ju keni të drejtë të flisni ashtu si dëshironi, por edhe ne kemi të drejtë të arrijmë në konkluzionet tona.

Tani vijmë te pyetja tjetër që u bë këtu. Kur ju keni qenë në dijëni të vijës dhe këto që bënit kanë qenë kundër vijës, domethënë ju me ndërgjegje shkoni kundër saj. Atëherë ku ishte qëllimi? Ku do të arrinit? Pikërisht këtë kërkojnë të dinë shokët. Po të ishte një gabim i rastit, do të qe tjetër punë. Por ju thoni se vijën e Partisë e keni kuptuar dhe se këto veprime ishin kundër vijës. Atëherë është logjike të mendohet se ju kishit një qëllim. Ju pranoni, gjithashtu, se këto qëndrime ishin antiparti. Atëherë qëllimi ishte i përcaktuar në mendjen tuaj se ku duhej arritur e çfarë duhej prishur.

*Pas përgjigjeve të dhëna e diskutimeve të shokëve, në fund të mbledhjes e mori fjalën shoku Enver Hoxha:*

Plenumi i Komitetit Qendror, që diskutoi problemet e rëndësishme që u shtruan në këtë sesion, u tregua, si kurdoherë, bile edhe më shumë se herët e tjera, në një nivel të lartë revolucionar dhe me një pjekuri të madhe marksiste-leniniste. Uniteti i çeliktë në udhëheqje pasqyroi në mënyrë të zjarrtë unitetin e çeliktë të Partisë, të mbrujtur e të frymëzuar nga teoria jonë, marksizëm-leninizmi.

Të gjitha diskutimet që u bënë në këtë Plenum ishin të bazuara dhe të frymëzuara nga diskutimi i madh e i thellë që u bë në Parti dhe në popull për problemet kapitale që u shtruan nga udhëheqja e Partisë këta muajt e fundit. Këto diskutime ishin një shkollë e madhe, veçanërisht për ne udhëheqjen, dhe si kurdoherë mësuam shumë sa i domosdoshëm, sa edukues, sa i guximshëm dhe frytdhënës është konsultimi

i hapët dhe i singertë me masat e gjera të Partisë dhe të klasës. Opinioni gjykoi veprimet e Partisë dhe të udhëheqjes së saj dhe rezultatet e këtij konsultimi janë shumë pozitive. Opinioni i shëndoshë na kritikoi të metat dhe gabimet e vërtetuara në punë, na mësoi se si duhet t'i korrigjojmë ato dhe sa më parë.

Tërë Partia dhe udhëheqja e saj u tregua e hapët, e singertë, e thjeshtë dhe e dashur me klasën dhe me punonjësit gjatë këtij diskutimi të madh. E gjithë kjo shtoi dashurinë, besimin dhe respektin e popullit ndaj Partisë dhe anasjelltas. Këtë eksperiencë të madhe që fituam në terren, e sollëm këtu, në Plenum, dhe këtu e përpunuam, bëmë përgjithësimë dhe këto do t'i çojmë përsëri poshtë, në Parti dhe në punonjësit.

Në Sekretariat kemi biseduar edhe për metodën e punës që duhet të zhvillojë Partia për përpunimin e dokumenteve të këtij Plenumi. Duhet të përpiqemi që kjo metodë t'i përshtatet stilit dhe metodës që u përdor këta muajt e fundit, kur u punuan me aq rezultate të mira dokumentet e fundit të Partisë. Shoku Hysni do t'ju flasë veçanërisht mbi këtë çështje.

Kuptimi i thellë i këtyre dokumenteve lyp që të përdoret edhe një stil e metodë e atillë, që jo vetëm të luftojë rutinën dhe punën e përciptë, por edhe për faktin se këto probleme u rrahën gjerësisht gjatë tre muajve në Parti dhe në popull dhe mund të konsiderohen si përsëritje e panevojshme. Kurse duhet thelluar shumë në to, që të bëhen për Partinë dhe punonjësit një ushqim ideologjik për ta mbajtur gjallë e për ta çuar më përpara këtë frymë të madhe revolucionare, të cilën duhet të mos e lëmë të shuhet për asnjë moment. Këto

dokumente të Komitetit Qendror duhet të konsiderohen dhe të trajtohen si plotësuese të mëtejshme të dokumenteve të tjera të rëndësishme të Partisë.

Është e tepërt të theksoj, për të mos përsëritur, se qëllimi i madh i Partisë është që vendimet e kongreseve, dokumentet e Komitetit Qendror, të Byrosë Politike dhe të Qeverisë të bëhen mish dhe gjak për komunistët, për klasën dhe për gjithë punonjësit, ato duhet të shërbejnë për realizimin me sukses të të gjitha detyrave që na kanë ngarkuar Partia dhe populli.

Uniteti marksist-leninist në Komitetin Qendror u manifestua, si kurdoherë, në mënyrë të shkëlqyer. Ky unitet nuk është një mit, por një realitet kolossal me baza të çelikta dhe, në emër të Byrosë Politike, unë nuk kam asgjë për të shtuar, pse raporti i saj u aprovua nga ju njëzëri, me përjashtim të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës, që mundet formalisht u treguan pro, por në realitet ata ishin katërcipërisht kundër.

Qëndrimi i këtyre të dyve përpara gabimeve dhe fajeve të tyre të rënda dhe përpara Plenumit të Komitetit Qendror ishte revoltues dhe skandaloz. Do të më lejoni që në këtë fjalën time të mbylljes t'ju them juve, të dashur shokë dhe shoqe, se jam plotësisht dakord me ju për të gjitha çka thatë në mënyrë marksiste-leniniste të dokumentuar plotësisht, kundër punës dhe pikëpamjeve antimarksiste, antiparti dhe antikombetare të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës. Ne, shokët e Byrosë Politike, jemi të gjithë shumë të entuziazmuar nga principialiteti dhe fryma juaj e lartë revolucionare në mbrojtjen e Partisë dhe të vijës së saj, gjë që na ka frymëzuar shumë. Ne ju sigurojmë ju se

armiku kurrë nuk do t'i çajë, qoftë edhe një grimë, muret e çeliktatë të Partisë sonë. Do të më lejoni, gjithashtu, të zhvilloj më tej disa mendime, që thashë në formë të përmbledhur në raport mbi gabimet e Fadilit dhe të Tudit.

E gjykova të nevojshme që thëniet e mia të mëposhtme për këtë çështje t'i bazoj mbi një autokritikë me shkrim, që, me kërkesën time, Fadili ia ka pasë dërguar Komitetit Qendror. Unë kam parasysh edhe ato çka tha ai aq keq këtu, por ju e patë vetë sa rrenacakë politikë janë që të dy: ç'thonë sot, i mohojnë nesër. Në qoftë se ata thonë *verba volant*<sup>1</sup>, ne themi *scripta manent*<sup>2</sup>.

## Mbi devijimet antimarksiste dhe antiparti të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës

Gjatë gjithë jetës së saj plot luftëra revolucionare Partia jonë ka mbajtur në parim dhe ka zbatuar në praktikë një vijë teorikisht të drejtë, marksist-leniniste, e ka zbërthyer teorinë drejt, në përputhje me ligjet objektive, me situatat dhe rrethanat e ndryshme shumë herë të koklavitura të vendit tonë. Partia e ka trajtuar dhe edukuar njeriun tonë në frymën e moralit proletar, edukues dhe transformues, si pjesëtar të një shoqërie të re socialiste, ku transformimet zhvillohen në interesin e përbashkët, në interes të pro-

1. Latinisht — fjalët i merr era.

2. Latinisht — e shkruara qëndron.



nës socialiste dhe në kundërshtim me botëkuptimet dhe konceptet idealiste, borgjeze, feudale, kapitaliste e klerikale.

Partia ka dalë me një bilanc të pasur suksesesh materiale dhe morale nga këto beteja, ka fituar, gjithashtu, një eksperiencë të madhe. Ajo ka mësuar të luftojë për të mirën, për të renë, për përparimtarën, për socializmin, ka mësuar, gjithashtu, të diktojë dhe të luftojë armiqtë e saj të brendshëm dhe të jashtëm. ideologjikë dhe politikë, nën çfarëdo maske që ata janë orvatur të fshihen. Partia ka qenë dhe është në luftë të vazhdueshme me këta armiq të hapët e të maskuar të saj, të popullit dhe të socializmit dhe kjo është pasqyra e luftës së klasave që zhvillohet me sukses te ne.

Një nga meritat e mëdha të Partisë sonë në lëvizjen komuniste botërore qëndron në atë që, si Parti e vogël e një vendi me tradita të theksuara mikroborgjeze, duke i qëndruar besnike në çdo kohë, të mirë dhe me furtuna, ideologjisë marksiste-leniniste, brenda një periudhe kohe të shkurtër prej tri dekadash, nëpërmjet luftës së armatosur, revolucionit popullor dhe ndërtimit të socializmit, ajo mundi ta kalitë vetveten, klasën, masat e gjera të popullit dhe t'u rezistojë me sukses valëve të armiqve të egër që i vërsuleshin njëra pas tjetrës, si valët e detit.

Kjo luftë e Partisë nuk është as përrallë, as fantazi, por është realitet, siç ka qenë realitet vala fashiste italiano-hitleriane, vala tiliste jugosllave, vala revizioniste sovjetike, siç është aktualisht vala e rrethimit dhe e bllokadës kapitalisto-revizioniste. Në fitoret e

Partisë s'ka as misticizëm, as metafizikë, as mrekulli shenjtorësh; kjo është vepra e një populli dhe e një Partie heroike, është deduksioni i pashmangshëm i zbatimit me konskruencë të teorisë së Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit.

Mbrojtja e pastërtisë dhe e drejtësisë marksiste-leniniste të vijës ka qenë preokupacioni kryesor dhe vendimtar i Partisë. Armiqtë e brendshëm të Partisë, të ndihmuar nga ata të jashtmit, kurdoherë kanë synuar që ta goditnin këtë vijë të drejtë, ta shmangnin, qoftë nga e majta, qoftë nga e djathta, dhe të merrnin frenat e drejtimit në duart e tyre për të ndërruar kursin në favor të ideologjisë së tyre antiparti, në favor të padronëve të tyre të jashtëm që lëviznin fijen. Partia, siç e dimë, ka luftuar me guxim, me pjekuri dhe me sukses, si kundër deviatorëve të majtë, ashtu dhe kundër deviatorëve të djathtë.

Eksperiencia na ka mësuar se këta deviatorë nuk lindin në një ditë, ata formohen, përfitojnë nga lëshimet, nga paqartësia politiko-ideologjike, nga mungesa e vigjilencës, nga rrethanat e brendshme dhe të jashtme. Këta maskohen, ruhen, janë prudentë, prandaj bazat qoftë në Parti, qoftë në popull, i kanë të dobëta, ata i kanë rrënjët mbi ujë, bazë ata kanë të pakënaqurit, të degjeneruarit, karrieristët dhe kontrabandistët që kanë hyrë në radhët e Partisë. Këta deviatorë shpërthejnë në momente që ata i gjykojnë «krize»; atëherë mendojnë të afirmohen si «shpëtimtarët» e situatës. Me fjalë të tjera ata punojnë nën rrogos dhe presin momentet të godasin. Kjo është karakteristika kryesore e punës së tyre, por ka edhe të atillë po aq të rrezikshëm,

të cilët, të maskuar me autoritetin e Partisë, veprojnë haptazi duke shtrembëruar vijën.

Të gjithë armiqtë e Partisë dhe të popullit tonë, deviatorë të çdo kallëpi, të lidhur me fije ose jo me armiqtë e jashtëm imperialisto-revizionistë, nuk janë veçse këlyshë të borgjezisë, të gjithë janë të djathtë, pavarësisht se vënë nga ndonjë maskë mëngjarashe.

Deviatorët armiq të Partisë, trockistët Aristidh Qendro, Anastas Lula e Sadik Premte hiqeshin «të majtë», gjoja pro klasës punëtore dhe kundër fshatarësisë. Po ata në fakt ishin kundër Partisë, kundër vijës së saj të drejtë, kundër Luftës Nacionalçlirimtare, kundër çlirimit të popullit. Ata ishin agjentë, deviatorë të djathtë.

Koçi Xoxe dhe Pandi Kristo «me shpirt proletar», siç e quanin veten, nuk ishin veçse dy tradhtarë, agjentë të klikës së Beogradit, të kësaj rryme tradhtare revizionistësh, nuk ishin veçse armiq të djathtë që atakonin Partinë.

Sejfulla Malëshova ishte një armik deviator i djathtë oportunist, që akuzonte Partinë dhe vijën e saj si sektare. Armiku deviator Bedri Spahiu nuk ishte veçse një fashist i maskuar.

Revizionistët modernë sovjetikë dhe agjentët e tyre si Liri Belishova, Koço Tashko e të tjerë nuk janë veçse tradhtarë të marksizëm-leninizmit, deviatorë të djathtë. Këta e quajnë Partinë tonë dhe vijën e saj dogmatike e konservatore.

Pra, siç vërejmë nga eksperiencia e pasur e Partisë sonë, Anastas Lula e kompani u manifestuan haptazi në momentin më kulminant të historisë së popullit to-

në. Sejfulla Malëshova, Koçi Xoxe e kompani dolën në një kthesë vendimtare të historisë së vendit. Edhe Liri Belishova e kompani dolën në kohën e tradhtisë së madhe hrushoviane. Kjo është e para.

E dyta, të gjithë këta armiq të djathtë e kanë aku-zuar Partinë tonë marksiste-leniniste dhe vijën e saj si sektare, dogmatike. Aktualisht, kapitalisto-revizioni-stët dhe lakenjtë e tyre, të gjitha partitë marksiste-leniniste ose njerëzit që nuk u binden urdhrave të tyre dhe i luftojnë me të gjitha forcat, nuk i quajnë vetëm «dogmatike» dhe «staliniste», por edhe «konservatore». Ky është termi i vjetër me kuptim të ri që u vihet atyre që nuk duan «të liberalizohen», «të modernizohen» sipas ideologjisë dhe mënyrës së jetesës kapita-listo-revizioniste, që nuk duan të braktisin marksizëm-leninizmin, por luftojnë me heroizëm për ta mbrojtur dhe për ta zbatuar me konsekuencë atë.

Partia jonë e ka pasur kurdoherë parasysh rrezikun e djathtë dhe kurdoherë e ka likuiduar këtë shfaqje të rrezikshme. Kjo nuk do të thotë se ajo i ka injoruar dhe nuk i ka luftuar shfaqjet mëngjarashe. Të dyja këto shfaqje Partia nuk i ka luftuar, gjithashtu, sipas rastit, duke u mbështetur te njëra për të luftuar tjetrën dhe anasjelltas, pse atëherë vija e saj do të ishte e lëkundshme, e paqëndrueshme dhe jo e drejtë. Ky fenomen nuk është vërtetuar asnjëherë, gjë që provon vendosmërinë e plotë të vijës në teorinë shkencore marksiste-leniniste dhe tregon ekuilibrin e shëndoshë të saj.

Marksistë-leninistët nuk duhet të maskojnë kurrë prirjen dhe orientimin e drejtë të vijës së tyre. Gabime

mund të vërtetohen në zbatimin e kësaj vije në praktikë, po këto duhet të korrighohen pa humbur kohë, pora shihen dhe vërtetohen. Kështu ka bërë gjithë jetën Partia jonë. Revizionistët, të djathtët dhe të majtët, e fshehin vijën e tyre antimarksiste, antiparti, antisocialiste, jo vetëm kur veprojnë si kolonë e pestë, por edhe kur arrijnë të marrin fuqinë. Revizionistët sovjetikë dhe të gjithë armiqtë e marksizëm-leninizmit e të Partisë sonë shkojnë në rrugën antimarksiste dhe restaurojnë kapitalizmin. Ata shkojnë në të djathtë dhe në ekstremin e djathtë dhe jo vetëm ruajnë disa maska të «socializmit», po tradhtia i bën të forcojnë edhe dozën e parullave demagogjike nga e majta, pse ashtu mendojnë që do t'i besojnë, se «jo vetëm ndërtojnë socializmin», po shkojnë edhe më tej, «në ndërtimin e komunizmit».

Kur revizionistët jugosllavë tradhtuan marksizëm-leninizmin dhe ecnin drejt zhdukjes së rolit udhëheqës të Partisë Komuniste të Jugosllavisë dhe po e çonin vendin nga e djathta, drejt restaurimit të kapitalizmit, ne pamë të vepronin me slogane të majta. Partia Komuniste e Jugosllavisë u quajt «Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë» dhe nuk munguan ta lidhnin këtë me emrin e Marksit. Kësaj farë «Lidhjeje» i dhanë funksionet e «kohës së shoqërisë komuniste», që nuk u deklarua haptazi se po ndërtohej, por po fillonte «me vet-administrimin punëtor» dhe këtë nuk munguan, gjithashtu, ta lidhin me Marks. Filloi në teori dhe në praktikë «zhdukja e shtetit» dhe këto ishin premiset e «shoqërisë komuniste» titiste. Të gjitha këto parulla e slogane majtiste puqeshin dhe me veprimet djathtë

dhe shërbenin për vendosjen e kapitalizmit në Jugosllavi.

E njëjta gjë ndodhi me revizionistët në Bashkimin Sovjetik. Atje tashmë është restauruar kapitalizmi, ndërsa nga ana e tyre flitet e propagandohet me të madhe se po «ndërtohet komunizmi». Si këtu dhe kudo ku revizionistët janë në fuqi, të dy ekstremet antiparti në ideologji, në politikë dhe në veprim, puqen.

Është pra e kuptueshme përse luftohet dhe do të luftohet Partia jonë nga antimarksistët dhe nga gjithë armiqtë e saj të çdo ngjyre. Me Partinë tonë, parti e proletariatit, që mbron diktaturën e proletariatit, ata janë në luftë. Me Partinë tonë, që ndërton dhe mbron socializmin, ata janë në luftë. Me Partinë tonë, parti e proletariatit, që busull të vetëm të pagabueshme ka teorinë marksiste-leniniste, ata janë kundër. Partia jonë është një parti e vërtetë leniniste që ruan dhe zhvillon në rrugën marksiste-leniniste parimet, normat, moralin proletar, disiplinën proletare leniniste, ajo bëhet fli për kauzën e popullit punonjës, është parti e klasës që ruan pastërtinë e klasës dhe frymëzohet nga klasa, prandaj ata janë kundër saj.

Pra Partia jonë po ndërton socializmin me sukses në një front të gjerë pune dhe lufte. Ajo nuk fle mbi dafina, përkundrazi nuk e zë gjumi për të konsoliduar fitoret, për ta çuar popullin në fitore të reja dhe për të shtypur armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm që bëjnë çmos të pengojnë marshimin e saj përpara.

Kurrë nuk ka qenë gjithçka e shtruar me lule dhe as tani nuk është shtruar gjithçka me lule për Partinë dhe për popullin tonë. Çdo gjë duhet të fitohet, të

ndërtohet, të ruhet, të përmirësohet, të shtohet. Kjo kërkon luftë, përpjekje, punë të palodhur, djersë, ndershmëri, drejtësi, dituri, vigjilencë, edukatë. Partia na mëson çdo orë e çdo ditë të jemi shembull në këto drejtime, ajo na udhëzon, na korrigjon, por edhe na dënon kur mbushim kupën. Po s'u shkulën barërat e këqija, s'ka grurë; po nuk u krasit pema, s'ka fruta; po nuk u spërkat vreshti, s'ka rrush.

Durimi dhe pjekuria e madhe e Partisë sonë, zemërgjerësia e saj në besimin e ndreqjes së njerëzve që gabojnë janë shembullore, janë marksiste-leniniste. Shumë keq për ata që këto virtyte të larta të Partisë i marrin për dobësi, që mendojnë se ajo nuk i sheh, dhe ca më keq është për ata që këshillat dhe mësimet e Partisë as që i peshojnë fare, pse u është rritur mendja.

Disa njerëz të tillë që bëjnë gabime të pafalshme, si Fadil Paçrami e Todi Lubonja thonë: «Partia të ketë parasysh të kaluarën time». Po, Partia e ka pasur kurdoherë parasysh këtë gjë, prandaj të ka nderuar, të ka besuar, të ka ngritur, të ka mësuar, të ka këshilluar. Ti, shok, i ke pasur parasysh këto, kur iu fute rrugës tënde të gabuar dhe plot rreziqe për popullin, për Partinë dhe për veten tënde? Jo, ti i harrove dhe nuk hoqe dorë nga kjo rrugë, edhe kur të këshillonte Partia. Çështja e popullit dhe e Partisë qëndron mbi të gjitha, prandaj kush e dëmton atë, duhet të përgjigjet dhe, sipas rëndësisë së fajit, të marrë dënimin, pse edhe dënimi është një nga format e edukimit.

Në këtë Plenum të Komitetit Qendror, ku u diskutuan probleme kaq të rëndësishme, u shtruan po ashtu edhe një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me

vijën e Partisë, që kanë lidhje me konceptet dhe me pikëpamjet antimarksiste dhe antiparti të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës. Të gjithë shokët folën për këto pikëpamje të tyre, e gjithë Partia ka folur dhe i ka kritikuar ashpër këta të dy, kështu siç po bëjmë edhe ne këtu. Autokritikat e tyre ishin kudo shumë të dobëta, të shpëllara, të pakënaqshme për gjithë Partinë. Unë, kur jap këtë konkluzion, nuk kam parasysh vetëm diskutimet e thella dhe të drejta marksiste-leniniste të shokëve të Plenumit të Komitetit Qendror që morën fjalën këtu, nuk kam parasysh vetëm autokritikat e të dy këtyre në organizatat-bazë përkatëse, në aktivet e punonjësve ku ata u paraqitën, por edhe një numër të madh procesverbalesh të ardhura nga baza, ku diskutantët kanë folur në mënyrë të zjarrtë dhe konstruktive për të gjitha këto probleme dhe për veprimtarinë e këtyre dy personave.

Fadili kërkoi të takohej me mua, unë e prita atë dhe e dëgjova dhe për këtë do të flas më poshtë, do të flas për gjithë çështjen e të dyve. Por, siç u konstatua, veprimet e gabuara dhe në kundërshtim me vijën e Partisë nga këta të dy nuk kanë qenë as të rastit, as të pakta, as të panjohura. Ato as nuk janë lënë pa u vënë në dukje, pa i kritikuar, pa i këshilluar nga organizatat-bazë ku bënin pjesë, nga kolektivat ku punonin ose nga ata me të cilët merrnin kontakt, nga shokë e punonjës të veçuar, nga byrotë dhe komitetet e Partisë, nga njerëzit e aparatit të Komitetit Qendror, nga Komiteti Qendror vetë, nga unë personalisht dhe, veçanërisht, shpeshherë nga shokët Hysni, Ramiz e Manush. Por të dy këta nuk janë ndrequr, nuk kanë dashur të ndreqen.



Të gjitha shtrembërimet në vijë nga ana e Fadilit dhe e Todit zhvilloheshin në dinamizmin e problemeve e të çështjeve dhe krijonin një sërë anomalish e situatash të vështira, sidomos në lëmin e letërsisë dhe të arteve, pengohej zgjidhja e drejtë e konflikteve nga mendjemadhësia dhe nga një arrogancë e pafrenuar nga ana e tyre, nga metoda antiparti e punës që ata zbatonin. Në fakt, Partia kishte hyrë në luftë me disa deviatorë të djathtë, kundërshtarë të vijës marksiste-leniniste të saj dhe kryesorët e këtij deviacioni ideologjik ishin Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja.

Duhej demaskuar dhe shpartalluar ky deviacion. Duhej të kalohej nga kritikata e rregullta e të drejta, nga këshillimet në debate të hapëta, masive, siç e praktikon Partia në këto raste, kur njerëz të tillë spekulojnë me bataçillëqet e tyre. Ky veprim u vu në lëvizje me fjalën që mbajta në Presidiumin e Kuvendit Popullor<sup>1</sup> dhe më vonë në mbylljen e punimeve të Plenumit të fundit të Komitetit Qendror.

Natyrisht, Partia e kuptoi menjëherë se ku duhej rrahur çekani dhe u çua në këmbë. Filluan debatet e zjarrrta kudo. Si reagues këta të dy përpara kësaj situatë? Shumë keq, jo si komunistë, po si antikomunistë. Ata u frikësuan se do t'u dëlnin të palarat, do të hapeshin gojët e njerëzve të thjeshtë që ata i kishin përbuzur dhe kërcënuar. Fadil Paçrami u përpoq të mos shkonte në këto mbledhje, pastaj u detyrua nga të tjerët të shkonte.

Ç'qëndrim mbajti ai ndaj kritikave dhe pyetjeve që

---

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 50, f. 1.

i drejtoheshin? Qëndrim nga më arrogantët. Asnjë autokritikë nuk bënte, bile fliste me «ne» dhe jo me «unë». «Ne», natyrisht, ishte komiteti, komiteti, pra, i kishte fajet dhe jo ky. Todi Lubonja mbante të njëjtin qëndrim arrogant dhe nuk i njihte fajet e tij. I gjithë ky qëndrim i tyre jokomunist u kundërvihet qëndrimeve parimore dhe me frymë partie të të gjithë shokëve të tjerë të sektorit të kulturës e të arteve etj., si edhe të atyre shokëve që gjatë punës dhe veprimtarisë së tyre kishin bërë gabime, por që ndershmërisht i njihnin ato dhe bënë autokritikë.

Fjalimi im në mbledhjen e përgjithshme të komunistëve të aparatit të Komitetit Qendror<sup>1</sup> i dha një zgjerim e një thellim më të madh debatit që kishte filluar në Parti për ndreqjen e gabimeve e të metave që ishin shfaqur në punë në të gjithë sektorët dhe në njerëzit. Siç e dini, në këtë fjalim vura theksin në çështjen e konservatorizmit dhe të liberalizmit dhe iu drejtova drejtpërdrejt me këtë rast Fadil Paçramit me një pyetje, që duhej të ishte shumë preokupuese për të, që duhej ta bënte atë të reflektonte thellë dhe t'i përgjigjej kritikës së hapët dhe të drejtpërdrejtë që i bëja. Këtë vendim e mora jo rastësisht, por pasi bëra një analizë të gabimeve të Fadilit dhe të përpjekjeve që kishte bërë Partia për ta ndrequr atë. Kjo analizë më nxori në disa konkluzione që do t'i radhis më poshtë dhe kishte ardhur koha që Fadili duhej pyetur përpara Partisë: «Ish-te ai me vijën e Partisë, apo me vijën e armikut?».

Të nesërmen e ditës që mbajta fjalimin (ku ishte i

---

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 50, f. 293.

pranishëm edhe vetë Fadili, sido që nuk bën pjesë në atë organizatë partie), ai kërkoi takim me mua<sup>1</sup>. Unë nuk u shpejtova ta thërrisja, pse një takim i tillë i kërkuar prej tij bëhej i shpejtuar. Ai nuk po merrte mundimin as të thellohej, as të reflektonte mbi gabimet e tij dhe mbi pyetjen time, kështu që do të më përsëriste ato gjëra pa vlerë që kishte thënë në mbledhjet e tjera. Prandaj e lashë në pritje, me shpresë se do të mendohej, do të reflektonte.

Kaloi më tepër se një javë dhe e thirra në takim. Fadili erdhi me një defter të vogël xhepi, ku kishte shënuar disa pika. «Të dëgjoj», i thashë. Ai bisedën e filloi duke më thënë se kritika që unë i bëra në mbledhje ishte e drejtë dhe gjoja e pranonte. Kjo ishte vetëm formula për të qenë gjoja në rregull, pse në fakt duhej t'i përgjigjej pyetjes që i vura: «Je ti me vijën e Partisë apo je me vijën e armikut?» dhe të shpjegonte pse është kështu ose nuk është ashtu.

E dëgjuam me durim, tok me shokun Hysni, dhe aq sa deshë ai të fliste, po nuk foli shumë. Fjala e tij konsistonte në disa pikëmbështetje, gjoja në formë tezash, për të na thënë se «kam punuar mirë, se aktiviteti im është pozitiv, se në konservatorizëm kam forcuar veprimtarinë, por nuk kam qenë dhe aq ekzigjent ndaj liberalizmit, se kam pasur disa shfaqje sporadike, ca intelektualizëm, ca mendjemadhësi». «Disa fjalë, disa gjeste të mia shokët i kanë keqkuptuar»<sup>2</sup> etj. Kjo ishte gjithë biseda e tij lakonike, e matur, e peshuar. Asgjë

1. Shih: Enver Hoxha, Vepra, vëll. 50, f. 366.

2. Shprehjet e futura në thonjëza që i referohen këtu dhe më poshtë Fadil Paçramit, janë tekstualisht të tijat.

konkrete, autokritikë shumë e dobët, për të mos thënë hiç fare.

Pasi mbaroi, u detyrova t'i thosha ç'kërkonte nga unë, pse në fakt ai asgjë nuk po më kërkonte mua Sekretarit të Komitetit Qendror. Pas pyetjes që i bëra, më tha: «Dua të më këshilloni». E këshilluam, e kritikua shoqërisht, i thamë se kjo ekspozë që bëri ishte foshnjarake, false, ishte autokritikë e një fajtori që përpiqet të fshehë fajet dhe ia numëruam këto fajet, por me paturpësinë më të madhe ai i hidhte poshtë, ashtu siç bëri edhe këtu përpara Plenumit. «Ju kanë informuar gabim, — thoshte, — s'ka ngjarë tamam ashtu, po kështu» etj.

Një taktikë e tillë, natyrisht, nuk e shfajësonte atë, prandaj e këshilluam të reflektonte thellë në punën, në qëndrimet dhe në gabimet e tij, në rast se donte të ndihmonte Partinë dhe veten e tij. «Mbledhja e Komitetit Qendror të Partisë është përpara, atje të jesh më i hapët», i thashë «se është e nevojshme që nga pikat e defterit të vogël, të dalësh në autokritikë të hapët me shkrim dhe të ma dërgosh». Dhe këtë autokritikë ma dërgoi. Ajo është në dispozicionin tuaj, e lexoni shokë, pse, siç do ta shihni, është shumë tipike.

Ju i dëgjuat ato që tha, por tani do të them mendimin tim për këtë autokritikë dhe disa konkluzione që kam nxjerrë prej saj, të cilat përforcojnë konkluzionet që kisha arritur më parë. Diskutimi i tij këtu tregoi plotësisht fytyrën e tij të vërtetë.

Kur mbarova së lexuari me kujdesin më të madh autokritikën e Fadilit, u krodha në mendime dhe pyeta veten: «Si është e mundur?». Prandaj u riktheva për-

sëri dhe e lexova atë për të dytën herë. Për fat të keq, në gjithë autokritikën, ku ai bënte analizën e punës dhe të gabimeve të tij, Fadil Paçrami fliste vetëm, e thaksoj, vetëm dy herë për Partinë dhe këto dy herë fliste kundër. «Është fakt, — thotë ai, — shtrembërimet dhe deformimet që janë bërë në vijën e Partisë» etj., etj. Në një vend tjetër thotë se «pas Kongresit të 5-të të Partisë ka pasur dhe ka diskutime», kjo ka lidhje me «krijimtarinë e viteve 60-të», periudha që i përcaktojnë Fadili me shokë. Më Partia nuk del, por për këtë do të flas më poshtë.

Ky njeri flet si udhëheqës partie, si komunist? Punojnë dhe lufton ai sipas vijës së Partisë, sipas direktivave të saj? I ndjek, i zbaton direktivat e kongreseve, të Komitetit Qendror, të Byrosë Politike? Asgjëkundi nuk do të gjesh një afirmim të tillë, një referencë të tillë në autokritikën e tij me shkrim. Ai shkruan si një element që qëndron jashtë Partisë, mbi Partinë, nuk konfondohet me Partinë. Ai shprehet me terma të tillë «unë mendoj», «unë kam menduar dhe mendoj». Thëniet e Partisë, direktivat e kongreseve dhe të Komitetit Qendror pa kurrfarë ndjenje thjeshtësie dhe me paturpësinë më të madhe ia atribuon vetes. Sukseset në lëmin e kulturës dhe të arteve nuk mungon që një pjesë të mirë t'ia dedikojë vetes «që lufton me të gjitha forcat për të renë, për novatoren». Ç'punë ka bërë Partia këtu, ç'punë kanë bërë njerëzit e artit dhe të kulturës në këtë çështje, pak rëndësi kanë për Fadilin.

Pse të ngjasë kjo harresë e një çështjeje kardinale, siç është Partia dhe vija e saj? Ku janë vërtetuar gabimet e Fadil Paçramit? Sigurisht në kuptimin e shtre-

mbër dhe të gabuar të vijës së Partisë nga ana e tij, në zbatimin gabim të saj në praktikë dhe në luftën e hapur që ai i ka bërë vijës dhe vetë Partisë. Atëherë logjika më e thjeshtë ta do që në këtë ose në atë problem ku ai ka gabuar, duhet të përmendej, qoftë edhe një herë, cila ka qenë vija e drejtë e Partisë që ai e ka shtrembëruar. Këtë Fadili nuk e bën, ai e harron. Mos është kjo një koincidençë e thjeshtë? S'ka mundësi të jetë kështu dhe sidomos në një dokument të tillë që ai e konsideron si «kredon e 30 vjetëve të jetës së tij, si një kuadër i frontit ideologjik».

Gabimet e Fadil Paçramit në zbatimin e vijës së Partisë janë të djathta. Ai e ndien rrezikshmërinë e tyre, por nuk ka guxim dhe kurajën komuniste t'i denoncojë, t'i njohë haptazi, t'i analizojë thellë, t'u gjejë burimet dhe qëllimet që të çlirohet dhe të shërohet. Ai e ka të zorshme të mos njohë asgjë, diçka thotë, por e minimizon, gjen arsye të rastit, për ta shpjeguar përdor formula dhe slogane të njohura si «intelektualizmi», ngre të ashtuquajturat anë pozitive të punës së tij për t'i zvogëluar dhe errësuar këto të meta, siç e patë dhe e dëgjuat vetë në tribunë.

Por, me të gjitha këto manovrime e të tjera, as gabimet e tij të mëdha nuk i nxjerr në shesh dhe as burimin ku e kanë dhe ku synonin këto veprime ai nuk i vë në dukje. Neve na duhet të ndihmojmë Partinë, në radhë të parë, duke u përpjekur të shfaqim sa të jetë e mundur mendimin tonë realist dhe të bazuar në faktet. Këtë mendim ne e shfaqëm një herë, por po e përsëritim edhe tani.

Në autokritikat standarde që po bën Fadili thotë

se burimi i gabimeve të tij të djathta liberale qëndron në atë «që kam qenë i prirë për të bërë deri në fund luftën kundër konservatorizmit» dhe, si konsekuencë, «nuk kam pasur po atë prirje për të bërë të njëjtën luftë edhe kundër liberalizmit». Këtë e arsyeton duke thënë: «Kjo ka ndodhur sepse prej shumë vjetësh kam pasur një formim dhe angazhim kundër obskurantizmit dhe prapambetjes» etj.

Lufta kundër obskurantizmit mesjetar dhe modern, kundër klerikalizmit mesjetar dhe modern, kundër konservatorizmit të ri dhe të vjetër, kundër patriarkalizmit, dokeve e zakoneve të këqija, kanuneve skllavëruese për njerëzit etj. ka qenë në themel të luftës së Partisë sonë, qëkurse u formua. Kjo ka zhvilluar, zhvillon e do të zhvillojë edhe për shumë kohë një luftë të ashpër kundër tyre, si në platformën ideologjike e politike, ashtu edhe në atë praktike. Dhe krahas kësaj, Partia, mbi gërmadhat e kësaj bote të urryer të vjetër, ndërton botën e re, shoqërinë socialiste, përparimtare. Dhe në qoftë se ka pasur prirje për këto luftëra, pavarësisht se Fadili nuk e pohon, këtë prirje ia ka mësuar Partia. Por, duhet të theksojmë, siç e pohon edhe vetë, se në të dy krahet e kësaj lufte, qoftë kundër konservatorizmit, qoftë pro së resë, jo vetëm nuk ka shkëlqyer, por ai ka dalë nga binarët e Partisë.

«Kam gabuar, — thotë, — në çështjen e konservatorizmit, pse kësaj i kam pasë vënë theksin». Të vësh theksin në të, nuk është gabim, por t'i hapësh rrugën liberalizmit, nën pretekstin se gjoja lufton konservatorizmin, këtu qëndron shtrembërimi i vijës. Partia vazhdimisht e ka shpjeguar teorikisht dhe me luftë kon-

krete ç'është konservatorizmi, si shfaqet, format e ndryshme që merr, ku e ka burimin, si duhet demaskuar e luftuar ai në rrethana të ndryshme, të veçuara e të koklavitura, në sektorë të ndryshëm. Po kështu ka vepëruar Partia edhe për pikëpamjet oportuniste, revizioniste, liberale e moderniste. Një luftë e vazhdueshme e ashpër po zhvillohet çdo ditë.

Fadil Paçrami, për të arsyetuar dhe për t'u gjetur një burim të paqenë gabimeve të tij të djathta në vijë, na thotë: «Kam treguar një zell të tepruar për luftën kundër konservatorizmit». Mirëpo ky pohim nuk vërteton tezën e tij, por vërteton një pikëpamje shumë të rrezikshme dhe zor të pohueshme nga ai vetë, që unë do ta shpreh ca më poshtë dhe që e thanë këtu hapët dhe në mënyrë të shkëlqyer edhe shokët e Plenumit.

Fadili, si anëtar partie, si udhëheqës dhe si letrar, siç e pretendon veten, a ka qenë i angazhuar kaq fuqimisht kundër obskurantizmit mesjetar, kundër klerikalizmit, kundër dokeve e zakoneve të vjetra? A është dalluar ky mbi të tjerët, goftë edhe mbi ato cucat e thjeshta heroike të malësisë? Aspak! A ka shkruar ai ndonjë satirë, ndonjë libër o ndonjë dramë kundër fesë, kundër priftërinjve o hoxhallarëve? A ka mbajtur ai konferenca dhe artikuj specialë për këto çështje që të mund të thoshim sot këtu: «Po, kjo është kështu, siç thotë Fadili». Jo aspak! I gjithë argumenti i tij në këtë çështje është se në një libret opere të një poeti, për Skënderbeun, na ishte vënë edhe një prift popullor që Fadili, sipas tij, propozoi të hiqej. Të paktën ne mund të themi se, për sa i përket luftës në këto drejtime



Fadil Paçrami ka bërë shumë më pak sesa ka bërë një anëtar i thjeshtë i Partisë.

Të gjithë komunistët e shëndoshë, duke zbatuar vijën e Partisë, luftojnë konservatorizmin, por jo për të qenë liberalë dhe oportunistë, por për të mos qenë as konservatorë, as liberalë, luftojnë, pra, si liberalizmin, edhe konservatorizmin.

Derisa Fadil Paçrami përqafoi dhe mbrojti pikëpamje të djathta, në kundërshtim me vijën e Partisë, kuptohet dhe shpjegohet «zelli i tij i madh për luftën kundër konservatorizmit, prapambetjes etj.». Për Fadil Paçramin konservatorizmit me kuptimin e vjetër, si me thënë klasik, i shtohet edhe «konservatorizmi i ri», që ekziston sipas tij në Parti. Pra vija e Partisë sonë, sipas mendimit, sipas fakteve, të thëna dhe të bëra nga Fadil Paçrami, qenka konservatore dhe duhet të liberalizohet, të modernizohet, të likuidohet dhe të krijohet një parti e re. Dhe kësaj pune antiparti dhe thellësisht armiqësore iu futën Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja.

Kur Fadili pohon se ka pasur prirje të luftonte konservatorizmin dhe nuk kishte prirje të luftonte liberalizmin, pohon vetë se nuk luftonte në vijën e Partisë, por në kundërshtim me të dhe kundër saj, pse me këto pikëpamje çdo gjë që nuk ishte liberale, siç e mendonte Fadili, ishte konservatore, pra duhej luftuar me të madhe. Në luftën në të dy krahët ai nuk ishte në vijën e Partisë dhe këtë e pohon vetë, sido që luftën kundër konservatorizmit, sipas tij, ai kërkon ta kalojë si «një çështje pozitive». I njëjti problem, i njëjti koncept i tij për sa u përket «obskurantizmit dhe pra-

pambetjes», kundër të cilëve ishte angazhuar Fadili, siç thotë. Të luftosh, si pretendon ai, kundër obskurantizmit dhe prapambetjes klerikale, mesjetare dhe feudale, kjo nuk të çon në atë që ra Fadili, në obskurantizmin dhe degjenerimin e letërsisë e të artit borgjez dekadent modernist.

Pra, lufta e tij nuk ka qenë aspak në vijën e Partisë, ajo nuk ka qenë e bazuar në ideologjinë tonë, bile ka qenë shumë formale dhe konkretisht në kundërshtim të hapët, pse Fadili nuk mundi dhe nuk donte të dallonte se ato koncepte liberale ku kishte shkarë, i mbrojnë dhe i përkrahin po ata obskurantistë, armiq të përparimit e të progresit të njerëzimit. Prandaj asgjë pozitive nuk ka në tezat që Fadili sjell në mbrojtje të gabimeve të tij të pambrojtshme.

Fadili në autokritikën e tij thotë se «nuk kam ditur kurdoherë të dalloj atë që është me të vërtetë e re dhe përparimtare». Ka mundësi që ndonjë shok edhe të mos i dallojë këto që thotë Fadili në mënyrë indirekte, por ai është i detyruar të pohojë më tej, natyrisht në formë të përgjithshme, se «kur i kam parë ndikimet e huaja, kam zvogëluar rrezikun e tyre, kam bërë lëshime dhe këto ndikime të huaja e lëshime i kam bërë në letërsi dhe në arte, në poezi, në muzikë dhe në pikturë, nuk vlerësova rrezikun në rritje të shfaqjes së rrugacërisë, modat, thyerjet e disiplinës etj.». Siç shihet, ky nuk është as një gabim i thjeshtë, as i veçuar dhe as i rastit, ku ka mundësi të bjerë ndonjë person jo i ngritur politikisht dhe ideologjikisht. Këto janë gabime të shumta antiparti dhe në një front të gjerë. Fadili vetë, me të drejtë, e ekskludon çështjen se këto ai i ka bërë

se nuk ka qenë i ngritur. Mirëpo këto gabime të tij në front të gjerë, ka ardhur koha t'i njohë, t'i përcaktojë, t'u gjejë edhe prejardhjen.

Natyrisht, në radhë të parë ai nxjerr «pikëpamjet intelektuale» të tij, të cilat, sipas tij, e kanë hedhur në një kontradiktë. Cila është kjo kontradiktë? Gjoja angazhohet fort në revolucion, kurse në praktikë ai bën të kundërtën e asaj që thotë. Kjo me fjalë të tjera do të thotë të mos jesh revolucionar ose me fjalë slogane «kontradiktë» dhe «intelektualizëm» të fshehtë atë që është e qartë, të jesh në kundërshtim me vijën e Partisë, në teori dhe në praktikë, dhe të mas-kosh luftën kundër saj.

Si mund të ngjasë ajo që thotë Fadili se «jam angazhuar dhe kam rënë në liberalizëm, kam folur drejt dhe kam vepruar shtrembër»? «Kjo është kontradikta ime», thotë ai! Me të vërtetë kontradiktë e çuditshme për një person, që e quan veten komunist dhe revolucionar. Por do të ishte fatkeqësi që të tillë komunistë t'i shpjegojnë kaq thjesht gabimet dhe pas çdo parashtrimi të tyre të dalin me refrenin, siç del Fadil Paçrami: «Kjo nuk bën tiparin tim kryesor, ose këto janë gjëra të vogla përpara së përgjithshmes së punës sime».

Që Fadil Paçrami është një intelektual i sëmurë, nuk ka asnjë dyshim, por që të pranojmë me naivitet se ai është një revolucionar, nuk na lejojnë faktet dhe veprimtaria e tij dhe këtë ne nuk e hamë. Aq sa është i pamohueshëm intelektualizmi i tij i sëmurë, aq është i dyshimtë edhe revolucionarizmi i tij.

Të gjitha argumentet që ai sjell (kurdoherë këtë e bën me terma të përgjithshëm për të vërtetuar se

gjoja ka luftuar për të renë, për të bukurën, për revolucionaren etj.), nuk qëndrojnë në këmbë, edhe pse e di që puna dhe pikëpamjet e tij tregojnë anën e keqe të «revolucionit» ala Fadil, ai shton se para fenomeneve konkrete nuk ka mbajtur kurdoherë qëndrim të drejtë, ka pasur lëshime, liberalizëm etj.

Shkarjen e Fadilit në «intelektualizëm», sipas tij, e kanë shkakuar rrethet intelektuale, ku ai jetonte dhe punonte, presionet e tyre e kanë bërë këtë të gabojë. Por për çudi presionet e këqija kanë influencuar, kurse presionet e njerëzve të mirë e me partishmëri të letërsisë e të arteve dhe që janë shumica dërrmuese, nuk kanë influencuar tek ai. Vihet pyetja: Kanë qenë intelektualët e sëmurë që kanë influencuar te Fadili, apo ka influencuar, ndihmuar dhe inkurajuar ai tek ata si komunist i shtrembër dhe si sekretar i komitetit të Partisë që merrej me këtë sektor? Sigurisht që të dyja palët kanë influencuar te njëra-tjetra dhe krijojnë kështu një pengesë dhe një sëmundje në gjirin e shkrimtarëve dhe të artistëve tanë të shëndoshë popullorë.

Këtë përgjegjësi që mban ai për gabimet që ka bërë, e njeh shkarazi tani në orët e fundit, pse deri tani i ka mohuar me arrogancë, siç i mohoi edhe këtu, gjithashtu, me arrogancë. Por edhe tani në orët e fundit ai nuk mungon të thotë: «Derisa kanë ndodhur gabimet në këto fusha, siç janë festivali i 11-të i këngës në Radiotelevizion, ndikimet në poezi, muzikë e pikturë, dhe me këta sektorë merrem unë, kam edhe përgjegjësi». Dhe ku qëndron përgjegjësia? Ai shton: «Se nuk i kapa, nuk u ngrita me kohë kundër tyre, nuk i bëra probleme të Partisë».

Sipas Fadil Paçramit, Partia bënte gjumin e madh, Fadil Paçrami ishte «papa i letërsisë dhe i arteve». Partia, sipas tij, nga një parti leniniste, ishte reduktuar e atillë që çdo gjë e priste «ta sinjalizonte, ta kapte, ta bënte çështje» vetëm Fadil Paçrami. Ky megaloman harron se gjithë aktivitetin revolucionar në këto fusha dhe në të gjitha të tjerat e ka udhëhequr dhe e udhëheq Partia, ndërsa Fadil Paçrami dhe disa shokë të tij kanë udhëhequr veprimtarinë antiparti. Veprimtarinë antiparti të tyre këta elementë kujtojnë se Partia, teorikisht dhe praktikisht, nuk po e luftonte çdo orë, çdo ditë. Fadil Paçrami harron ose nuk dëshiron të thotë se kundër qëndrimeve të tij dhe të shokëve të tij Partia ka reaguar vazhdimisht, që nga organizatat-bazë dhe deri në udhëheqjen më të lartë. Këta e kanë kritikuar shumë herë dhe ashpër Fadilin dhe veprimet e tij, padrejtësitë që ai ka bërë ose që është orvatur të bëjë, të cilat, kur janë njohur, janë vënë menjëherë në vend.

«Këto gjëra të këqija», thotë Fadili me paturpësinë më të madhe, «nuk i kapa». Por këto i kapte dhe i bënte çdo ditë probleme të komunistëve dhe të masave Partia. Kjo, nga ana e saj, luftonte kudo e me sukses kundër intelektualizmit që të mbulonte ty, luftonte që organizata-bazë të udhëhiqte, kurse ti dhe shokët e tu bënit një luftë antiparti që ta eliminonit atë nga mesi. Partia luftonte kundër teknokratizmit që ti me sistemin punoje për ta sjellë dhe solle në institucionet kulturore e artistike njerëz të degjeneruar, servilë e pa vlerë, që të bënin qejfin dhe me anën e tyre imponoje me arrogancë e me frikësime në ata elementë që të kundërshtojin; Partia luftonte për vijën e masave, kurse ti e kun-

dërshtojë këtë vijë. Ti s'ke zbatuar direktivat e kongreseve të Partisë, të Komitetit Qendror. Në Parti dhe në udhëheqjen e saj këto të janë vënë në dukje shumë herë.

Të gjitha çështjet e drejta që Partia dhe populli luftojnë për t'i mbrojtur dhe për t'i zbatuar në jetë, të gjitha të këqijat që duhen luftuar ndodhen të qarta në të gjitha dokumentet e Partisë. Ti pse nuk i ke pasur ato parasysh? Pse nuk i ke zbatuar? Përse nuk i ke korigjuar ti gabimet, kur të janë vënë në dukje? Këto pyetje kanë rëndësi. Je ti me vijën e Partisë apo me vijën e armikut? Nuk mjafton tani në orët e fundit të pohosh se ke një intelektualizëm të sëmurë ose je mendjemadh. Shumë shokë kanë bërë gabime, të ndryshme në punë, kanë pasur edhe shfaqje të intelektualizmit ose të mendjemadhësisë, por asnjëherë nuk u është vënë pyetja kështu, pse gabimi është i mundshëm, por ata e kanë kuptuar, janë korigjuar, janë bërë shokë shumë të mirë, pse kanë pasur besim të madh, të pafund te Partia. Kurse ty, Fadil, ky besim të është lëkundur, të është zhdukur. Dhe provat që sollëm këtu dhe që do të them edhe më poshtë e vërtetojnë këtë.

Nga fillimi i këtij diskutimi unë vura në dukje se në autokritikën me shkrim të Fadil Paçramit nuk del asgjekundi roli dhe Partia në udhëheqje, asgjekundi ajo nuk përmendet për të mirë, veçse «për gabime që ka bërë». Sipas tij, në asnjë rast nuk del që vija e Partisë ta ketë frymëzuar atë; pale ta ketë udhëhequr në punë. Atëherë vihet pyetja: Ku ka kullotur dhe ku kullot ky njeri? Le ta lëmë të flasë me gojën e vet dhe ai foli edhe këtu, por po jua lexoj pikë për pikë, pa

ndryshuar asnjë presje kredon e tij që figuron në paragrafin e parë të faqeve 5-6 të autokritikës së tij. Dëgjojeni shokë:

«Kam menduar dhe mendoj se për të pasur një zhvillim të drejtë dhe më të mirë të letërsisë dhe të arteve duhen kapërcyer disa fenomene të tilla, si: sentimentalizmi, natyralizmi, skematizmi etj., duhet të çlirohem gjithashtu dhe përfundimisht nga çdo ndikim i një lloji rryme letrare klerikaliste që ka ekzistuar para Çlirimit me temat e veta të preferuara mbi ekzotikën, ruajtjen e zakoneve patriarkale, largimin nga problemet shoqërore dhe hyznizimin e disa virtyteve mbi-klasore, shoqëruar me mënyra të foluri dhe pamje të jashtme aspak esenciale; duhej bërë një luftë e vendosur për të çrrënjosur koncepte e pikëpamje të huaja nën ndikimin e rrymave dekadente borgjeze e revizioniste, në përmbajtje dhe në mjetet shprehëse që mbjellin pesimizmin, fatalitetin, kotësinë e jetës dhe pamundësinë për ta transformuar botën; duhej të kapërceheshin edhe ato skema konfuze për letërsinë dhe artin të shkollës sovjetike që nuk qenë në gjendje t'i presin rrugën, po përkundrazi hapën rrugë për revizionizmin në Bashkimin Sovjetik e në vende të tjera. Dhe kam luftuar me të gjitha këto drejtime. Po ku qëndron gabimi? Këto çështje nuk janë bërë të qarta në masën e gjerë të shkrimtarëve e të artistëve edhe kjo flet për një punë të dobët të Partisë në rreth, të organizatave-bazë në institucionet kulturore e artistike dhe timen, që drejtoj këta sektorë. Po kështu nuk munda të krijoj gjithmonë marrëdhënie normale në mes të gjithë krijuesve, të krijoj edhe atë të ashtuquajtur ambient arti-

stik, por ka ndodhur që për disa prej tyre, në veprat e të cilëve ka pasur ndikime dhe shfaqje të llojeve të ndryshme, janë përdorur shprehje si natyralist, skematik, konservator, modernist etj. Reagimi im këtu nuk ka qenë i tillë, që t'u pritej rruga gjërave të tilla. Pas kritikës që u bë në Plenumin e 15-të të Komitetit Qendror të Partisë ndaj disa veprave me ndikime të huaja borgjeze e revizioniste, pati një punë më të mirë dhe rezultatet në krijimtarinë letrare dhe artistike qenë më të mëdha; mirëpo kjo bëri të nënvleftësohej rreziku i ndikimeve të huaja dhe unë për këto nuk tërhoqa vëmendjen e organizatave-bazë për të mos e harruar këtë rrezik, duket edhe unë e nënvleftësova, gjë që çoi në rënien përsëri në gabime të tilla».

Siç po e shohim, ky «teoricien i madh», ky «shef mbi Partinë, jashtë sferës dhe ndikimit të Partisë», që nuk dëgjon as të konfondohej, as ta zërë në gojë Partinë, «ka menduar dhe mendon» dhe «jep vijën» e për këtë «vijë të tij» Partia në rreth ka punuar dobët, organizatat-bazë dhe institucionet po ashtu. Shefi «nuk munda të krijojë gjithmonë marrëdhënie normale në mes të gjithë krijuesve, të krijojë edhe atë të ashtuquajtur ambient artistik etj.». Të gjithëve ne që kemi zhvilluar luftën kundër elementëve antiparti, na kujtohet «Teoria e shefit të partisë» e Sejfulla Malëshovës, Koçi Xoxes e të tjerëve, në Plenumin e Beratit, me të cilën goditnin vijën e Partisë dhe udhëheqjen e saj. Ky fenomen ngjet dhe me Fadil Paçramin dhe këtu është qëllimi. Na kujtohet arroganca dhe mendjemadhësia e Sejfulla Malëshovës. Këto tipare antiparti i gjejmë te Fadil Paçrami.



«E kam quajtur veten me koncepte të formuara, kjo është e vërtetë», thotë Fadil Paçrami në autokritikën e tij. Dhe ne i themi atij se e besojmë, se për çka mendonte, konceptet e tij ishin të formuara. Konceptet e Fadil Paçramit nuk ishin vetëm liberale e moderniste, por ato janë më parë koncepte antiparti e revizioniste në ideologji, në politikë, në kulturë e në art, në çështjet organizative dhe në veprimtarinë praktike. Konceptet e formuara kishin edhe objektivat e caktuar.

Për revizionistët Fadil Paçrami e Todi Lubonja, Partia e Punës e Shqipërisë ishte një parti e burokratizuar, një parti dogmatike, konservatore, staliniste. Prandaj objektivi i tyre megaloman ishte t'i ndërronin asaj kursin. Po si? Duke luftuar me maskën legale për shtrembërimin e vijës. Konceptet e tyre antiparti dhe antiproletare i çuan ata të zgjidhnin bazën e nisjes së veprimtarisë së tyre në kulturë dhe në arte, pse menduan me mendjelehtësi prej reaksionari se atje do të ishte pika e dobët e Partisë dhe e favorshme për ta.

Ata menduan po ashtu se në veprimet e tyre antiparti do të gjenin mbështetje në rini, të cilën, sipas tyre, do të mundnin ta vinin në kundërshtim me Partinë. Këto pikëpamje të gabuara janë të vjetra. Edhe Nako Spiru i ka shprehur këto në kohën e tij dhe Partia ia ka luftuar. Këto pikëpamje jo vetëm vijnë si remineshencë të këta dy njerëz, por janë edhe influenca të drejtpërdrejta të punës më të keqe kundërrevolucionare që bëjnë borgjezia dhe reaksioni me rininë në vendet kapitaliste dhe revizioniste. Nga këto pozita dhe nga ky terren këta filluan të goditnin vijën e drejtë të Partisë. «S'ka këtu, — thotë Fadil Paçrami, — çështje

brezash të rinj e të vjetër». Pikërisht këtu është një nga drejtimet kryesore të luftës së tyre: Çarja e këtij uniteti të madh, të kalitur me gjak e me djersë brez pas brezi nga populli ynë kundër armiqve të tij të jashtëm e të brendshëm, që e kurorëzoi Partia jonë heroike me Luftën Nacionalçlirimtare, me revolucionin popullor, me ndërtimin e socializmit, me revolucionarizimin e vazhdueshëm të jetës së vendit e të njerëzve, në luftë me ndikimet mikroborgjeze, revizioniste, kapitaliste.

Nuk është ashtu, siç duan të maskohen këta elementë antiparti, se gjoja padashur kanë gabuar kundër disa shkrimtarëve ose artistëve të kohëve para vitit 1960. Jo, kjo është një gënjeshtëri. Këta elementë kanë qenë kundër së kaluarës së shkëlqyer të popullit tonë, kundër patriotizmit të zjarrtë të tij të çdo periudhe të historisë, këta mohonin dhe urrenin kulturën e lashtë të popullit tonë, doket dhe zakonet e mrekullueshme përparimtare, ata mohonin dhe urrenin këngët, muzikën, folklorin e tij, i quanin këta «gangrenë» e muzikës që ata donin të restauronin në atdheun tonë socialist. Këta ishin kozmopolitë nga më të degjeneruarit.

Njerëzit thonë nëpër organizata: «Fadil Paçrami thoshte: me Skënderbeun jemi deri në fytyrë». Disa shokë që diskutuan sollën këtu të tjera fakte në këtë drejtim. Atij nuk i pëlqenin dramat për Bajram Currin, «Fisheku në pajë» e shumë të tilla, që i kualifikonin me përbuzje «Teatri Bogdani». Për Fadil Paçramin dhe për ndonjë regjisor servil, që e quante Fadilin «dramaturgu më i madh që ka parë Shqipëria», kishte vlerë vetëm drama «Shtëpia në bulevard», ku bëhet fjalë për një vajzë që mbetet me barrë, ose drama tjetër «Një ngjarje

në fabrikë», ku gazetari, si në Perëndim, bëhet gjykatësi i vijës së Partisë dhe i njerëzve dhe nuk vihet Partia në vendin e vet udhëheqës, edukues dhe këshillues. Sipas Fadil Paçramit dhe ndonjë tjetri, ishin këta që po krijonin teatrin me të vërtetë «modern» me tërë kuptimin perëndimor të fjalës.

Por le t'i lëmë mënjanë dramat e tij pa asnjë vlerë dhe të shohim problemet më tej.

Sa e drejtë ka qenë vija e Partisë sonë në ruajtjen e pasurisë së madhe të popullit dhe të atdheut, e asaj pasurie të madhe shpirtërore që e ka mbajtur gjallë kombin tonë, në stuhi e në furtuna. Sa drejt kanë luftuar Partia dhe njerëzit e artit e të kulturës sonë popullore për të spastruar ferrat që mbytnin këtë kopsht kaq të lulëzuar dhe e nxorën në dritë dhe në bazën e saj, duke ndjekur traditën e bukur, krijuan vazhdimin e natyrshëm të saj, kulturën e një vendi socialist, të mbështetur fort në truallin dhe në gurrën kombëtare, i ruajtën asaj format e bukura dhe i zbukuruan përmbajtjen, i dhanë përmbajtjen socialiste, revolucionare. Ata ia zhvilluan këtë përmbajtje revolucionare, pse kjo përmbajtje revolucionare nuk na ra as nga qielli, as na u soll me valixhe nga jashtë, por e trashëguam nga të parët tanë. Leninizmi dhe Partia jonë na mësojnë të mbështetemi fort këtu, pse këtu i kanë bazat revolucionari dhe socializmi, në popull, në klasën punëtore.

Ne jemi marksistë dhe zhvillimin e shohim nën prizmin e materializmit historik. Partia, klasa, populli, rinia, gruaja, ushtria, shkrimtarët, artistët, mësuesit e profesorët, në një unitet të çeliktë rreth Partisë dhe nën drejtimin e saj, e ndërtuan me gjak, me djersë,

me mundime e me sakrifica, në mes të një entuziazmi të papërshkruar dhe të pashuar kurrë, këtë ndërtesë kaq të bukur, kurse disa plehra revizioniste na dalin të predikojnë që të kaluarën ta braktisim, themelet duhet t'i hedhim në erë, pse ajo na qenka anakronike, është konservatore, nuk e do rinia. «S'duhet më të shkruajmë e të krijojmë vepra që të entuziazmojnë, duhet flakur tej çdo gjë që ngjall emocione ose ndjenja patriotike, modernia nuk i duron këto», thonë këto plehra dhe «modernët jemi ne, ne jemi avangarda» e atij revolucionari që predikojnë plehtrat revizioniste dhe kapitalisto-trockiste të Moskës, të rrugëve të Parisit, të Bonit, të Romës e të Beogradit.

Fadil Paçrami në të ashtuquajturën autokritikë të tij thotë «të ndalemi ca në çështjen e vitit 60-të e tëhu» dhe kërkon të na shpjegojë se si ky «revolucionar i madh» mori pjesë «me të madhe» në luftën e revolucionarizimit dhe veçanërisht të letërsisë dhe të arteve. Kjo i përngjet përrallës së mizës dhe të buajve që tërhiqnin qerren e ngarkuar plot në një rrugë të përpjetë. Ngritja e çdo gjëje në një nivel më të lartë, po ashtu edhe në letërsi dhe në artet, janë vepra të Partisë e të punonjësve dhe jo të atyre që bëjnë zhurmë si miza, që pickojnë dhe sabotojnë. Në çdo periudhë të jetës sonë ka pasur ngritje, ka pasur përparim, ka pasur progres. Kjo është karakteristika revolucionare e gjithë zhvillimit tonë. Të moshuarit revolucionarë dhe krijues janë të lumtur dhe ky është objektivi i tyre i jetës, t'i shërbejnë me të gjitha forcat atdheut e popullit dhe të ndihmojnë, të nxitin dhe të inkurajojnë brezin e ri që të afirmohet, të krijojë, të marrë stafetën, të vazhdojë

dhe të zhvillojë traditën revolucionare më me shkëlqim. Përse vallë Fadil Paçrami po përpiqet të na shpjegojë periudhën pas viteve 60-të që për ne e për të gjithë është e qartë? Apo pse pas vitit 60-të ai filloi të shkruajë «dramat e tij të famshme»? Gjepura!

Dihet historikisht se viti 1960 ishte fillimi i luftës së hapët frontale heroike të Partisë sonë kundër revizionizmit modern sovjetik dhe botëror, ishte lufta për jetë a për vdekje e Partisë dhe e popullit tonë trim kundër bllokadës revizionisto-kapitaliste.

Këtu fillon edhe starti juaj, Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja, veç jo në rrugën revolucionare të Partisë, por në rrugën kundërrevolucionare, antiparti, revizioniste. Faktet këtë tregojnë. Ju më kot doni të humbitni gjurmët e dhive të zgjebosura në këtë det të madh revolucionar që ka shpërthyer në vendin tonë; ju nuk mund të identifikoheni dot me rininë tonë heroike që ju përbuz, pse me pikëpamjet dhe veprimet tuaja përpqeshit ta degjeneroni moralisht, ideologjikisht dhe fizikisht. Ju nuk mund të identifikoheni me njësitet e mëdha e të çeliktat të shkrimtarëve, poetëve, kompozitorëve, këngëtarëve e artistëve popullorë të talentuar, të vjetër e të rinj nga mosha, pse ata ju urrejnë ju dhe shokët tuaj si ju, pa vlerë, intrigantë, ngatërrestarë, rrufjanë politikë, përkrahës të rrymave dekadente borgjezo-revizioniste në letërsi e në art dhe armiq të betuar të artit tonë të realizmit socialist.

Ata kurrë nuk ju kanë dashur, pse ju keni qenë me dy faqe, arrogantë, disave u jeni imponuar nën maskën e autoritetit të Partisë dhe ata ju kanë duruar për një kohë, disa i keni kërcënuar po me këtë autoritet.

dhe kjo formon faj dhe krim kundër Partisë, disa të tjerë janë gabuar, pse kanë qenë naivë, politikisht të pangritur, s'arrinin dot të dallonin hiletë tuaja revizioniste. Ju mblodhët rreth vetes disa servilë, disa të degjeneruar, për të cilët Fadil Paçramit i vjen keq që i mori në qafë, kurse në të vërtetë ata Fadilin dhe Todin kërkonin, dhe këta po në kërkim të të tillë njerëzve ishin, se vetëm një brumë i tillë mund të gatonte një bukë të tillë të mykur.

Lufta e Partisë, cdukata e saj dhe durimi që ka treguar ajo vazhdimisht për anëtarin e saj, Todi Lubonjën, nuk bëri efekt tek ai. Todi Lubonja mbeti një mikroborgjez me të gjitha karakteristikat meskine të njerëzve me këtë origjinë, që nga zemërvogëlsia dhe lufta e përpjekjet që bënte ai si për të përfituar favore dhe poste të rehatshme dhe deri tek arroganca e megalomania për «vlerat e mëdha» të vetvetes.

Për të, ashtu si edhe për Fadil Paçramin, vija e Partisë dhe horizontet që hapte ajo ishin të ngushta. Për «mendjet e tyre të mëdha» duheshin hapur të tjera perspektiva «të çlirëta, të gjera, pa fund, liberale, moderniste» në çdo gjë. Kur e dërgonte Partia për të punuar jashtë Tiranës, Todi Lubonja nuk shkonte pa shfaqur më parë pakënaqësi, pa kërkuar vende të preferuara. Dhe duhet thënë se atij asnjëherë nuk i është bërë as më e vogla padrejtësi. Duhet thënë, gjithashtu, se ky bënte përjashtim nga gjithë shokët e tjerë të udhëheqjes, të cilët kanë shkuar në çdo moment me entuziazëm atje ku e donte puna e Partisë.

Kudo ku niste nga puna, që ditën e parë hapi filestar që do të bënte Todi Lubonja ishte përmbysja,

«reforma», siç i quante ai në rrugën moderniste, siç u përpoq të bënte edhe në «Zërin e popullit». Todi Lubonja që e trumbetonte veten «përkrahës të së resë», luftën kundër konservatorizmit, luftën kundër skllavërimit të gruas nga zakonet dhe kanunet prapanike etj., si dhe fjalimet direktivë për këto çështje, duke qenë kryeredaktor i «Zërit të popullit», ai i linte në harresë. E kemi kritikuar rëndë për këto qëndrime, por rrjedha e kohës tregoi se ai nuk ka qenë dakord me vijën e Partisë.

Të njëjtën gjë ka bërë Todi Lubonja në Korçë, ku grumbulloi njerëz të deklasuara në art, si njëfarë Minush Jero e Mihallaq Luarasi. Këtë të fundit ai e kurorëzoi në Radiotelevizion, ku bëri «spastrimin», solli njerëz të degjeneruar, mënjanoi organizatën-bazë, rregulloi dhe manipuloi programet, në të cilat filluan të dominonin xhazi, këngët e dashurisë, format dhe mënyrat dekadente të artit borgjez perëndimor. Ai arriti deri atje sa Radiotelevizionin ta konsideronte domenin e tij, fushën e veprimit të ideve të tij revizioniste dhe me përbuzje arrogante s'pranonte as vërejtje dhe as kritika. Mbi të gjitha, ky njeri bosh e pa asnjë vlerë, duke u fshehur nën petkun e udhëheqësit dhe si ish-udhëheqës i rinisë, na hiqej sikur ishte një autoritet në materie, sikur mishëronte dëshirat dhe aspiratat e rinisë.

E tillë është konsiderata e Todi Lubonjës për Partinë, për vijën e saj, për Komitetin Qendror të Partisë, saqë autokritika e tij në organizatën-bazë s'ka qenë aspak e mirë, ndërsa as që i shkoi ndër mend t'i drejtonte një autokritikë Komitetit Qendror, ku të analizonte fajet e tij të rënda. Ju e dëgjuat autokritikën false

që ai bëri këtu, me një ton pompoz, por që u bë pluhur e hi nga diskutimet e zjarra të anëtarëve të Plenumit të Komitetit Qendror.

Siç shihet, Todi dhe Fadili kanë qenë në një rrugë antiparti, kanë pasur të njëjtat qëllime, kanë pasur të njëjtat mendime dhe kanë përdorur të njëjtat metoda pune.

Por jo, Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja, ju nuk mund ta vazhdonit gjatë punën tuaj antiparti, revizioniste. Kjo do të mbaronte pa lavdi për ju. Pse vazhdoi dhe kaq, mund të thotë me të drejtë Partia, pse s'u morën masa më parë kundër jush? Partia ka të drejtë të na kritikojë ne, që u treguam më tepër të durueshëm nga sa duhej me ju, që, duke jua vënë vazhdimisht në dukje gabimet, shkonim me shpresë se do të ndreqeshit, e tepruam me këshilla përpara kryeneçësisë suaj për të ecur nga gabimi në gabim. Por ne i themi Partisë se këta nuk i kemi lejuar të livadhitnin si të donin. Në çdo veprimtari të tyre këta i pritnin pritën e Partisë. Është e vërtetë se disa herë u gjendën në befasi organizatat-bazë, ku ata dhe disa njerëz të tyre vepronin në kundërshtim me vijën e Partisë. Fadili dhe Todi kanë përdorur edhe mashtrimin, edhe mohimin, si rrufjanë të vërtetë politikë, për të vënë në gjumë për një kohë disa organizata-bazë dhe disa kolektiva, deri edhe Komitetin e Partisë të Rrethit të Tiranës. Por hileja ka dalë sheshit, gënjeshtër i ka kurdoherë këmbët e shkurtra.

Ja, ju kaluat nga e gjithë shosha e Partisë dhe mbërritët deri këtu, në instancën e lartë të saj, në Ko-



mitetin Qendror, i cili gjykoi veprimtarinë tuaj. Ç'tha Partia për ju? Ju dënoi njëzëri me të drejtë, me ndër-gjegje të plotë dhe të pastër, në bazë të fakteve që vërtetojnë veprimtarinë tuaj. Ju ju gjykuan drejt, realisht dhe drejtësisht masat punonjëse. Partia ka pasur parasysh edhe të kaluarën tuaj, kurdoherë drejtësisht ju ka çmuar dhe me ndër-gjegje ju ka dhënë dorën, është përpjekur ajo dhe ne udhëheqja e saj që t'ju korrigjonim, po ju s'keni dashur, ju e keni përbuzur Partinë, udhëheqjen dhe ndihmën e tyre. Ju keni menduar se jeni «njerëz të mëdhenj», «njerëz të paprekshëm», «udhëheqës të një Shqipërie të re të ardhshme dhe të një partie tjetër», që ëndërronit. Ju edhe tani, përpara këtij gjykimi të drejtë dhe dënimeve të merituarra që u bëjmë veprimeve tuaja armiqësore, në veten tuaj thoni «s'ka gjë, ne jemi përsëri njerëzit e shquar të një të ardhmeje, për ne do të flasë Perëndimi, do të flasë Beogradi, do të flasë Moska», siç flet për Liri Belishovën dhe plehra të tjera. Kjo është e vërtetë, pse ju jeni të tyret, ideologjikisht dhe politikisht, ndërsa për Partinë tonë ju jeni komplotistë dhe, duke menduar se vendi ynë dhe Partia ishin në krizë për arsye të rrethimit kapitalisto-revizionist, ju aktivizuat veprimet tuaja armiqësore. Nesër mendonit se do të dilnit si shpëtimtarë të situatës. Ju, si elementët antiparti që përmenda në fillim, nuk u maskuat me parulla mëngjarrashe, por gjykuat se rrethanat ndërkombëtare kërkonin që të punonit dhe të dilnit me parulla të djathta. Vigjilenca e Partisë jua shkatërroi planet dhe ëndrrat.

Por ne ju themi se ju jeni lecka, ju nuk jeni asgjë,

jeni dhe do të jeni kufoma politike dhe ideologjike pa as më të voglën e vlerës. Ne ju këshillojmë të njihni thellësisht gabimet tuaja të mëdha dhe të rrezikshme. Duhet të spastroni kokën dhe ndërgjegjen nga shumë gjëra të këqija që kanë zënë rrënjë te ju, të ulni kokën në punë dhe në punë të spastroheni, të bëheni njerëz të rinj. Ëndërrimet e sëmura nuk e shërojnë njeriun, përkundrazi ato e sëmurin më shumë. Ne ju themi se konvaleshenca juaj do të jetë e gjatë, duhet të ndihmoni veten që t'ju ndihmojë Partia. Kjo nuk ka mundësi t'ju ndihmojë dhe mos harroni se ju e keni përbuzur dhe shqelmuar ndihmën e saj. Partia kurrë s'ka qenë dhe nuk do të jetë hakmarrëse ndaj atyre që gabojnë qoftë edhe rëndë, siç gabuat ju, por dijeni se Partia nuk e ka zakon t'ju fërkojë krahët, ajo do t'ju godasë akoma më ashpër, në rast se do të vazhdoni në gabimet tuaja.

Duke marrë parasysh gabimet e rënda në vijën e Partisë të Fadil Paçramit dhe të Todi Lubonjës; duke marrë parasysh se këto gabime të tyre të shumta u vërtetuan plotësisht me fakte në diskutime të hapëta dhe të bazuara nga e gjithë Partia, nga baza dhe deri në Komitetin Qendror; duke marrë parasysh se të dy këta nuk e kanë vlerësuar, përkundrazi e kanë përbuzur ndihmën e madhe e të vazhdueshme që u ka dhënë Partia për një kohë të gjatë, me qëllim që t'i ndreqnin gabimet e tyre dhe të korrigjoheshin; duke marrë parasysh se qëndrimet e tyre antiparti, si në teori dhe në praktikë, kanë dëmtuar Partinë, shtetin dhe ndërtimin

e socializmit dhe se për këto faje të rënda të tyre këta të dy bënë një autokritikë shumë të cekët, false dhe formale, unë propozoj, si të gjithë ju, që Fadil Paçrami dhe Todi Lubonja të përjashtohen nga Partia si anëtarë të saj, të përjashtohen nga Komiteti Qendror si anëtarë të këtij forumi të lartë udhëheqës të Partisë, të përjashtohen, gjithashtu, nga të gjitha funksionet e tjera udhëheqëse në shtet<sup>1</sup>.

Agim Mero bëri autokritikë për gabimet e tij të rënda. Ne gëzohemi kur një shok njuh sinqerisht gabimet, qofshin këto edhe të rënda, pse kështu ekzistojnë garancitë për Partinë që ai të ndreqet. Partia dhe udhëheqja e saj e ndihmuan dhe do ta ndihmojnë që ai të ecë drejt paskëtaj, duke mos harruar parimin e drejtë se autokritika nuk është kurrë e mjaftë, qoftë ajo dhe shumë e mirë, në rast se në punë, në luftë, në jetë, nuk vërtetohet me vepra, me aksione, me qëndrime.

Në dritën e gabimeve të Agim Meros unë i propozoj Plenumit që, për gabimet e tij, Agim Meros t'i jepet si dënim: të zbritet nga anëtar në kandidat<sup>2</sup> i Plenumit të Komitetit Qendror.

Përveç kësaj ne do të mbajmë parasysh edhe disa propozime që u bënë këtu në lidhje me funksionet e tij shtetërore aktuale.

*Propozimi u vu në votë dhe u miratua njëzëri.*

Atëherë, shokë dhe shoqe, me kaq mbaruam, ju

---

1. Më vonë, Fadil Paçrami e Todi Lubonja, për veprimtari armiqësore, morën dënimin e merituar nga gjykata popullore.

2. Shih në këtë vëllim shënimin e faqes 327.

uroj shëndet dhe punë të mbarë për triumfin e ideve të Partisë!

Rroftë Partia!

*Botuar për herë të parë  
në librin: Enver Hoxha,  
«Raporte e fjalime 1972-  
-1973», f. 286*

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

## MARRËVESHJET E REJA SOVJETO-AMERIKANE — NJË SFIDË E RËNDË PËR TË GJITHË POPUJT

*Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit»*

29 qershor 1973

Amerikanët janë të njohur për prirjen që kanë për të vendosur rekorde për çdo gjë, rekorde se kush mund të hajë më shumë, se kush mund të flasë më gjatë, ose se kush do të thotë gënjeshtren më të madhe. Shtypi dhe statistikat i regjistrojnë të gjitha rekordet e arritura, si ato që kanë të bëjnë me industrinë, me vrapiet e kuajve ose me burrat e ndarë të yjeve të Holli-vudit. Në sajë të këtyre zakoneve të çuditshme amerikane, bota mori vesh tani edhe rekordet e vendosura nga presidenti i Shteteve të Bashkuara dhe sekretari i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik gjatë një jave bisedimesh kokë më kokë. Kështu u bë e ditur se presidenti amerikan s'ka udhëtuar kurrë 4 000 km së bashku me një udhëheqës të huaj, s'ka pritur deri më sot asnjë burrë shteti joamerikan në rezidencën e tij kaliforniane, s'ka nënshkruar kurrë kaq shumë marrëveshje brenda disa ditëve etj. Po kështu, afaristëve amerikanë

nuk u ka ndodhur kurrë që një përfaqësues kaq i lartë i një vendi të huaj t'i lutë aq tepër për të investuar kapitalet e tyre në vendin e vet.

Por ajo që kronistët amerikanë nuk e thanë është se vizita e Brezhnjev-it në Shtetet e Bashkuara të Amerikës vendosi edhe një rekord të ri, rekordin e hipokrizisë, të cinizmit politik, të demagogjisë dhe të mashtrimit të paskrupull, rekordin e intrigave e të kompleteve në të tilla përpjesëtime që nuk lënë kontinent e rajon të botës pa prekur.

Sfida që imperializmi amerikan dhe socialimperializmi sovjetik u bëjnë popujve të botës është tepër e madhe dhe jashtëzakonisht revoltuese. Krerët e të dyja superfuqive përpiqen që arbitraritetin e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare ta bëjnë ligj, që diktati i tyre politik të pranohet nga të tjerët si një urdhër suprem, që çështjet botërore të zgjidhen e të vendosen në Uashington e në Moskë. Marrëveshjet që u përfunduan në takimin e fundit Brezhnev-Nikson, si dhe ato që mbahen akoma sekrete, janë një shprehje tjetër e synimeve të superfuqive, të cilat kërkojnë që me kthetrat e tyre të mbytin çdo gjë revolucionare e përparimtare në botë, të pushtojnë e të sundojnë mbi të gjitha vendet.

Tani Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik kërkojnë t'ia njohin edhe publikisht të drejtën vetes, siç është shkruar në një nga nenet e marrëveshjes së ashtuquajtur mbi ndalimin e luftës bërthamore, të mbytin çdo revolucion, luftë çlirimtare ose kryengritje popullore që, sipas gjykimit të të dyja superfuqive, rrezikon qetësinë e tyre. Pikërisht neni 4 i marrëveshjes në fjalë kërkon që qeveritë amerikane e

sovjetike të konsultohen dhe të ndërmarrin një veprim të përbashkët e të kombinuar sa herë që ato do të mendojnë se ky ose ai veprim i ndonjë vendi tjetër, këto ose ato marrëdhënie midis vendeve të tjera kanë arritur në atë shkallë sa të paraqesin rrezik për një konflikt bërthamor ose të një lloji tjetër. E përkthyer në gjuhën e zakonshme të njerëzve, kjo do të thotë se të dyja superfuqitë do të konsultohen dhe do të marrin masa të përbashkëta për të ndërhyrë kudo ku rrezikohen pushteti dhe dominimi i tyre, kudo ku preken interesat e tyre imperialistë.

Një kanunizim i tillë i arbitraritetit ndërkombëtar mund të krahasohet vetëm me «aleancën e shenjtë» të perandorëve feudalë të Evropës së fillimit të shekullit të kaluar. Traktati i ri sovjeto-amerikan, të cilin me qëllim demagogjic dhe mashtrimi e pagëzuan «marrëveshje për ndalimin e luftës bërthamore», do të mbetet në analet e marrëdhënieve botërore si një përpjekje e egër dhe djallëzore për ta ngritur ndërhyrjen në punët e brendshme të shteteve të tjera në normë të së drejtës ndërkombëtare dhe që marrjen nëpër këmbë të të drejtave të të tjerëve ta quajnë virtyt të sjelljes ndërkombëtare.

Por sado që autorët e këtij traktati të përpiqen për ta kallajisur këtë produkt të shëmtuar të politikës së tyre agresive e hegjemoniste, ata nuk do të mund t'ua mbushin kurrë mendjen të tjerëve se marrëveshja e re bërthamore sovjeto-amerikane u shërbeka forcimit të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Në të gjitha marrëveshjet që u përfunduan tani së fundi midis revizionistëve sovjetikë dhe imperialistëve amerikanë, ata tre-

gohen agresivë, arrogantë dhe arbitrare në të gjitha drejtimet, kundër popujve dhe kundër partnerëve të vet. Ata jo vetëm që nuk bëjnë ndonjë çarmatim, por ruajnë gjithë arsenalin e tyre luftarak, dhe, me anë të tij, mendojnë të shtypin çdo kundërshtar të diktatit të tyre.

Udhëheqësit e Shteteve të Bashkuara dhe të Bashkimit Sovjetik, pa i vrarë fare ndërgjegjja, deklarojnë se marrëveshjet e përfunduara midis tyre kanë për qëllim të ndalojnë lindjen e krizave ndërkombëtare, të shmangin konfrontimet ushtarake, të evitojnë krijimin e situatave që acarojnë marrëdhëniet midis shteteve, të pakësojnë rrezikun e luftës etj. Por pyetja që bëhet sot është po ajo që është bërë dje dhe pardje. Kush e kërcënon paqen botërore, kush i shkakton krizat, kush përgatitet për luftë e agresione? Dhe përgjigjja është po e njëjta: këta janë imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë. Janë ata që mbajnë nën sundimin e tyre zona të tëra influence dhe kërkojnë të tjera, janë ata që zhvillojnë me tërbim garën e armatimeve dhe kërcënojnë me shantazh atomik popujt e tërë botës, janë ata që mbajnë baza ushtarake në vendet e huaja dhe kanë mbushur detet e qiejt me anije e aeroplanë luftime, janë ata që u imponojnë popujve neokolonializmin dhe i shfrytëzojnë ekonomikisht. Lista e zezë e politikës së tyre agresive, e kompleteve dhe e intrigave të tyre nuk ka fund. Mos vallë pse mungonte një traktat si ky i përfunduar tani Shtetet e Bashkuara të Amerikës shpërthyen luftën në Kore dhe ndezën agresionin në Vietnam, ndërhyjnë në Kubë dhe dërguan ushtritë e tyre në Santo-Domingo, ndërsyen Izraelin



kundër arabëve dhe mbytën revolucionin në Kongo? Mos vallë tanket sovjetike hynë në Pragë dhe provokacionet e armatosura në kufirin me Kinën u bënë ngaqë të dyja superfuqitë atëherë nuk ishin bindur akoma se duhej «forcuar paqja» e u bindën tani për këtë?

Si me marrëveshje, ashtu edhe pa marrëveshje, politika dhe synimet agresive dhe ekspansioniste të të dyja superfuqive, që rrjedhin nga vetë sistemi i tyre, mbeten të pandryshuara. E re këtu është se ato tani synojnë të vendosin së bashku një diktaturë kundërrivolucionare ndërkombëtare, se kërkojnë të gjejnë së bashku çdo revoltë popullore dhe qëndrim revolucionar të popujve për të marrë pushtetin nga ata ose nga sateletët e tyre, se, nën pretekstin e rrezikut të paqes, duan të marrin përsipër të ndërhyjnë për të shuar flakët e revolucionit kudo që të shpërthejnë.

Imperialistët amerikanë dhe socialimperialistët sovjetikë krijuan edhe një lloj aparati të posaçëm për hartimin e kësaj politike të përbashkët reaksionare dhe për administrimin e përbashkët të punëve botërore. Ata vendosën të krijojnë njëfarë dyarkie, që do të gjejë zbatimin praktik në takimet e herëpashershme të presidentit të SHBA-së dhe të sekretarit të përgjithshëm të PK të BS. Sipas tyre, do të jenë pikërisht këto mbledhje që do të bëjnë bilancin e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe do të caktojnë fushat e reja ku do të drejtohet në të ardhmen veprimi i dy superfuqive.

Nga kryeqyteti amerikan, që përfaqëson qendrën e reaksionit të hapët antikomunist, qendrën e imperializmit më të egër e më barbar që ka njohur njerëzimi, Brezhnjevi, që mban titullin e sekretarit të Partisë

Komuniste të Bashkimit Sovjetik, bëri thirrje që «të thyejmë me guxim atë që është pengesë dhe të vjetrën, të ecim përpara në rrugën e forcimit të paqes, të uljes së tensionit, të zhvillimit të bashkëpunimit». Por ai nuk tha asgjë në ka ose jo në këlë botë luftë të klasave, në ka popuj që luftojnë akoma për lirinë e pavarësinë, në ka aspirata e përpjekje revolucionare të punonjësve të vendeve të ndryshme, në ka kolonializëm e shfrytëzim. Ai nuk foli për këto, pasi për të revolucionin, socializmin, liria e pavarësia kombëtare i përkasin gjoja asaj kohe kur njerëzit kishin qenë «skllëvër të tendencave të vjetra».

Lëvizjet revolucionare të popujve për liri e demokraci, solidariteti internacionalist i klasës punëtore janë në kundërshtim me interesat imperialistë të të dy super të mëdhenjve, të cilët do t'i shtypin me forcë në bazë të marrëveshjeve të përfunduara. Ajo që u intereson tani revizionistëve sovjetikë është ulja e tensionit me rivalët e tyre amerikanë dhe angazhimi reciprok për të mos ndërhyrë në zonat e veta të influencës, evitimi midis tyre i fërkimeve e i konflikteve. Ata duan të krijojnë një ekuilibër të tillë që bota të rrijë urtë dhe sundimi i tyre të mos tronditet nga asgjë.

Këtë politikë dhe këtë tendencë e treguan edhe marrëveshjet e reja midis dy superfuqive, të cilat, në çështjen e ndarjes së zonave të influencës, i lanë dorë të lirë njëra-tjetrës të veprojnë me efikasitet në zonat e veta, që të mos prishet ekuilibri i vendosur. Një shembull i qartë në këtë drejtim është Lindja e Mesme. Kjo zonë është e mbarsur me luftëra revolucionare. Një situatë e tillë është e rrezikshme për të dyja superfuqitë, të cilat, nga njëra anë, kanë vendosur influencat e

tyre dhe, nga ana tjetër, interesat e vet përpiqen t'i mbrojnë me çdo kusht. Kështu ato tani nuk lejojnë që arabët të rivendikojnë tokat e grabitura nga Izraeli nën pretekstin se gjoja një gjë e tillë do të shkaktonte një luftë botërore. Për këtë arsye gjendja «as luftë, as paqe» u rikonfirmua edhe në takimet e fundit Brezhnev-Nikson. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për zonat e tjera.

Por popujt arabë i kuptojnë komplotet që thurin armiqtë e tyre dhe nuk do ta durojnë këtë diktat të imperialistëve e të socialimperialistëve.

Duke komentuar qëndrimin antiarab të mbajtur nga Brezhnevi e Niksoni dhe që del i qartë edhe nga leximi i komunikatës përfundimtare sovjeto-amerikane, atje ku ajo prek problemin e Lindjes së Mesme, gazeta kryesore egjiptiane «Al Ahram» në kryeartikullin e saj të djeshëm shkruan: «Në qoftë se Amerika do të ishte me të vërtetë e shqetësuar, ajo do të kishte mundur të ndalonte atë mori armësh, që i dërgohen Izraelit, me qëllim që t'i japë fund politikës agresive të këtij shteti. Gjithashtu BRSS, po të ishte, edhe ai, i shqetësuar, do të kishte mundur të përfitonte në fushën politike nga ky afrim dhe do të kishte mundur t'i bindte Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Por, — vazhdon gazeta, — politika ndërkombëtare na ka mësuar se interesi personal del mbi parimet», «BRSS nuk është dakord me pikëpamjen egjiptiane, sipas së cilës çlirimi i territoreve të pushtuara nuk mund të realizohet pa përdorur forcën e armatosur. Bashkimi Sovjetik nuk e konsideron krizën në Lindjen e Mesme si një nga problemet më të rëndësishme dhe nuk dëshiron që politika e tij e mirëkuptimit me SHBA-në të priset për shkak të Lindjes

së Mesme», shkruan gazeta tjetër egjiptiane «Al Akh-bar». Në këtë frymë shkruan gati i tërë shtypi i vendeve të ndryshme arabe. Kundërshtimi i botës arabe ndaj qëndrimit që mbajtën Brezhnjevi e Niksoni rreth konfliktit të Lindjes së Mesme është një dëshmi tjetër që vërteton se popujt arabë po bëhen përditë e më të ndërgjegjshëm, se të dyja superfuqitë, me qëllim që të ruajnë interesat e vet imperialistë, përkrahin Izraelin kundër arabëve, se çështja e tyre e madhe dhe e drejtë kombëtare mund të përparojë e të fitojë në qoftë se ata e marrin tërësisht në duart e tyre dhe luftojnë për realizimin e saj me të gjitha forcat e deri në fund.

Marrëveshjet e reja sovjeto-amerikane janë pritur me mosbesim dhe me një shqetësim të pamaskuar edhe nga aleatët e të dyja superfuqive, të cilët e ndiejnë se tani po u preken edhe interesat e tyre më jetikë. Marrëveshjet i njohin të drejtën e plotë imperializmit amerikan të vendosë rregullin në gjirin e aleancave të tij ushtarake, kur ai e konsideron se nuk është zbatuar vullneti i tij. Po kështu, nëse një shtet i favorizuar nga imperializmi amerikan bëhet kërcënues i interesave të pjesëtarëve të tjerë të NATO-s, i kërcënuari nuk ka të drejtë dhe nuk duhet të kundërshtojë.

Po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për pjesëtarët e Traktatit të Varshavës. Zëdhënësit zyrtarë sovjetikë e bënë të qartë edhe tani, gjatë nënshkrimit të marrëveshjeve me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, se doktrina Brezhnjevi mbi «sovrانيتetin e kufizuar» do të zbatohet ashtu si deri më sot, pa asnjë zbutje dhe pa asnjë lëshim, edhe në të ardhmen.

Vizita e Brezhnjevit në Amerikë ishte një dëshmi

e re e faktit se sa janë larguar revizionistët sovjetikë nga marksizëm-leninizmi, sa i kanë tradhtuar ata çështjen e Revolucionit të Tetorit dhe veprën e Leninit e të Stalinit, sa poshtë e kanë ulur ata autoritetin dhe respektin që kishte dikur në botë Bashkimi Sovjetik, si vendi i parë i socializmit, sa rëndë i kanë goditur prestigjin dhe emrin e lartë të popujve sovjetikë. Përshtypja dhe bindja që krijoi sekretari i Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në Amerikë, bile edhe midis ultrareaksionarëve e antikomunistëve, ishte se opinioni publik amerikan u gjend përpara një biznesmeni të vërtetë që ishte aq larg komunizmit sa janë edhe drejtuesit e bankave të Nju-Jorkut ose mbretërit e naftës të Teksasit. Dhe me të vërtetë kush mund të besonte, ashtu siç njoftonte një agjenci amerikane, se «do të mund të ndodhte që, ndërsa flamujt e kuq të valëviteshin në sheshin Pensilvania, udhëheqësi i shtetit gjigant komunist do të bisedonte në një dhomë të mbushur me kapitalistë milionerë»? Shtypi amerikan vuri re me mjaft kënaqësi se gjatë gjithë fjalimeve të tij të gjata, dollive e intervistave me gazetarë, Brezhnjevi nuk përdori atë që ai e quan «terminologji komuniste», nuk tha asnjë fjalë që mund t'i referohej socializmit ose marksizmit. Këtë «zbutje të gjuhës së sovjetikëve» ose «mungesë të retorikës komuniste», siç e quajti Roxhersi, në Amerikë e përshëndetën si një dëshmi të re të shkëputjes përfundimtare të udhëheqësve të Kremlinit nga e kaluara revolucionare e socialiste e Bashkimit Sovjetik.

Edhe të vetmen herë që Brezhnjevi zuri në gojë emrin e Leninit ishte për ta paraqitur atë sikur ai pas-kësh hedhur bazat e bashkëpunimit të tanishëm sovje-

to-amerikan që realizuan Brezhnjevi dhe shokët e tij. Këta hiqen sikur mbështeten te Lenini për shitjen e lëndës së parë dhe koncesionet që u japin kapitalistëve amerikanë. Që këtu kemi të bëjmë me një shtrembërim të ideve të Leninit dhe të qëndrimit të tij ndaj imperializmit amerikan, kjo duket sheshit. Por revizionistët nuk turpërohen nga shtrembërime të tilla. Një deformim më shumë ose më pak i leninizmit tani nuk përbën më ndonjë shqetësim për ata që e kanë përmbysur të tërë. Por krerët e Kremlinit citojnë nga ndonjë tezë të Leninit për të mbuluar e për të legalizuar tradhtinë e tyre. Është e vërtetë se Lenini ka folur për tregtinë me kapitalistët, por në një kuptim krejt tjetër, e. për më shumë, për një qëllim krejt të ndryshëm nga ajo që i japin tani revizionistët bashkëpunimit sovjeto-amerikan. Lenini ishte për një tregti e cila duhej t'i shërbente revolucionit dhe ta mbronte atë, të ndihmonte në thyerjen e bllokadës që e tërë bota imperialiste e atëhershme kishte vendosur kundër shtetit të parë socialist. Ai e shikonte atë si një mjet për të përçarë bllokun intervencionist të vendeve imperialiste, për krijimin e kontradiktave të reja në botën kapitaliste dhe shfrytëzimin e të vjetrave. Parimi i Leninit në gjithë këtë çështje ishte: «Në bëjmë tregti, por nuk bëjmë lëshime politike e ideologjike, nuk heqim dorë nga revolucionit, nuk heqim dorë nga solidariteti dhe përkrahja e lëvizjes revolucionare». Qëndrimi i Leninit ndaj imperializmit amerikan ishte thellësisht parimor e konsekuent dhe sado përpjekje që të bëjnë udhëheqësit e sotëm revizionistë të Bashkimit Sovjetik, ata nuk mund ta shtrembërojnë e ta interpretojnë si të duan.

Lenini ka thënë se nga çdo dollar amerikan rrjedh gjak dhe ka qenë i pari që ka vënë në dukje me një mprehtësi të pashoqe karakterin agresiv e grabitqar të imperializmit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Më se një herë gjatë veprimtarisë së tij revolucionare ai pati bërë thirrje për vigjilencë e për luftë pa kompromis kundër imperializmit më të madh e më të rrezikshëm që kishte njohur historia botërore.

Lenini ka qenë kundër diplomacisë së fshehtë, të cilën ai e denoncoi dhe e demaskoi si një nga metodat më të urryera që përdor borgjezia për të fshehur veprimet e saj reaksionare kundër lirisë e sovranitetit të popujve. Rikthimi i sundesve revizionistë sovjetikë te diplomacia borgjeze është një provë tjetër që tregon sa janë larguar ata nga Lenini e leninizmi.

Tani revizionistët sovjetikë, pasi u vunë kazmën trashëgimisë teorike dhe veprës revolucionare të Leninit e të Stalinit, arritën deri atje sa t'i falen dollarit dhe t'i shesin tapitë e tokave sovjetike ashtu si mbretërit e Orientit ua lëshojnë tokat e tyre për shfrytëzim trustee kapitaliste.

Vetë Brezhnjevi, në lutjet që u bënte afaristëve amerikanë për të investuar sa më shumë në Bashkimin Sovjetik, dhe pas tij e tërë propaganda sovjetike mundohen të vërtetojnë se nga bashkëpunimi politik e ekonomik sovjeto-amerikan të dy vendet përfitojnë në mënyrë të barabartë dhe se asnjëri nuk ka mundësi të krijojë ndonjë epërsi ndaj tjetrit. Po nuk kërkohet ndonjë analizë e thellë për të parë se në marrëveshjet sovjeto-amerikane, lë nënshkruara tani së fundi, Shtetet e Bashkuara të Amerikës fitojnë më shumë në të

gjitha fushat. Përmbi të gjitha, Amerika konservon dhe shton forcat goditëse, asaj iu hapën të gjitha dyert për të shfrytëzuar nga ana ekonomike Bashkimin Sovjetik. Imperialistët amerikanë fitojnë më shumë jo vetëm sepse investojnë këtu kapitalet e tyre, por edhe pse bëhen edhe arbitra për të gjykuar se deri ku duhet të zhvillohet në ekonomi Bashkimi Sovjetik, cila degë e saj duhet përkrahur dhe cila duhet dekurajuar.

Por, mbi të gjitha, amerikanët futin influencën e ideologjinë e tyre, dhe kjo është fitorja kryesore në këtë pazarllëk të madh. Këtu vlen të përmendet se kjo përrulje e revizionistëve sovjetikë ndodh në një kohë kur në shumë vende kapitaliste, qofshin këto të Amerikës Latine ose të Evropës, vihet re një ngritje e valës antiamerikane dhe një kundërshtim më i madh ndaj imperializmit amerikan. Ndërkaq, të ashtuquajturit komunistë sovjetikë në këtë qëndrim i rrinë larg edhe Dë Golit, i cili e kishte kuptuar rrezikun e infiltrimit të kapitalit amerikan dhe, në kohën e vet, e sfidoi hapur atë.

Hyrja e kapitaleve dhe zgjerimi i influencës amerikane në Bashkimin Sovjetik do të krijojnë një situatë të re edhe për marrëdhëniet e tij me aleatët e vet. Aktualisht Bashkimi Sovjetik është vetë i falimentuar dhe nuk i ndihmon dot sa duhet ata. Por këtej e tutje do t'i ndihmojë akoma më pak. Përpara popujve të këtyre vendeve mbeten dy rrugë, ose të ngrihen në luftë kundër socialimperializmit dhe klikave revizioniste në vendet e tyre për të marrë pushtetin në duart e veta, ose të dorëzohen dhe të pranojnë zgjedhën e dyfishtë të socialimperializmit dhe të imperializmit amerikan.

Procesi i pandalshëm i afrimit e i bashkëpunimit



sovjeto-amerikan, koordinimi gjithnjë e më i madh i veprimtarisë kundërrevolucionare të të dyja superfuqive, marrja nëpër këmbë gjithnjë e më shumë e intereseve të popujve dhe përfshirja gjithnjë e më tepër e objektivave të rinj drejt të cilëve ata shtojnë aksionet e tyre ekspansioniste e hegjemoniste, vërtetojnë edhe një herë në praktikë drejtësinë e tezës dhe qëndrimet revolucionare të Partisë së Punës të Shqipërisë, të cilat u theksuan edhe në Kongresin e saj të 6-të, se duhen luftuar e demaskuar njësoj si imperializmi amerikan, ashtu edhe socialimperializmi sovjetik, pasi që të dy janë dinakë dhe që të dy janë të rrezikshëm. Koha vërteton se, me gjithë kontradiktat, rivalitetet e konkurrencat e pashmangshme që kanë midis tyre, tani Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimi Sovjetik janë radhitur në një front të bashkuar kundër popujve, përkrahin dhe nxitin njëri-tjetrin në qëllimet e tyre grabitqare e agresive. Si njëri edhe tjetri kanë një fytyrë, ata janë armiq të betuar të revolucionit e të popujve, si njëri, ashtu edhe tjetri punojnë e luftojnë për mbytjen e socializmit. Prandaj në këtë situatë lufta në dy frontet, si kundër njërit, ashtu edhe tjetrit imperializëm, mbetet një nga kushtet themelore për t'i bërë ballë presionit të aleancës së tyre kundërrevolucionare, për të kundërshtuar manovrat e tyre djallëzore dhe për të fituar mbi planet e tyre agresive.

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 154 (7760), 29 qershor 1973*

*Botohet sipas librit: Enver Hoxha, «Kundër revizionizmit modern» (Përmbledhje veprash) 1971-1975, f. 396*

**TREGUESIT**



**A**

*Aleanca, marrëveshjet dhe rivaliteti sovjetiko-amerikan* — 239, 249, 250, 254, 255, 256-257, 263, 265-266, 283-284, 410-417, 420-422.

*Aristokracia e klasës punëtore* — 158-159.

*Armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm; lufta kundër tyre* — 38-40, 98-99, 155-156, 254, 281-282, 286, 375-377, 379.

*Arsimi në RPSH*

— revolucionarizimi i mëtejshëm i shkollës; forcimi i disiplinës; lufta kundër shfaqjeve të huaja në shkollë — 47-48, 183, 324-326;

— nxënësit, studentët; roli i shkollës në edukimin e tyre — 15-16, 47, 183-184, 325, 326.

*Arti dhe letërsia botërore*

— arti demokratik përparimtar — qëndrimi marksist-leninist ndaj tij — 65, 66, 67, 301;

— arti dekadent, shkollat

dhe rrymat moderniste; kritika dhe lufta kundër tyre — 62-64, 65-66, 290, 291, 300-301.

**B**

*Bashkimet Profesionale të Shqipërisë* — gjallërimi; roli dhe detyrat e tyre në edukimin dhe në mobilizimin e punonjësve — 152-153, 346-348; — Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale dhe aparati i tij — 148-152.

*Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë* — gjallërimi, revolucionarizimi i organizatave të rinisë — 48-49, 135-136, 326-328, 329-331, 357-358;

— roli udhëheqës i Partisë në organizatën e rinisë — 49-50, 330;

— roli i tij në edukimin komunist të rinisë; lufta kundër shfaqjeve të huaja në radhët e saj — 9, 10-11, 16, 48-49, 50-51, 83-84, 95-96, 134-137, 162-

- 163, 181, 184, 328-329, 330-331, 357-359;
- rinia punëtore — 79-80, 82, 95-96;
- organizatat e rinisë në shkollë; rinia shkollore — 325-326, 327.
- Bashkimi Sovjetik, revizionizmi sovjetik; politika e jashtme e socialimperializmit sovjetik**
- 190-191, 194-195, 196, 197, 202, 236-237, 239-240, 248-249, 250, 253-254, 255, 256-258, 259, 263, 265, 271, 280, 282-284, 355, 410-422;
- revizionistët sovjetikë tradhtarë të marksizëm-leninizmit. Degjenerimi kapitalist i Bashkimit Sovjetik, lufta e grupeve për pushtet — 248-249, 261-262, 285, 379, 418-420, 421;
- rritja e urrejtjes dhe e kundërshtimit të popujve sovjetikë kundër klikës revizioniste Brezhnjev-Kosigin — 196, 260, 261, 263-264;
- qëndrimi armiqësor kundër Shqipërisë — 201-202, 236-237, 240, 243.
- Bindja — metodë kryesore në fushën e edukimit; harmonizimi i bindjes me masa administrative** — 33-37, 46-47, 127-128, 180, 347, 361-362.

**Bujqësia dhe blegtoria — rritja e prodhimeve bujqësore e blegtorale** — 46, 138, 140.

## D

- Demokracia proletare dhe centralizmi demokratik; lufta kundër shtrembërimit të demokracisë** — 47, 55-56, 172, 317, 338, 339-340.
- Disiplina proletare dhe lufta kundër qëndrimeve të huaja ndaj saj** — 36, 159-164, 345-346;
- disiplina e punës — 45, 46, 54-55, 79, 86-87, 125-127, 338-340;
- disiplina e planit dhe ajo financiare — 45, 335-336, 338-340, 343-344.

## E

- Edukimi komunist; puna me njerëzit** — 58, 124, 178-179, 207, 280, 313, 315, 320, 347, 361, 362, 373-374.
- Ekonomia — drejtimi dhe administrimi i ekonomisë; lufta kundër shfaqjeve të liberalizmit në ekonomi** — 44-45, 80, 332-336, 337-340, 343-345.
- Enver Hoxha — të dhëna autobiografike** — 8-9, 12, 14-15, 16-17, 19-20, 22-23, 101-103, 107-108, 109-110, 137-138, 210-211, 219, 225.

*E reja dhe e vjetra; lufta për fitoren e së resë — 297-298, 302.*

## F

*Faktori i brendshëm dhe faktori i jashtëm; roli i tyre në jetën e shoqërisë — 227, 244.*

*Familja — krijimi i familjes së re socialiste dhe roli i saj në edukimin e brezit të ri — 22, 123, 176, 181-183.*

*Feja; lufta kundër shfaqjeve të saj — 89-90, 219.*

*Folklori — 60-61, 294.*

*Fondet monetare dhe valutore; përdorimi me efektivitet i tyre — 333, 335-336, 344-345.*

## G

*Gruaja dhe Bashkimi i Grave të Shqipërisë; politika e Partisë për emancipimin e gruas — 130-131, 211-213, 214.*

## GJ

*Gjykata e Lartë; gjykatat popullore dhe gjyqtarët — 127, 175, 184-187.*

## II

*Heroizmi, heronjtë, dëshmorët; vepra heroike — 5-6, 7, 9-10, 13-14, 18-19, 193.*

*Hetimi, hetuesit — 156, 187.*

*Historia e Shqipërisë*

- luftërat e popullit shqiptar nën udhëheqjen e Skënderbeut kundër pushtuesve osmanë — 198;
- Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë (28 Nëntor 1912) — 242-243.

## I

*Ideologjia borgjeze e revizioniste; lufta kundër mbeturinave dhe ndikimeve të saj — 277-278, 279-282, 286-288, 292-293, 313-314, 366-367.*

*Ideologjia socialiste — edukimi i masave me ideologjinë socialiste — 279-282.*

*Indiferentizmi; lufta kundër tij — 129-130, 319-320.*

*Industria*

- industria minerale — 82-83, 89;
- industria metalurgjike, metalurgët — 80-81, 82-83, 84-85, 88-89, 90-91, 92-93, 94-95, 96, 97, 105-106;
- industria mekanike — 1-2, 81, 93, 344;
- industria e drurit — zhvillimi i saj — 112-121, 124-125.

*Iniciativat, lëvizjet dhe aksionet revolucionare — 278-279, 318.*

*Interesi i përgjithshëm dhe interesi vetjak, lokal e dikasterial* — 56, 81-82, 87, 92, 120, 126, 317-318, 335-336.  
*Internacionalizmi proletar* — 190, 252, 253-254, 271, 272.

## J

*Jetesa, mënyra e jetesës — kuptimi marksist-leninist i saj; lufta kundër shfaqjeve të mënyrës borgjeze të jetesës* — 92, 313-314, 316-319.

*Jugosllavia, revizionizmi jugosllav — degjenerimi revizionist i partisë dhe i jetës së vendit; politika e jashtme e RSFJ* — 86, 197, 202-203, 233, 251, 378-379;

— qëndrimi armiqësor kundër Shqipërisë — 233-234.

## K

*Kamboxia, lufta e popullit kamboxhian për liri e pavarësi* — 189-190, 191-192, 193, 194-195, 200-201, 227-228, 237, 243-245, 246-248, 250, 251, 252, 255, 269, 270, 271-273.

*Kapitalizmi — kontradiktat ndërkapitaliste; shtypja, shfrytëzimi dhe varfërimi i masave punonjëse* — 91-92, 131, 136, 159, 186, 287, 299, 417, 421.

*Këshillat popullorë, komitetet ekzekutive dhe aparatet e tyre*

— 31-33, 143, 144-145, 147, 161-162, 164, 336.

*Këshilli i Ministrave (Qeveria)* — 147, 164, 171, 206, 212, 234-235, 336, 338, 343, 344, 372.

*Klasa punëtore — cilësitë, roli udhëheqës dhe pjesëmarrja e saj në ndërtimin socialist të vendit* — 79-80, 86-87, 91, 337, 340-341;

— edukimi ideopolitik dhe kualifikimi profesional; lufta kundër shfaqjeve të huaja në radhët e saj — 81-82, 93-96, 115-116, 120-121, 127, 337, 346-347.

*Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale* — 184, 186, 187.

*Komunisti; edukimi, rritja e rolit militant; lufta kundër shfaqjeve të huaja* — 52, 53-54, 56-57, 66, 69, 122, 310, 353-355, 359.

*Konservatorizmi, patriarkalizmi dhe lufta kundër shfaqjeve të tyre* — 22-23, 281, 292, 293, 301-302, 328, 363, 388-391.

*Kontrolli i Partisë, i shtetit, i klasës punëtore dhe i masave punonjëse* — 31-32, 160-161, 333-334, 340-341, 342.

*Kooperativat bujqësore, Oborri kooperativist* — 34-35, 45.

*Krimet — shkaqet, rrezikshmëria, parandalimi dhe dënimi i tyre* — 175-188.

*Kritika dhe autokritika* — 128-129, 162, 348.

*Kuadrot — roli dhe vendi i tyre në shoqëri; edukimi komunist dhe lufta kundër shfaqjeve të liberalizmit në radhët e tyre* — 158-165, 168-169, 345, 355-356;

— politika e Partisë me kuadrin; përgatitja dhe kualifikimi i tyre — 206-207, 355-356;

— kompetencat, metoda dhe stili në punë — 31-32, 159-167, 168-169, 206, 345, 355-356;

— lidhjet kuadër-masë; kontrolli mbi kuadrot, puna në prodhim dhe qarkullimi i tyre — 121, 141-147, 159, 356, 357;

— kuadrot e Partisë — 165-166.

*Kultura; institucionet kulturore artistike* — 315-316, 318-319, 400-401.

## L

*Laosi — lufta e popullit laosian kundër imperializmit amerikan dhe tradhtarëve të vendit* — 226-228, 229-230, 231-232, 238-239, 252-253, 274.

*Lenin, Vladimir Iliç* — 91-92, 105, 230, 339, 375, 418-420.

*Letërsia dhe artet në RPSH — zhvillimi i tyre* — 58-59, 68-69, 288-289, 295-296, 311-312, 401-402;

— roli udhëheqës i Partisë në to — 67, 401;

— metoda e realizmit socialist, parimet e saj; partishmëria proletare — 289, 304;

— fryma kombëtare e popullore dhe brendia socialiste; tradita dhe novatorizmi — 289, 293-300, 304, 400;

— kritika letraro-artistike; puna kërkimore shkencore në letërsi dhe art — 62-63, 72, 73-74, 76, 296-297, 303-304;

— pasqyrimi i realitetit, trajtimi i kontradiktave dhe i heroit në letërsi dhe art — 290-291, 304-305;

— poezia, proza, drama — 291, 295-296;

— muzika, artet figurative — 291-292, 293-294, 296;

— lufta kundër shfaqjeve të liberalizmit, dekadentizmit, konservatorizmit dhe shfaqjeve të tjera të huaja në letërsi dhe art — 59-65, 66, 68, 289-295, 297-299, 302, 305-309, 381-382, 383, 393-394, 398, 399-400, 402-403;



- shkrimtarët dhe artistët. Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve — 62, 67-68, 289, 307, 308-311, 312.
- Liberalizmi dhe lufta kundër shfaqjeve të tij* — 27-30, 36-37, 38, 51, 52, 125, 153-154, 185-186, 281, 285-286, 292-293, 294-295, 301, 317, 319, 320, 331, 336, 341, 350, 363, 388-389, 390, 391.
- Ligjet ekonomike* — njohja dhe përdorimi i tyre — 333-334.
- Ligjet, ligjshmëria në RPSH* — njohja dhe zbatimi i tyre — 159-160, 163, 164-165, 166, 180, 342, 347.
- Lindja e Mesme* — marrëveshjet dhe ndërhyrjet sovjetiko-amerikane në këtë rajon — 190-191, 250, 266, 282, 415-417.
- Literatura e huaj* — qëndrimi dhe vigjilencia në përdorimin e saj — 42, 171-172, 344-345.
- Lufta Antifashiste Nacional-çlirimtare e popullit shqiptar* — përvoja, mësimet dhe rëndësia — 105, 198-199, 231, 233, 234-235, 245-246.
- Lufta e klasave në shoqërinë tonë socialiste* — 92, 341, 364-366, 374;
- lufta e klasave në frontin ideologjik — 59-60, 279-282, 287-288, 313-314, 320;
- lufta kundër oportunizmit në zhvillimin e luftës së klasave — 43, 363, 364-365.
- Luftërat çlirimtare dhe revolucionare të popujve* — 227, 415.

## M

- Marksizëm-leninizmi* — busulli dhe udhëheqje për veprim; njohja dhe zbatimi i tij — 33, 105, 200, 375, 400, 419-420.
- Marks, Karl* — 105, 158, 200, 270-271, 375, 378.
- Mbështetja në forcat e veta* — 244, 342-345.
- Mbrojtja e atdheut; përgatitja e popullit dhe e vendit për mbrojtje* — 38, 364-365.
- Mendjemadhësia* — 62.
- Metoda dhe stili në punë* — 26, 29-30, 32-33, 165-166, 366-367, 371.
- Ministritë* — funksionet e kompetencat e tyre — 334, 336, 337-338;
- Ministria e Punëve të Brendshme — 161;
- Komisioni i Planit të Shtetit — 334;
- Ministria e Financave — 334;
- Ministria e Industrisë dhe e Minierave — 336;

— Ministria e Arsimit dhe e Kulturës — 47, 308, 325.

## N

*Ndërgjegjja socialiste* — 121-122, 157, 207, 362.

*Ndërmarrjet socialiste — forcimi i tyre* — 45, 162-163, 164, 333-334, 335, 336.

*Ndërtimet, ndërtuesit. Politika e Partisë në fushën e ndërtimit* — 4, 96-97, 118-119, 205-206.

*Ndërtimi i socializmit në Shqipëri — politika e Partisë për ndërtimin socialist të vendit* — 91, 94, 207, 312-313, 334-335, 342.

*Ndëshkimi (dënimi) penal. Dënimi me kusht* — 37, 184-185.

*Normimi i punës, normat teknike* — 46, 112-114, 163-164, 337-338.

## O

*Opinionit shoqëror — forcimi i tij në luftë kundër indiferentizmit* — 57-58, 176-177, 291, 303, 314, 319-320, 371.

*Oportunizmi; lufta kundër tij* — 43, 375-379, 382, 387-388.

*Organet e Punëve të Brendshme* — 161, 173-174.

*Organizata-bazë e Partisë* — roli udhëheqës dhe lufta kundër shfaqjeve të libe-

ralizmit — 51-52, 350-352;

— mbledhjet, vendimet dhe detyrat e organizatës-bazë. Kërkesa e llogarisë dhe dhënia llogari — 52, 53, 54, 165-166, 352-353;

— organizatat-bazë të Partisë në institucione kulturore-artistike dhe arsimore — 51, 66-67, 309-310, 350-351.

*Organizata e Kombeve të Bashkuara; manipulimi i saj nga superfuqitë. Qëndrimi parimor i RPSH* — 39, 192, 250-251, 273-274.

*Organizatat e masave — roli udhëheqës i Partisë, gjallërimi i tyre* — 357-359.

## P

*Pacifizmi borgjez; demagogjia e superfuqive për uljen e tensionit* — 254, 282-283.

*Pagat, shpërblimi i punës* — 337-338.

*Partia e Punës e Shqipërisë — vija, vendimet, jeta e brendshme*

— karakteristikat marksiste-leniniste revolucionare — 298, 349, 373-375, 379-380;

— roli udhëheqës i Partisë — 21-22, 28-30, 53, 124, 359-360, 395;

- vija e përgjithshme, vendime e direktiva; njohja dhe zbatimi i tyre — 26-27, 30-31, 33-37, 97, 99-100, 160, 169, 214, 349-351, 352, 359-360, 361, 362, 363-364, 371-372, 373-378;
  - Statuti, parimet dhe normat e Partisë — njohja dhe zbatimi i tyre — 52, 66, 157-158, 163, 164-165, 310, 352, 370-371, 372;
  - uniteti në Parti; lidhjet e Partisë me masat, vija e masave në Parti — 26-27, 28-30, 97-98, 99, 103-104, 370-371, 372;
  - puna e Partisë dhe përmbytja e saj; kapja pas hallkës kryesore — 58, 166, 361-362;
  - qëndrimi klasor ndaj të metave e gabimeve, lufta kundër shfaqjeve të liberalizmit në Parti — 26-28, 32-33, 128-130, 162, 165-166, 218-219, 310, 349, 350, 353;
  - lufta kundër veprimtarisë armiqësore antiparti të F. Paçramit, T. Lubonjës dhe elementëve të tjerë armiq në Parti — 59-62, 307-308, 322-323, 368-370, 372-373, 375-377, 380-409.
- Partia e Punës e Shqipërisë* —
- organet udhëheqëse qendrore dhe aparati i KQ*
- Kongresi i 6-të i PPSH (1-7 nëntor 1971) — 280-281, 422;
  - Komiteti Qendror, Byroja Politike, Sekretariati i KQ — 29-30, 47, 49, 97-98, 171, 212, 213, 214, 276, 323, 330, 338, 343, 357, 369, 371, 372-373, 406;
  - Plenumi i 15-të i KQ të PPSH (25-26 tetor 1965) — 59, 69, 289;
  - Plenumi i 3-të i KQ të PPSH (5-6 shkurt 1973) — 28-29;
  - Plenumi i 4-të i KQ të PPSH (26-28 qershor 1973) — 26, 29-30, 275-276, 277-367, 368-409;
  - aparati i Komitetit Qendror — 306, 307, 363-364.
- Partia e Punës e Shqipërisë* —
- organizatat dhe komitetet e Partisë në rrethe* — 31-33, 160-162, 173-174, 306, 315, 357-358, 361;
- Komiteti i Partisë i Rrethit të Sarandës — 161-162;
  - organizata dhe Komiteti i Partisë i Rrethit të Elbasanit — 25, 27, 31-32, 69-70, 97;
  - organizata dhe Komiteti i

- Partisë i Rrethit të Tiranës — 306-307, 405.
- Partia e Punës e Shqipërisë* — përvoja dhe masat për të çuar përpara revolucionin e ndërtimin e socializmit dhe për të prerë rrugën revizionizmit në Shqipëri — 158-159, 280, 284-285, 287-288, 373-378.
- Patriotizmi, edukimi patriotik* — 122-123.
- Planifikimi* — realizimi i planeve në sasi, cilësi dhe asortiment; lufta kundër shfaqjeve të huaja në këto drejtime — 338-339, 343, 348-349.
- Politika e jashtme e RPSH*
- parimet themelore marksiste-leniniste të politikës së jashtme. Rritja e presigjit dhe e autoritetit të RPSH në botë — 21, 192-193, 195, 199, 234-235, 240-241, 244, 254, 255;
  - marrëdhëniet me RP të Kinës — 250, 260, 272, 276;
  - marrëdhëniet dhe përkrahja internacionaliste për popujt e Indokinës — 189-190, 191, 192, 194, 197, 199, 201, 226, 227, 229-230, 237, 238, 246-247, 250-251, 255, 263-274;
  - lufta kundër imperializmit, revizionizmit dhe reaksionit — 72-73, 75, 202, 235-236, 243, 249, 253-254, 266-267, 281, 422.
- Politika në plan të parë, vështrimi i problemeve me syrin politik* — 122-123, 167, 335, 336.
- Populli shqiptar* — virtytet moralo-politike, traditat patriotike, përparimet e revolucionare — 6-7, 209-210, 299; — pjesëmarrja dhe roli vendimtar i tij në ndërtimin socialist të vendit — 98, 210, 213-215.
- Prona socialiste* — mbrojtja dhe forcimi i saj — 119-120, 341-342.
- Propaganda, agjitacioni* — 43, 53, 120, 170, 178-179, 322.
- Propaganda borgjezo-revizioniste* — 257, 264-265, 287, 301, 418.
- Psikologjia mikroborgjeze, lufta kundër mbeturinave të saj* — 44-46, 360-361.
- Puna* — qëndrimi socialist dhe lufta kundër shfaqjeve të huaja ndaj saj — 45, 125-126, 333.

## R

- Radiotelevizioni shqiptar* — 170-171, 320, 322-324, 404.
- Regjimi i kursimit* — 117-118, 119-120.
- Revolucionarizimi i Partisë dhe i jetës së vendit* — 275-276, 277-279, 280-281, 318-320.

*Revolucioni proletar — strategjia dhe taktikat, roli udhëheqës i partisë marksiste-leniniste në revolucion — 230-231.*

232, 234-236, 272-273.

*Rinia — Shih: Bashkimi i Rinisë së Punës të Shqipërisë...*

## RR

*Rrethimi, bllokada e presioni imperialisto-revizionist dhe lufta për përballimin dhe çarjen e tyre — 37-42, 169-170, 275, 281-282, 283, 284-285, 286-288, 289-290, 299, 333.*

## S

*Sportet — rritja e nivelit të tyre — 172-173.*

*Stalin, Josif Visarionoviç — 201, 227, 233, 285, 375, 418, 420.*

*Superfuqitë — Shih: Aleanca, marrëveshjet dhe rivaliteti sovjetiko-amerikan.*

## SII

*Shfaqjet e huaja dhe lufta kundër tyre — 40, 57-58, 98, 99, 157, 170, 173-174, 275, 277-278, 288, 313-314, 316-317, 319-320, 348.*

*Shijet — formimi i shijeve të shëndosha ideoestetike marksiste-leniniste — 314-315.*

*Shqiptarët e mërguar dhe të huajt që vizitojnë Shqipërinë; qëndrimi ndaj tyre — 41-42, 172.*

*Shtetet e Bashkuara të Amerikës — politika e jashtme, strategjia dhe taktikat, politika e luftës dhe e agresionit — 190-191, 194-195, 196-197, 247, 248, 249, 250, 253-254, 255, 256, 258-260, 261, 282-284, 410-417, 420-422;*

— lufta kundër popujve të Indokinës dhe disfatat e tyre në këtë rajon — 227-228, 230, 231-232, 238, 239, 247, 248, 263, 271-272;

— qëndrimi armiqësor kundër Shqipërisë — 235, 236, 247.

*Shtypi, botimet; lufta kundër shfaqjeve të liberalizmit në to — 170, 320-321.*

## T

*Tregtia e brendshme; furnizimi i popullsisë — 3, 85-86.*

## U

*Uji, uji i pijshëm; sigurimi, vlera dhe përdorimi i tij — 209, 210-211, 215, 216-218, 219.*

*Uniteti i popullit, uniteti Partitë-popull — 198-199, 213-215, 218-219, 278-279, 362, 399.*

*Ushtria Popullore, kuadrot e ushtrisë — lufta kundër shfaqjeve të liberalizmit — 167-168.*

## V

*Vendet revizioniste — degjenerimi kapitalist dhe kontradiktat ndërmjet tyre — 195-196, 262-263, 280, 417, 421.*

*Vietnami — lufta e popullit*

*vietnamez për liri e pavarësi — 194, 227-228, 237-238, 246-247, 252-253, 265, 282.*

*Vigjilenca revolucionare — 9, 38, 40-43, 92, 98-99, 275, 278, 282, 365-366.*

*Vija e masave — 26-27, 276, 278, 366, 367, 370-371, 382.*

## Z

*Zakonet prapanike dhe lufta kundër tyre — 211-212, 388.*



## TREGUESI I EMRAVE

### A

- Alia, Ramiz — 3, 59, 381.  
Asllani, Muho — 220.  
Agolli, Dritëro — 295-296.  
Aleksandri i Madh — 198.  
Andropov, Juri — 261.

### B

- Bekteshi, Mehmet — 87, 88.  
Belishova, Liri — 74, 376, 377,  
406.  
Bishja, Mustafa — 216-217.  
Boçi, Kosta — 139.  
Brezhnjev, Leonid — 195, 236,  
239, 248-249, 256-257, 259,  
261, 262, 263, 264, 411, 414-  
415, 416, 417-418, 419, 420.

### C

- Cafi, Sait — 216, 217-218, 219.  
Cufi, Col — 217.

### Ç

- Çeliku, Hajredin — 84.  
Çaushesku, Nikolae — 193.  
Çeka, Hava — 107, 110.

- Çeka, Ramë — 110.  
Çeka, Selime — 107, 108-109,  
110.  
Çeka, Sherif — 107, 108-109,  
110.  
Çomo, Maço — 74.

### D

- Daija, Tish — 296.  
Dë Gol, Sharl — 421.  
Dibra, Enver — 204, 205.  
Dika, Haki — 17.  
Disha, Abaz — 109-110, 137-  
-138.  
Disha, Ali — 108, 109, 137, 140.  
Disha, Raife — 140.  
Disha, Selime — 109.  
Disha, Zenel — 109, 110, 138.  
Dishnica, Esat — 8.  
Dyrnishi, Tare — 103.

### G

- Godar, Zhysten — 22.  
Greçko, Andrei — 261.  
Gromiko, Andrei — 261.  
Gugu, Arqile — 111, 112, 114,  
115.



## GJ

- Gjata, Fatmir — 296.  
Gjebero, Veiz — 78, 84.

## H

- Hoxha, Nexhmije — 19, 20,  
222, 224, 225.  
Hoxha, Ilir — 15.  
Hrushov, Nikita — 240, 261,  
262.

## I

- Ibrahimi, Feim — 296.

## J

- Jero, Minush — 404.

## K

- Kapo, Hysni — 371, 381, 384.  
Koleka, Spiro — 215.  
Kadare, Ismail — 71, 72, 73,  
74, 75-77, 296.  
Karoli, Marko — 2, 3.  
Kasatanov, V. A. — 243.  
Koçllari, Fuat — 78, 79.  
Kosigin, Aleksei — 239, 262.  
Kristo, Pandi — 376.  
Kroi, Haxhi — 108.  
Kumbaro, Hajredin — 84.

## L

- Laçi, Vasil — 5-7, 8-9, 10, 11.  
Laçi, Vitori — 5, 7, 10, 11, 12.  
Leonardo da Vinçi — 65.  
Loli, Kasjani — 22.

- Lon Nol — 199, 201, 232, 237,  
244, 252, 269, 270.  
Luarasi, Mihallaq — 404.  
Lubonja, Todi — 59, 308, 322-  
-323, 368-370, 372-373, 380,  
381, 382, 383, 390, 398, 402,  
403-408.  
Lula, Anastas — 376.

## M

- Marko, Rita — 148, 152.  
Myftiu, Manush — 381.  
Murra, Prokop — 220, 222, 224.  
Madhi, Guri — 296.  
Malëshova, Sejfulla — 376, 377,  
397.  
Menzelxhiu, Jashar — 25, 85,  
101, 102, 108, 114, 132, 139.  
Mero, Agim — 48, 327, 403.  
Mikelanxhelo Buonaroti — 65.  
Muço, Sylo — 222-223, 225.  
Musai, File — 101, 103, 104-105,  
106.  
Musai, Kadri — 102, 105.  
Musai, Zylfie — 101, 102, 106.  
Musaraj, Shevqet — 295.

## N

- Nguyen Van Thieu — 194, 238,  
265, 271, 272.  
Nikson, Riçard — 239, 248, 257,  
263, 264, 265, 410, 411, 416,  
417.

## P

- Paçrami, Fadil — 59, 61, 64,  
304, 307-308, 323, 368-370,

Kongo — 414.  
 Kongresi i 9-të i Bashkimeve  
 Profesionale të Shqipërisë —  
 (6-9 qershor 1982) — 149.  
 Kongresi i 7-të i Bashkimit të  
 Grave të Shqipërisë (11-14  
 qershor 1973) — 212-213.  
 Koplík (Shkodër) — 209-210,  
 216, 220.  
 Korçë — 36, 335, 404.  
 Kore — 413.  
 Krujë — 193.  
 Kubë — 413.

## L

Labintot (Elbasan) — 110.  
 Lufta e Dytë Botërore — 192-  
 -199.  
 «Luftëtari» (gazeta ~) — 163.  
 Lunxhëri (Gjirokastër) — 224.

## M

Marrëveshja e Parisit — 252.  
 Mbishkodër (zona ~) — 209-  
 -210, 211, 212, 215.  
 Merilend (Shtetet e Bashkuar-  
 ra të Amerikës) — 265.  
 Mesdhe (zona ~) — 197.  
 «Mes njerëzve të thjeshtë» —  
 Kujtime (E. Hoxha, libri ~)  
 — 102.

## N

NATO (Pakti i Atlantikut Ve-  
 rior) — 263, 417.

Ndërmarrja Bujqësore — El-  
 basan — 134-135, 137, 138-140.  
 Ndërmarrja Bujqësore «8  
 Nëntori» — Sukth—Durrës —  
 138.  
 Ndërmarrja e Sharrave — El-  
 basan — 114.  
 «Nëntori» (revista ~) — 321.  
 Norvegji — 239.

## NJ

«Një ngjarje në fabrikë» (dra-  
 ma ~, F. Paçrami) — 399-  
 -400.

## P

Palestinë — 266.  
 Piqeras (Sarandë) — 10, 12.  
 Pnom-Pen — 241, 248.  
 Poloni — 262.  
 Presidiumi i Kuvendit Popu-  
 llor të RPSH — 175.

## R

Revolucioni i Madh Socialist  
 i Tetorit — 418.  
 Rilindja Kombëtare — 295.  
 Rilindja në Evropë — 65.  
 Rumani — 193.

## S

Santo-Domingo — 413.  
 Siberi (Bashkimi Sovjetik) —  
 239, 258.  
 Skandali i Uotergejtit — 239,  
 263.

Sopot (Gjirokastër) — 211.

## SII

Shijak — 3.

Shkodër — 3, 212-213.

Shkolla (e artit) e Firences (Itali) — 65.

Shkumbin (lumi ~) — 139.

Shmil (Elbasan) — 107, 108, 109, 137.

Shtëpia botuese «Naim Frashëri» — 321.

«Shtëpia në bulevard» (drama ~, F. Paçrami) — 399.

## T

Tajlandë — 247, 248, 258, 272.

Tiranë — 19, 335.

Traktati i Varshavës — 195-196, 417.

## U

Universiteti i Tiranës (Universiteti i Tiranës «Enver Hoxha») — 47.

Ushtria e Kuqe — 227.

Uzina e Përpunimit të Thellë të Naftës — Ballsh—Fier — 85.

## V

Vatikan — 39-40, 193.

Vendet arabe — 196, 266.

Vlorë — 242, 243.

## Y

«Ylli» (revista ~) — 321.

## Z

«Zëri i popullit» (gazeta ~) — 404.

«Zëri i rinisë» (gazeta ~) — 321.

## L È N D A

PARATHËNIE PËR VËLLIMIN E 51-TË ..... V—IX

1973

SUKSESET ARRIHEN ME PUNË — Nga biseda me  
kuadro e drejtues të Partisë dhe të pushtetit të rre-  
thit të Durrësit (5 maj 1973) ..... 1—4

VASIL LAÇI — SIMBOL I GUXIMIT DHE I TRIMË-  
RIKË — Nga biseda në familjen e Heroit të Popullit  
Vasil Laçi (5 maj 1973) ..... 5—12

ADEM REKA MBI ÇDO GJË VINTE INTERESIN  
E PËRGJITHSHËM — Nga biseda në familjen e He-  
roit të Punës Socialiste Adem Reka (5 maj 1973) ..... 13—17

TË TRE DO TË MBETEN PISHTARË TË PASHUAR  
— Nga biseda në familjen e tre vëllezërve dëshmo-  
rë Thanasi (5 maj 1973) ..... 18—24

TË FORCOJMË FRYMËN REVOLUCIONARE DHE  
QËNDRIMIN VIGJILENT NË PUNË E NË JETË —  
Diskutim në mbledhjen e byrosë së Komitetit të Par-  
tisë të Rrethit të Elbasanit (15 maj 1973) ..... 25—70

KRIKAT DHE VËREJTJET PËR NJË VEPËR LE-  
TRARE DUHEN BËRË ME KUJDES E ME VEND  
DHE TË JENË SHOQËRORE — Disa mendime rreth  
romanit të Ismail Kadaresë «Dimri i vetmisë së ma-  
dhe» (15 maj 1973) ..... 71—77

- PUNËTORËT QË PO NDËRTOJNË KOMBINATIN METALURGIK JANË HEROIKË — Nga biseda me kuadro drejtues të Kombinatit Metalurgjik në Elbasan (16 maj 1973) ..... 73—87
- QË SHQIPËRIA TË RROJË NË SHEKUJ — Fjala në mitingun në Kombinatit Metalurgjik të Elbasanit (10 maj 1973) ..... 88—100
- TAKIMET DHE KËSHILLIMI ME POPULLIN JANË KURDOHERË TË DOMOSDOSHËM — Nga biseda në familjen e File Musait (16 maj 1973) ..... 101—106
- QOFSHI GJITHNJË TË LUMTUR E TË GËZUAR! — Nga biseda në familjen e Sherif Çekës (16 maj 1973) ..... 107—110
- ÇDONJËRI TE NE DUIET TË MENDOJË E TË PUNOJË SI MILITANT — Nga biseda me punëtorët e Kombinatit të Drurit në Elbasan (17 maj 1973) ..... 111—133
- TË REJAT E TË RINJTË JANË E ARDHMJA E AT-DHEUT — Nga biseda me një grup punonjësish të serreve të Ndërmarrjes Bujqësore të Elbasanit (17 maj 1973) ..... 134—140
- ORGANIZIMI EFEKTIV SIGURON MBARËVAJTJEN E PUNËS PRODHUESE — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 maj 1973) ..... 141—147
- ORGANIZIMI I BASHKIMEVE PROFESIONALE TË JETË SA MË MIRË NË FUNKSION TË DETYRËS SË TYRE KRYESORE — EDUKIMIT — Diskutim në mbledhjen e Sekretariatit të KQ të PPSH (19 maj 1973) ..... 148—154

- TË FORCOHEN PUNA DHE PROPAGANDA E PARTISË KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA — Diskutim në mbledhjen e Byrosë Politike të KQ të PPSH (21 maj 1973) ..... 155—174
- PUNA E PARTISË SYNON RRIJEN DHE FORCIMI E NJË SHOQËRIE GJITHNJË TË PASTËR E TË SHËNDETSHME — Diskutim në mbledhjen e Presidiumit të Kuvendit Popullor të RPSH (29 maj 1973) ..... 175—188
- FITORJA SIGUROHET KUR LUFTËS I SHKOHET DERI NË FUND — Nga biseda me Norodom Sihanukun (5 qershor 1973) ..... 189—199
- ÇËSHTJA E DREJTË MBROHET DUKE VEPRUAR ME GUXJM DHE HAPUR KUNDËR ARMIQVE — Nga biseda me Norodom Sihanukun (8 qershor 1973) ..... 200—203
- TE JU PARTIA SHEH JO VETËM NDËRTUESIN, POR EDHE NJERIUN ME NDËRGJEGJE TË LARTË SOCIALISTE — Nga biseda me punonjës e specialistë në Hidrocentralin e Vaut të Dejës (12 qershor 1973) ..... 204—208
- PËR SHËNDETTIN DHE LUMTURINË E POPULLIT TË MBISHKODRËS — Fjala në mitingun në Koplikun e Sipërm (13 qershor 1973) ..... 209—215
- POPULLI YNË MERITON LUMTURI MË TË MADHE — Nga biseda në sallën e shtëpisë së kulturës në Koplik (13 qershor 1973) ..... 216—221
- JETËN E POPULLIT E BËRI TË RE E TË BUKUR PARTIA — Nga biseda në shtëpinë e kooperativistit Sylo Muço në Koplik (13 qershor 1973) ..... 222—225

TAKTIKAT E NDËRTUARA MBI BAZËN E PARI-MEVE MARKSISTE-LENINISTE I SHËRBEJNË FITORES PËRFUNDIMTARE — Nga biseda me një delegacion të Frontit Patriotik të Laosit (18 qershor 1973) .....	236—241
KUR NJË POPULL MBRON ME VENDOSMËRI LIRINË E VET, INTRIGAT E ARMIQVE DËSHITOJNË — Nga biseda me Norodom Sihanukun (21 qershor 1973) .....	242—255
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I PK TË BASHKIMIT SOVJETIK BISEDON ME KREUN E IMPERIALIZMIT AMERIKAN — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (21 qershor 1973) .....	256—267
TAKIMET JANË TË NEVOJSHME PËR TË NJOHUR ME GJENDJEN E NJËRI-TJETRIT — Nga biseda me ambasadorin e RP të Kinës (23 qershor 1973) .....	268—276
TË THELLOJMË LUFTËN IDEOLOGJIKE KUNDËR SHFAQJEVE TË HUAJA E QËNDRIMEVE LIBERALE NDAJ TYRE — Raport në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH (26 qershor 1973) .....	277—367
ÇËSHTJA E POPULLIT DHE E PARTISË QËNDRON MBI TË GJITHA — Fjala e mbylljes në Plenumin e 4-t të KQ të PPSH (28 qershor 1973) .....	368—409
MARRËVESHJET E REJA SOVJETO-AMERIKANE — NJË SFIDË E RËNDË PËR TË GJITHË POPULLIT — Artikull i botuar në gazetën «Zëri i popullit» (29 qershor 1973) .....	410—422
Treguesi i lëndës .....	425
Treguesi i emrave .....	437
Treguesi gjeografik dhe i emërtimeve të tjera .....	441

-----  
Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1986